



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFIË

Disertacion me temë:

**HAPËSIRA PERIURBANE E SHKODRËS: PËRDORIMI
I TERRITORIT DHE VEÇORITË E ZHVILLIMIT
SOCIAL-EKONOMIK**

Doktoranti:

DRITAN RUSTJA

Udhëheqës shkencor:

Prof. dr. SABRI LAÇI

Tiranë, 2014

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË

DISERTACION

i paraqitur nga

MA. Dritan RUSTJA

në kërkim të gradës shkencore

DOKTOR

Drejtimi: *Gjeografi rurale*

Tema:

**HAPËSIRA PERIURBANE E SHKODRËS:
PËRDORIMI I TERRITORIT DHE
VEÇORITË E ZHVILLIMIT SOCIAL-EKONOMIK**

Udhëheqës shkencor:

Prof. dr. SABRI LAÇI

Mbrohet me datë _____ 2014, para **jurisë** së përbërë nga:

1. _____ Kryetar
2. _____ Anëtar oponent
3. _____ Anëtar oponent
4. _____ Anëtar
5. _____ Anëtar

Tiranë 2014

Lista e shkurtesave:

AKPT:	Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit
ALUIZNI:	Agjencia për Legalizmin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave dhe Ndërtimeve Informale
BE:	Bashkimi Europian
DBUSH:	Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Shkodër
FB:	Fshat i Bashkuar
HPU:	Hapësirë Periurbane
HPUSH:	Hapësira Periurbane e Shkodrës
IMO:	Instituti i Misrit dhe Orizit
INSTAT:	Instituti i Statistikave
KRRTRSH:	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
NB:	Ndërmarrje Bujqësore
OJF:	Organizatë Jofitimprurëse
OMP:	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit
PPV:	Plani i Përgjithshëm Vendor
QRTTB:	Qendra Rajonale e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore
UNDP:	United Nations Development Fund

PËRMBAJTJA

HYRJE	10
1. Përzgjedhja e temës dhe parashtrimi i problemit	10
2. Rëndësia e studimit dhe synimet kryesore	11
3. Pyetjet kërkimore dhe objektivat specifike	12
4. Metodologjia e punës kërkimore	13
5. Kufizimet në realizimin e studimit	16
6. Struktura e temës	17
Kapitulli I: HAPËSIRAT PERIURBANE NË BOTË DHE SHQIPËRI: NJË PËRMbledhje e literaturës	18
I.1. <i>Koncepte bazë mbi hapësirat periurbane: një vështrim teorik</i>	18
I.1.1. Çështje konceptuale	18
a) Urbanizimi dhe periurbanizimi: dy procese të lidhura ngushtë mes tyre	18
b) Përkufizimi i hapësirave periurbane	19
c) Tipare të përgjithshme të hapësirave periurbane	20
I.1.2. Tipet e zhvillimit periurban	21
I.1.3. Strategjitë menaxhuese	24
I.2. <i>Zhvillimi i hapësirave periurbane dhe procesit të periurbanizimit në Shqipëri</i>	25
I.2.1. Një vështrim historik i procesit të periurbanizimit në Shqipëri	25
I.2.2. Dinamika e zhvillimeve në hapësirën periurbane të Tiranës	27
I.3. <i>Hapësira periurbane e Shkodrës, përcaktimi i saj dhe studimet e deritanishme</i>	29
I.3.1. Përcaktimi i HPU të Shkodrës	29
I.3.2. Studimet e deritanishme mbi hapësirën periurbane të Shkodrës	30
Kapitulli II. VEÇORITË FIZIKO-GJEOGRAFIKE DHE PASURITË NATYRORE TË HAPËSIRËS PERIURBANE TË SHKODRËS	31
II.1. <i>Hapësira periurbane e Shkodrës: pozita gjeografike, origjina e emrit dhe organizimi administrativo-territorial</i>	31
II.2. <i>Veçoritë fiziko-gjeografike dhe resurset natyrore</i>	32
II.2.1. Veçoritë e relievit dhe ndërtimit gjeologjik të zonës	34
II.2.1.1. Relievi	34
II.2.1.2. Ndërtimi gjeologo-strukturor	38
II.2.2. Veçoritë klimatike	41
a) <i>Faktorët klimëformues</i>	41
b) <i>Elementët klimatik</i>	41
II.2.3. Pasuritë ujore	44
II.2.4. Tokat, flora dhe fauna	47
II.2.5. Gjendja e mjedisit natyror dhe kërcënimi nga rrisqet natyrore	48
a) <i>Gjendja e mjedisit natyror</i>	48
b) <i>Kërcënimi nga rrisqet natyrore</i>	50
II.2.6. Pasuritë minerale të HPUSH	51

Kapitulli III. VEÇORITË DEMOGRAFIKE DHE PASURITË NJERËZORE TË HAPËSIRËS PERIURBANE TË SHKODRËS	53
III.1. <i>Historiku i krijimit të vendbanimeve dhe popullimit të HPUSH</i>	53
III.2. <i>Karakteristika të përgjithshme demografike</i>	55
III.2.1. Numri i popullsisë dhe evolucioni kohor i saj.....	55
III.2.2. Dendësia dhe shpërndarja e popullsisë.....	58
III.2.3. Shtimi natyror i popullsisë	59
III.2.4. Struktura gjinore e popullsisë	61
III.2.5. Struktura moshore e popullsisë	62
III.2.6. Përbërja etnike dhe fetare e popullsisë së HPUSH.....	63
III.3. <i>Lëvizjet migruese të popullsisë, shkaqet, përmasat dhe pasojat</i>	64
III.3.1. Migrimi i brendshëm.....	64
III.3.2. Migrimi i jashtëm	66
Kapitulli IV. VEÇORITË E ZHVILLIMIT SOCIAL-EKONOMIK.....	67
IV.1. <i>Jeta sociale</i>	67
IV.1.1. Familja dhe komuniteti	67
IV.1.1.1. Evolucioni i familjes dhe gjendja e sotme	67
IV.1.1.2. Marrëdhëniet në familje dhe komunitet	68
IV.1.1.3. Integrimi dhe diskriminimi social	69
IV.1.2. Arsimi	70
IV.1.2.1. Historiku i zhvillimit të arsimit dhe infrastruktura	70
IV.1.2.2. Personeli arsimor dhe nxënësit	71
IV.1.2.3. Struktura e arsimit të popullsisë sipas niveleve	73
IV.1.3. Shëndetësia	74
IV.1.3.1. Infrastruktura	74
IV.1.3.2. Personeli shëndetësor	75
IV.1.3.3. Gjendja shëndetsore e popullsisë.....	75
IV.1.4. Kultura dhe koha e lirë	76
IV.2. <i>Veçoritë e zhvillimit ekonomik</i>	76
IV.2.1. Ekonomia bujqësore-sektor i rëndësishëm dhe përdoruese kryesore e hapësirës	76
IV.2.1.1. Vështrim historik i zhvillimit të bujqësisë në HPUSH.....	76
IV.2.1.2. Çështje të pronës bujqësore	78
IV.2.1.3. Inputet bujqësore	80
IV.2.1.4. Prodhimet kryesore bujqësore	82
IV.2.1.5. Blegtoria - më e pakët, por më cilësore	87
IV.2.1.6. Peshkimi dhe gjuetia	90
IV.2.1.7. Pylltaria (livadhet, kullotat) dhe bimët mjekësore	91
IV.2.1.8. Peisazhi bujqësor periurban.....	92
IV.2.1.9. Problemet e sotme të ekonomisë bujqësore dhe e ardhmja	93
IV.2.2. Sektori ekonomik dytësor.....	94
IV.2.2.1. Objektet dhe veprimtaritë industriale	94
IV.2.2.2. Ndërtimtaria	95
IV.2.3. Shërbimet dhe infrastruktura	95
IV.2.3.1. Tregtia me shumicë dhe pakicë	95

IV.2.3.2. Turizmi dhe restorantëria.....	98
IV.2.3.3. Transporti dhe telekomunikacioni	99
IV.2.3.4. Furnizimi me ujë dhe energji elektrike.....	103
IV.2.3.5. Menaxhimi i ujrave të përdorura dhe trajtimi i mbeturinave urbane ...	104
IV.3. <i>Veçoritë dhe treguesit e zhvillimit social-ekonomik</i>	105
IV.3.1. Banesat dhe gjendja e strehimit.....	105
IV.3.2. Mënyra dhe niveli i jetesës	108
IV.3.3. Punësimi (dhe papunësia).....	110
IV.3.4. Shtresëzimi social dhe varfëria.....	111
IV.3.5. Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike	113
IV.3.6. Personat me aftësi të kufizuar.....	114
IV.3.7. Pensionistët.....	115
IV.3.8. Qeverisja vendore.....	116
Kapitulli V. PËRDORIMI I HAPËSIRËS, RREGULLIMI I TERRITORIT DHE PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM	119
V.1. <i>Përdorimi i hapësirës në HPUSH</i>	119
V.1.1. Transformimet hapsinore të HPUSH.....	119
V.1.1.1. Përdorimi i territorit në HPUSH në v.1985	119
V.1.1.2. Përdorimi i territorit në HPUSH në v. 2013.....	121
V.1.1.3. Ndryshimi i përdorimit të territorit në HPUSH për periudhën 1985-2013	122
V.2. <i>Rregullimi i territorit në HPUSH</i>	123
V.2.1. Nevoja për rregullimin e territorit në HPUSH	123
V.2.2. Kuadri ligjor i rregullimit të territorit në vendin tonë dhe për rastin e HPUSH ...	124
V.2.3. Rregullimi i territorit të HPUSH në kontekstin rajonal	127
V.2.4. Një model i Rregullimit të Territorit për HPUSH	131
V.2.4.1. Vështrim i detajuar mbi përdorimin e territorit në HPUSH në ditët e sotme	131
V.2.4.2. Parashtrimi i një linje veprimi për planifikimin dhe rregullimin e territorit në HPUSH	136
V.2.4.3. Sugjerime mbi planifikimin, rregullimin dhe zonimin e territorit në HPUSH	144
V.3. <i>Planifikimi i zhvillimit të qëndrueshëm të HPUSH</i>	146
V.3.1. Resurset natyrore dhe njerëzore, bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të HPUSH	146
V.3.2. Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik	147
V.3.3. Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit	150
V.3.4. Zhvillimi social dhe mirëqeverisja	154
PËRFUNDIME DHE SUGJERIME	157
<i>Burimet e shfrytëzuara</i>	160
Shtojca	165

LISTA E HARTAVE

1: Pozicioni gjeografik i komunës Rrethinat në periferi të qytetit të Shkodrës	29
2: Pozicioni gjeografik i HPUSH në Qarkun Shkodër.....	31
3: Hartë administrative e HPUSH.....	32
4: Hartë fizike e HPUSH.....	34
5: Ndërtimi gjeologjik i HPUSH.....	38
6: Ndryshimi i numrit të popullsisë për periudhën 1989-2012 në HPUSH	58
7: Dendësia e popullsisë në vendbanimet e HPUSH	60
8: Infrastruktura arsimore dhe shëndetsore në HPUSH	74
9: Rrjeti hidrografik dhe ujitës potencial në HPUSH	81
10: Zhvillimi dhe shpërndarja hapsinore e bujqësisë në HPUSH	88
11: Rrjeti kryesor i transportit në HPUSH	100
12: Përdorimi i territorit në HPUSH në v. 1985	120
13, 17: Përdorimi i territorit në HPUSH në v. 2013	121
14: Ndryshimet kryesore në përdorimin e territorit në HPUSH, në v.1985-2013	123
15: Propozim i zhvillimit të korridorit nënurban Shkodër-Koplik në kuadër të Planit Rajonal Shkodër-Lezhë (Eptisa 2006)	129
16: Pamje satelitore e HPUSH	131
18: Zonat e rëndësisë së veçantë në HPUSH	137
19: Gjendja e pronësisë në fshatin Bardhaj.....	138
20: Gjendja e pronësisë në fshatin Bleran.....	138
21: Gjendja e pronësisë në fshatin Dobraç	138
22: Gjendja e pronësisë në fshatin Golem	139
23: Gjendja e pronësisë në fshatin Grudë e Re	139
24: Gjendja e pronësisë në fshatin Guci e Re	139
25: Gjendja e pronësisë në fshatin Hot i Ri	140
26: Gjendja e pronësisë në fshatin Shtoj i Ri.....	140
27: Gjendja e pronësisë në fshatin Shtoj i Vjetër.....	140
28: Gjendja e pronësisë në fshatin Zues	141
29: Rregullimi dhe zonimi perspektiv i territorit në HPUSH	145

LISTA E TABELAVE

1: Temperaturat mesatare mujore për periudhën 1951-1980 në Shkodër dhe HPUSH ...	42
2: Sasia vjetore reshjeve sipas muajve në stacionin Fshati i Paqes (Zues), viti 2008.....	43
3: Trëndafili vjetor i erërave në Shkodër dhe HPUSH për periudhën 1975-1985	44
4: Numri i popullsisë dhe i familjeve sipas fshatrave në HPUSH	55
5: Ecuria kohore e numrit të popullsisë së HPUSH	56
6: Staf i dhe nxënësit sipas shkollave në HPUSH, në fund të v. shkollor 2012-2013	71
7: Personeli shëndetsor në HPUSH, në fund të vitit 2013.....	75
8: Ndarja e tokës bujqësore sipas ligjit nr.7501 në HPUSH.....	79
9: Aftësia ujitëse në ha për HPUSH.....	80
10: Numri i mjeteve mekanike që përdoren në HPUSH.....	81
11: Bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në HPUSH.....	96
12: Llojet e bisneseve të mëdha në HPUSH.....	97

13: Ndërtesa për qëllime banimi sipas periudhës së ndërtimit në HPUSH.....	107
14: Struktura e punësimit sipas grupmoshave në HPUSH në v. 2001	111
15: Gjendja dhe gjinia e personave me aftësi të kufizuar në HPUSH	114
16: Struktura organizative e komunës Rrethinat.....	116

LISTA E GRAFIKËVE

1: Temperaturat mesatare mujore në HPUSH për periudhën 1951-1980	42
2: Sasia dhe shpërndarja vjetore e reshjeve në HPUSH në v. 2008	43
3: Trëndafili i erërave në Shkodër dhe hapësirën periurbane të saj	44
4: Ndryshimi i numrit të popullsisë në HPUSH për periudhën 1927-2012	57
5: Shtimi natyror i popullsisë në HPUSH	61
6: Ndryshimi i strukturës gjinore të popullsisë së HPUSH	62
7: Ndryshimi i strukturës moshore të popullsisë së HPUSH	63
8: Përbërja fetare e popullsisë në HPUSH	64
9: Lëvizja mekanike e popullsisë në HPUSH pas vitit 1990	65
10: Ndryshimi i numrit të anëtarëve për familje për periudhën 1945-2011	68
11: Ndryshimi i numrit të nxënësve për çdo fshat, mes vitit 2008 dhe 2013	72
12: Struktura e arsimit të popullsisë për v.2001 dhe 2011	73
13: Sipërfaqja e mbjellë në ha, sipas kulturave bujqësore kryesore në HPUSH	83
14: Llojet kryesore të drufrutorëve që kultivohen në HPUSH	84
15: Zhvillimi i blegtorisë (numri i krerëve të gjësë së gjallë) në HPUSH	88
16: Bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në HPUSH	97
17: Banesat dhe llojet e tyre në HPUSH	106
18: Ndërtesat për qëllime banimi sipas llojit të tyre	106
19: Ndërtesa për qëllime banimi sipas periudhës së ndërtimit në HPUSH	107
20: Gjendja e pajisjeve elektroshtëpiake të përdorura në HPUSH	109
21: Struktura e punësimit në HPUSH në v. 2001	110
22: Shpërndarja e ndihmës ekonomike sipas fshatrave në HPUSH (v. 2013).....	113
23: Lloji i aftësisë së kufizuar në HPUSH	115
24: Përdorimi i tokës në HPUSH sipas zërave kryesor.....	132

LISTA E FOTOGRAFIVE

1: Rruga dhe hekurudha Shkodër - Han i Hotit në territorin e HPUSH (D. Rustja).....	33
2: Fusha e Shtoit dhe e Bardhajve, (D.Rustja)	36
3: Kodrat e Bardhajve dhe e Zuesit, (D.Rustja)	36
4: Lumi Kir dhe zgjerimi i tij tek Ura e Bardhajve (D.Rustja)	37
5: Pamje nga ujëmbajtësi i Bleranit dhe përroi i Vrakës (D.Rustja).....	46
6: Pamje nga bimësia e HPUSH: (D.Rustja)	48
7: Mbetjet ngurta në brigjet e Bunës dhe ato urbane në përroin e Vrakës në HPUSH.....	50
8: Vërshimi i Kirit në Bardhaj dhe projekti për ndërtimin e argjinaturës mbrojtëse	51
9: Shkolla 9-vjeçare Golem (D.Rustja).....	72
10: Stema zyrtare e komunës Rrethinat, me simbolin e vreshtarisë (D. Rustja)	86
11: Mbarështrimi i dhenve dhe bletaria në HPUSH (D.Rustja).....	89
12: Pyjet dhe kullotat në HPUSH (D.Rustja).....	91

13: Punishte (kantinë) për prodhimin e verës në fshatin Shtoj i Ri (D.Rustja)	95
14: Bisnese në Dobraq dhe përgjatë rrugës Shkodër - Han i Hotit (D.Rustja)	97
15: Pamje nga fshati Zues (D.Rustja)	99
16: Rrugë të asfaltuara dhe të paasfaltuara në HPUSH (D.Rustja).....	101
17: Mbetje të ngurta dhe urbane në zonën Bardhaj-Bleran (D.Rustja)	105
18: Pallatet e vjetra (Dobraç) dhe të reja në HPUSH, ngjitur me bashkinë (D.Rustja) ..	108
19: Ndërtesa administrative e komunës Rrethinat (D.Rustja)	117
20: Tokë arë në HPUSH (D.Rustja).....	133
21: Sipërfaqe e ndërtuar me vendbanime informale (pas v. 1990), (D.Rustja)	135

LISTA E FIGURAVE

1: Përcaktimi i hapësirave periurbane në Europë	20
2: Dendësia e popullsisë në fshatrat e Tiranës (v.1986)	26
3: Hapësira periurbane e Tiranës	28
4: Harta e Corronellit (v.1688), ku përmendet Dobraqi	54

HYRJJE

1. Përzgjedhja e temës dhe parashtrimi i problemit

Dy dekadat e fundit përbëjnë, në shumë drejtime, periudhën e transformimeve hapsinore më dramatike që ka përjetuar territori i Shqipërisë. Ndryshimi i sistemeve ekonomiko-politike u shoqërua me sfida të reja dhe të panjohura për shoqërinë shqiptare: diferencim social (varfëri e skajshme e rreth ¼ së popullsisë dhe pasurim i shpejtë i një pakice); braktisje masive e zonave të thella malore; migrime të brendshme dhe emigracion i përmasave të panjohura më parë; urbanizim kaotik; informalitet; konflikte për pronën, etj.

Ndoshta më shumë se kudo tjetër, këto transformime hapsinore dhe social-ekonomike u shprehën përreth qendrave urbane. Kështu, në raportin e Bankës Botërore mbi zhvillimet urbane në Shqipëri¹ shkruhet: “*urbanizimi dhe migracioni, që nga periudha e tranzicionit, kanë vazhduar të korrigojnë atë strukturë hapsinore të gabuar dhe të dhunshme që u krijua nga planifikimi qendror*”, se “*dallga e migracionit në dukje kaotike dhe spontane, ka reflektuar kundërveprimin e natyrshëm dhe praktik të shqiptarëve drejt gjeografisë së re të mundësive*” dhe se “*në hapësirat periurbane, të karakterizuara përgjithësisht nga vendbanimet informale, po ndodh rritja hapsinore dhe demografike më e madhe, ku konfliktet ligjore dhe politikat përzihen së bashku*”.

Këto zhvillime dhe ndikimi i tyre në përdorimin e hapësirës, rregullimin e territorit, peisazh dhe mjedis, janë tema studimesh ndërdisiplinore, ku gjeografia ka vendin e saj të rëndësishëm, prandaj u gjykua që disertacioni të fokusohet në studimin e thelluar të tyre dhe në sugjerimin e zgjidhjeve shkencore të problemeve të sotme dhe perspektive.

Një arsye më shumë për t’u marrë me këtë tematikë studimi, pra me hapësirat periurbane, është mungesa e studimeve (sidomos të karakterit gjeografik) mbi to, të cilat siç e thamë, janë ndoshta hapësirat më dinamike dhe më të ndryshuara gjatë dy dekadave të fundit në vendin tonë. Një gjë e tillë është vënë në pah nga studiues të ndryshëm. Kështu Nase dhe Ocaqçi² theksojnë faktin se procesi i urbanizimit në Shqipërinë e pas viteve ‘90, përbën një laborator studimi me shumë anë të pazbuluara, si psh. karakteristikat e zhvillimit të HPU³ dhe segregimin social.

Ndërkohë, Mele, vëren se suburbanizimi, me të cilin nënkupton zhvillimin informal të HPU të vendit tonë pas v. 1990, përfaqëson një dukuri të re për Shqipërinë, pak të njohur dhe mjaft interesante për t’u studiuar⁴.

Gjithashtu vihet re se edhe ato pak studime të kryera mbi HPU në Shqipëri⁵, janë të përqendruara kryesisht në zhvillimet e ndodhura përreth kryeqytetit, duke lënë mënjanë ndryshimet e ndodhura në HPU e tjera në Shqipëri.

Prandaj, u pa e arsyeshme që ky disertacion të marrë në studim hapësirën periurbane të Shkodrës⁶ dhe të bëjë një analizë të plotë të karakteristikave natyrore dhe

¹ Banka Botërore, *Vlerësim i sektorit urban në Shqipëri*, Janar 2007, fq. 10

² Ilir Nase, Mehmet Ocaqçi; *European Planning Studies*, 18:11, 1837-1861

³ HPU – Hapësirë PeriUrbane

⁴ Marcela Mele; *Disertacion*, University of Hull 2010, fq. 67

⁵ Më gjerësisht mbi këtë do flitet në kapitullin e dytë

⁶ Hapësira Periurbane e Shkodrës – HPUSH

humane të saj, si dhe të transformimeve që ka pësuar ajo pas vitit 1990. Këto transformime janë kryesisht rrjedhojë e vendosjes në këtë territor të popullsisë së ardhur nga zonat e thella malore. Në këtë zonë, që i përket kryesisht komunës “Rrethinat”, numri i popullsisë gjatë 23 viteve të fundit është dyfishuar dhe shumica e saj është vendosur në territore dhe banesa informale.

Nëpërmjet *metodave kërkimore* cilësore dhe sasore dhe një qasjeje shkencore gjeografike të karakterit regjional dhe aplikativ, studimi përpiqet të evidentojë shkaqet dhe dinamikën e këtyre transformimeve demografike, social-ekonomike dhe mjedisore, si dhe të japë sugjerime konkrete mbi rrugët dhe drejtimit që duhen ndjekur për të planifikuar dhe realizuar zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Punimi është realizuar në kuadrin e studimeve të karakterit regjional të bëra nga gjeografë dhe studiues shqiptar e të huaj, por duke shënuar risi në drejtim të tematikës së marrë në shqyrtim, studimit të thelluar në këndvështrimin e përdorimit të resurseve dhe rregullimit të territorit, si dhe të sugjerimit të zgjidhjeve shkencore për problemet që shqetësojnë komunitetin, pushtetin vendor, institucionet dhe subjektet që veprojnë ose dëshirojnë të veprojnë në zonat periurbane.

2. Rëndësia e studimit dhe synimet kryesore

Në aspektin *teorik*, ky studim paraqitet i rëndësishëm, pasi sjell këto risi:

- Përbën studimin e parë në nivel doktrate për hapësirat periurbane në vendin tonë, veçanërisht në këndvështrimin gjeografik
- Përbën studimin e parë të mirëfilltë për zonën e marrë në studim, pra HPUSH
- Sjell për herë të parë në literaturën shkencore në shqip, një trajtim të hollësishëm të karakteristikave dhe tipareve të zhvillimit të HPU në botë dhe Shqipëri

Gjithashtu, një veçori përbën edhe trajtimi i koncepteve të tilla, si:

- modeleve të organizimit, përdorimit dhe administrimit të hapësirave periurbane;
- rregullimit të territorit; sistemimit të vendbanimeve informale;
- përdorimit racional të tokës;
- ristrukturimit dhe diversifikimit të ekonomisë gjatë procesit të urbanizimit;
- modernizimit të infrastrukturës fizike (rrugë, ujësjellës, kanalizime, qendra të trajtimit të mbetjeve urbane, furnizim me energji elektrike, etj.);
- zbatimit të politikave mjedisore dhe valorizimit të peisazhit;
- kompletimit të infrastrukturës sociale dhe gjallërimit të veprimtarive kulturore në nivel komuniteti e krahine, etj.

Studimi ka *rëndësi praktike*, pasi:

- *së pari, duke qenë i pari studim i këtij lloji në nivel disertacioni doktrate për hapësirën periurbane*, do të ofrojë një *model* që do të mund të shërbejë edhe për studimin e zonave periurbane në gjithë hapësirën shqiptare;
- *së dyti*, kjo zonë, me zhvillime dinamike dhe problematikë komplekse, deri më sot ka evoluar në mënyrë kaotike dhe informale, prandaj studimi synon t’i propozojë

pushtetit vendor dhe komunitetit një model bazë të planifikimit dhe rregullimit të territorit, ku do të jepen rekomandime mbi zonimin e territorit, si: zonat për vendbanimet (rezidenciale), objektet social-kulturale e sportive, veprimtaritë ekonomike e tregtare, turizëm, shlodhje e rekreacion (lulishte dhe hapësira të gjelbërta) etj, si dhe një Strategji të Zhvillimit Social-ekonomik e Mjedisor.

- *së treti*, pushteti vendor, subjektet private, OJF-të, komuniteti dhe kushdo që është i interesuar për të investuar në këtë hapësirë, duke patur në dorë këtë studim, do të mund të orientojë veprimtarinë në përputhje me ofertën natyrore dhe humane të zonës, planin e rregullimit të territorit, interesat e komunitetit dhe perspektivat e zhvillimit lokal e rajonal.

3. Pyetjet kërkimore dhe objektivat specifike

- Pyetjet kërkimore

Duke pasur parasysh atë ç'ka u tha më sipër, *kjo temë disertacioni bën përpjekje t'u përgjigjet këtyre pyetjeve kryesore kërkimore:*

- a) Cilat janë karakteristikat kryesore të zhvillimit të HPU të Shkodrës në ditët tona dhe cila është tendenca e zhvillimit të saj në të ardhmen?
- b) Çfarë ndryshimesh ka pësuar HPU e Shkodrës gjatë 23 viteve të fundit dhe cilët janë shkaqet që sollën këtë ndryshim?
- c) Çfarë të përbashkëtash dhe ndryshimesh ka HPU e Shkodrës me HPU e tjera në botë dhe Shqipëri?
- d) Cili është tipi i zhvillimit periurban që po ndodh në HPU të Shkodrës (si një model edhe për HPU e tjera në Shqipëri) dhe ç'farë kontributi mund të japin gjeografët në orientimin e zhvillimit perspektiv të tyre?

- Objektivat specifike

Më konkretisht punimi synon:

- a) të japë një panoramë të përgjithshme të *veçorive natyrore* të HPUSH, resurseve dhe mundësive për shfrytëzimin e tyre në të mirë të komunitetit;
- b) të evidentojë *gjendjen e mjedisit* dhe ekosistemeve natyrore të zonës, problemet që janë krijuar, shkaqet, përmasat dhe pasojat e shkaktuara, si dhe masat që duhen marrë për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit;
- c) të trajtojë dinamikën e transformimeve hapsinore që ka përjetuar zona pas vitit 1990, si në këndvështrimin demografik, ashtu edhe të rritjes së dendësisë së popullimit dhe zgjerimit të vendbanimeve etj, që kanë impakt të ndjeshëm në përdorimin e territorit;
- d) të parashtojë dhe analizojë *zhvillimet kryesore social-ekonomike* të zonës, problemet që janë krijuar (papunësia, varfëria, emigracioni, konfliktet për pronën etj.), impaktin në përdorimin e hapësirës dhe perspektivën e zhvillimit, si dhe të propozojë Strategjinë e Zhvillimit Social-Ekonomik, si pjesë e rëndësishme e zhvillimit lokal;

- e) të sugjerojë diversifikimin e veprimtarive ekonomike e social-kulturore, si rrugë për shtimin e të ardhurave, përmirësimin e nivelit të jetesës dhe pasurimin e jetës sociale të komunitetit;
- f) të vlerësojë gjendjen e infrastrukturës fizike, social-kulturore dhe të sektorit të shërbimeve etj, me synimin për të projektuar modernizimin e saj dhe vënien më mirë në funksion të nevojave të komunitetit;
- g) të evidentojë *transformimet drastike në përdorimin e territorit* gjatë 23 viteve të fundit, zhvillimin e sektorit të ndërtimit, problemet e pronësisë dhe rregjistrimit të pasurisë së paluajtshme, nivelin e informalitetit dhe ecurinë aktuale të procesit të legalizimeve, si dhe tendencën e përdorimit të tokës në të ardhmen;
- h) të ndërtojë, në bazë të dinamikës së zhvillimeve të sotme, *një platformë sa më të plotë dhe realiste të planifikimit të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës*, e cila mund të përbëjë bazat e zhvillimit perspektiv;
- i) të hartojë e t'i propozojë pushtetit vendor dhe komunitetit një model të rregullimit dhe planifikimit të territorit të HPUSH, si zgjidhje për problemet e ndërlikuara të përdorimit të hapësirës dhe zhvillimin perspektiv të zonës.

- *Përdoruesit e studimit*

Studimi pritet t'u shërbejë komuniteteve shkencore, strukturave qeverisëse vendore, politikbërësve, OJF-ve, investitorëve, kompanive të ndërtimit, subjekteve të sektorit të shërbimeve, banorëve të zonës dhe gjithë përdoruesve të tjerë të hapësirës.

Ai synon të shërbejë si *platformë* konkrete mbi cilën mund të mbështetet zhvillimi perspektiv i zonës, dhe si *model* referimi për studime të të njëjtës tematikë në zonat e tjera periurbane të hapësirës shqiptare.

4. Metodologjia e punës kërkimore

Metodologjia e punës kërkimore që aplikohet në një studim të caktuar, përcaktohet nga qëllimet, objektivat dhe pyetjet kërkimore të tij⁷. Duke pasur parasysh një gjë të tillë, në realizimin e këtij studimi, është përdorur një kombinim i metodave cilësore dhe sasore të kërkimit shkencor gjeografik, në kontekstin e rastit studimor që kemi marrë në shqyrtim.

- Si një linjë fillestare veprimi ka shërbyer *metoda e punës e ofruar nga Clark*⁸, në lidhje me HPU. Sipas tij, kur vjen puna tek HPU, gjeografi mund të luajë këto role kryesore:

- a) Ai mund të jetë një *mbledhës i informacionit* në lidhje me tiparet e zhvillimit të HPU, proces i domosdoshëm për të kuptuar atë se çfarë po ndodh në këtë hapësirë dhe për të bërë përshkrimin e saj
- b) Mund të jetë një *interpretues (analizues) i situatës aktuale*, duke shpjeguar proceset që po shpalosen në HPU dhe problematikat kryesore të saj: këtu ai mund të vlerësojë edhe ndikimin që kanë pasur politikat e kaluara të zhvillimit në këtë zonë

⁷ Nicolas Clifford, et al; *Key Methods in Geography, 2nd edition*, SAGE 2010, fq. 7

⁸ Gordon Clark; në *Applied Geography; Principles and Practice* (ed. Pacione, M.), Routledge, London 1999, 301-309.

- c) Mund të jetë *parashikues i situatës*, duke përcaktuar drejtimin e zhvillimit që po ndjek HPU dhe ku duhet të shkojë ajo
- d) Së fundi, në HPU gjeografi mund të bëhet *avokat, ose mbrojtës i një pozicioni të caktuar* në lidhje me zhvillimin perspektiv të HPU, duke dhënë rekomandimet e duhura që sipas tij korrigjojnë problemet aktuale dhe e përmirësojnë gjendjen në të ardhmen.

- Një linjë të tillë pune jemi përpjekur ta aplikojmë edhe në rastin tonë studimor pra HPUSH, arsyet e përzgjedhjes së të cilës ne i kemi sqaruar më sipër.

- *Metoda e rastit studimor* është një ndër metodat parësore të kërkimit shkencor, mjaft e përshtatshme për t'u përdorur atëherë kur duam të njohim karakteristikat e zhvillimit të një dukurie dhe arsyet e saj⁹. Ajo është mjaft e përshtatshme edhe në rastin tonë, duke na ndihmuar t'u përgjigjemi pyetjeve kërkimore të mësipërme në lidhje me tiparet e zhvillimit të HPUSH pas v. 1990, shkaqet që ndikuan në ndryshimet e përjetuara nga ajo gjatë kësaj periudhe dhe tipin e zhvillimit periurban që po ndodh në të.

- Faza e parë e punës në lidhje me hartimin e kësaj teme disertacioni, ka qenë ajo e *punës në tavolinë dhe kërkimit të literaturës shkencore* të nevojshme. Kjo gjë ka ndihmuar për të krijuar një ide dhe mendim paraprak mbi gjendjen ekzistuese të kërkimeve në lidhje me HPU, në rang botëror dhe për rastin e Shqipërisë. Kjo etapë ka shërbyer gjithashtu edhe për të gjetur "mangësitë" që ekzistojnë në këtë drejtim, fushat e panjohura dhe anët e paprekura nga studiuesit, si dhe për të gjetur raste të ngjashme studimore me të cilët të mund të replikohen dhe krahasohen të dhënat dhe gjetjet. Pjesa më e madhe e punës në lidhje me këtë fazë është realizuar nëpërmjet kërkimit në internet, duke shfrytëzuar burime dhe referenca të ndryshme informacioni, si revistat më të njohura shkencore gjeografike, libraritë online, abstrakte dhe citime, faqe të ndryshme interneti, etj.

- *Mbledhja e të dhënave dhe informacionit* në lidhje me këtë studim është realizuar nga burime të ndryshme. Përmendim këtu, së pari, të dhënat dytësore të marra nga burimet zyrtare dhe institucionet përkatëse sipas kategorive të nevojshme¹⁰, vërtetësinë e të cilave e kemi ballafaquar nëpërmjet informacioneve të marra nga intervistat e realizuara me personat kyç apo ekspertët, si dhe me të dhënat e marra vetë drejtpërdrejt në terren; metodë e njohur ndryshe edhe si triangulacion¹¹.

- *Intervistat*, përbëjnë një ndër format kryesore të metodologjisë së punës të përdorura në kuadrin e kësaj teme disertacioni. Ato kanë shërbyer si një mënyrë shumë efikase për të marrë informacion mbi çështje të caktuara, dhe janë realizuar duke përfshirë grupe të ndryshme interesi. Format kryesor i tyre, ka qenë ai i intervistave gjysëm të strukturuar, dmth. me pyetje të parapërgatitura, por duke lejuar një lloj fleksibiliteti në përgjigje^{12, 13}. Bazuar në objektivat e studimit dhe nga njohja paraprake e

⁹ Robert K. Yin; *Case Study Research: Design and Methods, 3rd Edition*; SAGE, CA 2002

¹⁰ Mund të përmendim këtu të dhënat e marra nga zyrat përkatëse të njësisë administrative që kemi marrë në studim – komunës Rrethinat, INSTAT-in, drejtoritë e ndryshme rajonale me qendër në Shkodër, etj.

¹¹ Michael Q. Patton; London – Sage Publications, 2002, fq. 247

¹² Basil Gomez dhe John Paul Jones III; Wiley- Blackwell, 2010

¹³ Pyetjet e realizuara dhe personat kyç të intervistuar në secilën prej kategorive, gjenden tek pjesa "Shtojcat", në fund të kësaj teme

zonës, u pa e arsyeshme që intervistat të realizoheshin me personat kyç (ekspertët) lokal të komunës, me personat kyç të përzgjedhur për çdo fshat, si dhe me popullsinë e ardhur në HPUSH pas v. 1990.

Së pari u realizuan intervistat me ekspertët (personat kyç) në komunë, gjatë muajit tetor, 2013; gjithsej 4. Ato ndihmuan për të marrë informacion dhe për të njohur këndvështrimin e tyre në lidhje me karakteristikat e zhvillimit të HPUSH dhe tendencat e saj.

Pothuajse gjatë së njëjtës periudhe u realizuan edhe intervistat me personat kyç për çdo fshat (gjithsej 10), të cilët u përzgjedhën nga shkalla e njohjes dhe e reputacionit të tyre në vendbanimin përkatës. Intervista me ta bëri të mundur marrjen e të dhënave dhe informacioneve shtesë, parë në këndvështrimin e njerëzve që jetojnë çdo ditë në këtë zonë me problemet e saj.

Së fundi, u realizuan intervistat me persona të përzgjedhur nga popullsia e ardhur në HPUSH pas viteve '90, për ta parë zonën me sytë e tyre, dhe për të njohur më mirë mënyrën e vendosjes, përshtatjes dhe jetesës së tyre. Janë gjithsej 10 intervista të bëra me banorë të vendosur në vendbanime të ndryshme të HPUSH gjatë këtyre 23 viteve.

- *Puna në terren dhe pjesëmarrja e drejtpërdrejt*, kanë ndihmuar për të njohur konkretisht gjendjen në zonën e marrë në studim, për ta parë atë me paanshmëri dhe për të mbledhur të dhëna dhe informacione shtesë ose të mangëta. Theksojmë faktin se metoda e vëzhgimit dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejt vjen natyrshëm në këtë rast, duke qenë se autori i kësaj teme doktorature është banues i zonës së marrë në studim. Meqënëse pamjet vizuale si fotot, janë shumë të rëndësishme në njohjen e kontekstit lokal të një vendi, ato janë përdorur gjerësisht në këtë studim, për të ilustruar në mënyrë konkrete dukuritë dhe problemet e marra në shqyrtim.

- Ndërkohë për *analizën e të dhënave* janë përdorur kryesisht *metodat sasiore*, si psh. në lidhje me treguesit dhe komponentet fiziko-gjeografikë (klimatologjikë, hidrologjikë, hipsometrikë etj.), demografikë (lindje, vdekje, shtim natyror, martesë, tregues moshor dhe gjinorë, etj.), social-ekonomikë (punësimi, papunësia, migrimet, varfëria, niveli i jetesës, ndihma ekonomike, etj.), ekonomikë (prodhimi, konsumi, tregtia etj.), të grumbulluara në terren ose burimet dytësore.

- *Interpretimi i tyre* është realizuar nëpërmjet përpilimit të grafikëve, tabelave, figurave dhe hartave. Pikërisht këto të fundit, pra hartat tematike të realizuara për qëllimet e këtij studimi paraqesin një vlerë të shtuar të saj, pasi ato realizohen për herë të parë në lidhje me zonën e marrë në studim. Janë 28 harta me tematikë të ndryshme, që janë ndërtuar duke përdorur Sistemin e Informacionit Gjeografik (SIG), mbështetur në bazën hartografike ekzistuese, pamjet satelitore si dhe të dhënat parësore e dytësore të grumbulluara.

- Analizimi dhe interpretimi i të dhënave është shfrytëzuar si bazë për llogaritjen e zhvillimeve të ardhshme demo-sociale (*proгноза*), si dhe për të bërë parashikimin e kërkesave për vende pune, banesa, objekte social-kulturore dhe ekonomike, etj.

- Analiza e informacionit përmes metodave të mësipërme ka ndihmuar për nxjerrjen e *përfundimeve* shkencore, me vlera praktike dhe aplikative. Në bazë të tyre janë përpunuar *hipotezat* përkatëse për rrugët, mënyrat dhe mjetet që do të çojnë në

zgjidhjen e problemeve social-ekonomike, të përdorimit dhe rregullimit të hapësirës periurbane të Shkodrës, si dhe projektimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

- Parimet bazë të *etikës dhe kërkimit shkencor* janë ndjekur dhe aplikuar me kujdes gjatë realizimit të këtij studimi; në rastin e intervistave, personat e intervistuar janë informuar paraprakisht mbi qëllimet e studimit dhe arsyet e intervistimit duke i siguruar gjithmonë që të dhënat e marra do shfrytëzoheshin vetëm për qëllime shkencore dhe që do ruhej konfidencialiteti i tyre. Gjithashtu, autori i këtij studimi, është përpjekur që të ruajë në çdo rast paashmërinë gjatë analizimit dhe interpretimit të të dhënave, si dhe në parashtrimin e gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve; duke bërë kujdes që të mos ndikohet nga asnjë arsye objektive apo subjektive në këtë drejtim.

5. Kufizimet në realizimin e studimit

Në përfundim të kësaj teme disertacioni, vihet re se ka pasur edhe disa kufizime në realizimin e qëllimeve të saj, të cilat po i parashtrojmë më poshtë:

a) Tematika e marrë në studim dhe mungesa e studimeve të mëparshme në lidhje me të sidomos në vendin tonë, ka bërë që të jetë e vështirë të gjenden modele pune të ngjashme, që mund të shërbenin si udhërrëfyes apo me të cilët të mund të krahasoheshin apo replikoheshin të dhënat dhe gjetjet

b) Studimi për herë të parë i zonës në fjalë, sidomos në nivel doktrature, ka bërë që thuajse për çdo çështje të trajtuar, të fillohet nga e para; duke ia nisur me gjetjen e të dhënave dhe burimeve të informacionit e duke vazhduar me analizimin dhe interpretimin e tyre; një gjë e tillë ka marrë shumë kohë dhe energji dhe njëkohësisht nuk ka lejuar që të bëhen krahasime me studime të mëparshme

c) Gjetja e të dhënave në vetvete ka përbërë një problem të rëndësishëm, pasi ato kanë rezultuar të vështira për t'u gjendur dhe për t'u marrë nga zyrat dhe institucionet përkatëse, duke paraqitur edhe mangësi në fusha të caktuara dhe pasaktësi: për këtë arsye janë përdorur burime të tjera të dhënash si intervistat dhe puna në terren, që të bëhej krahasimi i tyre nëpërmjet triangulacionit, megjithatë autori i këtij studimi është i ndërgjegjshëm se prapë se prapë nuk është arritur të mbulohen të gjitha mangësitë dhe boshllëqet në këtë drejtim

d) Vështirësi janë hasur edhe në aplikimin e metodave të përdorura; psh. gjatë intervistave me personat kyç në kategori të ndryshme, është vënë re në disa raste ngurrimi për të folur apo thënë gjithë të vërtetën, apo pozicionimi i përgjigjeve sipas interesave të personit të intervistuar; gjithsesi përgjigjet e tyre janë marrë si të mirëqëna duke besuar në profesionalizmin dhe integritetin e të intervistuarve

e) Së fundi përmendim edhe kontekstin specifik të autorit të këtij studimi, i cili është banor i zonës së marrë në studim dhe përfaqëson një kategori të caktuar (banorët më të hershëm dhe shtresën e ish-pronarëve); një gjë e tillë mund të ketë ndikuar qoftë edhe në mënyrë ta pandërgjegjshme në lidhje me rezultatet e studimit, megjithëse çdo përpjekje është bërë për ta shmangur një gjë të tillë.

6. Struktura e punimit

Punimi është strukturuar në bazë të katër pjesëve dhe kapitujve kryesor:

- a) *Pjesa hyrëse* e saj parashton arsyet e përzgjedhjes së temës, problemit kërkimor dhe zonës së marrë në studim, së bashku me rëndësinë e këtij studimi dhe objektivat e hipotezat studimore që hidhen për diskutim; duke përfundur me metodologjinë e punës kërkimore të ndjekur për realizimin e synimeve të saj dhe kufizimet që vihen re në fund të studimit
- b) *Kapitulli i parë*, përbën një ndër risitë e këtij studimi sepse sjell për herë të parë në kërkimet shkencore dhe gjeografike në Shqipëri, një përmbledhje të literaturës në lidhje me konceptet bazë teorike të HPU në botë; gjithashtu për herë të parë vjen edhe një analizim i ecurisë së procesit të periurbanizimit në Shqipëri dhe veçanërisht në hapësirën periurbane të Tiranës: kapitulli mbyllet me kriteret e marra parasysh në përzgjedhjen e HPUSH dhe gjendjen e studimeve të deritanishme mbi të.
- c) *Kapitulli i dytë*, bën një përmbledhje të veçorive fiziko-gjeografike dhe pasurive natyrore të HPUSH, duke trajtuar me rradhë të gjithë elementët përbërës (relievin, ndërtimin gjeologjik, klimën, hidrografinë, biodiversitetin); në fund jepet gjendja aktuale e mjedisit natyror të saj dhe problematikat në këtë drejtim, së bashku me rrisqet natyrore që e kërcënojnë atë.
- d) *Kapitulli i tretë*, jep karakteristikat kryesore demografike të HPUSH me të gjithë elementët dhe treguesit përbërës (numrin, dendësinë, shtimin natyror, strukturën moshore, gjinore, etnike dhe fetare të popullsisë) dhe analizon në thellësi edhe lëvizjet migruese në këtë zonë, sidomos migrimin e brendshëm që është tipar i veçantë i saj pas v. 1990.
- e) *Kapitulli i katërt* evidenton veçoritë e zhvillimit social-ekonomik të zonës, si jetën sociale dhe treguesit e zhvillimit social-ekonomik; aty analizohen në mënyrë të veçantë evolucionin e familjes, ndryshimi i marrëdhënieve sociale mes banorëve pas viteve '90, gjendja aktuale e zhvillimit të arsimit dhe shëndetësisë; ndryshimi i strukturës ekonomike të zonës dhe gjendja e infrastrukturës; në fund theksi vendoset tek niveli i jetesës së banorëve të HPUSH dhe roli i qeverisjes lokale.
- f) *Kapitulli i pestë*, analizon përdorimin e hapësirës dhe transformimet hapësirë të zonës gjatë 28 viteve të fundit, shkaqet dhe pasojat e tyre; ai gjithashtu evidenton nevojën për rregullimin e territorit në HPUSH dhe jep rekomandime konkrete në lidhje me të; pjesa e fundit e kapitullit paraqet mundësitë që ekzistojnë për planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm të kësaj hapësire, duke dhënë edhe një platformë konkrete që mund të ndiqet në këtë drejtim.
- g) Kjo temë disertacioni mbyllet me paraqitjen e *përfundimeve* të studimit pas analizimit të të dhënave dhe rezultateve, duke iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të hedhura në fillim të saj; së fundi jepen edhe disa *sugjerime* që mund të ndiqen nga politikëbërësit në lidhje me mirëmenaxhimin e HPUSH dhe HPU të tjera në vendin tonë.

Kapitulli i parë

HAPËSIRAT PERIURBANE NË BOTË DHE SHQIPËRI: NJË PËRMBLEDHJE E LITERATURËS

I.1. Koncepte bazë mbi hapësirat periurbane: një vështrim teorik

I.1.1. Çështje konceptuale

a)Urbanizimi dhe periurbanizimi: dy procese të lidhura ngushtë mes tyre

Zhvillimi i hapësirave periurbane konsiderohet si një pasojë e natyrshme e urbanizimit, procesit të kalimit nga një shoqëri rurale, në një shoqëri më urbane¹⁴. Pikërisht procesi i rritjes urbane, kryesisht në zonat tranzitore mes qyteteve dhe fshatrave, po quhet gjithnjë e më shumë si *periurbanizim*¹⁵. Ky term ka të bëjë me procesin dinamik të urbanizimit të hapësirave rurale në periferi të qyteteve, proces që ndodh në terma fizik, ekonomik dhe social¹⁶. Pra, *periurbanizimi* është vazhdim i procesit të urbanizimit në hapësirat përreth qyteteve, ndërsa krijimi i hapësirave periurbane është rrjedhojë e natyrshme e tij: ato quhen ndryshe edhe “zona para-urbane”. Periurbanizimi mund të bëhet elementi kryesor i procesit të urbanizimit dhe planifikimit në shekullin XXI¹⁷.

Në përgjithësi, vihet re një mungesë vëmendjeje e studiuesve ndaj HPU, për shkak edhe të ndarjes ekzistuese mes hapësirave urbane dhe atyre rurale, dhe studimit veçmas të tyre. Në fakt, më shumë sesa reale, dallimet mes “rurales” dhe “urbanes” janë artificiale. Kjo sepse një numër i konsiderueshëm familjesh në zonat urbane kanë tendencë të bazohen tek burimet rurale për të jetuar, dhe nga ana tjetër popullsia rurale gjithnjë e më shumë po angazhohet në veprimtari jobujqësore¹⁸.

Duhet thënë se përkufizimi i urbanes dhe rurales bazohet zakonisht në kriteret ekonomike dhe demografike, dhe prandaj përgjithësimet janë problematike. Një tjetër problem është përcaktimi i kufinjve urban: psh në Indonezi përdoret emërtimi “*kotadesasi*” (qytet-fshat) për të përshkruar hapësirat gjeografike ku ndodh njëkohësisht edhe veprimtaria rurale edhe ajo urbane¹⁹. Nga ana tjetër, gjurma ekologjike e qendrave urbane (hapësira nga e cila ajo merr resurse), është shumë më e gjerë sesa ajo e kufinjve administrativ dhe ndërveprimet sektoriale mes tyre (bujqësia urbane, punësimi rural jobujqësor, etj.), shumë më të ngushta sesa mendohet. Shumë nga ndërveprimet mes hapësirave rurale dhe urbane, ndodhin pikërisht në zonën periurbane.

¹⁴ Për herë të parë popullsia botërore u bë urbane (pra më shumë se gjysma e popullsisë jetonte në qytete) në v. 2008; kurse në Shqipëri në v. 2011

¹⁵ United Nations Population Fund; New York 2007, fq.48

¹⁶ Douglas Webster; Larissa Muller; *Human settlement development -Vol.1*, Encyclopedia of Life Support Systems 2002

¹⁷ Annette Piore, et. al; *Peri-urbanization in Europe: a Synthesis Report*, University of Copenhagen 2011, fq.32

¹⁸ Cecilia Tacoli; *Environment and Urbanization*, Vol.10, nr. 1, April 1998, fq.147

¹⁹ McGregor, D., Simon D. & Thompson D.; London, Sterling V.A: Earthscan 2006

b) Përkufizimi i hapësirave periurbane

Në kuptimin semantik, fjala “periurbane” rrjedh nga fjalët “peri”- pranë ose përreth, dhe “urbane” - e vendosur në qytet, domethënë *përreth ose pranë qytetit*²⁰, dhe ka më shumë se një gjysmë shekulli që përdoret^{21, 22}.

Gjithsesi, për të gjitha arsyet që përmendëm më sipër, përkufizimi i HPU është një mision i vështirë. Këto hapësira identifikohen me vështirësi, pasi kufinj të tyre janë fluidë dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Në përgjithësi ato konsiderohen si “zona kalimtare ndërmjet hapësirave urbane dhe atyre rurale, të cilat mbartin karakteristikat e të dyjave, por duke pasur njëkohësisht tiparet e tyre origjinale”²³. Ato janë zona të takimit të “urbanes” dhe “rurales”, vendi ku ato përzihen dhe bashkëveprojnë dhe ku kufinj të administrativ mes tyre janë të paqartë²⁴.

Termi “periurban” është përdorur për të përkufizuar një hapësirë (përreth qytetit); një proces (urbanizimin - kalimin nga rurale në urbane) dhe një kompleks funksionesh dhe veprimtarish (urbane dhe rurale). Prandaj HPU konsiderohen si zona skajore të qyteteve ku ndryshime dinamike janë duke ndodhur në kohë dhe hapësirë²⁵. Rakodi e përkufizon HPU si “zonë tranzitore mes hapësirave urbane dhe atyre rurale, që karakterizohet nga një përdorim i larmishëm i tokës, me kufinj të brendshëm dhe të jashtëm të papërcaktuar, e cila zakonisht shtrihet mes dy ose më shumë njësive administrative”²⁶.

Ndërsa sipas Clark, me hapësira periurbane (ose *skaj urban*) kuptojmë ato zona që gjenden fill pas pjesës dendësisht të banuar të një qyteti, por njëkohësisht edhe mjaftueshëm pranë tij sa për të qenë nën trysninë e zhvillimit. Në fakt më shumë sesa një vijë në hartë, shton ai, skaji urban është një hapësirë ku veprimtaritë urbane zvogëlohen në mënyrë graduale, duke përfaqësuar mbi gjithçka tjetër një hapësirë të konflikteve të shtuara mbi tokën, të paqartësisë dhe të mundësisë së përfitimit²⁷.

Në raportin mbi zhvillimin e HPU në Europë²⁸, bëhet një përpjekje më konkrete për të përcaktuar zonën periurbane; këtu fillimisht bëhet ndarja e zonës së përbashkët urbane dhe rurale (rajonit ruralo-urban) në këto pjesë kryesore: qendra e qytetit, pjesa e brendshme e tij, zona suburbane, skaji urban, periferia urbane dhe hapësira rurale. Sipas këtij studimi, HPU përfshin skajin urban së bashku me periferinë urbane, në një skemë të konkretizuar në figurën e mëposhtme:

²⁰ Albert Sidney Hornby; Oxford University Press; 4th edition, May 1989

²¹ David L. Iaquina dhe Axel W. Drescher; *Land Reform 2000/2*, FAO; fq. 8-26

²² Terma të tillë si jashtë-urbane (*ex-urban*), rurbane, skaj urban (*urban fringe*), gjysmë-urbane (*semi-urban*), madje edhe suburbane, janë përdorur që të gjithë për të nënkuptuar hapësirën periurbane, në literaturën shkencore, gjatë shekullit të XX-të.

²³ German Adell; DPU – University College London, UK, fq.3

²⁴ Sabri Laçi; *Gjeografia Rurale*, PROGRES, Tiranë 2005, fq. 26

²⁵ Fiona Marshall, et al; *STEPS Working Paper 35*, Brighton - STEPS Centre 2009, fq.3

²⁶ Douglas Webster; Larissa Muller; Human settlement development -Vol.1, Encyclopedia of Life Support Systems 2002

²⁷ Gordon Clark; në *Applied Geography; Principles and Practice* (ed.Pacione, M.), Routledge, London 1999, 301-309.

²⁸ Annette Piore et al; *Peri-urbanization in Europe- A Synthesis Report*, University of Copenhagen 2011, fq.25



Figura 1: Përcaktimi i hapësirave periurbane në Europë

Duhet thënë se kjo ndarje vlen më shumë për rastin e Europës dhe më tepër synon të konkretizojë sadopak hapësirën periurbane. Megjithatë, karakteristikat e zhvillimit të HPU, siç do e shohim më poshtë, janë shumë të larmishme. Përfundimisht mund të thuhet se HPU janë diçka e ndërmjetme, të vështira për t'u përcaktuar, rezultat hibrid i faktorëve të ndryshëm në shkallë të ndryshme. Prandaj ato mbeten një element sfidues studimi, në shumë drejtime²⁹. Ndërsa, mënyra sesi një shoqëri e caktuar i ka menaxhuar apo i menaxhon këto hapësira, flet shumë edhe mbi vetë mënyrën sesi kjo shoqëri funksionon dhe mbi vlerat që ajo mbart³⁰.

c) Tipare të përgjithshme të hapësirave periurbane

Gjatë përmbledhjes së literaturës në dispozicion mbi hapësirat periurbane, vihen re disa karakteristika kryesore të tyre, të përsëritura thuajse në të gjitha studimet e realizuara. Kështu, ato konsiderohen si *zona dinamike ndryshimesh* në këndvështrimin ekonomik, social e mjedisor dhe karakterizohen nga një qarkullim i njerëzve, mallrave dhe ideve. Ato dallohen gjithashtu për rritjen e vazhdueshme të popullsisë, copëzimin e tokës dhe larminë e formave të përdorimit të saj, diversitetin social dhe ekonomik, probleme mjedisore të mprehta, mungesë të infrastrukturës dhe shërbimeve dhe të rregullimit në përgjithësi³¹. Pra vihet re se HPU shpesh mbartin një nënkuptim (konotacion) gati-gati negativ, kur përmenden apo flitet për to³².

Pavarësisht mundësive që ofron, zona e kontaktit periurban është *pak e njohur*, e kontestuar, shpesh e përcmuar dhe e margjinalizuar, sidomos në aspektin social (papunësi, varfëri, shërbime sociale të pamjaftueshme dhe të dobëta), ekonomik (zhvillime kaotike dhe konflikte mbi përdorimin e tokës), infrastrukturor (mungesë e theksuar e rrjeteve të infrastrukturës fizike: rrugë, ujësjellës, kanalizime, energji elektrike, etj.) dhe mjedisor

²⁹ Joe Ravetz, et al; *The dynamics of peri-urbanization*, Springer-Verlag, Berlin Heidelberg 2013, fq.13

³⁰ Gordon Clark; Routledge, London 1999, 301-309.

³¹ Fiona Marshall, et al; *STEPS Working Paper 35*, Brighton - STEPS Centre 2009, fq.4

³² David L. Iaquinta dhe Axel W. Drescher; *Land Reform 2000/2*, FAO; fq. 8-26

(degradim i mjedisit si rrjedhojë e abuzimit me tokën, bimësinë, ujin, hedhjen vend e pa vend të mbetjeve urbane dhe ujërave të përdorura).

Është pikërisht *ndryshimi i përdorimit të tokës* në hapësirat periurbane (kthimi gradual nga hapësira rurale në urbane) që sjell edhe *problemet kryesore mjedisore* si ndotje të ajrit dhe ujit. Një rol të rëndësishëm në këto hapësira, luan sektori ekonomik informal si dhe bujqësia urbane³³.

Tjetër tipar i tyre është *heterogjiniteti social*: në HPU jetojnë së bashku fermerët e vegjël, banorët informal, sipërmarrësit industrial dhe shtresa e mesme dhe e lartë suburbanë; të cilët kanë interesa, zakone dhe perceptime të ndryshme mbi territorin ku gjenden³⁴.

Rritja e shpejtë e popullsisë është karakteristika më e përbashkët e HPU; ato janë prodhuese të rëndësishme bujqësore në shumë vende, resurset natyrore të të cilave shfrytëzohen në mënyrë të paqëndrueshme. Ato janë ndër zonat më të kontestuara në botë, kanë larmi në përdorimin e tokës, përzierje dhe shkrije të kufinjve administrativ, janë dinamike dhe luajnë një numër të madh funksionesh. Në shumë vende HPU janë nën një trysni të jashtëzakonshme ndryshimi ku përmendim faktorë të tillë si rritja e popullsisë, migrimi, suburbanizimi, copëzimi i tokës dhe ndryshimi i formave të përdorimit të saj, etj³⁵.

Një tjetër karakteristikë e evidentuar e tyre është edhe *fragmentizimi institucional*, si dhe paqartësia dhe mbivendosja e roleve dhe autoriteteve qeverisëse qendrore dhe lokale, urbane dhe rurale³⁶.

1.1.2. Tipet e zhvillimit periurban

Vihet re se ka një larmi të zhvillimit periurban gjatë shekullit të XX në shkallë botërore. Së pari, ka dallime të qarta të tipareve të hapësirave periurbane në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim. Kështu, nëse tek të parat ka mbizotëruar rurbanizimi³⁷ (ose suburbanizimi) si proces, në vendet në zhvillim ka mbizotëruar eksodi (migrimi) rural, ose urbanizimi rural. Pra, nëse në vendet e zhvilluara, në procesin e formimit të periferisë urbane mbizotërojnë shtresat e pasura dhe të mesme të popullsisë, të shtyra nga dëshira për të pasur një mjedis më cilësor jetese; në vendet në zhvillim ndodh e kundërta: domethënë janë shtresat e varfra që e mbizotërojnë atë³⁸.

Edhe sipas UNPF³⁹, theksohet se zgjerimi urban përfshin suburbanizimin dhe periurbanizimin; tek ky i fundit, në krahasim me zonat suburbane, larmia e veprimtarive ekonomike është më e madhe; periferia ofron infrastrukturë, tokë dhe punë më të lirë, duke inkurajuar periurbanizimin⁴⁰.

³³ University of Nottingham & University of Liverpool ; *Final Technical Report*, Natural Resource Systems Programme, 1999; fq. 40,70

³⁴ Adriana Allen; *Environment&Urbanization Vol 15, No 1*, April 2003

³⁵ Michael Buxton et al; RMIT University, Melbourne 2006, fq. 250

³⁶ Fiona Marshall, et al; *STEPS Working Paper 35*, Brighton - STEPS Centre 2009, fq.6

³⁷ Zhvendosja e popullsisë nga qyteti në zonat rurale përreth tij.

³⁸ Sonia Hirt; *Urban Geography* 2007, 28, 8; fq. 755-780

³⁹ United Nations Population Fund: *Fondi i Popullsisë së Kombeve të Bashkuara*

⁴⁰ United Nations Population Fund; New York 2007, fq.48

Sipas autorëve Webster dhe Muller, dallohen këto karakteristika kryesore të procesit të zhvillimit të HPU në shkallë rajonale dhe botërore⁴¹:

1. *Në Afrikë*, procesi i periurbanizimit drejtohet nga migrimi rural, nxitur nga faktorë të ndryshëm si mungesa e tokës, papunësia, zhvendosja e popullsisë apo pasiguria; në HPU të qyteteve afrikane, bujqësia urbane dhe sektori ekonomik informal, janë burim i rëndësishëm të ardhurash.
2. *Në Amerikën V.* kemi shfaqjen e qytetit skajor (*edge city*), si një dukuri e re e HPU gjatë 20 viteve të fundit, sidomos në zonat bregdetare. Këtu ekonomia bazohet kryesisht tek sektori i shërbimeve dhe tregtia, dhe vihet re gjithashtu një lloj autonomie (politiko-ekonomike) e qytetit periferik në raport me qendrën urbane.
3. *Në Azi*, periurbanizimi në qytetet e mëdha të vendeve me zhvillim të fuqishëm ekonomik gjatë kohëve të fundit - sidomos në Azinë JL dhe në qytetet bregdetare të Kinës, është i nxitur fuqishëm nga investimet e huaja, pra bazohet tek zhvillimi industrial dhe nevoja për krah pune e tij. Këtu shfaqet edhe dukuria e “desakotës” (qytetit-fshat), të cilin e kemi përmendur më sipër. Kjo hapësirë e veçantë periurbane dallohet për një përzjerje të veprimtarisë bujqësore me atë industriale dhe me vendbanimet (si psh në Xhakartë, Bangkok, etj).
4. *Në Amerikën Latine*, periurbanizimi i dikurshëm i nxitur nga migrimi ruralo-urban, thuhet se ka përfunduar, pas ngopjes së qyteteve me popullsi të re. Këtu vihet re krijimi i hapësirave periferike urbane në formë getosh (*favelas*), si në rastin e qyteteve të mëdha të Brazilit (Rio de Zhanerios, etj); por nga ana tjetër ka edhe shenja të suburbanizimit të tipit perëndimor.
5. *Rajonet metropolitane ndërkufitare*, karakterizohen nga një variant i veçantë i periurbanizimit që ndodh përgjatë kufinjve shtetëror, ku qendra e qytetit ndodhet në një shtet tjetër, kurse HPU e tij në zonën periurbane (periferike të tij) në anën tjetër të kufirit, pra në një shtet tjetër (si psh mes SHBA-së dhe Meksikës), etj.
6. Përsa i takon *Europës*, vihet re se ka dallime në zhvillimin e procesit të urbanizimit dhe periurbanizimit mes vendeve të Evropës P dhe Evropës L, kjo edhe për shkak të sistemeve të ndryshme ekonomike dhe politike që zbatuan ato gjatë 40 viteve. Kështu periurbanizimi dhe qytetet, në vendet ish-socialiste të Evropës Lindore gjatë komunizmit, ishin mjaft të ndryshëm nga ato të Perëndimit. Një dallim kryesor ishte se qyteteve të Lindjes u mungonte periferia suburbane, domethënë hapësira urbane ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me atë rurale. Por, që nga viti 1990, qytetet e Evropës Lindore kanë përjetuar rritje të konsiderueshme të popullsisë në zonat periurbane. Shumë studiues janë ngutur ta quajnë këtë proces si “suburbanizim”, duke i dhënë karakteristika të ngjashme me qytetet Perëndimore. Në fakt, ky emërtim nuk është plotësisht i saktë. Suburbanizimi është vetëm një nga arsyet e rritjes periurbane, ashtu si edhe urbanizimi rural, por në vendet ish-socialiste të dyja këto procese janë zhvilluar pothuajse në të njëjtën kohë. Ndërkohë, është vërejtur se procesi i urbanizimit i ka prekur këto vende në mënyra të ndryshme, duke shpalosur shpesh herë karakteristika të veçanta

⁴¹ Douglas Webster; Larissa Muller; *Human settlement development -Vol.1*, Encyclopedia of Life Support Systems 2002

zhvillimi në secilin prej tyre. *Tre janë skenarët e mundshëm të zhvillimit periurban në vendet ish-socialiste*⁴²:

- a) suburbanizim i tipit perëndimor;
- b) rurbanizimi - lëvizja e popullsisë urbane drejt periferisë së qyteteve për shkak të pamundësisë së përballimit të jetesës në pjesën e brendshme të qytetit
- c) urbanizim rural, si rezultat i eksodit rural, që është tipik për vendet në zhvillim.

Edhe pse procesi i periurbanizimit mes vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim paraqet karakteristika të ndryshme, ai ka gjithashtu edhe ngjashmëri: së pari këto zona skajore janë në dinamizëm, ku struktura ekonomike dhe e punësimit ndryshon; ka rritje të popullsisë dhe vlerës së tokës, zhvillim dhe përdorim të larmishëm të territorit; probleme të ndryshme mjedisore dhe sociale, planifikimi nuk i përshtatet tipareve të tyre origjinale⁴³.

Ndërkohë, *autorët Iaquina dhe Drescher*, paraqesin një tipologji më të përgjithshme të klasifikimit të HPU (ndër të paktat që hasim në shqyrtimin e literaturës), lidhur edhe me kontekstin e tyre institucional, demografik dhe mënyrën sesi janë prekur nga urbanizimi⁴⁴. Kështu, ata dallojnë 5 tipe të HPU:

- a) *HPU rurale* (peri-rural), hapësira rurale me një ndërgjegje urbane: kjo kategori u referohet zonave që gjeografikisht nuk janë edhe aq afër qytetit, por që gjithsesi ndihen urbane. E thënë thjesht, përcaktimi i tyre si HPU qëndron më tepër në aspektin socio-psikologjik, sesa në atë gjeografik. Numri dhe dendësia e popullsisë së tyre është e ulët, dhe shumë nga banorët merren me bujqësi. Në aspektin institucional ato paraqiten të qëndrueshme dhe tradicionale.
- b) *HPU heterogjene* (diffuse peri-urban), të krijuara nga ardhja e migrantëve nga zona të ndryshme, por që janë vendosur në afërsi të qyteteve. Si rezultat ato paraqiten nga një larmi etno-sociale dhe kulturore dhe mbartin më shumë potencial për krijimin e konflikteve; prandaj krijimi i një identiteti kolektiv është shumë i rëndësishëm për to. Karakteristikë tjetër domethënëse e tyre është mungesa e institucioneve formale.
- c) *HPU zinxhir* (chain periurban), të krijuara nga vendosja e popullsisë me origjinë të ngjashme, por në periudha të ndryshme. Si rezultat ato paraqesin më shumë homogjenitet, dhe konsiderohen ndryshe edhe si “fshatra urban”. Paraqiten të qëndrueshme dhe me më pak potencial për krijimin e konflikteve, megjithatë vendosja në një territor të ri e bën të nevojshme rindërtimin e identitetit për to.
- d) *HPU të krijuara si rezultat i zgjerimit të qyteteve* (in-place periurban); ato gjenden pranë tyre dhe janë krijuara si rezultat i shtrirjes natyrale të zonave urbane në hapësirën e tyre periferike por edhe si rezultat i migrimit të dyanshëm (si nga qyteti, ashtu edhe nga zonat rurale). Këto lloj HPU

⁴² Sonia Hirt; *Urban Geography* 2007, 28, 8; fq. 755-780

⁴³ Riley Smith; *Peri-urbanization: what is it and why is it happening*, aksesuar në faqen: <http://www.celsias.co.nz/article/peri-urbanization:what-is-it-and-why-it-happening>, më 04.11.2012

⁴⁴ David L.Iaquina dhe Axel W. Drescher; *Land Reform* 2000/2, FAO; fq. 8-26

gjenden në prag të thithjes (asimilimit) nga qyteti dhe riklasifikimit administrativ të tyre.

- e) *HPU të asimiluara*, përbëjnë kategorinë e fundit të këtij klasifikimi. Këtu bëjnë pjesë zona që kanë qenë nën ndikimin urban prej kohësh, dhe që më përpara kategorizoheshin në tipin C dhe D të HPU. Ato tashmë janë administrativisht, politikisht dhe psikologjikisht pjesë e qyteteve; por ato përmenden këtu si HPU, për shkak se mënyra e organizimit të tyre institucional është më e lidhur me mjedisin periurban, sesa me atë urban.

1.1.3.Strategjitë menaxhuese

Duke pasur parasysh gjithë karakteristikat e lartpërmendura të HPU, ndër strategjitë kryesore menaxhuese të tyre, përmendet së pari planifikimi ose *hartimi i master-planeve, pra planeve rregulluese të territorit*. Gjithashtu theksohet se janë përdorur me sukses edhe një strategji të tilla, si:

- a) kontrollimi (zbutja) e rritjes urbane
- b) rritja e rolit të qyteteve të vegjël dhe të mesëm në zhvillimin rajonal⁴⁵
- c) sigurimi i strehimit më kosto të ulët për të ardhurit dhe përmirësim (urbanizim) i kushteve të jetesës së zonave informale
- d) forcimi i kapaciteteve të qeverisjes lokale, promovimi i decentralizimit financiar dhe qeverisës dhe shfrytëzimit të kapaciteteve lokale⁴⁶.

Dy nga strategjitë më të përdorura për të mbrojtur tokën bujqësore nga urbanizimi, sidomos në vendet e zhvilluara, janë kufinj të zhvillimit urban dhe “brezat e gjelbër”⁴⁷.

Gjithsesi duhet thënë se HPU janë komplekse, shpesh herë unike (sipas kontekstit lokal), të larmishme në karakteristikat e tyre, dhe prandaj nuk mund të kenë një zgjidhje të vetme. Mozaiku natyror (urban dhe rural) i peisazhit dhe diferencimi shoqëror, së bashku me ndërvendosjen e kompetencave institucionale, kontribuojnë në këtë larmi⁴⁸.

Së fundi, theksohet se nevojitet një planifikim i ri që t’u përshtatet tipareve të tyre origjinale. Kështu Allen, vë në dukje faktin se menaxhimi dhe planifikimi i HPU kërkon një qasje të ndryshme konceptuale dhe metodologjike nga ajo tradicionale e hapësirave urbane apo rurale, duke përfshirë një këndvështrim më të gjerë, pra një kombinim të praktikave urbane, rurale dhe rajonale të planifikimit⁴⁹.

⁴⁵ Cecilia Tacoli; *Rural-urban interactions: a guide to the literature*, Environment and Urbanization, Vol.10, nr 1, April 1998, fq. 152

⁴⁶ University of Nottingham & University of Liverpool; *Literature review on Peri-urban Natural Resource Conceptualization and Management Approaches*, Final Technical Report, Natural Resource Systems Programme, 1999; fq. 86

⁴⁷ Michael Buxton et al; *Change and continuity in peri-urban Australia: state of the peri-urban regions: a review of the literature*; RMIT University, Melbourne 2006, fq. 95

⁴⁸ Riley Smith; *Peri-urbanization: what is it and why is it happening*, aksesuar në faqen: <http://www.celsias.co.nz/article/peri-urbanization:what-is-it-and-why-it-happening>, më 04.11.2012

⁴⁹ Adriana Allen; *Environmental planning and management of the peri-urban interface: perspectives on an emerging field*, Environment&Urbanization Vol 15, No 1, April 2003

I.2. Zhvillimi i hapësirave periurbane dhe procesit të periurbanizimit në Shqipëri

I.2.1. Një vështrim historik i procesit të periurbanizimit në Shqipëri

Edhe pse periurbanizimi është përgjithësisht një dukuri e pas viteve '90, disa tendenca të krijimit të hapësirave periurbane në Shqipëri janë shfaqur më herët, gjatë periudhës socialiste. Kjo shprehet në zhvillimet demografike dhe migrimin e brendshëm të popullsisë në periudha të ndryshme, para vitit 1990.

- Kështu, gjatë periudhës 1945-1990, popullsia e Shqipërisë u rrit nga një në tre milion, ndërsa lëvizja e brendshme e popullsisë, sidomos drejt qyteteve u tolerua disi vetëm në periudhën 1945-1960, kur ndodhi edhe rritja më e madhe e popullsisë urbane në sistemin totalitar, nga 20% në 31%. Migrimi u drejtua kryesisht drejt zonave periferike të qyteteve të reja industriale, për të plotësuar nevojat për krah pune. Kjo fazë mund të konsiderohet si fazë fillestare e periurbanizimit në Shqipëri⁵⁰.


- Gjatë periudhës 1960-1989, lëvizja e brendshme e popullsisë, veçanërisht drejt qyteteve thuajse u ndalua (edhe me kufizime administrative, si pengesat e shumta për pasaportizim në qytet) dhe, si rrjedhojë, popullsia urbane u rrit vetëm me 5%, kryesisht nga shtimi natyror i popullsisë urbane ekzistuese. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe është zhvilluar një lloj tjetër migrimi, ai ruralo-rural, që u tolerua më shumë nga regjimi dhe, si rrjedhojë ndodhi rritja e dendësisë së popullsisë në fshatrat dhe ish-fermat bujqësore që ndodheshin më pranë qendrave të mëdha urbane, sidomos Tiranës dhe qyteteve të tjera të mëdha. Këtë proces, O. Sjoberg e ka quajtur "*migrimi i shmangur*", i cili u zhvillua deri diku në rrugë jozyrtare, duke çuar në krijimin e vendbanimeve jashtë-urbane (njerëzit jetonin në fshat dhe punonin në qytet)⁵¹. Ky proces mund të ndihmojë për të shpjeguar shkallën e lartë të migrimit të popullsisë drejt kryeqytetit pas vitit 1990⁵². Gjithsesi, periurbanizimi i vërtetë në Shqipëri lidhet me migrimin e brendshëm (dhe deri diku të jashtëm) të popullsisë pas vitit 1990.

⁵⁰ Martin Schuler et al; në *Socio-demographic statistics in Albania: selected topics and future developments*, Instat, Tiranë 2010, fq. 129

⁵¹ Orjan Sjoberg; *Geografiska Annaler*, Series B, Human Geography, Vol. 74, No. 1 (1992), fq. 3-19

⁵² Erka Çaro; *Disertacion*, Rijkuniversiteit, Groningen 2011, fq. 2

Figure. 2.3 Population densities in the villages of Tirana



Source: Alihmeti, 1986 cited by Sjöberg, 1992: 13

Figura 2: Dendësia e popullsisë në fshatrat e Tiranës (v.1986) sipas Alimehmetit, cituar nga Sjöberg

Pas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit politik dhe ekonomik, Shqipëria përjetoj valë migrimesh të vrullshme. Kjo dukuri, qëndron në themel të zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale të Shqipërisë gjatë 22 viteve të fundit. Migrimi i brendshëm, ndodhi si një fazë e dytë, pas atij të jashtëm (i dyti financoi të parin). Të dy së bashku çuan në ulje të numrit të popullsisë në vend dhe në rishpërndarjen hapsinore të saj⁵³. Kështu, në vitin 2011 Shqipëria kishte 2,8 milion banorë ose 11% më pak se në vitin 1990. Po gjatë së njëjtës periudhë, llogaritet që 20% e popullsisë të ketë lëvizur brenda vendit, kryesisht nga zonat malore, drejt qendrave më të mëdha urbane të Ulëtësirës Perëndimore, veçanërisht drejt kryeqytetit. Si rezultat, në zonat urbane jetonte 42% e popullsisë së vendit në vitin 2001 dhe 54% në vitin 2011⁵⁴.

Procesi i urbanizimit në Shqipëri pas vitit 1990, pavarësisht ngjashmërive me vendet e tjera ish-socialiste, është unik, si për ritmet e larta, edhe për periudhën e shkurtër që ndodhi. *Më shumë se kudo tjetër, transformimet hapësinore dhe urbane u shprehën në rrethinat e qyteteve më të mëdha shqiptare të Ulëtësirës Perëndimore, jashtë kufirit administrativ të tyre, në të ashtuquajturat zona peri-urbane.* Janë pikërisht këto hapësira, me ndërtime kryesisht joformale, ku ka ndodhur shtrirja e vendbanimeve dhe rritja demografike më e madhe, dhe ku konfliktet ligjore dhe politikat e rregullimit të territorit ndërthuren, në mënyrë përgjithësisht të paqartë. Në formimin e tyre ndikuan: urbanizimi i shpejtë, mungesa e administrimit të tokës dhe planifikimit hapësinor, marginalizimi i grupeve të caktuara sociale, burokracia, legjisllacioni i mangët si dhe mungesa e vullnetit politik⁵⁵.

Pra vëmë re se periurbanizimi është një proces i vonshëm në Shqipëri, dhe përcaktohet nga shfaqja e një zone të banuar jo domosdoshmërisht të vazhdueshme. Ky

⁵³ Erka Çaro; *Dizertacion*, Rijkuniversiteit, Groningen 2011, fq. 31

⁵⁴ INSTAT; *Të dhënat paraprake të Censurit 2011*, Tiranë 2012

⁵⁵ Marcela Mele; *Disertacion*, University of Hull 2010, fq. 60

proces ndodhi si rezultat i braktisjes së sistemit të planifikimit urban të mëparshëm, nën ndikimin e një rritjeje të fuqishme të popullsisë në zonat urbane. Qoftë banorët e ardhur nga zonat rurale, qoftë elita urbane me të ardhura të mira, është vendosur në njësitë vendore jashtë qendrave urbane tradicionale. Komunitat e vendosura në skajet e zonave urbane mund të diferencohen nga grupet sociale: shtresa me të ardhura më të ulëta në zonat suburbane përgjatë rrugëve kryesore të transportit dhe në zonat e dikurshme industriale, dhe shtresa me të ardhura më të larta në komunitat me kushte më të mira jetese në zonat bregdetare dhe kodrinore⁵⁶.

Disa nga vendbanimet më të mëdha informale të krijuara në zonat periurbane gjatë kësaj periudhe janë: Kamza, Selita, Shkoza (Tiranë), ish-këneta dhe zona e plazhit (Durrës), si dhe periferia e Fushë Krujës, Kurbinit, Lezhës, Elbasanit, Shkodrës, Fierit, Vlorës dhe Sarandës⁵⁷. Këto ndërtime u bënë kryesisht mbi ish-tokat e fermave shtetërore dhe të ish-kooperativave, por dendësia nuk është e lartë sa ato të urbanizohen zyrtarisht.

Zhvillimet më të vrullshme ndodhën pikërisht në kryeqytetin e vendit - Tiranë, dhe në hapësirat periferike të saj, duke e bërë atë një rast unikal të urbanizimit në Europë, të paktën gjatë dy dekadave të fundit. Prandaj po e trajtojmë më konkretisht rastin e zhvillimit të HPU në kryeqytet, që siç e kemi theksuar ka marrë edhe vëmendjen më të madhe nga studiuesit.

1.2.2. Dinamika e zhvillimeve në hapësirën periurbane të Tiranës

Tirana mund të konsiderohet si një pol tërheqës i popullsisë në Shqipëri që në momentin e shpalljes së saj si kryeqytet i vendit. Këtë e tregon vetë rritja e popullsisë së saj në vite: 10.000 banorë në v. 1918, 35.000 në v. 1937, 60.000 në v. 1945, 137.000 në v. 1960, 300.000 në (v. 1992) dhe 800.000⁵⁸ sot⁵⁹. Rritja më e madhe ndodhi pikërisht pas vitit 1990, në të gjithë hapësirën periferike të saj, por veçanërisht në Kamzë dhe Bathorë, të cilat mbahen si shembull i urbanizimit të egër në Shqipëri (fig. 3).

Tokat e fermave shtetërore në periferi të Tiranës (Kamzë, Babrru, Sauk, Selitë, Yzberisht, etj.) u zunë gradualisht nga ndërtimet, duke zëvendësuar qindra hektarë toke të dikurshme të mbjellë me vreshta, drufrutorë dhe serra⁶⁰. Ato i janë bashkëngjitur qytetit, duke u zhvilluar horizontalisht. Kanë shërbime sociale dhe infrastrukturë të kufizuara, ndërsa banesat janë të mira, përgjithësisht individuale dhe të tipit “vilë”, të ndërtuar nga dërgesat e emigrantëve⁶¹. Kamza⁶² kishte 6000 banorë në v. 1990 dhe 54.000 në v. 2002, ndërsa sot ka 75.000 banorë. Bashkia Kamzë përbëhet nga disa njësi administrative si: Qendra, Bathorja dhe pesë njësi rurale (Valias, Valias i Ri, Laknas, Zall Mner dhe Bulçesht). Bathorja është vendbanim joformal, me mbi 30.000 banorë, por me mungesë të infrastrukturës dhe shërbimeve, pasiguri të pronësisë, papunësi, edukim të ulët dhe ndjesi përjashtimi.

⁵⁶ Martin Schuler et al; Instat, Tiranë 2010, fq. 130

⁵⁷ Banka Botërore; *Vlerësim i sektorit urban në Shqipëri*, World Bank Office, Tiranë 2007.

⁵⁸ Rajoni metropolitan.

⁵⁹ Bashkia Tiranë; *Vlerësim strategjik dhe mjedisor i planit rregullues të Tiranës*, Tiranë 2012

⁶⁰ Felstehausen, H; *Working Paper nr. 31 - Albanian Series*, Land tenure Center, University of Wisconsin Madison, USA, 1999,

⁶¹ Jorida Cila; *Erasmus University, MSc Thesis*, Rotterdam 2006, fq.34

⁶² Kamza u shpall qytet në vitin 1996.




Figura 3: Hapësira periurbane e Tiranës; në të majtë - shtrirja e vendbanimeve informale, në të djathtë – Bathorja

Në vitin '90 ishte destinacioni kryesor i migrimit të brendshëm, pasi ndodhej pranë kryeqytetit dhe rrugëve kryesore, kishte tokë të lirë e pak të kushtueshme. Migrimi ishte i tipit familjar (zinxhir), me prejardhje heterogjene, por me mbizotërim të popullsisë së varfër nga rajoni verilindor. Evidentohen dy valë ardhjesh: 1991-1992 dhe 1997-1998⁶³. Pavarësisht përmirësimit të situatës gjatë viteve, varfëria në këto zona mbetet e pranishme (sidomos në krahasim me zonën urbane) dhe jetesa sigurohet me vështirësi nëpërmjet një larmie veprimtarish (kryesisht në sferën joformale), ku kontribuojnë të gjithë anëtarët e familjes⁶⁴. Në përgjithësi banorët e ardhur, shprehen më të kënaqur me jetesën tani, pavarësisht problemeve me të cilat përballen çdo ditë⁶⁵.

Duhet theksuar se një kontribut të rëndësishëm në njohjen e gjendjes dhe menaxhimin e zhvillimit të pakontrolluar informal të zonës së Kamzës dhe Bathores kanë dhënë edhe OJQ të ndryshme dhe veçanërisht Co-PLAN⁶⁶, i cili që ndër të parët që u mor me problematikat e këtyre zonave, duke filluar nga v. 1995. Në bashkëpunim edhe me komunitetin dhe qeverisjen lokale, Co-PLAN kontibuo i në përmirësimin e gjendjes infrastrukurore dhe social-ekonomike të këtyre vendbanimeve, edhe nëpërmjet implementimit të programeve strategjike të zhvillimit urban, ndër të parët në Shqipëri⁶⁷; duke shërbyer si një model i mirë për t'u ndjekur edhe në zona të tjera me të njëjtat problematika. Ndërsa sot është ALUIZNI⁶⁸, që ka marrë përsipër të realizojë legalizimin dhe urbanizimin e vendbanimeve informale, që gjenden kryesisht në zonat periurbane.

⁶³ Erka Çaro; Dizertacion Rijkuniverteit, Groningen 2011, fq. 31

⁶⁴ Deda, L; Tsenkova, S; *Poverty and inequality in Greater Tirana: the reality of peri-urban areas*, Physica –Verlag, 2006, fq 151-173

⁶⁵ Jorida Cila; Erasmus University, MSc Thesys, Rotterdam 2006, fq.61

⁶⁶ Co-PLAN, *Instituti për zhvillimin e habitatit*, website www.co-plan.org

⁶⁷ Besnik Aliaj et al: “*Tirana: The Challenge of Urban Development*”, CETIS, Tirana 2003

⁶⁸ ALUIZNI (*Agjensia për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave Informale*), krijuar në v. 2006


I.3. Hapësira periurbane e Shkodrës, përcaktimi i saj dhe studimet e deritanishme

I.3.1. Përcaktimi i HPU të Shkodrës

Siç e përmendëm edhe më sipër, termi “periurban” mbetet disi subjektiv dhe i vështirë për t’u përkufizuar dhe përcaktuar; megjithatë në përcaktimin e hapësirës periurbane të Shkodrës në këtë studim, ne kemi marrë parasysh këto kritere kryesore:

- ekzistencën e një hapësire territoriale që gjendet pranë qytetit të Shkodrës, pra që kufizohet me të; duke përmbushur kështu kriterin e parë të përkufizimit të HPU që kemi trajtuar
- përfshirjen e një njësie të vetme administrativo-territoriale; kjo edhe për arsye studimore, duke plotësuar edhe kriterin e rastit studimor
- studimin e një njësie administrative rurale (por që gjendet në periferi të qytetit), meqë ndryshimet më të mëdha në zonat periurbane të vendit tonë, gjatë këtyre 20 viteve, kanë ndodhur në territorin e ish-fërmave të dikurshme bujqësore që kishin në dispozicion tokë të lirë.

Të gjitha këto kritere i plotëson më së mirë në rastin tonë, komuna “Rrethinat”, e cila siç kuptohet nga vetë emri, e rrethon pothuajse nga të gjitha anët bashkinë e Shkodrës, klasifikohet zyrtarisht si njësi administrative rurale dhe njëkohësisht ka përjetuar ndryshime drastike në aspektin social-ekonomik, mjedisor dhe të përdorimit të territorit gjatë 20 viteve të fundit. Pra ajo mund të identifikohet qartë, si HPU e qytetit të Shkodrës dhe është zona që ne kemi marrë në studim.



Harta 1: Pozicioni gjeografik i komunës Rrethinat në periferi të qytetit të Shkodrës

1.3.2.Studimet e deritanishme mbi hapësirën periurbane të Shkodrës

Kjo pjesë e rëndësishme përbërëse për çdo temë disertacioni, në rastin tonë paraqet një kontekst specifik, sepse në fakt studimet e mëparshme dhe të posaçme për zonën në fjalë (jo vetëm gjeografike), pothuajse nuk ekzistojnë. Kështu, gjatë gjithë punës sonë kërkimore të këtyre viteve, duke hulumtuar në arkiva, biblioteka apo duke folur drejtpërdrejt me banorët e zonës dhe persona të kualifikuar që e njohin atë, ne nuk kemi arritur të gjejmë një studim të mirëfilltë të realizuar për këtë hapësirë që kemi marrë në studim.

Kjo gjë mund të shpjegohet deri diku me faktin se në përgjithësi zona në fjalë, është një zonë e re, heterogjene dhe pa shumë identitet, e cila u krijua si njësi e veçantë administrative relativisht vonë, në v.1992. Siç duket deri vonë nuk ka pasur ndonjë arsye të veçantë që të zgjonte interesin e studiuesve; e për pasojë ajo ka mbetur larg vëmendjes së tyre dhe e mënjanuar.

Duhet thënë se edhe ato pak studime në të cilat flitet për HPUSH janë realizuar para v.1990, dhe në kuadrin e trajtimit të hapësirave më të gjera, pra edhe aty ku flitet për të, informacioni mbetet sipërfaqësor. Këto studime janë kryesisht të tipit historik apo autobiografik, të cinguara dhe sporadike, duke mos na dhënë shumë informacione të dobishme për atë që ne na intereson. Ato japin kryesisht të dhëna mbi historikun e popullimit të këtij territori dhe krijimit të vendbanimeve të tij; pak mbi historikun e arsimit dhe ndonjë informacion gjeografik; gjithmonë në kuadër të trajtimit të hapësirave më të gjera⁶⁹. Nga ana tjetër edhe pas viteve '90 vëmë re se nuk është realizuar ndonjë studim, qoftë edhe nga komuna apo nga ndonjë OJF⁷⁰ mbi HPUSH; të paktën deri më sot që flasim.

Për të gjitha këto arsye, studimi i kësaj hapësire paraqet në fakt një sfidë të vërtetë për çdo studiues, gjë të cilën e kemi vënë re shumë herë gjatë punës sonë. Kjo sepse thuhet për çdo gjë, na është dashur t'ia fillojmë nga e para.

Megjithatë theksojmë se kjo temë disertacioni është e përqendruar kryesisht në njohjen e karakteristikave të zhvillimit të HPUSH pas vitit 1990, periudhë gjatë së cilës ajo ka pësuar edhe ndryshimet më të rëndësishme; ndryshime të cilat ne besojmë se ia vlejnjë të studiohen për të kuptuar dhe njohur më mirë hapësirat periurbane në terësi dhe zonën tonë në veçanti.

⁶⁹ Në secilin kapitull dhe çështje të veçantë, ne do i përmendim dhe citojmë këto burime informacioni


⁷⁰ Organizatë Jofitimprurëse

Kapitulli i dytë

VEÇORITË FIZIKO-GJEOGRAFIKE DHE PASURITË NATYRORE TË HAPËSIRËS PERIURBANE TË SHKODRËS

II.1. Hapësira periurbane e Shkodrës: organizimi administrativ-territorial dhe pozita gjeografike

HPUSH, të cilën e njësuar më *komunën Rrethinat*⁷¹, është pjesë përbërëse e qarkut të Shkodrës dhe rrethit me të njëjtin emër dhe e ka nisur jetën e vet si njësi e veçantë administrative më 26 korrik 1992, kur u bë riorganizimi administrativ i fundit i Shqipërisë, pas ndryshimeve demokratike. Vetë rrethi i Shkodrës ka një sipërfaqe prej 1302.96 km² dhe është i ndarë administrativisht në 2 bashki - Shkodër dhe Vau i Dejës dhe 15 komuna - Ana e Malit, Bushat, Bërdicë, Dajç, Gur i Zi, Hajmel, Mnel-Vig, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shllak, Shosh, Temal, Velipojë; gjithsej 138 fshatra dhe 2 qytete⁷².




Harta 2: Pozicioni gjeografik i HPUSH në qarkun Shkodër

HPUSH përbëhet nga 10 fshatra, të cilët janë: 1.Bardhaj, 2.Bleran, 3.Dobraç, 4.Golem, 5.Guci e Re, 6.Grudë e Re, 7.Hot i Ri, 8.Shtoj i Ri, 9.Shtoj i Vjetër, 10.Zues. Sipërfaqja e saj është 47,05 km² dhe popullsia më 30.06.2012 zyrtarisht ishte 25119 banorë. Arsyeja që këta fshatra u bashkuan në një njësi të vetme administrative është pozicioni gjeografik i tyre në periferi të qytetit të Shkodrës. Ky pozicion gjeografik

⁷¹ Nga këtu e mbrapa, këto dy emërtime do i përmendim si sinonime të njëri-tjetrit

⁷² Burimi i referohet të dhënave zyrtare të vetë qarkut në faqen zyrtare: <http://www.qarkushkodër.org>

shpjegon edhe origjinën e emrit të komunës “Rrethina”, pasi ajo rrethon thuajse nga të gjitha anët qytetin më të madh verior të Shqipërisë.



Harta 3: Hartë administrative e HPUSH

- Evolucionit kohor i organizimit administrativ të HPUSH

Kuptohet që evolucionit i organizimit administrativ të vendbanimeve të HPUSH, ka ecur paralelisht me ndryshimet në shkallë kombëtare, sipas periudhave kohore përkatëse.

Kështu, të dhënat më të hershme të dokumentuara në lidhje me këtë na vijnë nga v. 1927⁷³ ku përmenden vetëm 4 fshatra të komunës sot: Dobraçi, Golemi, Shtoji dhe Zuesi, të cilët që të gjithë janë pjesë e prefekturës, nënprefekturës dhe krahinës së Shkodrës. Kurse në v. 1945⁷⁴, vihet re se Bardhajt, Dobraçi, Golemi, Gruda e Re, Gucia e Re, Shtoji i Ri, Shtoji i Vjetër dhe Zuesi (pra vendbanimet e njohura të komunës në atë kohë), janë pjesë e rrethit të Shkodrës dhe lokalitetit të qendrës. Edhe në v.1960, në

⁷³ Teki Selenica; *Shqipëria në v. 1927*, Tiranë 1928, fq. 370

⁷⁴ Arkiva Shkodër; *Rregjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i v. 1945*, tetor 2012

rregjistrimin përkatës të popullsisë ato vazhdojnë të jenë pjesë e së njëjtës ndarje administrative.

Në v.1986⁷⁵ dhe në v.1989⁷⁶, në prag të ndryshimeve demokratike, fshatrat Bleran, Grudë e Re, Guci e Re, Hot i Ri dhe Shtoj i Ri ishin pjesë e FB⁷⁷ Grudë e Re - rrethi Shkodër; fshatrat Dobraq dhe Golem, pjesë e FB Dobraq - rrethi Shkodër; Bardhajt pjesë e FB Mes - rrethi Shkodër; Shtoji i Vjetër pjesë e FB Grilë - rrethi Malësi e Madhe; dhe Zuesi pjesë e FB Oblikë - rrethi Shkodër.

- Pozita gjeografike, kufinj të dhe madhësia

Nga vetë emri që mban, kuptohet që komuna “Rrethinat” rrethon thuajse nga të gjitha anët qytetin e Shkodrës, duke përjashtuar pjesën Perëndimore të tij, ku si komuna ashtu dhe qyteti, lagen nga ujërat e liqenit me të njëjtin emër dhe nga lumi Buna. Territori i komunës përfshihet brenda këtyre koordinatave gjeografike të pikave ekstreme: në veri - 42°08' dhe në jug 42°01' gjerësi gjeografike veriore; në perëndim 19°26' dhe në lindje 19°35' gjatësi gjeografike lindore.

Ajo kufizohet në veri me komunën Gruemirë, në verilindje me atë të Postribës, në juglindje me komunën Gur i Zi dhe në pjesën jugore me bashkinë Shkodër dhe shumë pak me komunën Ana e Malit, nëpërmjet fshatit Zues, i cili duhet thënë se gjendet krejt i veçuar nga pjesa tjetër e komunës Rrethinat, e cila shtrihet kryesisht në verilindje të Shkodrës.

Territori i komunës përshkohet nga rrugët nacionale Tiranë - Hani i Hotit dhe Shkodër-Muriqan, të cilat në fakt janë edhe rrugë ndërkombëtare, pasi shërbejnë për të lidhur Shqipërinë me Malin e Zi; si dhe nga hekurudha e vetme ndërkombëtare e vendit tonë, që nëpërmjet pikës kufitare të Hanit të Hotit, e lidh atë me Evropën Qendrore.

Largësia e qendrës së komunës nga disa pika dhe vende strategjike që e rrethojnë është: komuna Rrethinat - Shkodër 2 km, komuna Rrethinat - Tiranë 95 km, komuna Rrethinat - Hani i Hotit 35 km dhe komuna Rrethinat - Podgoricë 65 km.



Foto nr. 1: Pamje e rrugës kombëtare Shkodër - Hani i Hotit dhe hekurudhës ndërkombëtare Tiranë - Hani i Hotit në territorin e HPUSH (D. Rustja)

⁷⁵ RPSSH; *Vjetari Statistikor i v. 1986*, Shkodër 1986

⁷⁶ *Rregjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i v. 1989*, Instat - Shkodër, tetor 2013

⁷⁷ FB – Fshat i Bashkuar (ndarje administrative e kohës)

II.2. Veçoritë fiziko-gjeografike dhe resurset natyrore


II.2.1. Veçoritë e relievit dhe ndërtimit gjeologjik të zonës

II.2.1.1. Relievi.

Si njësi fiziko-gjeografike komuna Rrethinat bën pjesë thuhet krejtësisht në fushën e Mbishkodrës, në pjesën jugore të saj. Përjashtim këtu bën fshati Zues, i cili shtrihet në pjesën juglindore të Taraboshit, pranë lumit Buna. Lartësia mbi nivelin e detit shkon nga 0 në 395 m. Nga ana gjeomorfologjike dallojmë tri njësi kryesore:

- Njësinë fushore
- Njësinë kodrinore
- Luginën e lumit Kir

a) *Njësia fushore* zë rreth 70% të sipërfaqes së përgjithshme të zonës. Përbëhet nga fusha e Shtoit, Dobraçit dhe Bardhajve.



Harta 4: Hartë fizike e HPUSH

Fushat e Shtoit dhe Dobraçit kanë të njëjtat karakteristika gjeomorfologjike, prandaj do t'i trajtojmë së bashku; ato njihen zakonisht me emërtimin e vetëm: fusha e Shtoit. Kanë një pjerrësi të vogël rreth 1%. Kuota e tyre lëviz nga niveli i liqenit të Shkodrës 6 deri 8 m dhe arrin në pjesën lindore rreth 40 m.

- **Fusha e Shtoit**⁷⁸, me gjatësi rreth 8 km dhe gjerësi 4 - 7.5 km, shtrihet në pjesën jugore të fushës së Mbishkodrës dhe kufizohet nga lumi Kir në juglindje dhe përroi i Vrakës në veriperëndim. Ajo është formuar pikërisht nga veprimtaria grumbulluese e tyre dhe veçanërisht nga depozitimet aluvionale të lumit Kir⁷⁹. Dallohet për një reliev të rregullt si rezultat i trashësisë shumë më të madhe të këtyre depozitimeve, të favorizuara dhe nga një fundosje relativisht më e madhe e bazamentit të saj nga tektonika bllokore. Kështu shkëmbinjtë rrënjësore karbonatike të kësaj pjese ndodhen të zhytur deri në një thellësi 80 m.

Për këtë fushë, siç e thamë, ka patur shumë rëndësi veprimtaria e lumit Kir, i cili ka formuar pjesën më të madhe të saj midis qytetit të Shkodrës dhe Bishtit të Qindisë që zgjatet në liqen në trajtën e një delte të dikurshme të Kirit. Sot ky lumë rrjell në skajin juglindor të fushës. Pikërisht lëvizjet e tij herë nga perëndimi për në liqen dhe herë nga jugu për në lumin Drin, kanë çuar në mbathjen e fushës. Shtrati i sotëm ka thellësi 6-8 m brenda depozitimeve aluvionale të tij⁸⁰.

Në luginën e tij dallohen edhe disa tarraca. Tarraca e parë shtrihet midis fshatrave Bardhaj dhe Dobraç (në këtë nivel tarrace përfshihet dhe qyteti i Shkodrës) në lartësinë 28-30m. Kurse tarraca e dytë shtrihet midis fshatrave Myselim dhe Hot i Ri në lartësinë 38-40 m (Stomi i Golemit). Këto nivele tarracash i kanë dhënë kësaj fushe një formë të shkallëzuar, ku shkalla e parë formohet midis bregut të liqenit dhe vijës Stomi i Golemit - Boriç (në lartësinë 5-38 m) dhe shkalla e dytë mbi këtë vijë deri në lartësinë 60 m. Në tarracën e parë mbizotërojnë rërat dhe argjilat lumore dhe liqenore, kurse në të dytën zhavorret lumore dhe deluvionet. Një gjë e tillë ka ndikuar edhe në trashësinë e tokës bujqësore dhe në aftësinë ujëmbajtëse të saj⁸¹. Relievi karstik që dominon në pjesën veriore të fushës së Mbishkodrës gjendet edhe këtu por i zhytur më në thellësi, pa forma të dukshme sipërfaqësore. Kjo gjë dëshmohet nga mungesa e rrjelljeve të tjera ujore përveç Kirit dhe Vrakës si dhe nga thatësira e vazhdueshme që e karakterizon këtë zonë. Nga ana gjeologjike ndërtohet nga depozitime të shkriфта të kuaternarit.

- **Fusha e Bardhajve** shtrihet në krahun e majtë të lumit Kir, në pjesën juglindore të zonës sonë. Ka një pjerrësi shumë të vogël, pothuajse horizontale. Kuota e saj është rreth 40-45m. Nga ana gjeologjike ndërtohet nga depozitime të shkriфта të kuaternarit të vonë.

⁷⁸ Mendohet se origjina e emrit të kësaj fushe ka të bëjë me stepat ruse, pasi kjo fushë ngjason me to: ky emërtim sllav (Shtojet) është përdorur si sinonim i tyre që nga viti 1940; *Fjalori enciklopedik nr. 3*, Tiranë 1985

⁷⁹ Perikli Qiriazhi, *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Tiranë 2001, fq. 310

⁸⁰ Mahir Hoti, *Studime gjeografike nr. 4*, Tiranë 1990, fq.163

⁸¹ Gjovalin Gruda, *Ultësira e Shkodrës*, në *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, ASHRSH, Tiranë 1991, fq. 456



Foto nr. 2: *Fusha e Shtoit* (në të majtë) dhe *e Bardhajve* (në të djathtë), (D.Rustja)

b) Njësia kodrinore zë rreth 30% të sipërfaqes së përgjithshme të zonës. Përbëhet nga kodrat e Bardhajve dhe nga shpati juglindor i vargmalit të Taraboshit.

a) *Kodrat e Bardhajve* zënë një sipërfaqe të kufizuar, duke u vendosur në skajin më juglindor të komunës. Kuotat e tyre lëvizin nga 54 m, kodra pranë varrezave të dëshmorëve, deri 190 m - kodra e Frashërit. Pra shohim se lartësia e tyre është e ulët, por në hapësirën e vogël dhe kryesisht fushore të zonës sonë, ato mund të dallohen si njësi e veçantë. Pjerrësia e shpateve është e butë nga 10-15° deri në 25°. Nga ana gjeologjike ndërtohen kryesisht nga shkëmbinj të masivit ultrabazik të Bardhanjorëve dhe më pak nga formacione ofiolitike të serisë efuzivo-sedimentare.

b) *Shpati juglindor i Taraboshit* zë pjesën kryesore të njësisë gjeomorfologjike kodrinore. Shtrihet në skajin jugperëndimor të zonës, pranë fshatit Zues. Kuota e tij është nga 5 m në breg të lumit Buna, deri 395 m - maja e Bajrakut, pika më e lartë e relievit në HPUSH. Shpati ka një pjerrësi të lartë deri mesatare dhe lëviz nga 20-25°, pjesa e poshtme e tij; deri në 30-35°, pjesa e sipërme. Nga ana gjeologjike ndërtohet nga formacioni flishor i paleogjenit i Krasta-Cukalit - pjesa e mesme dhe e poshtme e shpatit; dhe nga gëlqerorët e triasikut të sipërm të Alpeve Shqiptare - pjesa e sipërme e tij.



Foto nr. 3: *Kodra e Bardhajve* (në të majtë) dhe *e Zuesit* (në të djathtë), (D.Rustja)

c) Lugina e lumit Kir, mund të evidentohet gjithashtu si një njësi e veçantë fiziko-geografike, në territorin e komunës. Kjo luginë që fillon që nga Alpet, del në fushën e Mbishkodrës mbi fshatin Drisht duke humbur tiparet e një lumi malor. Këtu ajo është formuar në pjesën më të madhe mbi depozitimet e saj, të cilat formojnë terracat e lartpërmendura, derisa përfundon në luginën e lumit Drin, në juglindje të qytetit të Shkodrës, pasi kalon fshatin Bardhaj. Nga ura e Mesit, deri në hyrje të lagjes Tepe, kjo luginë dallohet për një zallishtore 250-300 m të gjerë. Rruga e dikurshme e lumit kalonte nëpër fshatrat Dobraq e Golem, në veri të qytetit të Shkodrës, duke përfunduar në juglindje të liqenit të Shkodrës (tek Bishti i Qindisë), gjë që vërtetohet nga depozitimet e shumta lumore, të përfaqësuara nga zhavorret⁸². Ndërsa sot, në territorin e komunës, ky lumë kalon pranë fshatrave Hot i Ri, Bardhaj, Bleran dhe Golem; por siç e thamë në të kaluarën ai e ka ndryshuar vazhdimisht shtratin e tij, duke qenë faktori kryesor i formimit të fushës së Shtoit.




Foto nr. 4: *Lumi Kir dhe zgjerimi i tij tek Ura e Bardhajve (D.Rustja)*

⁸² Mahir Hoti, *Veçoritë fiziko-geografike të fushës së Mbishkodrës*, Studime gjeografike nr. 4, Tiranë 1990, fq.163

II.2.1.2. Ndërtimi gjeologo-strukturor i zonës

a. Ndërtimi gjeologjik⁸³

Zona ku shtrihet komuna Rrethinat, nga ana gjeologjike, ka një larmi të gjerë formacionesh, si nga ana moshore ashtu edhe nga ajo litologjike. Kjo shpjegohet me faktin se në këtë territor takohen tri zona strukturoro - faciale: konkretisht zonat Mirdita, Alpet Shqiptare dhe Krasta-Cukali. Nga ana moshore këtu gjejmë depozitime që nga triasiku i sipërm deri në kuaternar.



Harta 5 : Ndërtimi gjeologjik i HPUSH

⁸³ Trajtimi i kësaj pjese është realizuar me ndihmën dhe bashkëpunimin e specialistëve të Ndërmarrjes Gjeologjike Shkodër dhe realizohet për herë të parë, posaçërisht për këtë zonë

Më poshtë po japim përshkrimin litologjik të këtyre depozitimeve:

- *Depozitimet e triasikut të sipërm (T_3)* zënë një sipërfaqe të kufizuar në këtë zonë. Ato shtrihen në veri të fshatit Zues, duke ndërtuar kuotat më të larta të shpatit JL të Taraboshit. Janë depozitime të zonës strukturoro - faciale të Alpeve Shqiptare.

Përfaqësohen nga shkëmbinj karbonatikë, kryesisht gëlqerorë dhe më pak gëlqerorë të dolomitizuar dhe dolomite. Janë shtresëmesëm, rrallë shtresëtrashë, ngjyrë gri të hapur, nganjëherë më nuanca rozë, me pamje konglobrekçioze. Paraqiten mjaft të karstëzuar. Kanë shtrirje verilindje - jugperëndim dhe rënie veriperëndimore, me kënde të butë 15 deri 25°. Kontaktojnë tektonikisht në formë mbihypje mbi flishin e zonës Krasta-Cukali. Trashësia e përgjithshme e triasikut të sipërm arrin deri në 900 m.

- *Depozitimet e paleogjenit të poshtëm-mesëm (Pg_{1-2})*. Këto depozitime ndërtojnë pothuajse gjithë shpatin jugor të vargmalit të Taraboshit pranë fshatit Zues dhe njëkohësisht dalin në formën e ‘‘pullave’’ të vogla në lindje të fshatit Bardhaj.

Përfaqësohen nga formacione flishore të zonës Krasta-Cukali. Ndërtohen nga ndërthurje të argjilave, mergeleve dhe ranorëve. Paraqiten me rrudhosje intensive, kanë ngjyrë kafe të errët, gri deri në gri të errët. Shtresëzat e ranorëve krijojnë relief pozitiv në shpatin e malit. Kontaktojnë tektonikisht në formë shariazhi me depozitimet karbonatike të triasikut të sipërm, në pjesën e varur të prerjes, duke u mbihypur nga ato; dhe me depozitimet flishore të zonës Kruja, në pjesën e shtruar të prerjes, duke mbihypur edhe mbi ato. Trashësia e përgjithshme e këtyre depozitime arrin deri në 900m.

- *Depozitimet e neogjen-kuaternarit (N_2-Q_p)*. Këto depozitime kanë përhapje të kufizuar. Shtrihen në formë të një brezi të zgjatur pranë kurrizores së vargmalit të Taraboshit, sipër fshatit Zues. Janë depozitime të mbetjeve kontinentale dhe ndërtohen nga përzierje të çregullta të argjilave, ranorëve dhe më pak të silicorëve. Janë depozitime të pa konsoliduara mirë, pra me çimentim të dobët. Vendosen transgresivisht mbi depozitimet karbonatike të triasikut të sipërm dhe flishit të paleogjenit.

- *Depozitimet e kuaternarit (Q)* shtrihen në qendër, veri dhe perëndim të zonës, duke ndërtuar gjithë pjesën fushore të saj, që nga brigjet e liqenit të Shkodrës në perëndim, deri në lindje, në kufirin ndarës me komunën Postrinë dhe shtratin e lumit Kir, së bashku më fushën e Bardhajve. Përfaqësohen kryesisht nga rëra, zhavorre, argjila e alevrite të pleistocen-holocenit. Për të patur një ide më të qartë për përbërjen e tyre në këto formacione i kemi detajuar me tej, duke patur parasysh përbërjen litologjike dhe moshën e tyre. Po i trajtojmë si më poshtë:

a) Sedimente aluviale të pleistocenit (al Qp_3)

Këto sedimente aluviale ndërtojnë pothuajse gjithë fushën e Shtojit në veri të zonës dhe pjesën veriore të fushës së Bardhajve, pranë lumit Kir, në formën e një brezi markues të tij. Përfaqësohen nga zhavorre karbonatike të madhësive të ndryshme deri në rëra të trasha e të përziara me material argjilor. Janë produkte proluviale të konit më të hershëm të depozitimit (glacies kontinentale) dhe shërbejnë si bazamente të depozitimeve të tjera më të reja. Meqënëse janë depozitimet më të vjetra të kuaternarit, nganjëherë paraqiten edhe gjysmë të çimentuara, duke u kthyer në formë konglomeratesh me çimentim shumë të dobët. Madhësia e zhavorreve shkon nga 3-20 cm. Trashësia e tyre në Ultësirën e Shkodrës arrin deri 120 m.

b) Sedimente të përzierra kontinentale (Qp₃-h)

Këto sedimente shtrihen në formë fragmentesh në verilindje, pranë fshatit Guci e Re, pranë bregut të lumit Buna në fshatin Zues dhe ndërtojnë pjesën kryesore të fushës së Bardhajve. Zakonisht vendosen si markues pranë shkëmbinjve të moshave të vjetra, në rrëzë të shpateve. Janë të moshës pleistocen i sipërm - holocen, të përfaqësuara nga një përzierje e çrregullt e depozitimeve kontinentale, aluvialo-koluvialo-proluviale, të ndërthurura me material të shumtë argjilor. Trashësia e tyre shkon deri në 10 m.

c) Depozitime aluviale të holocenit (al Qh).

Këto depozitime shfaqen në jug-jugperëndim të zonës. Ndërtojnë pjesën kryesore të fushës së Dobraç-Golemit dhe përfaqësohen kryesisht nga argjila dhe më pak nga zhavorre dhe rëra të ndërthurura në mes tyre. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin deri në 10 m.

d) Depozitime liqenore të holocenit (li Qh).

Këto depozitime shfaqen në formë brezi afro meridional në perëndim të zonës, pranë brigjeve të liqenit të Shkodrës dhe përfaqësohen nga alevrite dhe argjila. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin deri në 10 m.

e) Depozitime liqenore të holocenit (li Qh₂).

Këto depozitime shfaqen në kufirin ndarës me ujin e liqenit në formën e një brezi të ngushtë, me ndërprerje, përgjatë këtij bregu me shtrirje meridionale, dhe përfaqësohen nga zhavorre dhe rëra, duke ndërtuar të ashtuquajturat rëra të plazhit, kujtojmë plazhin e Bregut të Ranës.

f) Depozitime kënetore-liqenore (k-li Qh₂).

Këto depozitime shfaqen në perëndim të zonës, zonë e cila përmytet gjatë stinës së reshjeve nga ujrat e liqenit të Shkodrës, duke ndërtuar të ashtuquajturin Pylli i Dobraçit. Përfaqësohen nga torfa, llumra dhe argjila. Janë sedimente të reja dhe të pa konsoliduara mirë. Në to mbizotëron lënda organike në dekompozim e sipër. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin deri në 5 m.

g) Sedimente aluvialo - proluviale (al, Qh₂)

Këto sedimente ndërtojnë shtratin e lumit Kir dhe tarracat e shtratit të tij, të cilat herë pas herë mundet edhe të ndryshojnë pozicion brenda shtratit. Janë depozitimet me të reja të holocenit. Përfaqësohen kryesisht nga zhavorre dhe më pak nga rëra e alevrite. Trashësia arrin deri në 8 m.

- **Shkëmbinjtë magmatikë**, përfaqësohen nga formacionet e serisë efuzivo-sedimentare të zonës strukturoro-faciale Mirdita, dhe nga shkëmbinjtë ultrabazikë të po kësaj zone. Ndërtojnë kodrat e Bardhanjorëve, duke qënë pjesë e masivit ultrabazik të Bardhajve. Në zonën tonë këto formacione zënë një sipërfaqe të kufizuar në pjesën më juglindore të saj.

a) Formacionet e series efuzivo-sedimentare (J3ef-s) ndërtohen kryesisht nga rreshpe argjilo-silicore të karakterit radiolaritik dhe më pak nga diabazë, të ndërthurur mes tyre. Kanë përhapje të kufizuar në lindje të fshatit Bardhaj. Kontaktojnë tektonikisht nëpërmes ballit të mbihypjes më flishin e Krasta-Cukalit, duke mbihypur mbi të dhe njëkohësisht kanë marrëdhënie tektonike edhe me shkëmbinjtë ultrabazikë.

b) Shkëmbinjtë ultrabazikë të masivit të Bardhanjorëve (δJ₂). Këto formacione mbulojnë një pjesë të kufizuar të sipërfaqes së përgjithshme në zonën tonë, duke ndërtuar kuotat më të larta të kodrave të Bardhajve. Shkëmbinjtë ultrabazikë janë kryesisht të llojit

harcburgit - lërçolit dhe më pak dunitik. Kanë shtrirje vëriperëndim - juglindje dhe rënie verilindore me kënd 50°-65° dhe rrallë edhe 85°. Kanë marrëdhënie tektonike me të gjithë shkëmbinjtë kontaktues.

b) Ndërtimi tektoniko-strukturor

Formacionet që dalin në sipërfaqe në këtë zonë përfaqësohen kryesisht nga depozitime të shkriфта të kuaternarit dhe më pak nga formacione shkëmbore. Poshtë këtyre depozitimeve të kuaternarit, kemi vazhdimin e strukturës sinklinale të rendeve të mëdha, që lidh formacionet karbonatike të malit të Maranajt më ato të malit të Taraboshit. Falë këtij sinklinali gjendet sot liqeni i Shkodrës dhe Ultësira Shkodrane.

Trashësia e përgjithshme e depozitimeve të kuaternarit në Ultësirën e Shkodrës, rrjedhimisht edhe në zonën tonë, është afro 150 m. Kjo trashësi është mjaft e madhe në kushte normale të sedimentimit. Ky fenomen anormal, shpjegohet me ekzistencën e *neotektonikës* në këtë rajon. Si rezultat i kësaj, Ultësira Shkodrane, vazhdimisht është në lëvizje (ulje), dhe kjo ulje kompensohet me sedimentim të vazhdueshëm të materialeve terrigjene.

Në zonën tonë është shumë e zhvilluar tektonika mbihypse deri në formë luspore. E kemi thënë më sipër se këtu përplasën tre zona strukturoro-faciale, ku zonat e Alpeve Shqiptare dhe ajo Mirdita, mbihypin mbi atë të Krasta-Cukalit. Masivi ultrabazik i Bardhanjorëve mbihypën në zonën e Krasta-Cukali në formën e një luspore. Në këtë zonë janë të zhvilluara edhe tektonika shkëputëse, por ato janë të mbuluara nga depozitimet e reja të kuaternarit dhe nuk dalin në hartën tonë.

II.2.2. Veçoritë klimatike

E vendosur në veriperëndim të Shqipërisë dhe duke qënë pjesë përbërëse e Fushës së Mbishkodrës, komuna Rrethinat paraqet veçori klimatike të përafërta me të, duke bërë pjesë në nënzonën veriore të zonës me klimë mesdhetare fushore. Ajo ka po ashtu të njëjtat tipare klimatike që shfaqen dhe në qytetin e Shkodrës.

a) Faktorët klimëformues.

Pozicioni gjeografik në veriperëndim të Shqipërisë, lartësia e vogël mbi nivelin e detit dhe mungesa e kontrasteve të theksuara të relievit, rrethimi nga malet në lindje, afërsia relative me detin dhe ndikimi i liqenit, janë disa nga faktorët kryesorë klimëformues të HPUSH, e cila në përgjithësi dallohet për një klimë të butë. Ndikimi detar depërton vetëm nga jugu dhe juglindja nëpërmjet grykës së Bunës, ndërsa ndikimi kontinental vjen nga gryka e Drinit dhe Kirit, përmes të cilave hyjnë në fushën e Mbishkodrës erëra të ftohta nga brendësia e vendit⁸⁴.

b) Elementët klimatik.

- Vlerat e rrezatimit diellor në vendin tonë, por dhe në Shkodër dhe hapësirën periurbane të saj, lidhen me gjerësinë gjeografike ku ajo bën pjesë dhe shkallën e vranësirës. Nga të dhënat që zotërojmë vihet re se shuma vjetore e rrezatimit në Shkodër

⁸⁴ Gj. Gruda, *Ultësira e Shkodrës*, në *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, vëll. II, ASHRSH, Tiranë 1991, fq. 460


është rreth 131 kkal/cm², ku maksimumi i rrezatimit diellor vjen në muajin korrik dhe muajt e verës në terësi, kurse minimum në muajin dhjetor dhe dimër. Sasia vjetore e orëve me ndriçim po në Shkodër është 2520 orë, ku sërish vlerat më të larta i gjejmë në stinën e verës dhe minimumin në atë të dimrit⁸⁵.

- *Temperatura* mesatare vjetore në HPUSH është rreth 15°C, ajo e janarit 5°C dhe e korrikut afërsisht 25°C. Temperaturat minimale në dimër (janar) mund të arrijnë deri në -7°C, kurse ato maksimale të korrikut deri 40°C⁸⁶. Amplituda mesatare vjetore është rreth 20°, një diferencë relativisht e vogël, që flet mbi tiparet përgjithësisht mesdhetare të klimës së zonës sonë, por që gjithsesi është pak më shumë e prekur nga tiparet kontinentale, si pasojë e pozitës gjeografike më veriore. Numri i ditëve me ngricë gjatë vitit arrin nga 18-30 ditë. Periudha e temperaturave mesatare mbi 7°C zgjat afërsisht 10 muaj (nga fundi i shkurtit, tek mesi i dhjetorit), ndërsa gjatë verës kjo zonë është një ndër më të nxehtat në vend⁸⁷.

Tabela 1: *Temperaturat mesatare mujore (1951-1980) në Shkodër dhe HPUSH (°C)*

Stacioni	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Shkodër	5	6.5	9.5	13.5	18	22	24.6	24.7	20	15.7	10.9	6.9

Burimi: Atlasi Klimatologjik i Shqipërisë, 1988



Graf. 1: *Temperaturat mesatare mujore në HPUSH për periudhën 1951-1980*

- *Shpërndarja e reshjeve* dhe regjimi i tyre është rezultat i bashkëveprimit të faktorëve të tillë si: relievit në përgjithësi fushor, me malet e larta që e rrethojnë. Masat ajrore shi-prurëse perëndimore e jug-perëndimore, përplasen në lartësimin e menjëhershëm të malit të Cukalit dhe Maranajt, që rrethojnë zonën në verilindje dhe lindje, duke

⁸⁵ ASH - Instituti Hidrometeorologjik, *Klima e Shqipërisë*, Botimet Hidmet, Tiranë 1975, fq. 39, 47

⁸⁶ M. Hoti, *Veçoritë fiziko-gjeografike të fushës së Mbishkodrës*, Stud. Gjeog. nr. 4, Tiranë 1990, fq.166


⁸⁷ ASH - Instituti Hidrometeorologjik, *Klima e Shqipërisë*, Botimet Hidmet, Tiranë 1975, fq. 277

shkarkuar reshje të bollshme, që gjithsesi bien kryesisht në stinën e dimrit dhe në formë shiu (rreth 1500 mm në vit). Reshjet e dëborës nuk janë karakteristikë e përvitshme; numri i ditëve me shtresë bore gjatë vitit është 5-6 ditë, kurse trashësia e zakonshme e saj 8-20 cm.

Tabela 2: *Sasia vjetore e reshjeve sipas muajve në stacionin Fshati i Paqes (Zues), viti 2008*

Stacioni	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Fshati i Paqes	152,5	38,9	282,2	101,8	31,4	91,9	34,5	0,0	70,2	256,0	124,5	406,6

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik, Tiranë



Graf. 2: *Sasia dhe shpërndarja vjetore e reshjeve në HPUSH në v. 2008*

Edhe breshëri është një dukuri e pranishme, kryesisht në stinën e vjeshtës dhe pranverës, ndërsa stina e verës karakterizohet nga një thatësi e dukshme. Pjesa më e madhe e reshjeve, siç shihet edhe nga grafiku i mësipërm, bien në gjysmën e ftohtë të vitit (tetor-mars), afërsisht 65-70 % e sasisë vjetore; kurse muajt me më shumë reshje janë nëntori dhe dhjetori, kurse më të thatët korriku dhe gushti.


- *Erërat.* Drejtimi kryesor vjetor i erës në HPUSH, ashtu si në të gjithë fushën e Mbishkodrës dhe vetë qytetin e Shkodrës është ai lindor, sidomos për stinën e dimrit; dhe më pas ai juglindor, jugor dhe verilindor. Disa nga erërat lokale më të pranishme janë murlani (sidomos në dimër) dhe shiroku (dimër, vjeshtë). Murlani në këtë zonë ndihet, si kudo tjetër në vendin tonë, si një erë e thatë dhe e ftohtë dhe depërton kryesisht nga lugina e Kirit dhe e Drinit⁸⁸. Kurse shiroku, ka një drejtim jugor dhe juglindor dhe sjell në përgjithësi temperatura më të larta dhe reshje të bollshme Afërsia me liqenin e Shkodrës është një faktor zbutës i klimës për këtë zonë, duke pasur parasysh dhe përmasat e konsiderueshme të tij, dhe ndikon në krijimin e puhive liqenore, që gjithsesi në zonën tonë nuk para ndihen shumë ngaqë qendrat e banuara të HPUSH, gjenden disi larg brigjeve të liqenit.

⁸⁸ Theksojmë se gjatë viteve të fundit, kjo erë karakteristike dimërore e vendit tonë dhe zonës në fjalë po ndihet gjithnjë e më pak

Tabela 3: Shpërndarja vjetore e drejtimit të erës në Shkodër dhe HPUSH për periudhën 1975-1985 (në përqindje)

Qetësi	Veri	VL	Lindje	JL	Jug	JP	Perëndim	VP
60.8	0.6	2.3	10.5	7.1	5.8	4.3	5.2	3.4

Burimi: Atlasi Klimatologjik i Shqipërisë 1988



Graf. 3: Trëndafili i erërave në Shkodër dhe hapësirën periurbane të saj

II.2.3. Pasuritë ujore

Për vetë pozicionin e saj gjeografik, HPUSH ka pasuri të konsiderueshme hidrografike pasi rrethohet nga lumenj dhe liqene. Megjithatë, njësia kryesore fiziko-gjeografike e saj, fusha e Shtoit, si pjesë përbërëse e ultësirës së Mbishkodrës që ka origjinë tektoniko-karstike, karakterizohet nga një rrjet relativisht i varfër sipërfaqësor ujqor. Por meqë gjendet më në jug ku thamë se bazamenti karbonatik gjendet i zhytur më në thellësi, paraqitet disi më e lagësht, për pasojë gjenden ujëra të bollshëm nëntokësor.

Njësitë kryesore hidrografike të zonës janë:

a) Lumi Kir - është lumi kryesor që rrjell në HPUSH. Ai gjithsesi më tepër ka tiparet e një përroi, jo aq nga gjatësia e tij (fillon që nga Alpet dhe derdhet në Drin, 52 km), por nga fakti se gjatë muajve të nxehtë të verës thahet. Nga ana tjetër, në muajt e dimrit për shkak të reshjeve dhe në muajt e pranverës për shkak të shkrirjes së dëborës, ai paraqitet me ujë të bollshëm, duke marrë karakteristikat e një lumi të mirfilltë. Ky lumë paraqitet si një element mjaft i rëndësishëm natyror i zonës sonë studimore, pasi siç e thamë, ai ka qenë faktori kryesor i formimit të fushës së Shtoit dhe është burimi kryesor i ujërave nëntokësor dhe vetë ujit të pijshëm për këtë hapësirë. Nga ana tjetër lumi Kir ka

qenë dhe vazhdon të jetë edhe një element kërcënues natyror, duke rrezikuar vazhdimisht erozionin e tokave bujqësore dhe përmytjen e territoreve që shtrihen pranë tij.

b) Lumi Buna lag gjithashtu një pjesë të territorit të komunës, konkretisht fshatin Zues, që gjendet në një largësi rreth 500 m pas daljes së Bunës nga liqeni. Ai këtu ka një shtrirje relativisht të gjerë prej 100 e më shumë metrash dhe një pamje mjaft piktoreske dhe është shfrytëzuar gjatë këtyre viteve të fundit sidomos për ndërtimin e bar - restoranteve, të cilët në fakt u shërbejnë më shumë banorëve të qytetit të Shkodrës dhe turistëve.

c) Në pjesën perëndimore të saj HPUSH, siç e thamë, kufizohet nga **liqeni i Shkodrës**, i cili lag me ujërat e tij më shumë se 5 km brigje të komunës, që nga bishti i Qindisë deri në vijën e Vrakës, paralel me pyllin e Dobraçit. Ky liqen ka qenë dhe është akoma më shumë sot, një element i rëndësishëm i peisazhit natyror dhe human të zonës, megjithëse mundësitë për zhvillim që ai ofron, mund dhe duhet të ishin shfrytëzuar me mirë. Një tipar dallues i tij, që është i njohur edhe për zonën në fjalë, është luhatja e dukshme e nivelit të ujrave të tij, që shkon nga 4,4 në 9,4 m; duke bërë që edhe sipërfaqja e pasqyrës së ujërave të tij të lëkundet në kufinj relativisht të gjerë (368-542 km²)⁸⁹. Për këtë arsye, gjatë stinës së dimrit ai përparon me qindra metra në drejtim të tokës, duke përmytur hapësira të tëra me drurë dhe livadhe që, meqenëse përmyten çdo vit thuajse në të njëjtën masë, janë gati të pabanuara (megjithëse një pjesë e periferike e tyre është zënë me banesa gjatë 20 viteve të fundit). Liqeni dhe hapësira përreth tij shfrytëzohen nga banorët e zonës për turizëm lokal, për peshkim, për lëndë druri, kullotje, etj.

d) Përroi i Vrakës, kalon në pjesën veriore të HPUSH dhe e ndan atë me komunën e Gruemirës dhe rrethin e Malësisë së Madhe. Ai ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 343 km² dhe buron në rrëzën jugperëndimore të kodrave të Postribës; ku pasi përshkon fushën e Shtoit në drejtim verilindje-jugperëndim, derdhet në liqenin e Shkodrës⁹⁰. Ky përroi ushqehet nga një burim i rëndësishëm karstik me të njëjtin emër, që gjendet në fshatin Kullaj dhe thahet vetëm gjatë stinës së verës. Analiza e regjimit të Vrakës tregon se prurjet varen drejtpërdrejt nga reshjet dhe shkalla e lartë e koeficientit të përshkueshmërisë së formacioneve që përbëjnë pellgun e tij. Prurja maksimale e tij ka arritur në 6 m³/sek⁹¹.

- Gjithashtu, në kodrat e Bardhajve dhe në shpatin juglindor të Taraboshit (Zues), vihet re edhe krijimi i rrëkeve të përkohshme të ujit, sidomos gjatë periudhës së reshjeve të rrëmbyeshme, të cilët përfundojnë në lumin Kir dhe Bunë.

⁸⁹ Niko Pano, *Ujërat e Shqipërisë*, në *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, vëll.I, ASHRSH, Tiranë 1991, fq. 252

⁹⁰ Mahir Hoti, *Studime gjeografike nr. 4*, Tiranë 1990, fq. 168

⁹¹ Gjovalin Gruda, *Ultësira e Shkodrës*, në *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, vëll.II, ASHRSH, Tiranë 1991, fq. 461



Foto nr. 5: Pamje nga ujëmbajtësi i Bleranit dhe përroi i Vrakës (D.Rustja)

e) Ujërat nëntokësorë. Një rëndësi të veçantë për pasuritë ujore të fushës së Mbishkodrës dhe vetë fushën e Shtoit, kanë ujërat nëntokësorë. Një gjë e tillë është e lidhur ngushtë me karakterin e depozitimeve kryesisht zhavorrore, aluvoproluviale, shkëmbinjve karbonatik shumë të karstëzuar me veti të larta ujëgrumbulluese dhe me karakterin e reshjeve⁹². Territori i komunës Rrethinat, për shkak të veçorive të mësipërme gjeologjike dhe klimatike, është i pasur me ujëra nëntokësor në formën e ujërave arteziane në një thellësi 15-20 m nën sipërfaqen e tokës, kurse burimet janë të pranishëm kryesisht në brigjet e liqenit, në atë hapësirë që i përket komunës, por ato janë të përmasave të vogla dhe gjenden më tepër në pyllin me shelgje afër brigjeve të liqenit ose nën tabanin e tij, pra gjithsesi të vështirë për tu njohur dhe studiuar. Studimet hidrogeologjike të bëra nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe shpimet eksperimentale të realizuara në fushën e Dobraçit, flasin për rezerva të konsiderueshme të ujit nëntokësor në këtë zonë, dhe me veti fiziko-kimike të mira, të përshtatshme për ujë të pijshëm.

f) Ujëmbajtësi i Bleranit, është një element tjetër i dallueshëm hidrografik për zonën në fjalë, edhe pse i vogël dhe me karakter lokal dhe artificial. Ai u ndërtua rreth viteve '60, duke shërbyer si një mbështetës i ujëmbajtësit më të madh të Shtodrit, që gjendet pak më në VL, në Postribë. Ky i fundit kishte një vëllim uji prej 11 milion km³ dhe një aftësi ujitëse prej 3400 ha. Ujëmbajtësi i Bleranit u krijua pikërisht për vaditjen e tokave të fushës së Bardhajve, dhe vazhdon të jetë funksional edhe sot, pavarësisht se nuk përdoret më si dikur dhe nuk mirëmbahet.

- Nga ajo që përmendem më lart nuk është e vështirë të kuptojmë se territori i HPUSH gjendet në një nga zonat më të pasura hidrografike të vendit dhe zotëron potenciale të konsiderueshme në këtë drejtim. E megjithatë, duhet thënë se fatkeqësisht, kjo pasuri ujore nuk është shfrytëzuar siç duhet dhe për pasojë, pjesa më e madhe e banorëve të zonës vazhdojnë të përballen me problemin e mungesës së furnizimit me ujë.

⁹² Mahir Hoti, *Studime gjeografike nr. 4*, Tiranë 1990, fq. 168

II.2.4. Tokat, flora dhe fauna

- **Tokat** e kësaj zone janë formuar mbi depozitimet kuaternare aluvionale dhe liqenore. Tokat e fushës së Shtoit janë toka livadhore të murrme pyjore dhe janë formuar nga gërryerja e tokave të murrme pyjore dhe nga depozitimi i lëndëve organike, pra janë të ardhura⁹³. Ato shquhen për aciditet dhe janë pjesërisht neutrale. Këto toka janë të nëntipit të dherave të zeza, të shpëlara, të gjinisë subargjilore të mesme dhe të lehta. Trashësia e tabanit të tokës në këtë zonë që përbën pjesën më të madhe të tokës bujqësore është 60-140 cm. Këto toka janë shumë të përshtatshme për kultivimin e drufrutorëve, hardhisë dhe patates. Pjesa tjetër e tokave, sidomos në zonën kodrinore të Bardhajve dhe Zuesit, përfaqësohet nga tipet e tokave livadhore të kafenjta, livadhore aluvionale dhe të kafenjta malore, të cilat gjithashtu ofrojnë mundësinë e kultivimit të drufrutorëve dhe veçanërisht ullirit. Një vend të rëndësishëm zënë edhe tokat moçaliko-liqenore në afërsi të brigjeve liqenore, të formuara në kushtet e një lagështie të madhe, ku niveli i ujërave freatike është pranë horizontit të punueshëm. Ato janë të papërshtatshme për bujqësinë, pasi gjatë stinës së dimrit mbulohen nga uji i liqenit; prandaj tradicionalisht janë përdorur më tepër për kullotë gjatë stinës së verës⁹⁴. Së fundi përmendim dhe tokat aluvionale në sektorët e poshtëm të lumenjve, posaçërisht Kirit, tipike për fushën e Dobraçit, ku ai kalonte dikur.

- **Bimësia** natyrore e zonës, është relativisht e varfër dhe përfaqësohet nga kati i shkurreve mesdhetare dhe dushqeve. Kjo ka ardhur si pasojë e ndërhyrjes së dukshme antropogjene në tiparet origjinale të saj, nëpërmjet zgjerimit të vendbanimeve, hapjes së tokave të reja bujqësore, kultivimit të bimëve të arave, drufrutorëve, etj. Shkurret janë të përhapura më tepër në kodrat e Bardhajve dhe Zuesit (këtu kultivohet dhe ulliri) dhe në brigjet e liqenit. Ato përfaqësohen nga driza, shega, friganat (sherebela)⁹⁵. Në shpatet e Taraboshit nga ana e liqenit si dhe në kodrat e Bardhajve, gjenden dhe pyje të vegjël me pishë mesdhetare, ndërsa në brigjet e lagëta të liqenit rritet bimësia barishtore higrofile (livadhet ose siç njihen nga vendasit “*livadet*”) dhe drurë higrofile si shelgu apo vidhi, të cilat krijojnë një pyll me gjerësi të ndryshme gjatë gjithë brigjeve të liqenit. Këtu ato gërshetohen edhe me lloje të tjera bimësh higrofile si kallamishtet, etj. duke krijuar një lloj xhungle në miniaturë të vështirë për t’u depërtuar. Në fushën e Shtoit ruhen të lokalizuara pyje gështenje dhe arre.

⁹³ Gj. Gruda, *Ultësira e Shkodrës*, në *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, vëll.II, ASHRSH, Tiranë 1991, fq. 462

⁹⁴ M. Hoti, *Stud. Gjeog. nr. 4*, Tiranë 1990, fq. 169

⁹⁵ M. Hoti, *Po aty*, fq. 169



Foto nr.6: *Bimësia e HPUSH: higrofile në të majtë, shkurrore në të djathtë (D. Rustja)*

- Bota shtazore.

Lidhur me tiparet e botës bimore dhe hidrografisë, fauna e zonës është më e pasur në ujëra dhe në brigjet e liqenit.

Fauna tokësore paraqitet mjaft e varfër, për shkak të ndryshimeve të mëdha në përdorimin e tokës, që ka pësuar zona gjatë viteve të sistemit socialist e në vazhdim. Ajo përfaqësohet nga gjarpërinjtë, hardhucat, iriqi, nusja e lalës, lepuri, insekte të ndryshme, etj., kurse tek shpendët dallohen shkurta, pëllumbat, shpendët shtegtarë (dallëndyshja, etj.). Ato vihen re veçanërisht në zonën kodrinore të Bardhajve e Zuesit, e më pak në zonën e fushës së Shtoit.

Brigjeve të liqenit dhe lumit Buna mund të shihen shapka, rosat, patat; të cilat përdoren edhe për gjueti; si kudo tjetër pa kriter. Këtu edhe fauna ujore është e pasur pasi depërtojnë nga deti edhe disa peshq të ujrave të kripur si levreku, kubla, qefulli, etj. Ndërsa në liqenin e Shkodrës dallohet veçanërisht krapa, qefulli, gjuca, ngjala, etj. të cilët peshkohen nga banorët e zonës që merren me këtë aktivitet ekonomik.

Duhet thënë se për shkak të ushtrimit të peshkimit dhe gjuetisë së paligjshme dhe ndikimit në rritje të veprimtarisë njerëzore në mjedis, fauna ujore dhe tokësore e HPUSH, kërcënohet seriozisht nga dëmtimi i specieve të mbetura të saj, zvogëlimi i numrit të tyre, madje edhe nga zhdukja.

II.2.5. Gjendja e mjedisit natyror dhe kërcënimi nga rrisqet natyrore

a. Gjendja e mjedisit natyror

Si gjithë fusha e Mbishkodrës, edhe hapësira e komunës “Rrethinat” ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë viteve të sistemit komunist e në vazhdim. Në të kaluarën ishte joproduktive, pjesa më e madhe e saj zihej nga shkurre, ferra, driza dhe ishte shumë e thatë. Fuqishëm është ndjerë dora e njeriut në pastrimin e fushës së Shtoit nga shkurret, si dhe në zgjidhjen e problemit të ujit, jetik si për banorët dhe për bujqësinë. U ngritën dhe u vunë në shfrytëzim një sërë veprash ujitëse, kanalesh kulluese e më pas ujëmbajtës, hidrovore, etj. Të gjitha këto ndryshime të bëra nga njeriu çuan në krijimin e një hapësire bujqësore të përshtatshme dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve; por

njëkohësisht ato dëmtojnë rëndë ekosistemin natyror mjaft të pasur të zonës pothuajse në mënyrë të pariparueshme⁹⁶. Gjatë kësaj periudhe u vu re gjithashtu edhe një ndotje e konsiderueshme e ajrit si pasojë e tymrave që lëshojnë fabrikat e ndryshme industriale që gjendeshin në periferi të qytetit të Shkodrës dhe pranë HPUSH. Nga banorët e zonës akoma mbahet mend ndotja dhe era e rëndë që sillnin daljet e tymrave nga fermentimi (fabrika e duhanit).

Pas ndryshimeve të ndodhura në vitet '90 pjesa më e madhe e të gjithë këtyre veprave hidroteknike, fatkeqësisht, ose u shkatërruan ose dolën jashtë përdorimit, duke e rihapur edhe njëherë plagën e vjetër të furnizimit me ujë për banorët dhe për sektorin bujqësor. Gjithashtu ndryshime të konsiderueshme ka pësuar sipërfaqja e tokës bujqësore dhe në përgjithësi përdorimi i tokës.

Kjo për faktin se pas viteve '90, në HPUSH pati dyndje dhe vendosje masive të popullsisë nga zonat malore të Shkodrës. Ata u vendosën në hapësirat bujqësore të cilave akoma nuk u ishte përcaktuar pronari dhe më pas këto territore i kthyen në troje ndërtimi. Gjithashtu vetë banorët e zonës filluan të ndërtonin shtëpi të reja në tokat që morën nga reforma agrare, të ndikuar në këtë proces nga copëtimi gradual i familjes së madhe, si pasojë e situatës së re social-ekonomike që u krijua. Të gjitha këto ndërtime të reja, të bëra në mënyrë krejtësisht spontane dhe kaotike, pa një plan rregullues, e kanë shndërruar një pjesë të mirë të tokës bujqësore të dikurshme në troje ndërtimi, duke i dhënë tipare të mirëfillta të *një zone periurbane* në ndryshim e sipër.

Po ashtu, problematike paraqitet edhe *ndotja e mjedisit*, në të gjithë komponentët e tij, si ajri, uji, apo toka. Ndër burimet kryesore të ndotjes së ajrit në HPUSH, janë aktivitetet ndërtimore që kryhen pa masa apo rregulla mbrojtëse, rrugët e paasfaltuara, mbeturinat e shpërndara vend e pa vend, etj.

Burimi kryesor i ndotjes së ujit janë sërish mbetjet urbane, që jo rrallëherë gjenden dhe grumbullohen pranë apo përgjatë brigjeve të lumenjve, depozitimi i ujërave të zeza, si dhe përdorimi i pesticideve dhe kimikateve të ndryshme në bujqësi. Erozioni paraqet gjithashtu një kërcënim mjedisor për HPUSH, sidomos përgjatë brigjeve të lumit Kir, ku kërcënon edhe me përmbytje, por edhe në shpatet kodrinore të Bardhajve dhe Zuesit. Gjithashtu, edhe një pjesë e tokave bujqësore të lëna djerr dhe të copëzuara si rezultat i urbanizimit, gjenden në degradim të vazhdueshëm dhe kërcënohen nga shkretizimi. Së fundi përmendim si një problem të rëndësishëm mjedisor për HPUSH edhe shpyllëzimin, që kërcënon sipërfaqet me pyje dhe kullota që gjendet përgjatë brigjeve të liqenit dhe në zonën kodrinore, duke cënuar edhe biodiversitetin e tyre.

⁹⁶ M. Hoti, *Stud. Gjeog. nr. 4*, Tiranë 1990, fq. 170



Foto nr. 7: Mbetjet e ngurta buzë Bunës (majtas) dhe mbetjet urbane buzë Vrakës (djathtas), (D. Rustja)

b. Kërcënimi nga rrisqet natyrore

Rrisqet natyrore janë dukuri të natyrës që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre⁹⁷. Përsa i takon Shqipërisë, rrisqet natyrore më kërcënuese vlerësohet të jenë *tërmetet dhe përmytjet*⁹⁸; dhe nga studimet e bëra rezultojnë se vetë njerëzit i konsiderojnë përmytjet si kërcënimin natyror më serioz dhe më të shpeshtë për ta⁹⁹. Këto karakteristika të rrisqeve natyrore në vendin tonë janë të ngjashme edhe për rajonin e Shkodrës dhe vetë hapësirën periurbane të qytetit të Shkodrës.

E gjendur në brezin sismik mesdhetar, përgjatë thyerjes tektonike Shkodër-Pejë dhe zonës sismike Lezhë-Ulqin, kjo hapësirë ka përjetuar pasojat e të njëjtëve *tërmete* të fuqishëm që kanë goditur Shkodrën, si ai i v.1905 dhe 1979¹⁰⁰. Duke pasur parasysh se kushtet gjeologjike dhe tektonike mbeten të njëjta, ndërkohë që ndërtimet e reja të bëra pas v. 1990 nuk janë ndërtuar në bazë të kodeve të duhura të ndërtimit, mund të arrijmë në përfundimin se rrisqet sismike mbeten kërcënuese për këtë zonë edhe në të ardhmen.

Ndoshta akoma më kërcënuese janë për rajonin e Shkodrës dhe zonën në fjalë, një lloj tjetër rrisiku natyror: ato më karakter hidrologjik, pra *përmytjet*. Duhet thënë se për HPUSH, një kërcënim të vazhdueshëm në këtë drejtim në të shkuarën ka përbërë lumi Kir, i cili në çdo rast reshesh të bollshme dhe daljeje nga shtrati, ka përmytur territoret që gjendeshin në të dy anët e tij; duke kërcënuar veçanërisht fshatrat Bardhaj, Bleran dhe Golem. Por gjatë viteve të sistemit socialist, u ndërtuan argjinatura dhe diga mbrojtëse që i shpëtuan këto vendbanime nga ky rrezik. Megjithatë vihet re se gjatë viteve të fundit, me ndryshimet e ndodhura në përdorimin e territorit, ndërtimet vend e pa vend dhe urbanizmin e shpejtë dhe kaotik të kësaj hapësire, rreziku nga përmytjet është rikthyer. Kjo gjë vlen sidomos për hapësirën që ndodhet relativisht pranë brigjeve të liqenit, e cila është populluar gjatë 20 viteve të fundit nga popullsia e ardhur, dhe për vendbanimet në krahun e majtë të lumit Kir, pjesë e fshatrave Bardhaj dhe Bleran. Në këta të fundit, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe mbetjet e shumta urbane dhe të ngurta që janë

⁹⁷ Edward A. Keller, Robert H. Blodgett; *Natural hazards*, Pearson Prentice Hall, NJ –USA, 2008, fq.6

⁹⁸ UNDP; *Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri*, Tiranë 2003, fq 19

⁹⁹ UNDP; *Local vulnerability and capacity assessment in Albania*, Tiranë 2004, fq. 7

¹⁰⁰ Sh. Aliaj, etj.; ASHSH, Tiranë 2010, fq.31, 54

hedhur anash dhe në shtratin e tij, duke devijuar rrjellën normale të lumit; si dhe marrja e inerteve (zhavorrit) nga lumi Kir, për ndërtim dhe përfitim ekonomik.

Në përmbytjen që përjetoj rajoni i Shkodrës në v. 2010, rreth 15 ha i përkisnin edhe komunës Rrethina; ndërkohë që 50 familje dhe 200 banorë u evakuuan¹⁰¹.

Rasti më i fundit është ai i Marsit 2013, ku si pasojë e prurjeve të larta të lumit Kir për shkak të reshjeve të dendura, ky lum doli nga shtrati dhe përmbyti rrugën dytësore të fshatit Bardhaj, duke rrezikuar shembjen e rrugës, përmbytjen e banesave dhe dëmtimin e shtyllave të tensionit të lartë.




Foto nr. 8: Vërshimi i Kirit në Bardhaj (majtas) dhe projekti i argjinaturës (djathtas)

Duke pasur parasysh rrezikshmërinë serioze të situatës në fjalë, u ngrit një grup pune emergjence nga Qarku i Shkodrës, u hartua një projekt dhe u ndërtua një argjinature mbrojtëse provizore në këtë pjesë; megjithatë në rastin më të parë, reshjet e rrëmbyera që ranë pas dy javësh e dëmtuan atë. Kështu situata mbetet akoma problematike dhe askush nuk e di se ç'farë do të sjellë dimri i ardhshëm për banorët e kësaj zone në këtë drejtim.

Shihet qartë se ndryshimet e mëdha të përjetuara gjatë 20 viteve të fundit në këtë territor dhe mosndërhyrja nga ana e strukturave përkatëse, ka risjellë në vëmendje kërcënimin nga rrisqet natyrore, sidomos nga përmbytjet, për hapësirën periurbane të Shkodrës.

II.2.6. Pasuritë minerale të HPUSH

Në këtë zonë është punuar për kërkimin dhe vlerësimin e mineraleve të dobishme nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Mund të vlerësohen si lëndë të para minerale këto resurse të saj:

a) *Vendburimi i argjilave të Bregut të Ranës*, i cili ka afro 50 vjet që shrytëzohet nga fabrika e tullave e ngritur shumë vite më parë në perëndim të HPUSH, pranë bregut të liqenit të Shkodrës, kështu që ana cilësore e këtij minerali ka vite që është provuar si e mirë. Më poshtë po japim disa tregues të cilësisë të këtyre argjilave:

¹⁰¹ Raport i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave, Shkodër më 21.01.2010

- a) përbërja minerale: $\text{SiO}_2 = 50,1\%$; $\text{Al}_2\text{O}_3 = 13,47\%$; $\text{Fe}_2\text{O}_3 = 6,97\%$; $\text{CaO} = 9,08\%$; $\text{MgO} = 6,12\%$; $\text{TiO}_2 = 0,63\%$;
- b) plasticiteti: 13,61 attenberg, kufiri i poshtëm - 18,69 att., kufiri i sipërm-32,3 att.;
- c) shkrifshmëria në ujë :100% ; gurë mbi 1 mm: nuk ka;
- d) pesha volumore: në gjendje natyrore, $2,01\text{gr/cm}^3$; e bluar në 1mm dhe e tharë $1,17\text{kg/m}^3$.

Rezervat janë llogaritur disa herë, pra janë bërë disa raporte me llogaritje, sipas kërkesave të fabrikës së tullave, në miliona m^3 . Përsëri mundësia për shtimin e rezervave ekziston, por duhet të merret parasysh ndikimi i karrierve të hapura në mjedisin pranë liqenit të Shkodrës.

b) Zhavorret e shtratit të lumit Kir për prodhimin e inerteve, direkt për mbushje ose fraksionimin e tyre me anë të impianteve. Shfytëzimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar, që të mos ketë ndikim negativ në mjedis.

c) Shkëmbinjtë ultrabazikë të kodrave të Bardhajve mund të përdoren si inerte për shtrimin e rrugëve të standarteve të larta, duke zëvendësuar inertet e prodhuara nga shkëmbinjtë karbonatikë, për shkak të cilësisë më të mirë, sepse kanë peshën volumore më të lartë.

d) Vendburimi i ujit të pijshëm i Dobraçit, është për nga rëndësia i dyti në shkallë republike, pas atij të Fushë Kuqes, pranë grykëderdhjes së lumit Mat. Nga ky vendburim shfrytëzohen rreth 800 l/sek ujë, me të cilin bëhet furnizimi me ujë të pijshëm i rreth 100 000 banorëve të qytetit të Shkodrës dhe një pjese të banorëve të komunës Rrethinat. Cilësia e ujit është shumë e lartë.

Kapitulli i tretë

VEÇORITË DEMOGRAFIKE DHE PASURITË NJERËZORE TË HAPËSIRËS PERIURBANE TË SHKODRËS

III.1. Historiku i krijimit të vendbanimeve dhe popullimit të HPUSH

Përsa i takon historisë së popullimit të HPUSH dhe zhvillimeve të mëpasme historike, duhet thënë që në fillim, se ka pak burime informacioni. Sado që thuhet se ky territor është banuar që në lashtësi, gjurmët e para të dokumentuara të një vendbanimi të kësaj hapësire vijnë nga shekulli i XV¹⁰², përforcuar nga dokumente të mëvonshme historike, ku në vazhdimësi përmendet fshati *Dobraç*.

Kështu ai përmendet për herë të parë në Regjistrin e Kadastrës së Venedikut të v. 1416, e më pas edhe në Defterët e Regjistrimit Osman të viteve 1485 dhe 1582. Në Regjistrin e Kadastrës së Venedikut, thuhet se: “*ka shumë shtëpi në anën e sipërme të tokës së Shkodrës, në vendin e quajtur Dobranc, që nuk paguajnë taksë sepse nuk janë njerëz të ngulitur, por barinj që shkojnë e vijnë*”¹⁰³. Pra mesa duket këto të dhëna dëshmojnë për zanafillën e krijimit të vendbanimit më të hershëm të komunës sot, Dobraçit. Kurse në të dhënat e Defterit Osman të v.1485, thuhet se: “*fshati Dobranica varet nga Shkodra, është timar i Dautit (vëllait të Hamzait) dhe ka 6 shtëpi*”¹⁰⁴. Pra me sa shihet pas rreth 70 viteve, ky vendbanim fillimisht i përkohshëm, është kthyer tashmë në një vendbanim të përhershëm. Një gjë e tillë ka vijuar në kohë dhe vendbanimi ka vazhduar të zgjerohet, pasi në hartën e Corronellit të v.1688 përmendet sërish Dobranzi (Dobraçi), “*fshat në të dalë të qytetit të Shkodrës, tashmë me 40 shtëpi*”¹⁰⁵.

Mendohet që edhe origjina e fshatit *Golem* është e lidhur me atë të Dobraçit, por është krijuar disi më vonë.

Dëshmi të një popullimi relativisht më të hershëm ka edhe për fshatin *Zues*, i cili duhet të jetë krijuar para rreth 300 vitesh, me banorë të ardhur nga Lohja e Malësisë së Madhe si dhe nga zona e Krajës dhe përtej Vermoshit, në Mal të Zi¹⁰⁶. Këtu gjenden dhe ruhen rrënojat e një kishe të vjetër mesjetare (ish Shën Marku).

Pas kësaj periudhe, nuk ka shumë të dhëna në lidhje me evolucionin e popullimit të territorit të sotëm të HPUSH, por vihet re se në *rregjistrimin e popullsisë së v. 1927*¹⁰⁷ përmenden vetëm këto fshatra të sotëm të HPUSH: Dobraçi (334 banorë), Golemi (332 banorë), Zuesi (229 banorë) dhe Shtoji (si një emërtim i vetëm me 145 banorë). Në fakt Shtoji i Vjetër, është krijuar si vendbanim në fund të shek. XIX, në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me banorë të shpërngulur nga trevat shqiptare në Mal të Zi¹⁰⁸.

Ndërsa në vitet 1924-25, me banorë të së njëjtës origjinë, u krijua edhe fshati *Shtoj i Ri*. Kurse në v.1930 u krijuan dy fshatra të tjerë të rinj: *Gruda e Re* dhe *Gucia e*

¹⁰² Përparime Huta, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 1990, fq 21- 24

¹⁰³ Injac Zamputi; Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Historisë, Tiranë 1977, fl 65/a

¹⁰⁴ Selami Pulaha; Akademia e Shkencave e RP. të Shqipërisë, Tiranë 1974, fq 377

¹⁰⁵ Ermao Armao; Botimet Korbi, Tiranë 2006, fq 70

¹⁰⁶ Dritan Rustja; *Intervista me personat kyç – fshati Zues*; Shkodër, tetor 2012

¹⁰⁷ Teki Selenica; *Shqipëria në v.1927*, Tiranë 1928

¹⁰⁸ Emri i vjetër i fshatit ishte Hamidi

Re, me banorë të ardhur nga trojet etnike shqiptare në Mal të Zi me të njëjtin emër; dhe në v. 1932 edhe *Hoti i Ri*, me banorë të ardhur nga Traboini, Mal i Zi^{109, 110}.

Nga dokumentet në dispozicion, vëmë re se fshati Bardhaj përmendet për herë të parë si vendbanim i veçantë në regjistrimin e popullsisë së v.1945 (me 331 banorë)¹¹¹, kurse fshati Bleran, që mesa duket është krijuar nga shkëputja prej fshatit Bardhaj, evidentohet si vendbanim i veçantë për herë të parë në v.1989^{112, 113}.

Pra siç e vëmë re nga sa trajtuam më sipër, kuptohet se vendbanimet e sotme të HPUSH janë në përgjithësi vendbanime të reja të krijuara relativisht vonë, pa ndonjë interes dhe rëndësi të veçantë historike. Që nga krijimi i tyre e në vazhdim ata kanë bërë pjesë në njësi të ndryshme administrative sipas ndarjes së realizuar nga pushteti në fuqi, duke u bashkuar për herë të parë në një njësi të vetme administrative në v.1992.



Figura 4: *Harta e Corronellit (v.1688) ku përmendet fshati Dobraj*

¹⁰⁹ Akademia e Shkencave e RPSSH; *Fjalori enciklopedik*, Tiranë 1985, fq 322,327,380

¹¹⁰ Krijimi i fshatrave Shtoj i Ri, Grudë e Re, Hot i Ri dhe Guci e Re është i lidhur me një vendim të marrë nga qeveria e mbretit Zog në v. 1928, që u jepte të drejtën shqiptarëve të Malit të Zi që banonin në krahinat me të njëjtin emër, të vendoseshin në zonën periferike veriore të qytetit të Shkodrës, kryesisht në fushën e Shtoit, që ishte tokë e lirë dhe djerr në atë kohë. Sipas dëshmive të banorëve të vjetër të zonës, ai i dha çdo familjeje të ardhur 5 dynym tokë truall dhe 20 dynym tokë arë.

¹¹¹ Mendohet se ka shërbyer më përpara si një vend verimi i njohur për familjet katolike shkodrane

¹¹² ZSSH; *Të dhëna të marra në Zyrën e Statistikave të INSTAT*, Shkodër, korrik 2013

¹¹³ Origjina e banorëve të fshatrave Bardhaj dhe Bleran, mendohet të jetë heterogjene, me banorë të ardhur nga Vermoshi, Tropoja, Pulti, Postriba, Dugagjini, etj; madje pas krijimit të fermës “Perlat Rexhepi” në v. 1957, kanë ardhur edhe familje nga jugu i Shqipërisë

III.2. Karakteristika të përgjithshme demografike¹¹⁴

III.2.1. Numri i popullsisë dhe evolucioni kohor i saj

Me datën 31.06.2012 në territorin e komunës Rrethinat banonin zyrtarisht 25 119 banorë . Dy fshatrat me numrin më të lartë të popullsisë janë Dobraçi dhe Gruda e Re, kurse fshatrat me numrin më të vogël të popullsisë janë Zuesi, Bardhajt dhe Gucia e Re. Gjithsesi, nga të dhënat e marra në periudha të ndryshme historike dhe burimet arkivore, ne kemi mundësinë të studiojmë evolucion kohor dhe ndryshimin e numrit të popullsisë në vendbanimet e HPUSH, gjë që na ndihmon të kuptojmë më mirë edhe gjendjen demografike në ditët tona.

Tabela 4: Numri i popullsisë dhe i familjeve sipas fshatrave më 30.06.2012

<i>Nr</i>	<i>Fshati</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Nr. i familjeve</i>
1	<i>Grude e Re</i>	4187	2434	1773	1056
2	<i>Shtoj i Ri</i>	2848	1451	1397	671
3	<i>Guci e Re</i>	999	521	478	252
4	<i>Shtoj i Vjetër</i>	1859	930	929	334
5	<i>Zues</i>	828	448	380	260
6	<i>Dobraç</i>	5039	2589	2450	1249
7	<i>Golem</i>	2795	1430	1365	695
8	<i>Hot i Ri</i>	2568	1342	1226	587
9	<i>Bleran</i>	3029	1604	1425	745
10	<i>Bardhaj</i>	967	522	445	195
	Shuma	25119	13271	11848	6044

Kështu, në v.1927 përmenden vetëm 4 fshatra të komunës, me një numër të përgjithshëm të popullsisë prej 1040 banorësh, pra siç e shohim një numër relativisht i vogël. Ndërsa në regjistrimin e v.1945, menjëherë pas Çlirimit, numri i përgjithshëm i popullsisë në vendbanimet e sotme të komunës, është 2305. Në këtë regjistrim nuk përmenden fshatrat Bleran dhe Hot i Ri: nëse i pari ka qenë i bashkuar me fshatin

¹¹⁴ Në trajtimin e karakteristikave demografike të HPUSH, ne kemi marrë për bazë të dhënat e zyrës së gjendjes civile të komunës “Rrethinat” dhe vetëm në ato raste kur ajo nuk i ka disponuar informacionet për tregues të caktuar demografik, u jemi referuar burimeve të tjera, sidomos censuseve të përgjithshëm të popullsisë të v. 2001 dhe 2011

Bardhaj, mungesa e Hotit të Ri, është e diskutueshme, sepse ai ishte krijuar si vendbanim që në v. 1930.

Tabela 5: *Ecuria kohore e numrit të popullsisë së HPUSH¹¹⁵*

<i>Fshati</i>	<i>V. 1927</i>	<i>V.1945</i>	<i>V. 1960</i>	<i>V.1975</i>	<i>V.1989</i>	<i>V. 2000</i>	<i>V. 2012</i>
1.Grudë e Re	-	88	365	1286	1866	2569	4187
2.Shtoj i Ri	-	221	442	894	1401	1282	2848
3.Guci e Re	-	174	194	332	544	740	999
4.Shtoj i Vjetër	145	264	391	720	1157	1612	1859
5.Zues	229	319	396	621	701	810	828
6.Dobraç	334	492	797	1025	1766	2410	5039
7.Golem	332	416	675	952	1167	1313	2795
8. Hot i Ri	-	-	-	512	1150	1559	2568
9. Bleran	-	-	-	-	994	1920	3029
10. Bardhaj	-	331	677	1196	680	878	967
SHUMA	1040	2305	3937	7538	11426	15093	25119

Burimi: *Te ndryshme*


Nga viti në vit, vihet re një rritje e vazhdueshme e numrit të popullsisë së këtyre vendbanimeve, i cili arrin gjithsej 3937 banorë në v. 1960 dhe 7538 banorë në v.1975. Pra siç e shohim, gjatë periudhës 1960-1975 ka një rritje të konsiderueshme të popullsisë, pothuajse një dyfishim të saj, gjë që shkon paralel me tendencën e përgjithshme në shkallë vendi në atë periudhë. Ndërkohë, sipas regjistrimit të përgjithshëm të v.1989, numri i popullsisë në vendbanimet e sotme të komunës është 11 426; pra sërish ka një rritje por në vlera më të vogla se në periudhën e mësipërme dhe si rezultat, ka mundësi që në vitin 1992, kur komuna Rrethinat u krijua si njësi administrative, numri i popullsisë së saj të jetë rreth 11 000 banorë, pa përfshirë Shirokën dhe Zogajt, që në këtë periudhë ishin pjesë e saj dhe që më vonë, në vitin 1996, iu bashkangjitën bashkisë Shkodër.

¹¹⁵ Për përpilimin e kësaj tabele janë shfrytëzuar të dhëna nga burime të ndryshme historike dhe arkivore. Kështu, të dhënat për v.1927 janë marrë nga libri i T.Selenicës që e kemi përmendur më sipër, kurse të dhënat për vitet 1946, 1960, 1975 dhe 1989 janë marrë nga regjistrimet përkatëse të popullsisë nga burimet e Arkivës Shkodër. Kurse për vitet 2000 dhe 2012 kemi shfrytëzuar të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile, Shkodër. Sipas censusit të v. 2001, numri i popullsisë në komunë është 15 337 banorë, kurse sipas censusit të v. 2011, 21 199; por duhet thënë se për këto dy censuse nuk disponohen të dhënat e popullsisë për çdo fshat.

Siç e vëmë re, gjatë këtyre 20 viteve të fundit, numri i popullsisë në territorin e komunës është më se dyfishuar. Kjo dukuri është e lidhur me ardhjen masive të popullsisë nga zonat malore të Shkodrës dhe vendosjen e tyre në territorin e komunës pas viteve '90, si pasojë e ndryshimit të sistemeve ekonomiko-politike dhe mundësisë që iu krijua njerëzve për të lëvizur lirshëm. Shkaku kryesor i kësaj lëvizjeje demografike qëndron në kushtet e vështira të jetesës së këtyre banorëve në zonat e tyre malore, tek kushtet mjedisore dhe natyrore jo të favorshme, si dhe tek liria e rifituar pas 45 viteve¹¹⁶.

Gjithsesi, duke studiuar në vazhdimësi ndryshimin e numrit të popullsisë në HPUSH, edhe pas v.1990, ka edhe disa momente të tjera interesante që ia vlen t'i diskutojmë. Kështu, vihet re se ka një rënie të numrit të popullsisë nga v. 1996 kur kishte 15198 banorë, në 14 471 banorë në v.1997. Një gjë e tillë mund të shpjegohet me situatën e rëndë sociale të krijuar në këtë vit në vendin tonë, i cili pati ndikime negative edhe në aspektin demografik.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm në numrin e popullsisë vihet re mes vitit 2004, kur komuna kishte 17 304 banorë dhe vitit 2005, kur ajo rregjistron 22 098 banorë. Një gjë e tillë shpjegohet me faktin se në tetor të v. 2004 doli ligji i ri i lejeve të banimit i njohur si pasaportizimi; pra mesa duket në këtë kohë u njoh zyrtarisht një pjesë e popullsisë informale të komunës, e cila u vendos këtu pas v. 1990¹¹⁷. Nga viti 2005 e në vazhdim, vëmë re se ka një rritje graduale dhe relativisht të vogël të popullsisë deri në ditët tona; gjë që mund të shpjegohet me rënien e ritmeve të ardhjes së popullsisë në hapësirën periurbane të Shkodrës.



Graf. 4: Ndryshimi i numrit të popullsisë në HPUSH për periudhën 1927-2012

Megjithatë, duhet thënë se ka mundësi që numri i vërtetë i banorëve që jetojnë në territorin e kësaj hapësire të jetë edhe më i madh (disa burime jo zyrtare japin vlerën prej 30 000 e më shumë banorësh). Kjo gjë ka mundësi të jetë e vërtetë, për shkak të:


- a) nivelit të lartë të informalitetit që e karakterizon këtë komunë;

¹¹⁶ Dritan Rustja; *Buletini Gjeografik Kroat* 73 (2), Zagreb 2011, fq. 81-92

¹¹⁷ Intervista me personat kyç – specialisti i zyrës së gjendjes civile, komuna Rrethinat, tetor 2013

b) numrit të lartë të vetëdeklarimeve¹¹⁸ të bërë nga banorët e kësaj komune në procesin aktual të legalizimeve, gjithsej – 2397 të tillë¹¹⁹

c) nga fakti se shumë prej banorëve të ardhur vazhdojnë të jenë të regjistruar si banorë të komunave të mëparshme malore të origjinës, nxitur edhe nga fakti se vlera e ndihmës ekonomike që marrin atje është më e lartë, meqë konsiderohen si zona malore¹²⁰.



Harta 6: Ndryshimi i numrit të popullsisë për periudhën 1989-2012 në HPUSH

III.2.2. Dendësia dhe shpërndarja e popullsisë

Duke pasur parasysh se popullsia e sotme e HPUSH është 25119 banorë dhe sipërfaqja e saj është rreth 47 km², arrijmë në përfundimin se *dendësia mesatare* e popullsisë në HPUSH është 534 b/km², një vlerë mjaft e lartë kjo, rreth 5 herë më e lartë se mesatarja e vendit që është 97 b/km² (121).

Duhet thënë se kjo dendësi ka ardhur duke ndryshuar në kohë, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të popullsisë. Kështu nga të dhënat që kemi në dispozicion mund të

¹¹⁸ Vetëdeklarimet, janë deklarime të bëra nga vetë pronarët e ndërtesave informale të ndërtuara pas vitit 1990, të cilat i janë nënshtruar procesit të legalizimit.

¹¹⁹ Të dhëna të marra nga ALUIZNI, dega Shkodër; tetor 2013

¹²⁰ Dritan Rustja; *Studime Albanologjike nr. 4*, Tiranë 2009, fq 73-81

¹²¹ INSTAT; *Të dhënat paraprake të Censurit 2011*, Tiranë 2012.

nxjerrim dendësinë e popullsisë në komunë për v. 1989, që është 243 b/km², pra vëmë re se kemi më shumë se një dyfishim të këtij treguesi.

Nga kjo arrijmë të kuptojmë faktin se vetë HPUSH, e gjendur në periferi të qytetit më të madh verior të Shqipërisë - Shkodrës, përfaqëson në vetvete një zonë deri diku të urbanizur, sidomos në hapësirën që gjendet më pranë qytetit. Tipik këtu është fshati Dobraq, i cili më shumë sesa një fshat është në realitet një lagje e qytetit, me tipare urbane të theksuara. Dendësi të konsiderueshme kanë edhe fshatrat Golem, Shtoj i Ri dhe Grudë e Re (madje mund të themi se të tre këto fshatra lidhen mes tyre nëpërmjet ndërtimeve, duke mos pasur më kufinj të mirëpërcaktuar), ndërkohë që më e rrallë paraqitet dendësia e popullsisë dhe banesave në fshatrat periferik të komunës si Guci e Re, Bardhaj, Zues, Bleran, etj. të cilat paraqesin tipare më rurale.

Pra në përgjithësi vihet re ndikimi i faktorit natyror në shpërndarjen e popullsisë, sidomos relievit (e lidhur me të edhe klimës) ku në vija të përgjithshme zona fushore dhe veçanërisht fusha e Shtoit paraqitet me një dendësi më të lartë të popullsisë, kurse zona kodrinore më një vlerë më të ulët të saj. Gjithashtu edhe urbanizimi i dy dekadave të fundit ka prekur më shumë zonën fushore, pasi atë zgjodhën banorët e ardhur për të ndërtuar shtëpitë e tyre, për shumë arsye të cilat ne do i shpjegojmë në çështjet në vijim.


III.2.3.Shtimi natyror i popullsisë

Shtimi natyror i popullsisë është një nga treguesit më të rëndësishëm demografik për një zonë apo vend të caktuar dhe llogaritet nga diferenca mes numrit të lindjeve dhe vdekjeve të kësaj popullsie, për një periudhë të caktuar kohore, zakonisht për një vit. Le t'i trajtojmë atëherë me rradhë, secilin prej këtyre dy treguesve të tij për komunën Rrethina dhe të nxjerrim rezultatën e tyre.

•*Lindshmëria*. Dimë se lindjet janë treguesi pozitiv i shtimit natyror, tregues që varet nga një sërë faktorësh ekonomik, shoqëror, politik, etj. Duke parë statistikën e popullsisë së komunës Rrethinat dhe duke i analizuar ato shohim se gjatë vitit 2011 në komunë ka pasur 405 lindje të gjalla (205 meshkuj, 200 femra) ose 16 për mijë¹²². Kjo vlerë është pak më e lartë sesa mesatarja në rang vendi, që llogaritet të jetë në 12 për mijë, por në vija të përgjithshme, duke parë këtë tregues edhe në vite të tjera, mund të thuhet se vlerat e këtij treguesi në këtë zonë janë pak a shumë të përafërta me ato në rang kombëtar. Duke pasur në dispozicion të dhënat e këtij treguesi edhe më herët, vëmë re se në v.1997 numri i lindjeve të gjalla në komunë ishte 25 për mijë, pra shihet se ka një rënie të konsiderueshme me v. 2011 prej rreth 9 lindjesh më pak për 1000 banorë.

Kështu, vihet re se lindjet kanë ardhur në rënie të vazhdueshme, gjë që reflekton pikërisht ndryshimin e kushteve shoqërore dhe ekonomike gjatë këtyre 20 viteve të sistemit demokratik, forcimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe gjithashtu edhe futjen e praktikave të planifikimit familjar. Mund të thuhet se nga një proces i tillë, u prek së pari popullsia më e hershme e hapësirës periurbane, e në mënyrë graduale kjo tendencë po përhapet edhe në popullsinë e ardhur.

¹²² Të dhënat janë marrë nga Zyra e Gjendjes Civile e komunës Rrethinat, Shkodër



Harta 7: Dendësia e popullsisë në vendbanimet e HPUSH

Një tjetër tregues që mund të na ndihmojë të kuptojmë më mirë lindshmërinë në komunën Rrethina, është edhe numri i *martesave*. Edhe vlerat e këtij treguesi janë në rënie: kështu në v. 1997 kishim 300 lidhje martesore në këtë zonë, në v. 2005 - 155 të tilla, dhe në v. 2011-153 lidhje martesore. Siç e shohim, rënia e numrit të lindjeve, ka ecur paralelisht me rënien e numrit të martesave në HPUSH, duke reflektuar ndryshimet sociale të ndodhura pas vitit 1990.


•*Vdekshmëria*. Vdekjet janë treguesi negativ i shtimit natyror të popullsisë, të cilat ndikojnë në zvogëlimin e numrit të saj. Gjatë vitit 2011, në komunën Rrethina rezultojnë të ketë 114 të vdekur (nga të cilët 70 janë meshkuj dhe 44 femra), ose 4.5 për mijë. Një vlerë e tillë e vdekshmërisë, është në fakt më e ulët sesa mesatarja në rang vendi, që sipas të dhënave të censusit 2011 rezultojnë të jetë afërsisht 7 për mijë. Duke e parë këtë tregues gjatë viteve, vëmë re se edhe ai ka pësuar rënie; kështu në v.1997 ishte 8 për mijë, ndërkohë që pas viteve 2000 është stabilizuar në kuotat e 4-5 për mijë. Rënia e numrit të vdekjeve, mund të lidhet me përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e zonës, si dhe me përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe të kujdesit shëndetësor në terësi, nga ana e shtetit. Ndërkohë, sipas të dhënave që zotërojmë, vdekshmëria foshnjore në komunë gjatë v. 2011 rezultojnë të jetë 0, duke përforcuar atë që thamë më sipër.

Duke zotëruar vlerat e lindshmërisë dhe vdekshmërisë, ne mund të nxjerrim edhe vlerën e *shtimit natyror* për popullsinë e kësaj komune në v. 2011: i cili rezultojnë të jetë

me 291 banorë ose 11,5 për mijë (pra 11,5 banorë të rinj të shtuar, për çdo 1000 banorë, kuptohet në vlera aritmetike); një tregues ky më i lartë sesa mesatarja në rang vendi. Duke e parë këtë tregues në kontekstin kohor, shohim se në v.1997 vlera e tij ishte 17/000, në v. 2005 rreth 11/000 dhe sot pak a shumë në ato vlera. Tendenca, fillimisht e rënies së vlerës së shtimit natyror, dhe më pas e stabilizimit deri diku të tij, është e lidhur me uljen paralele si të numrit të lindjeve, ashtu edhe të vdekjeve dhe ndikohet nga një sërë faktorësh.

Kështu, pas viteve '90 kemi ndryshime rrënjësore të ndodhura në sferën ekonomike, sociale, politike, të mënyrës së jetesës, etj. Mosha mesatare e popullsisë është rritur, mosha e hyrjes në martesë qoftë për meshkujt, qoftë për femrat është rritur; numri i martesave gjithashtu, siç e thamë, ka rënë. Po ashtu, tek çiftet e rinj vërehet një zgjatje e periudhës së pritjes për fëmijën e parë pasi ata dëshirojnë fillimisht të stabilizohen nga ana ekonomike, profesionale, etj. Edhe numri i fëmijëve të lindur nga një çift është në rënie të vazhdueshme, zakonisht jo më shumë se dy, sidomos nëse janë djalë e vajzë. Vetë prindërit dëshirojnë të jenë më pak të angazhuar me fëmijët, e t'i kushtojnë më shumë kohë vetes, punës e pse jo edhe karrierës, etj.

Natyrisht këto dukuri janë më të përhapura në zonat urbane, por që kanë prekur edhe hapësirat e tjera të banuara, aq më shumë kur ato ndodhen në periferi të qyteteve të mëdha. Pastaj nuk duhet harruar fakti se tek moshat e reja mentalitetet dhe mënyrat e jetesës uniformizohen më shpejt. Madje, mund të thuhet se po të mos ndërhynte faktori i shtimit të lartë natyror nga popullsia e ardhur në komunë, (banorët e rinj që vijnë kryesisht nga zona më të thella), rritja natyrore e popullsisë së komunës do ishte në ritme dhe më të vogla sesa ndodh aktualisht.




Graf. 5: Shtimi natyror i popullsisë në HPUSH

III.2.4. Struktura gjinore e popullsisë

Me datë 30.06.2012 rezulton se popullsia e komunës Rrethina përbëhet nga 13 271 meshkuj dhe 11 848 femra¹²³. Duke parë të dhënat, vëmë re se në të gjithë fshatrat e komunës popullsia e gjinisë mashkullore, mbizotëron mbi atë femërore (një diferencë e konsiderueshme vihet re veçanërisht në fshatin Grudë e Re) dhe në terësi për të gjithë komunën ka 1423 meshkuj më shumë sesa femra. Duke e studiuar këtë tregues në

¹²³ Të dhënat janë marrë nga Zyra e Gjendjes Civile e komunës Rrethinat, Shkodër, korrik 2013

këndvështrimin kohor, vëmë re se në v.1989 në këtë zonë popullsia përbëhej nga 5933 meshkuj dhe 5455 femra; në v.1997-7372 meshkuj dhe 7099 femra dhe në v. 2005 - 11835 meshkuj dhe 10260 femra; pra pavarësisht luhatjeve në kohë, popullsia mashkull ka qenë gjithnjë më e shumtë në numër sesa ajo femër¹²⁴; madje siç e vëmë re në grafikun e mëposhtëm, kjo tendencë veçse ka ardhur duke u theksuar gjatë viteve. Arsyet mund të kërkohen tek numri lehtësisht më i madh i të lindurve gjatë viteve në favor të seksit mashkull¹²⁵, si dhe tek përqindja më e lartë e popullsisë së ardhur që i përket gjinisë mashkullore. Gjithsesi, vitet e fundit mund të ketë ndërhyrë në këtë drejtim edhe një faktor tjetër jo natyror, ai i preferencës që kanë prindërit e rinj për të lindurit meshkuj, në raport me ato femra, e vënë re si dukuri edhe në shkallë kombëtare.



Graf. 6: Ndryshimi i strukturës gjinore të popullsisë së HPUSH, gjatë viteve


III.2.5. Struktura moshore e popullsisë

Për llogaritjen e këtij treguesi mund të bazohemi tek të dhënat që kemi në dispozicion nga dy censuset e përgjithshme të popullsisë, ato të v. 2001 dhe 2011¹²⁶. Sipas përlllogaritjeve të bëra nga të dhënat e *censusit të v. 2001*, nga një total prej 15 337 banorësh, 32% i përkasin grupmoshës 0-14 vjeç; 61% grupmoshës së punës, 15-64 vjeç dhe 7% grupmoshës mbi 65 vjeç (popullsisë së dalë në pension). Ndërkohë, të dhënat e marra mbi këtë tregues nga *censusi i v. 2011* na japin një panoramë disi të ndryshme: këtu vihet re se nga një total prej 21199 banorësh, 26% i përkasin grupmoshës 0-14 vjeç; 64% grupmoshës 15-64 vjeç dhe 10% grupmoshës mbi 65 vjeç. Pra duke bërë një krahasim mes të dhënave të dy censuseve, vihet re një rënie e përqindjes së popullsisë që përfshin grupmosha 0-14 vjeç dhe një rritje e popullsisë që bën pjesë në grupmoshën e punës dhe në atë të pensionit. Edhe moshja mesatare është rritur nga rreth 31 vjeç në v. 2001, në afërsisht 35 vjeç sot.

¹²⁴ Edhe sipas të dhënave të censusit 2011, pavarësisht se me një diferencë më të vogël, mbizotëron popullsia mashkull në raport me atë femër (10618 M - 10581 F)

¹²⁵ Raporti gjinor në lindje sipas censusit 2011 në vendin tonë 107,8 meshkuj për 100 femra

¹²⁶ Të dhënat mbi strukturën moshore të popullsisë nuk disponohen në zyrën e gjendjes civile të komunës



Graf. 7: *Ndryshimi i strukturës moshore të popullsisë së HPUSH*

Pra siç shihet, vëmë re tendencat e para të ndryshimit të strukturës moshore të popullsisë edhe në HPUSH, si dhe shenjat e para të plakjes së kësaj popullsie; në raport me strukturën e trashëguar nga periudha para viteve '90. Përqindja e lartë e popullsisë aktive (në moshën e punës) sot, nga njëra anë përbën një burim të pazëvendësueshëm njerëzor, por nga ana tjetër përbën edhe një problem të ndjeshëm social për shkak të mundësive të pakta të punësimit që ekzistojnë.

III.2.6. Përbërja etnike dhe fetare e popullsisë së HPUSH


Përsa i takon *përbërjes etnike* të popullsisë së HPUSH (ose komunës Rrethinat) ajo është homogjene duke qenë 100 % shqiptare; megjithatë duhet thënë se nga origjina dhe përbërja social-kulturore, siç e theksuam edhe më sipër, popullsia e komunës karakterizohet nga heterogjeniteti; dukuri për të cilën do flasim më shumë në kapitujt në vijim.

Ky heterogjenitet vihet re edhe në *përbërjen fetare* të popullsisë, ku sipas të dhënave të marra nga komuna, si dhe nga vezhgimet në terren dhe intervistat e realizuara me banorët dhe personat kyç për çdo fshat, vihet re se ka një mbizotërim të popullsisë së besimit islam, me rreth 62%, ndjekur nga besimtarët katolikë me rreth 38%; mund të evidentohet këtu një pakicë e besimtarëve ortodoks me rreth 0,1%.

Fshatrat Grudë e Re, Hot i Ri, Bardhaj dhe Bleran, dallohen për mbizotërim të popullsisë së besimit katolik; kjo vihet re si tek popullsia më e hershme ashtu dhe tek ajo e ardhur; kjo e fundit e ka origjinën nga zona malore e Shkodrës, sidomos nga Dugagjini (zona e Shalës, Shoshit, Shllakut, etj). Kurse fshatrat Dobraç, Golem, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, Guci e Re dhe Zues kanë në shumicë popullsi të besimit mysliman; gjë që vlen si për popullsinë më të hershme, ashtu edhe për atë të ardhur gjatë 20 viteve të fundit, origjina e së cilës është më tepër nga zona e Malësisë së Madhe dhe Postriba (Vilëz, Domën, Reçi, etj)¹²⁷.

Gjithsesi duhet theksuar është se në të gjithë fshatrat e HPUSH gjen besimtarë të të dy besimeve kryesore dhe se në përgjithësi marrëdhëniet mes banorëve të besimeve të ndryshme kanë qenë vazhdimisht të mira, korrekte dhe reciprokisht tolerante; duke reflektuar në këtë mënyrë vlerat më të mira të tolerancës fetare në rang vendi.

¹²⁷ D. Rustja; *Intervista me personat kyç për çdo fshat*, Shkodër, tetor - nëntor 2013



Graf. 8: Përbërja fetare e popullsisë në HPUSH

III.3. Lëvizjet migruese të popullsisë, shkaqet, përmasat dhe pasojat

III.3.1. Migrimi i brendshëm

Migrimi, sidomos ai brendshëm, përbën një ndër elementët demografik më dinamik për zonën që kemi marrë në studim, sidomos gjatë 23 viteve të fundit. Siç e thamë, numri i popullsisë së HPUSH gjatë kësaj periudhe është mëse dyfishuar, dhe kjo rritje është kryesisht rezultat i ardhjes së popullsisë në territorin e saj.

Dy janë treguesit kryesor të këtij migrimi: *vendosjet* (ardhjet e popullsisë në një zonë të caktuar, konkretisht në HPUSH) dhe *shpërnguljet* (largimi i popullsisë nga ajo zonë). Ky proces, me të dy treguesit e tij ka qenë mjaft i spikatur për popullsinë e komunës Rrethinat pas viteve '90 dhe drejtimet kryesore të tij kanë qenë: ardhja e popullsisë nga zonat më të thella rurale dhe malore të Shkodrës dhe Malësisë së Madhe dhe largimi i kësaj popullsie, kryesisht drejt zonave urbane (sidomos qytetit të Shkodrës).

Gjatë vitit 2011¹²⁸ rezulton se në komunën Rrethinat janë vendosur 356 banorë të rinj (nga të cilët 104 meshkuj dhe 252 femra) dhe janë shpërngulur vetëm 25 banorë (pothuajse të gjitha femra); kështu diferenca e lëvizjeve migruese është mjaft pozitive, me rreth 331 banorë të shtuar vetëm nga ardhjet e popullsisë. Duke pasur parasysh edhe diferencën pozitive nga shtimi natyror (atë mes lindjeve dhe vdekjeve me 291 banorë), vëmë re se gjatë vitit 2011, popullsia e komunës Rrethina është shtuar me 622 banorë në raport me vitin paraardhës.

Siç e kemi theksuar edhe më sipër, shtimi i popullsisë ka qenë i vazhdueshëm në HPUSH, pas viteve '90. Megjithatë, diferenca e konsiderueshme që vihet re mes ardhjeve dhe largimit të popullsisë gjatë v. 2011 është disi specifike për këtë vit; sepse nga të dhënat që zotërojmë për vitet e mëparshme, pavarësisht se gjithmonë kanë mbizotëruar vendosjet e popullsisë, kjo diferencë është më e vogël. Kështu, në v.1997, numri i të ardhurve në komunën Rrethina ishte 400, kurse i të larguarve 380; në v. 2005 ky raport ishte 1731 me 681¹²⁹; në v. 2007, 371 me 267 dhe në v. 2010, 341 me 365; pra me përjashtim të v. 2010 tendenca është në favor të vendosjes së popullsisë në territorin e HPUSH.


¹²⁸ Të dhënat janë marrë nga Zyra e Gjendjes Civile të komunës Rrethinat

¹²⁹ Në tetor 2004 doli ligji i lejeve të banimit ose pasaportizimi, që solli njohjen e një pjese të popullsisë informale të zonës

- *Vendosja* (ardhja) e popullsisë në HPUSH, siç e thamë, është një dukuri tipike për këtë zonë gjatë këtyre viteve të tranzicionit. Një gjë e tillë është e lidhur me disa faktorë, si: pozicioni i përshtatshëm gjeografik që ka ajo në raport me qytetin e Shkodrës, si dhe me përparësi të tjera që ofron kjo zonë në aspektin natyror apo human, aq më tepër nëse i krahasojmë ato me karakteristikat e popullsisë së ardhur.

Që në vitet e para të sistemit të ri demokratik u vunë re dyndje të popullsisë në HPUSH. Shkaqet që çuan në lëvizjen e kësaj popullsie në drejtim të periferisë së qytetit të Shkodrës ishin disa. Faktorët kryesor qenë padyshim ata ekonomik dhe social, ku përmendim fondin e kushtëzuar të tokës bujqësore, varfërinë, gjendjen e rënduar të shërbimit shëndetsor, arsimor dhe infrastrukturor në terësi si dhe mungesën e mundësive për argëtim¹³⁰, pra kushtet mjaft të vështira të jetesës së kësaj popullsie në zonat e tyre malore.

Shkaqe të tjera plotësuese ishin edhe e drejta e rifituar e lëvizjes së lirë si dhe dëshira për një jetë më të mirë¹³¹. Afërsia me qytetin e Shkodrës dhe ekzistenca e tokave të lira bujqësore me pronësi të dikutueshme, ishte një faktor nxitës i rëndësishëm për vendosjen e kësaj popullsie në HPUSH.



Graf. 9: Lëvizja mekanike e popullsisë në HPUSH pas vitit 1990

Duhet thënë se ardhja e popullsisë në territorin e komunës nuk ka ndodhur vetëm nga zonat malore, por edhe nga zonat rurale të rajonit të Shkodrës. Ka banorë që vijnë nga fshatra të tjera jashtë komunës, në disa raste edhe nga qyteti i Shkodrës, por gjithsesi vazhdon të mbizotërojë ardhja e popullsisë nga zonat periferike malore të rajonit të Shkodrës.

Ardhja e kësaj popullsie në HPUSH ka pasur padyshim pasoja të konsiderueshme mjedisore, social-ekonomike dhe territoriale, ku mund të përmendim: rritjen e numrit dhe dendësisë së popullsisë së saj, copëzimin e tokës bujqësore dhe

¹³⁰ Sabri Laçi, Selman Sheme; *Seminari ndërkombëtar "Shkodra në shekuj"*, fq. 275-281, Shkodër 1995

¹³¹ Dritan Rustja; *Intervista me popullsinë e ardhur në komunë pas v. 1990*; Shkodër, nëntor 2013.

degradimin e saj, zhvillimit e informalitetit urban dhe ekonomik, si dhe rritjen e tensioneve sociale.

- Edhe *shpërngulja*, ose largimi i popullsisë nga territori i komunës, është gjithashtu një dukuri që ndodh, edhe pse vazhdimisht ka qenë më pak e rëndësishme sesa ardhjet. Popullsia e larguar nga HPUSH zhvendoset më shpesh drejt qytetit të Shkodrës, më rrallë drejt qyteteve të tjera (sidomos Tiranës) e në disa raste edhe në fshatra apo zona të tjera rurale të Shkodrës. Largohet në përgjithësi ajo pjesë e popullsisë që e ka jetesën të lidhur më shumë me qytetin sesa me fshatin.

III.3.2. Migrimi i jashtëm

Përsa i takon migrimit të popullsisë së komunës jashtë vendit (*emigrimit*), mund të themi se edhe ai është një element që duhet marrë në konsideratë. Ky emigrim është një proces që ka marrë përmasa masive pas viteve '90, por duhet thënë se nuk ka shifra të sakta sesa mund të jetë numri i emigrantëve nga HPUSH që jetojnë jashtë vendit, pasi mungojnë të dhënat zyrtare. Megjithatë mund të themi se kjo dukuri, prek një pjesë të konsiderueshme të familjeve të komunës, qoftë për popullsinë më autoktone, qoftë për popullsinë e ardhur; kështu sipas të dhënave jozyrtare, mendohet se rreth 25% e familjeve të komunës e kanë të paktën një anëtar në emigracion me kohë të përhershme; ndërsa rreth 10 % e tyre kanë emigrantë sezonalë¹³². Grupmosha që gjendet më shumë në emigracion është ajo 20-40 vjeç dhe në përgjithësi grupmosha e punës.

Emigrantët jetojnë dhe punojnë kryesisht në Itali, Greqi dhe Angli (por kuptohet edhe në vendet e tjera të BE-së), dhe vitet e fundit një pjesë e mirë e tyre janë pajisur me dokumentat përkatëse dhe vijnë për të kaluar pushimet në vendin e tyre. Arsyet e largimit të tyre kanë qenë natyrisht ekonomike, dhe në fakt këta emigrantë, përveç se kanë arritur të përmirësojnë jetën e tyre, vazhdojnë të jenë një burim i rëndësishëm të ardhurash për familjet e tyre të origjinës dhe vetë HPUSH.

¹³² Dritan Rustja - *Intervista me personat kyç për çdo fshat dhe me specialistin e demografisë në komunën Rrethinat, Shkodër, tetor 2013*

Kapitulli i katërt

VEÇORITË E ZHVILLIMIT SOCIAL- EKONOMIK

IV.1. Jeta sociale

IV.1.1. Familja dhe komuniteti

IV.1.1.1. Evolucioni i familjes dhe gjendja e sotme

Familja, si bërthama e shoqërisë, përbën një element shumë të rëndësishëm të tipareve dhe marrëdhënieve sociale për HPUSH. Evolucioni i saj, tregon në një mënyrë thelbësore, edhe evolucionin që përjeton një shoqëri e caktuar. Le të shohim si paraqitet ecuria e saj në zonën që kemi marrë në studim, duke filluar me numrin e familjeve dhe të pjestarëve të saj në periudha të ndryshme kohore.

Të dhënat në këtë drejtim për HPUSH, i zotërojmë që nga viti 1945¹³³. Bazuar në këto të dhëna vëmë re se për këtë zonë, numri i përgjithshëm i banorëve është 2305, kurse ai i familjeve 422, duke na dhënë një vlerë mesatare prej 5,5 pjestarësh për çdo familje. Po nga këto të dhëna, vëmë re se pavarësisht faktit se në terësi mbizotërojnë familjet me 3-5 frymë, kemi edhe një numër të konsiderueshëm të familjeve me 6-10 frymë, ndërkohë që nuk mungojnë edhe ato me 11-20 frymë (sidomos në Dobraç, Golem, Bardhaj, etj).

Ndërkohë në v.1989¹³⁴, numri i banorëve është 11388, kurse ai familjeve 2670, duke na dhënë një vlerë prej afërsisht 4,3 pjestarësh për familje. Pra shohim se edhe gjatë viteve të sistemit socialist, numri i anëtarëve për familje në HPUSH, është ulur në mënyrë të ndjeshme.

Sipas të dhënave të *Censusit 2001*, në HPUSH kemi 11335 banorë dhe 3785 familje dhe një numër prej 4,05 pjestarësh për familje. Gjithsej janë 239 familje me 1 person, 571 familje me 2 persona, 5993 familje me 3 persona, 906 familje me 4 persona, 788 familje me 5 persona dhe 682 familje me 6 persona¹³⁵.


Së fundi, përmendim të dhënat e *Censusit të v. 2011*, i cili evidenton 21199 banorë dhe 5214 bërthama familjare, duke na dhënë një vlerë prej 4,06 pjestarësh për familje¹³⁶. Nga këta, 1149 bërthama familjare janë çift i martuar pa fëmijë, 3485 çift i martuar me fëmijë, 52 baba i vetëm me fëmijë dhe 321 bërthama familjare nënë e vetme me fëmijë.

¹³³ Rregjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i v. 1945 (Lokaliteti i Qendrës); Të dhëna të marra në Arkivën Shkodër, tetor 2012

¹³⁴ Të dhënat janë marrë në Zyrën e Statistikave të Instat Shkodër, korrik 2013

¹³⁵ INSTAT, *Popullsia e Shqipërisë*, Qarku Shkodër, Tiranë 2001

¹³⁶ INSTAT; *Censusi i popullsisë dhe banesave 2011* – Qarku Shkodër, Tiranë 2012



Graf. 10: Ndryshimi i numrit të anëtarëve për familje për periudhën 1945-2011

Siç edhe e shohim, nga analizimi i të dhënave në kohë, edhe nëpërmjet grafikut të mësipërm, vëmë re sesi numri i anëtarëve për familje ka ardhur në rënie të vazhdueshme, sidomos në periudhën 1945-1989, duke arritur një lloj stabiliteti me rreth 4 pjestarë për familje, në vitet 2000. Një gjë e tillë reflekton vetë ndryshimet sociale dhe ekonomike të shoqërisë në përgjithësi në periudha të ndryshme kohore, ndryshimin e marrëdhënieve sociale brenda familjes dhe copëzimin e vazhdueshëm që ka pësuar ajo. Të dhënat e censurit të fundit na bëjnë të kuptojmë se tendenca e sotme është drejt mbizotërimit të familjeve të veçanta (çift me fëmijë), që jetojnë në një strehë të vetme dhe me njësi ekonomike familjare të veçantë. Pra vëmë re se konceptet bashkëkohore të marrëdhënieve familjare janë karakteristike edhe për hapësirën periurbane të Shkodrës.

IV.1.1.2. Marrëdhëniet në familje dhe komunitet

Në HPUSH, vihet re se *marrëdhëniet brenda familjes* paraqiten mjaft komplekse por në përgjithësi janë në fazën e kalimit nga tradicionale në bashkëkohore. Ndërsa marrëdhëniet mes familjeve të të njëjtit fis dhe në terësi brenda fshatit mbeten përgjithësisht korrekte, por duhet thënë se kanë pësuar një ftohje relative, lidhur me individualizmin që karakterizon shoqërinë e re shqiptare dhe me problemet e pronësisë që nuk janë të rralla.

Përsa i takon *marrëdhënieve mes anëtarëve të komunitetit*, ato tradicionalisht kanë qenë të mira. Duke pasur parasysh edhe prejardhjen ose origjinën, afërsinë territoriale etj., kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë lidhje më të forta mes banorëve të fshatrave Dobraç dhe Golem; Grudë e Re dhe Hot i Ri; Bardhaj dhe Bleran; si dhe atyre Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër dhe Guci e Re. I izoluar dhe jo thjesht në aspektin gjeografik mbetet fshati Zues i cili realisht ka pak gjëra të përbashkëta me fshatrat e tjerë përbërës të komunës. Ky fshat është i lidhur më shumë, dhe më tepër sesa në aspektin gjeografik në atë etnografik dhe shpirtëror, me banorët e komunës së Anës së Malit prandaj realisht duket se ai vazhdon të jetë pjesë e komunës Rrethinat thjesht për rastësi ose më saktë nga dembelizmi burokratik.

Ndërkohë, *marrëdhëniet mes banorëve të ardhur dhe atyre autokton* janë të pranueshme dhe në proces ndërtimi, megjithëse duhet thënë se problemet dhe paragjykimet në këtë aspekt nuk mungojnë.

Përsa i takon *tipareve sociale dhe kulturore* të banorëve të HPUSH duhet të bëjmë sërish një dallim që vihet re mes banorëve të ardhur me ata vendas. Banorët e hershëm të

komunës, të gjendur vazhdimisht nën tryshinë urbane të qytetit të Shkodrës janë ndikuar dukshëm nga karakteristikat humane, kulturore dhe sociale të tij duke marrë mjaft nga mënyra e jetesës qytetare. Siç edhe e kemi thënë Dobraçi më shumë sesa një fshat mund të konsiderohet një lagje e qytetit. Kjo vlen deri diku edhe për fshatrat e tjerë të HPUSH, sidomos ata që janë më pranë Shkodrës. Ndërsa banorët e ardhur vitet e fundit, pavarësisht vështirësisë për tu shkëputur nga mënyra e tyre e jetesës malësore, janë gjithsesi të prirur për të përqafuar të renë dhe për t'u përshtatur.

IV.1.1.3. Integrimi dhe diskriminimi social

Studimet në lidhje me integrimin dhe diskriminimin social, sidomos të banorëve të ardhur në HPU të vendit tonë, nuk janë të shumta dhe paraqesin rezultate kontradiktore. Sipas një studimi të kryer në lidhje me integrimin e banorëve të ardhur nga Alpet P. në rajonin e Shkodrës¹³⁷, shenjat janë inkurajuese, pasi në vetëm 5,3% të rasteve familjet e anketuara deklaruan se kanë konflikte me vendasit për shkak të tokës që kanë zënë; ndërsa 42% e tyre deklaruan se ndjehen të integruar në jetën e komunitetit të ri.

Ndërsa sipas një studimi tjetër, të kryer në HPU të Tiranës, thuhet se: “ndër banorët e rrethinës, ndjenja e kolektivitetit është e zbehtë; njohjet e ndërsjellta ndërmjet fqinjëve janë të pakta, përgjithësisht ata jetojnë brenda subkulturës së krahinës nga kanë ardhur¹³⁸. Një tjetër studim i kryer, thekson faktin se individit i ardhur në një mjedis të ri kulturor, moral dhe shoqëror, ndjehet i huaj, i paintegruar dhe i përjashtuar¹³⁹, gjendje e cila i ngjall një ndjenjë agresiviteti ndaj mjedisit që e rrethon, duke e shtyrë atë drejt sjelljeve deviante.

Në një nga studimet e pakta në këtë drejtim, ku përmendet edhe HPUSH¹⁴⁰, thuhet se kjo zonë, pasqyron në aspektin social-kulturor, njëherazi edhe tipare të qytetit, edhe të fshatit, diçka të ndërmjetme që anon aktualisht më shumë nga fshati.

Gjithashtu, aty theksohet fakti se banorët e vjetër shfaqin skepticizëm kur bëhet fjalë për integrimin e banorëve të rinj, ndërkohë që këta të fundit e ndjejnë denigrimin që u bëhet atyre. Megjithatë, po aty thuhet se, në rastet kur këta banorë kanë mundësinë për të punuar dhe komunikuar së bashku, ata mësojnë ta rivlerësojnë njëri-tjetrin.

Ndërkohë, sipas intervistave të kryera për qëllimet e këtij studimi¹⁴¹ me banorët e ardhur në HPUSH pas vitit 1990, vihen re shenja optimiste. Shumica e tyre shprehën se janë të kënaqur në lidhje me marrëdhëniet që kanë me fqinjët dhe se në përgjithësi nuk ndjehen të diskriminuar. Duhet thënë se me kalimin e viteve banorët e vjetër dhe ata më të rinj të HPUSH mësuuan të njihnin më mirë dhe të pranonin njëri-tjetrin. Kuptohet, që integrimi në jetën urbane i popullsisë rurale të vendosur gjatë viteve të fundit në periferi të qyteteve, nuk është i lehtë, pasi është një proces që kërkon kohë dhe shpenzime. Si çdo lëvizje sociale edhe kjo shprehet në shtimin e konflikteve sociale, sidomos në lidhje me çështjen e pronësisë si dhe në integrimin e subkulturave. Prandaj është e nevojshme që

¹³⁷ S. Laçi, S. Sheme: *Seminari ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”*, fq. 275-281, Shkodër 1995

¹³⁸ Z. Dervishi; *Politika dhe shoqëria* 2001, 1 (8): fq 33-42

¹³⁹ A. Fuga, Z. Dervishi; *Botimet Dudaj*, Tiranë 2010, fq. 172

¹⁴⁰ M. Kroni; *Lente sociologjike*, Vëllimi I, nr. 1 – 2011, fq. 99-119

¹⁴¹ D. Rustja, *Intervista të thelluara me popullsinë e ardhur në HPUSH pas vitit 1990*; Shkodër, 2013

organet shtetërore të kenë strategji të qarta në lidhje me integrimin e natyrshëm të tyre në jetën e komunitetit¹⁴², gjë e cila deri më sot, të paktën për HPUSH, nuk ka ndodhur.

Kështu vihet re qartë se shërbimi social, infrastruktura apo punonjësit social, që duhej të kontribuonin në këtë drejtim janë të mangët ose thuhet se inekzistencen në këtë zonë.

IV.1.2. Arsimi

IV.1.2.1. Historiku i zhvillimit të arsimit dhe infrastruktura

Në lidhje me zhvillimin e arsimit në HPUSH, mund të thuhet se popullsia e zonës ka qenë dhe është arsimdashëse. Shkolla e parë është hapur më 1 Tetor 1946 në fshatin Golem¹⁴³, e cila ka shërbyer edhe për nxënësit e fshatrave të tjerë të zonës deri pas viteve '60, ku gradualisht u hapën njëra pas tjetrës shkollat në çdo fshat. Kështu, në v. 1964 u ndërtua dhe u hap shkolla e re në fshatin Grudë e Re, kurse në v. 1970 u ndërtuan shkollat 8-vjeçare edhe në fshatrat Dobraq dhe Shtoj i Ri, e më vonë edhe në Hot të Ri. Më të fundit janë shkollat e reja të arsimit bazë të ndërtuara në fshatin Guci e Re (v. 2000) dhe Bardhaj (v. 2005). Deri vonë mësuesit kanë ardhur kryesisht nga qyteti i Shkodrës, por vitet e fundit po angazhohen në këtë profesion edhe banorët vendas që kanë mbaruar shkollën e lartë. Me përjashtim të disa mësuesve të ciklit të ulët që kanë arsim të mesëm, pjesa më e madhe e tyre ka arsimin përkatës. Pas një rënie të dukshme që pësoi cilësia e mësimit pas vitit 1990, vihet re një përmirësim i saj në vitet e fundit.

Gjendja e godinave të shkollave është relativisht e mirë, pasi pjesa më e madhe e tyre është rikonstruktuar vitet e fundit apo është ndërtuar krejtësisht e re. Edhe infrastruktura e brendshme e tyre është përmirësuar nëpërmjet pajisjes me kompjutera, mjete të reja mësimore, etj. megjithatë në këtë drejtim mbetet akoma shumë për t'u bërë.

Megjithatë, arsimi në HPUSH nuk arrin t'i përmbushë plotësisht nevojat e komunitetit. Të gjithë objektet shkollorë kanë nevojë për shtim të ambjentëve, përmirësim të kushteve dhe në disa raste ka nevojë edhe për objekte të reja, ndërkohë që paraqitet i domosdoshëm ndërtimi i një shkolle të mesme që mungon në këtë komunë.

¹⁴² Sabri Laçi; *Gjeografia rurale*; Progres, Tiranë 2005. Fq. 285

¹⁴³ Eljaz Kraja; *Mësues në fshat në vitet '60 - kujtime dhe refleksione*, Rozafa 1, Shkodër 2005; fq. 79

IV.1.2.2. Personeli arsimor dhe nxënësit

Siç edhe e shohim nga pasqyra përmbledhëse e paraqitur më poshtë, në të gjithë fshatrat e komunës ka shkolla të nivelit 9-vjeçar pra me cikël të plotë, si dhe kopshte të ciklit parashkollor.

Tabela 6: *Personeli arsimor dhe nxënësit sipas shkollave në HPUSH, në fund të vitit shkollor 2012-2013¹⁴⁴*

Nr	Shkolla	Nxënës (Gj)	Nxënës (F)	Mësues
1	Dobraç	333	144	26
2	Golem	297	154	23
3	Grudë e Re	493	241	28
4	Hot i Ri	275	131	20
5	Bardhaj (+Bleran)	596	271	29
6	Shtoj i Ri	324	171	23
7	Guci e Re	121	58	10
8	Shtoj i Vjetër	216	102	16
9	Zues	80	38	11
	Gjithsej	2735	1310	186


Së fundi edhe në fshatin Bleran është ndërtuar një shkollë e re, e cila shërben edhe për banorët e fshatit Bardhaj. Prandaj mund të themi se mundësitë për shkollim, të paktën përsa i takon arsimin të detyrueshëm, ekzistojnë për të gjithë banorët e zonës dhe në fakt, me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë (fëmijë, familjet e të cilëve janë në konflikte të hapura ose që për arsye ekonomike janë të detyruar të punojnë), pjesa dërrmuese e fëmijëve 6-15 vjeç e ndjekin rregullisht procesin mësimor.

Theksojmë se janë rreth 19 fëmijë (nga të cilët 16 femra), që gjenden kryesisht në fshatin Bardhaj dhe Grudë e Re, të cilët janë të ngjuar për shkak të gjakmarrjes dhe ndjekin mësimin në kushtet e shtëpisë, të shpërndarë në 9 vatra. Ata i përkasin më shumë kategorisë së popullsisë së ardhur në HPUSH pas viteve '90 dhe mbartin konflikte të mëparshme nga vendi i origjinës.

¹⁴⁴ Të dhënat janë marrë nga Zyra e Statistikave të Drejtorisë Rajonale Arsimore, Shkodër; tetor 2013



Foto nr. 9: Shkolla 9-vjeçare Golem (D.Rustja)




Graf.11: Ndryshimi i numrit të nxënësve për çdo fshat, mes vitit 2008 dhe 2013

Përsa i takon arsimin të mesëm, siç e thamë mungon një shkollë e këtij niveli në territorin e HPUSH, e cila ka ekzistuar para viteve '90 në fshatin Grudë e Re. Kjo edhe për faktin se qyteti është krejt afër dhe se jo të gjithë nxënësit që mbarojnë ciklin 9 - vjeçar vazhdojnë arsimin e mesëm. Sidoqoftë numri i tyre ka ardhur duke u rritur madje një pjesë e mirë e tyre, sidomos vitet e fundit, ndjekin edhe studimet e larta. Prandaj, mungesa e një shkolle të mesme që të plotësojë kërkesat e banorëve të zonës, shihet se një problem aktual që duhet zgjidhur në të ardhmen.


IV.1.2.3. Struktura e arsimimit të popullsisë sipas niveleve

Për të njohur strukturën e arsimimit të popullsisë në HPUSH, na ndihmojnë të dhënat mbi këtë tregues të censusit 2001 dhe 2011, të cilët më mirë po i shpjgojmë në grafikun e mëposhtëm.



Graf. 12: Struktura e arsimimit të popullsisë për v.2001 dhe 2011

Grafiku i mësipërm na ndihmon të kuptojmë faktin se pjesa më e madhe e popullsisë në HPUSH ka arsimin bazë (ciklin e lartë 8 dhe 9-vjeçar), kategori së cilës i përket gati gjysma e popullsisë së arsimuar. Një pjesë shumë e vogël e popullsisë di shkrim dhe këndim, pavarësisht se nuk ka ndjekur shkollën; ndërkohë që vëmë re se ka rënë në mënyrë të konsiderueshme numri i analfabetëve për periudhën 10-vjeçare 2001-2011. Numri i banorëve që kanë arsimin bazë 4 dhe 5-vjeçar (ciklin e ulët) si dhe arsimin e mesëm është pothuajse i barabartë dhe ka pësuar një rritje të vogël për të dy kategoritë nga v.2001 në v. 2011, për shkak edhe të rritjes së përpjestuar të popullsisë. Një ndryshim më të dukshëm mes këtyre dy viteve vëmë re sidomos në kategorinë e arsimit të lartë (niveli bachelor dhe master), ku vëmë re një rritje të konsiderueshme që popullsisë që ka mbaruar arsimin universitar (6-fishim) të saj nga v. 2001 në v. 2011. Duhet thënë se kjo është periudha e liberalizmit dhe masivizimit të këtij sistemi arsimor në vendin tonë, gjë që është reflektuar në rritjen e numrit të studentëve që e kanë kryer ose po e ndjekin këtë arsim në këtë zonë. Një gjë e tillë besojmë se krijon premisa të mirë për zhvillimin perspektiv të HPUSH, duke rritur kualifikimin e krahut të punës dhe mundësinë e punësimit të tij në të ardhmen.



Harta 8: Infrastruktura arsimore dhe shëndetësore në HPUSH

IV.1.3. Shëndetësia

IV.1.3.1. Infrastruktura shëndetësore

Në HPUSH shërbimi shëndetësor ofrohet nga shteti nëpërmjet shërbimit parësor i cili përbëhet nga rrjeti i qendrave shëndetësore dhe ambulancave në fshatra, ku mjeku i lagjes, infermieri dhe mamia përgjigjen për shëndetin e banorëve të zonës. Me përjashtim të Zuesit, në të gjithë fshatrat e komunës ekzistojnë ambulancat me personelin shëndetësor përkatës; një pjesë e mirë e tyre janë ndërtuar gjatë viteve të fundit dhe në përgjithësi janë funksionale dhe në shërbim të banorëve të zonës. Afërsia me qytetin e Shkodrës lehtëson akoma më shumë kryerjen e shërbimeve të nevojshme shëndetësore për këta banorë. Në disa nga fshatrat e komunës ekzistojnë edhe autambulancat për rastet urgjente, ndërkohë që pothuajse çdo fshat ka farmaci private. Megjithatë, edhe sektori i shëndetësisë nuk i plotëson siç duhet nevojat e komunitetit, dhe ka nevojë për përmirësime të shumta në sasi dhe cilësi dhe shtim të kapaciteteve në ambiente.

IV.1.3.2. Personeli shëndetësor

Siç e shohim nga tabela e mëposhtme, personeli shëndetsor në HPUSH përbëhet nga 8 mjekë dhe 28 infermierë, duke mbuluar të gjithë fshatrat e komunës, me përjashtim të Zuesit. Fshati Bleran dhe Bardhaj kanë një ambulancë të përbashkët dhe një mjek të vetëm, por kanë një numër më të mjaftueshëm infermierësh; kurse fshati Zues mbulohet nga mjeku i Zogajve. Në përgjithësi stafi mjekësor ka arsimimin e duhur (të lartë), mjekët patjetër, por dhe shumica e infermierëve, ndërsa kualifikimi lë akoma për të dëshiruar dhe ka vend për përmirësim; ndërkohë që edhe numri i personelit shëndetsor mund të jetë më i lartë.

Tabela 7: *Personeli shëndetsor në HPUSH, në fund të vitit 2013*¹⁴⁵

Nr.	Fshati	Mjekë	Infermierë
1.	Bardhaj	1	4
2.	Bleran	-	3
3.	Dobraç	1	4
4.	Golem	1	2
5.	Grudë e Re	1	4
6.	Guci e Re	-	2
7.	Hot i Ri	1	3
8.	Shtoj i Ri	1	3
9.	Shtoj i Vjetër	1	2
10.	Zues	-	1
	Gjithsej	8	28

IV.1.3.3. Gjendja shëndetsore e popullsisë

Gjendja shëndetsore e popullsisë paraqitet në përgjithësi e pranueshme dhe e krahasueshme me atë në rang kombëtar. Megjithatë, ndotja e ambientit, mungesa e kanalizimeve të ujrave të zeza dhe të një edukate higjieno-sanitare përbën një rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektuese. Prandaj në këtë drejtim nevojitet më shumë vëmendje, investime dhe paralelisht me këtë është i domosdoshëm edhe ndërgjegjësimi i banorëve të zonës mbi problemet e pastërtisë dhe mjedisit të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në cilësinë e shëndetit dhe jetës së tyre.

¹⁴⁵ Të dhëna të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Parësor – Shkodër, tetor 2013

IV.1.4. Kultura dhe koha e lirë

Duhet theksuar që në fillim se jeta social-kulturore e banorëve të HPUSH është e zbehtë dhe ofron pak mundësi për mbushjen e kohës së lirë me veprimtari të dobishme qoftë në nivel individual, qoftë në nivel komuniteti.

Aktualisht në komunë nuk ka ndonjë qendër kulturore apo ndonjë bibliotekë, megjithëse në të kaluarën ka ekzistuar një e tillë në fshatin Dobraq. Po ashtu mungojnë parqet, lulishtet apo këndet e lojërave. Vihet re qartë mungesa e vëmendjes së strukturave të qeverisjes lokale në këtë drejtim, ku pothuajse nuk është realizuar asnjë investim me karakter publik.

Të vetmet mundësi për kalimin e kohës së lirë nga banorët e HPUSH, janë fushat sportive, sidomos të minifutbollit, të ndërtuara nga sipërmarrësit privatë. Duhet thënë se ato shfrytëzohen kryesisht nga djemtë, kurse për vajzat e vetmja mundësi argëtimi mbeten aktivitetet me karakter social-kulturor të organizuara nga shkollat.

Sado që afërsia me qytetin e Shkodrës krijon më shumë mundësi për të kaluar kohën e lirë dhe për t'u argëtuar për banorët e zonës periurbane, kjo nuk do të thotë se këto veprimtari dhe mundësi duhet të mungojnë në vetë fshatrat e saj.

Përveç të tjerave ato do shërbenin edhe për socializimin dhe risocializimin e popullsisë, pasi siç e theksuam marëdhëniet dhe komunikimi mes banorëve të HPUSH, qoftë atyre më të hershëm por edhe atyre të rinj, janë të zbehta. Përvoja botërore tregon se një ndihmesë të rëndësishme në këtë drejtim japin edhe veprimtaritë kulturore, sportive, etj¹⁴⁶.

IV.2. Veçoritë e zhvillimit ekonomik

IV.2.1. Ekonomia bujqësore-sektor i rëndësishëm dhe përdoruese kryesore e hapësirës

E kemi theksuar vazhdimisht gjatë studimit tonë që komuna Rrethinat, duke pasur parasysh vetë pozitën gjeografike në të cilën ndodhet, paraqet në mjaft aspekte tiparet e një hapësire periurbane (siç edhe e kemi emërtuar në studimin tonë). E pra, një ndër arsyt kryesore pse ajo është një komunë dhe klasifikohet si e tillë, është pikërisht fakti se dega kryesore dhe burimi bazë i të ardhurave për banorët e saj mbetet ekonomia bujqësore.

IV.2.1.1 Vështrim historik i zhvillimit të bujqësisë në HPUSH

Për të kuptuar më mirë zhvillimet aktuale të bujqësisë në territorin e HPUSH, është e nevojshme që të bëjmë një retrospektivë përsa i takon evolucionit të kësaj dege të ekonomisë në aspektin kohor, të paktën deri aty ku jemi në gjendje të grumbullojmë të dhëna. Është gjithashtu e domosdoshme të kuptojmë edhe ndryshimet që kanë ndodhur në pronësinë e tokës gjatë kësaj periudhe.

Përsa i takon pronësisë së tokës në periudhën *para vitit 1945*, duhet të themi se ka pak burime zyrtare informacioni. Gjithsesi, nga të dhënat e grumbulluara mund të

¹⁴⁶ Artan Fuga, Zyhdi Dervishi; Botimet Dudaj, Tiranë 2010

themi se vetëm një pjesë e vogël e familjeve banuese të asaj kohe zotëronin tokë të tyre, pasi pronaret kryesore të kësaj toke në periferi të qytetit të Shkodrës, ishin pikërisht familjet e pasura tregtare dhe latifondiste të tij. Të pakta ishin familjet që kishin tokë më shumë sesa thjesht për mbijetesë (po i quajmë pronare të mesme tokash), disi më të shumta ishin familjet që zotëronin tokë të tyre sa për të jetuar, dhe kishte gjithashtu mjaft familje që punonin si argatë në tokat e pronarëve të tjerë (sidomos të familjeve qytetare të Shkodrës ose zotërinjve të Shkodrës, siç i quanin banorët e zonës), të cilët paguheshin në natyrë ose në të holla¹⁴⁷. Ndërsa, përsa i takon shpërndarjes hapsinore dhe zhvillimeve kryesore të bujqësisë në atë kohë, mund të themi se ka disa ngjashmëri me ditët e sotme. Kështu ndër bimët kryesore që janë kultivuar tradicionalisht përmendim misrin, grurin dhe disa lloj drufrutorësh. Edhe blegtoria ka pasur rolin e vet të rëndësishëm, sidomos dhentë dhe gjedhët gjenin mbarështrim të konsiderueshem.

Pas vitit 1945, si kudo në Shqipëri ndodhën ndryshime rrënjësore në strukturën e bujqësisë dhe të pronësisë. Meqenëse pjesa më e madhe e familjeve fshatare të zonës, siç e thamë, ishin të varfra dhe pa pronë (një pjesë e tyre ishin angazhuar edhe në luftën nacional-çlirimtare), mund të thuhet se kjo zonë ka qenë ndoshta ajo që ka përkrahur më shumë ndryshimet që bëri sistemi i ri komunist në bujqësi, përsa i takon rrethit të Shkodrës. Kështu, më 17 Nëntor 1946 u ngrit në Dobraq kooperativa e parë bujqësore në rrethin e Shkodrës dhe një ndër shtatë kooperativat e para në të gjithë territorin e vendit. Por kjo është vetëm një datë zyrtare. Faktikisht, sipas dëshmimeve nga banorët e zonës, kolektivizimi i bujqësisë në Shqipëri ka filluar pikërisht në fshatin Dobraq, 8 muaj më parë sesa njihet zyrtarisht¹⁴⁸. Provë për këtë janë disa dokumente të kohës: psh. në një numër të gazetës “Koha e re” të Shkodrës të Prillit 1946, thuhet se më 22 Mars 1946 filloi punën në fshatin Dobraq - Kooperativa e Prodhimit të Fshatarëve, ku 9 familje kanë bashkuar tokën dhe mjetet e prodhimit, e cila zhvilloi rregullisht aktivitetin e saj për 8 muaj¹⁴⁹. Nëse do pranohej nga instancat shtetërore përkatëse të kohës, kjo do ishte hera e parë kur filloi procesi i kolektivizimit në Shqipëri. Ndoshta për këtë, në atë kohë, askush nuk paraqiti interes për të ditur më shumë dhe ky fakt më pas u mbulua nga pluhuri i harresës.

Në vitin 1971 kooperativa bujqësore u shndërrua në Stacionin Qendror të Misrit e më pas në *Insitutin e Misrit dhe Orizit*,¹⁵⁰ (banorët e quajtën fermë). Ky institucion kërkimor-shkencor që sot është shndërruar në Qendrën Rajonale të Transferimit të Teknologjisë Bujqësore, ishte dhe mbeti i vetmi në llojin e tij në të gjithë vendin. Gjatë këtyre viteve në të kanë punuar, shërbyer dhe kanë dhënë kontribut, disa nga specialistët më të mirë të Shqipërisë në fushën e kërkimeve shkencore për hibride të reja të misrit. Nën administrimin e IMO-së përfshiheshin territoret e fshatrave Dobraq dhe Golem. Në v.1985 sipërfaqja e tokës së punuar në IMO ishte 641 ha, nga të cilat 640 ha ishin tokë arë, kurse 1 ha ullishte. Prodhimet kryesore bujqësore të saj ishin misri me 660 tonë, gruri me 261 tonë, orizi me 58 tonë, duhani me 5 tonë, perimet me 63 tonë, fruta me 5 tonë. Po në v.1985 kishte 481 krerë gjedhë dhe 40 krerë njëthundrakë. Prodhoheshin 493 tonë

¹⁴⁷ Dëshmi të marra nga banorët e vjetër të zonës

¹⁴⁸ 11 Nëntor 1946 - kooperativa e parë bujqësore në Shqipëri: Krutje, Lushnjë

¹⁴⁹ Eljaz Kraja; Rozafa 1, Shkodër 2005; fq. 79

¹⁵⁰ Fondacioni KEA; *Historia e bujqësisë dhe agroindustrisë shqiptare*; Tiranë 2003, fq. 419

qumësht dhe 22 tonë mish¹⁵¹. Në ditët e sotme QRTTB¹⁵² ka në dispozicion të saj 11 ha tokë, ku specialistët dhe punonjësit e mbetur vazhdojnë të kryejnë eksperimentime për prodhimin dhe përshtatjen e farërave të reja dhe hibride të misrit.

Përsa i takon fshatrave të tjerë të HPUSH, ata fillimisht u bënë pjesë e kooperativave të tjera bujqësore dhe më pas shumica e tyre u përfshinë nën administrimin e fermës “Perlat Rexhepi” e cila u krijua në v.1956 dhe specializua në kultivimin dhe prodhimin e drufrutorëve, ullirit dhe sidomos të vreshtarisë¹⁵³. Kjo lidhur edhe me faktin se toka bujqësore e këtyre fshatrave (Shtoj i Ri, Hot i Ri, Guci e Re, Grudë e Re, Bardhaj, Zues) ishte mjaft e përshtatshme për kultivimin e këtyre kulturave. Në v.1985 sipërfaqja e punuar e kësaj NB ishte 3188 ha, nga të cilat 558 ha ishin tokë arë, 947 ha pemishte, 902 ha vreshtë (47% të totalit të rrethit) dhe 781 ha ullishte (84% të ullishteve në shkallë rrethi). Prodhimet kryesore bujqësore të kësaj ferme në v. 1985 ishin: 33 tonë grurë, 2451 tonë perime, 366 tonë bostan, 1478 tonë fruta, 3031 tonë rrush, 111 tonë ullinj. Po në këtë vit në këtë NB kishte 580 krerë gjedhë, 236 krerë njëthundrakë dhe prodhoheshin 616 tonë qumësht dhe 42 tonë mish¹⁵⁴. Kulmin e saj kjo NB¹⁵⁵ e arriti gjatë viteve ‘70, kur prodhonte deri në 8000 tonë rrush të varieteteve shesh i zi e i bardhë, merlot, kallmet, etj; duke u shndërruar jo vetëm në një model që duhej ndjekur në rang vendi; por, siç thuhet, edhe në një nga ndërmarrjet më të njohura të Ballkanit në atë kohë, në llojin e vet. Fatkeqësisht, pas viteve ‘90 ajo degradoi në mënyrë dramatike dhe pothuajse u shkatërrua plotësisht; ndërsa sot vihen re edhe përpjekje për ringjalljen e traditës së dikurshme të saj nga fermerët privat.

Këto ishin në vija të përgjithshme disa nga zhvillimet kryesore të bujqësisë në territorin e HPUSH deri në vitin 1990, kur me ndryshimin e rendit ekonomiko-shoqëror ndryshoi dhe rrjella e zhvillimit politik dhe ekonomik të të gjithë vendit, e në këtë mënyrë edhe bujqësisë. *Pas vitit 1990*, kemi tipare të reja në zhvillimin e bujqësisë në territorin e komunës e në radhë të parë në pronësinë e tokës.

IV.2.1.2. Çështje të pronës bujqësore

Ne i trajtuam më sipër disa karakteristika të përgjithshme të pronësisë së tokës në HPUSH, deri në v. 1990. Pas v.1991, si kudo tjetër në Shqipëri, edhe në këtë zonë, bujqësia dhe veçanërisht pronësia e tokës pësoi ndryshime të jashtëzakonshme. Momentin kyç të ndryshimeve në strukturën e pronës e shënon miratimi i “Ligjit për tokën” me 31.07.1991. Në ish-Ndërmarrjet Bujqësore, ku bënte pjesë edhe toka bujqësore e HPUSH, shpërndarja e tokave ka kaluar në dy faza: gjatë *fazës së parë* pjesa më e madhe e tokave pronë të ish-NB-ve, iu dha në përdorim ish-punonjësve të saj; kurse në *fazën e II-të* që filloi në v. 1994, kjo tokë iu dha në pronësi atyre¹⁵⁶. Ky ligj u zbatua edhe për ndarjen e tokës bujqësore të HPUSH, e cila siç e thamë më sipër, ishte pjesë e

¹⁵¹ RPSSH - Komiteti Ekzekutiv i rrethit Shkodër; *Vjetari Statistikor i v. 1986*, Shkodër 1986

¹⁵² Qendra Rajonale e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore

¹⁵³ Dritan Rustja; *Intervista me personat kyç për çdo fshat*; Shkodër, tetor 2013

¹⁵⁴ RPSSH - Komiteti Ekzekutiv i rrethit Shkodër; *Vjetari Statistikor i v. 1986*, Shkodër 1986

¹⁵⁵ NB – *Ndërmarrje Bujqësore*

¹⁵⁶ Sabri Laçi; *Gjeografia rurale*; Progres, Tiranë 2005, fq.149

NB Dobraç (ose IMO) dhe NB “Perlat Rexhepi”. Më konkretisht, mënyra sesi u nda kjo tokë paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela 8: *Ndarja e tokës bujqësore sipas ligjit nr.7501 në HPUSH*

<i>Nr</i>	<i>Fshati</i>	<i>Tokë bujqësore e ndarë (në ha)</i>	<i>Sipërfaqe për frymë (dynym)</i>	<i>Kategoria e tokës</i>
1	Dobraç	349	2,0	I
2	Shtoj i Vjetër	326	2,0	IV
3	Shtoj i Ri	320	2,0	IV
4	Grudë e Re	293	1,2	IV
5	Bleran	225	1,5	V
6	Golem	251	2,0	I
7	Hot i Ri	182	1,1	V
8	Bardhaj	158	1,5	V
9	Guci e Re	142	2,0	III
10	Zues	106	3,2	V
	<i>Totali</i>	<i>2352 ha</i>		

Reforma agrare ishte një element i domosdoshëm dhe kusht bazë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë në këtë territor. Edhe pse nuk munguan problemet, konfliktet apo dhe abuzimet në kryerjen e saj, duhet thënë se në përgjithësi ajo rezultoi e sukseshme, pasi pothuajse çdo familje, duke përfshirë dhe ato të ardhura menjëherë pas vitit 1990, u pajisën me tokë sipas ligjit dhe mundësive të çdo fshati. Ndoshta më të humbura nga ky proces dolën familjet ish-pronare të mesme të tokës, të cilat me dëshirën për të marrë pronën e tyre të dikurshme, refuzuan fillimisht të merrnin tokën që iu caktua, madje edhe tapitë.

Më vonë, kur ato e panë se ishin përfundimisht të humbura, pranuan ta merrnin atë, por tani morën tokën që kishte mbetur, shpesh e dobët në cilësi por dhe e pamjaftueshme në sasi. Ndërkohë, janë edhe rreth 10 ha tokë bujqësore e pandarë në Bleran, ka probleme në përcaktimin e kufinjve dhe pronësisë së tokës, si mes fshatrave të komunës ashtu edhe me njësitë vendore fqinje (si psh. me komunën e Gruemirës dhe bashkinë)¹⁵⁷, ndërkohë që edhe çertifikimi i pronësisë së tokës (marrja e tapive) nuk është

¹⁵⁷ D. Rustja; *Intervista me personat kyç në HPUSH – specialisti i tokës*; Shkodër, tetor 2013

kryer plotësisht¹⁵⁸. Duke pasur parasysh edhe shitblerjet e ligjshme e të paligjshme të tokës, sidomos me popullsinë e ardhur, gjatë këtyre 20 viteve; si dhe kontestimin e ligjit 7501 “Për tokën” nga ish-pronarët dhe pakënaqësinë e pretendimet ekzistuese të tyre, kuptohet qartë se çështja e pronës veçse e zgjidhur nuk mund të quhet, si në të gjithë vendin, edhe për HPUSH.

IV.2.1.3. Inputet bujqësore

Lidhur ngushtë me zhvillimet dhe ndryshimet e mësipërme, është edhe niveli i përdorimit të inputeve bujqësore në HPUSH. Le ta fillojmë trajtimin e kësaj pjese me *aftësinë ujitëse* dhe gjendjen e rrjetit kullues të tokave në HPUSH.

Tabela 9: *Aftësia ujitëse në ha për HPUSH*¹⁵⁹

Nr.	Fshatrat	Sipërfaqja gjithsej (ha)	Aftësia ujitëse		Sip. faktike e ujitur Ha
			Potenciale	Aktuale	
1	Grudë e Re	293	293	100	40
2	Shtoj i Ri	320	320	83	20
3	Guci e Re	142	142	142	120
4	Shtoj i Vjetër	326	326	130	30
5	Zues	106	40	40	10
6	Dobraç	349	320	140	45
7	Golem	251	220	115	30
8	Hot i Ri	182	170	160	70
9	Bleran	225	180	150	110
10	Bardhaj	158	130	130	100
Shuma:		2352	2141	1190	575


Siç e shohim edhe nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme, nga 2352 ha tokë bujqësore që ka në dipozicion HPUSH, vetëm 575 ha janë sipërfaqe faktike e ujitur në v. 2012. Kjo edhe për faktin se sistemi i rrjetit ujitës dhe kullues të ujëmbajtësve dhe kanalave të dikurshme, në një masë të madhe ka dalë jashtë përdorimit, pas v. 1990.

Gjatë viteve të sistemit socialist u ndërtua një rrjet i gjerë dhe mjaft efikas në këtë drejtim, ku përmendim veçanërisht ujëmbajtësin e Shtodrit, që shërbente për vaditjen e tokave të fushës së Mbishkodrës, atë të Bleranit, hidrovorin e Dobraçit si dhe gjithë rrjetin e dendur të kanaleve kulluese (sidomos në fushën e Shtoit dhe atë të Dobraçit), me një gjatësi të përgjithshme prej 67 km. Mirëpo, ndryshimet e ndodhura pas viteve ‘90 nuk e lanë pa prekur dhe dëmtuar edhe këtë sistem; hidrovori është shkatërruar tashmë, rrjeti i

¹⁵⁸ D. Rustja; *Intervista me personat kyç – fshati Zues*; Shkodër, tetor 2013

¹⁵⁹ Të dhënat janë marrë në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit, Shkodër; gusht 2013

kanaleve parësore dhe dytësore kulluese ekziston por ka degraduar rëndë për shkak të mosmirëmbajtjes; ndërsa ujëmbledhësi i Shtodrit që furnizohet si nga liqeni i Vaut të Dejës dhe nga ujërat e reshjeve dhe që gjendet në komunën fqinje të Postribës, vazhdon të përdoret për vaditjen e tokave të komunave më të afërta më të, por jo për komunën “Rrethinat”, për shkak të dëmtimit të kanaleve vaditëse që e lidhnin me të. Ndërsa ujëmbledhësi i Bleranit përdoret vetëm për nevojat e fshatrave Bardhaj dhe Bleran.



Harta 9. Rrjeti hidrografik dhe ujtës potencial dhe sistemi i kanaleve vaditëse në HPUSH

Përsa i takon *shkallës së mekanizimit* të bujqësisë mund të themi se ajo është e pamjaftueshme. Tabela e mëposhtme na ndihmon sërish, për ta kuptuar më mirë nivelin e zhvillimit të saj:

Tabela 10: Numri i mjeteve mekanike që përdoren në HPUSH

Fshatrat	Traktor me rrota	Minitraktorë	Makinë mbjellëse	Motokorrëse	Autokombajna	Freza
Grudë e Re	5	2		1		3
Shtoj i Ri	4	2		1		2

Guci e Re	3	1				1
Shtoj i Vjetër	4	3	1	2		2
Zues	2	1		1		1
Dobraç	6	5	2	3	2	4
Golem	4	3	2	1		2
Hot i Ri	2	2				1
Bleran	3	2	1	1		2
Bardhej	2	1		1		1
Shuma	35	22	6	11	2	19


Në vitin 2013 në HPUSH numërohen 35 traktorë me rrota, 22 minitraktorë, 6 makina mbjellëse, 11 motokorrëse, 2 autokombajna dhe 19 freza që shërbejnë për të lehtësuar punët bujqësore të bujqëve të zonës dhe njëkohësisht për të rritur rendimentet e produkteve bujqësore. Edhe pse ka pasur një rritje të përdorimit të tyre gjatë viteve të fundit, ato, siç e thamë janë të pamjaftueshme, duke i dhënë zhvillimit të bujqësisë në HPUSH tipare të një bujqësie më tepër ekstensive. Kjo edhe për shkak të copëzimit të pronës bujqësore dhe lënies djerrë të tokave nga vetë fermerët pronar.

Përsa i takon shkallës së *kimizimit*, llogaritet që gjatë v. 2012, në HPUSH të jenë përdorur rreth 200 tonë plehra kimike dhe pesticide të llojeve të ndryshme, me qëllim mbrojtjen e kulturave bujqësore nga dëmtuesit dhe rritjen e rendimenteve. Edhe në këtë tregues vëmë re pamjaftueshmërinë e përdorimit të tyre, duke pasur parasysh sipërfaqen e konsiderueshme të tokës bujqësore në HPUSH dhe larminë e kulturave bujqësore që mbillen, gjë që lidhet sërish me copëzimin e tokës bujqësore, lënien djerr të saj në një masë jo të vogël dhe karakterin ekstensiv të bujqësisë në këtë zonë.

IV.2.1.4. Prodhimet kryesore bujqësore

Në vitin 2012, nga 2352 ha tokë bujqësore që ka gjithsej në këtë zonë (sipas statistikave zyrtare), 1310 ha janë sipërfaqe faktike e mbjellë. Nga këto vihet re se mbizotëron sipërfaqja e mbjellë me jonxhe, drufrutorë, vreshta, ullinj dhe perime. Më konkretisht, po paraqesim grafikun e mëposhtëm¹⁶⁰:

¹⁶⁰ Të dhënat statistikore mbi bujqësinë dhe blegtorinë në komunën Rrethina, janë marrë nga specialistët e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit - Shkodër, në bashkëpunim me inspektoriatin e bujqësisë në komunë.



Graf. 13: Sipërfaqja e mbjellë në ha, sipas kulturave bujqësore kryesore në HPUSH

a. Kulturat e arave

- *Gruri* ka qenë një kulturë e rëndësishme bujqësore e zonës në fjalë dhe vazhdon të kultivohet edhe në ditët e sotme, por në një masë dukshëm më të vogël. Në vitin 2012 në HPUSH janë mbjellë 52 ha tokë me grurë, më një prodhim vjetor prej 172 tonësh. Mbillet kryesisht në tokat më pjellore të fshatrave Dobraç, Golem, Grudë e Re dhe Shtoj i Vjetër.

- *Misri* është ndoshta kultura bujqësore më tradicionale e zonës në fjalë, ndër drithrat. Gjatë viteve të ekzistencës së Institutit të Misrit dhe Orizit rëndësia e tij u rrit dhe më shumë, pasi shërbente dhe si zonë eksperimentale për të krijuar farëra të reja hibride, të cilat do jepnin prodhimtari më të lartë duke iu përshtatur klimës. Duhet thënë se pas viteve '90 sipërfaqja e kultivuar dhe prodhimi i kësaj kulture (bashkë me grurin), ka pësuar rënie të vazhdueshme. Kjo qoftë për shkak të ndryshimit të strukturës së bujqësisë të kërkuar nga nevojat e tregut, qoftë edhe për shkak të degradimit të sistemit ujitës dhe kanalizues. Gjatë vitit 2012 janë mbjellë 72 ha tokë me misër në komunë, duke dhënë një prodhim prej 374 tonësh.

- *Perimet* përbëjnë një kulturë të rëndësishme bujqësore për zonën në fjalë, e cila duhet thënë se nuk është shquar shumë për kultivimin e tyre, por vitet e fundit lidhur edhe me kërkesat e tregut dhe leverdinë ekonomike, vëmë re se prodhimi i tyre ka pësuar një rritje të ndjeshme. Kjo gjë kushtëzohet edhe nga ekzistenca e tregut të madh të qytetit të Shkodrës pranë. Janë ndërtuar edhe sera të thjeshta për të rritur rendimentet dhe për të shkurtuar kohën e daljes në treg të tyre (sipërfaqja e mbjellë me serra arrin në 1,35 ha). Gjatë vitit 2012 në HPUSH janë mbjellë 217 ha dhe janë prodhuar 4324 tonë perime të llojeve të ndryshme. Nga këto 131 ha janë mbjellë me perime të njoma, duke dhënë një prodhim prej 2334 tonësh. Dallojmë këtu domaten, specin, patëllxhanin, trangullin, barbungjen, kungullin dhe qepët e njoma. Gjithashtu janë mbjellë edhe 49 ha me perime të thata, sidomos qepë dhe më pak hudhër, duke prodhuar 1229 tonë. Po ashtu, përmendim edhe 37 ha të mbjella me bostan (shalqi dhe pjepër), me një prodhim prej 761 tonësh. Në kultivimin e perimeve dallohen veçanërisht fshatrat Dobraç dhe Grudë e Re, por nga pak


të gjithë fshatrat e komunës. Kjo sepse banorët e zonës i kanë përdorur oborret familjare dhe parcelat e tokës pranë shtëpive të tyre, kryesisht për të mbjellë perime.

Po gjatë vitit 2012, vëmë re se në HPUSH, 51 ha janë mbjellë me *patate*, (duke prodhuar 1479 tonë); si dhe 40 ha me *fasule* (duke prodhuar 56 tonë). Pra vihet re se, sidomos kultura e patates ka pësuar rritje të dukshme në sipërfaqen e mbjellë dhe prodhimtari, duke qenë ndër zonat kryesore të kultivimit të saj në gjithë rrethin. Kjo i dedikohet edhe tokës së përshtatshme që jep rendimente të larta, karakteristike për “dherat e zeza” të fushës së Shtojit (Grudë e Re, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër).

- *Foragjeret*. Lidhur ngushtë me blegtorinë, meqë shërbejnë si bazë ushqimore për rritjen e tyre, foragjeret kanë qenë dhe janë edhe në ditët tona një kulturë e rëndësishme bujqësore edhe për zonën në studim. Dallohet në këtë aspekt kultivimi i jonxhës e cila mbizotëron në raport me foragjeret e tjera. Sipërfaqja e mbjellë me foragjere në HPUSH gjatë vitit 2012 ka qenë 449 ha, më shumë se çdo kulturë tjetër, ndërsa prodhimi ka arritur në 9848 tonë. Nga këto 427 ha janë mbjellë me jonxhë, 25 ha me misër foragjere dhe 17 ha të tjera. Foragjeret këtu shërbejnë si bazë ushqimore kryesisht për gjedhët dhe më pak për dhentë.

b. Pemët frutore

Pemëtaria dhe drufrutorët, përbëjnë një tjetër drejtim të rëndësishëm të sektorit bujqësor dhe ekonomisë së zonës në fjalë. Mbjellja dhe kultivimi i drufrutorëve, ka një traditë të vjetër në HPUSH, sidomos në disa fshatra të saj. Gjatë v. 2012 në komunë ishin mbjellë 186.7 ha me pemë frutore, me një numër rrënjësh gjithsej prej 84 329, dhe një prodhim vjetor prej 1152,8 tonësh. Për sipërfaqen e mbjellë, numrin e rrënjëve dhe sasinë e prodhuar dallohen veçanërisht fshatrat Guçi e Re, Grudë e Re dhe Shtoj i Vjetër; por në terësi ky është një aktivitet i përhapur në të gjithë fshatrat e komunës.



Graf. 14: Llojet kryesore të drufrutorëve që kultivohen në HPUSH

Siç e shohim edhe nëpërmjet grafikut të mësipërm, drufrutorët kryesor që kultivohen në HPUSH janë pjeshka, qershia, kumbulla dhe fiqtë, për të cilat ajo zë një vend të rëndësishëm edhe në shkallë rrethi. Vëmë re se për kultivimin e pjeshkës dallohet veçanërisht fshati Guci e Re, me 9900 rrënjë dhe më pak Gruda e Re dhe Shtoji i Vjetër; për kultivimin e qershisë sërish fshati Guci e Re dhe më pak Gruda e Re; për kumbullën Gruda e Re, Shtoji i Vjetër, Shtoji i Ri dhe Dobraçi; kurse për fiqtë Bardhajt dhe Blerani. Mund të thuhet se struktura e sotme e përhapjes së pemëve frutore në HPUSH, është e lidhur ngushtësisht me të kaluarën, sidomos me karakteristikat e zhvillimit të saj gjatë periudhës socialiste dhe veçanërisht me krijimin NB “Perlat Rexhepi” në v.1956, e cila siç e thamë u orientua drejt zhvillimit të pemëtarisë dhe vreshtarisë.

Nga ana tjetër, vëmë re se në krahasim me v. 2008, është rritur me rreth 20 000 - numri i rrënjëve të mbjella me drufrutorë, ndërkohë që prodhimi është rritur me rreth 300 tonë. Kjo gjë flet për faktin se pas një periudhe hutimi dhe çoroditjeje në lidhje me drejtimin që do merrte zhvillimi i bujqësisë dhe ekonomisë në terësi në këtë zonë, banorët e saj po orientohen sërish drejt traditës në këtë drejtim, si rruga më e përshtatshme dhe më e leverdishme për ta.

c. Vreshtaria

Vitikultura dhe vreshtaria përbëjnë një tjetër drejtim shumë të rëndësishëm të bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik në HPUSH. Gjatë v. 2012 këtu kishte 111 ha tokë të mbjella me vreshta në blloqe me madhësi të ndryshme, me një numër rrënjësh prej 365 625 varietetesh të ndryshme rrushi gjithsej; gjithashtu edhe 41400 rrënjë rrushi në formën e pjergullave shtëpiake. Në total, prodhimi i rrushit për v. 2012 është 1330 tonë, nga të cilat 930 tonë nga vreshtat dhe 400 tonë nga pjergullat. Dallohen në terësi në këtë drejtim sidomos fshatrat Grudë e Re, Shtoj i Ri dhe Shtoj i Vjetër, megjithëse ky aktivitet është i përhapur dhe ka peshën e tij në çdo fshat të komunës. Duhet thënë se në të gjithë këta tregues, komunë “Rrethinat” zë vendin e parë në shkallë rrethi, duke u dalluar mjaft nga komunat e tjera. Zhvillimi i vreshtarisë në këtë zonë është i lidhur sërish me trashëgiminë e së kaluarës dhe me krijimin e NB “Perlat Rexhepi” që e kemi përmendur edhe më sipër, e cila u specializua në këtë drejtim. Këtu ndihmoi edhe toka e kësaj zone, e përshtatshme për kultivimin e rrushit, ku varieteti më i njohur është *kallmeti*. Po ashtu, vihet re sërish rritja e sipërfaqes së mbjellë në raport me v. 2008, me 10 ha; kurse prodhimi me 300 tonë më shumë. Duke pasur parasysh edhe atë që thamë në lidhje me pemët frutore, mund të thuhet me bindje se *drufrutorët dhe vreshtaria* janë kulturat më të rëndësishme bujqësore në HPUSH, duke përbërë njëkohësisht dhe një nga drejtimet kryesore të zhvillimit të bujqësisë dhe ekonomisë në terësi për këtë zonë në të ardhmen.



Foto nr. 10: Stema zyrtare e komunës Rrethinat, ku paraqitet vreshtaria si simbol i saj (D.Rustja)

e. *Ulliri*

Ulliri është një tjetër kulturë bujqësore që ia vlen për tu përmendur në rastin tonë, pasi është një kulturë me traditë në HPUSH. Në fakt, ai është mbjellë më shumë përpara sesa sot, megjithatë vazhdon të kultivohet. Në këtë drejtim dallohen veçanërisht fshati Zues, e më pak Bardhajt dhe Blerani, të vetmit që trashëgojnë një pjesë të sipërfaqes me ullinj të mbjellë në kodrat e tyre, gjatë sistemit të kaluar. Në v. 2012 në territorin e komunës Rrethinat kemi 27283 rrënjë ullinj të mbjella (nga të cilat 20142 janë në prodhim) duke prodhuar gjithsej 296 tonë ullinj. Vihet re se në raport me v. 2008 ka rreth 6000 rrënjë ullinj më shumë, ndërkohë që prodhimi është rritur me 60 tonë. Pra shohim se edhe kjo kulturë bujqësore disi tradicionale në HPUSH, ka një lloj rivitalizimi dhe mund të përbëjë një pikë të rëndësishme mbështetëse të zhvillimit bujqësor në këtë zonë, sidomos për fshatin Zues.

f. *Agrumet*

Edhe pse nuk kanë ndonjë rol të rëndësishëm dhe nuk zënë ndonjë vend të veçantë në strukturën e bimëve të kultivuara në HPUSH, vihet re se në v. 2012 në territorin e saj ka rreth 1540 rrënjë agrume të mbjella, nga të cilat shumica janë mandarina (1105 rrënjë) dhe të tjerat portokalle dhe limonj. Ajo që të bie më shumë në sy, është fakti se ato nuk kanë ndonjë traditë në këtë zonë, dhe mbilleshin më pak përpara. Pavarësisht se edhe sot mbillen kryesisht për përdorim shtëpiak, rritja e numrit të tyre në këtë zonë, flet ndoshta edhe për disa ndryshime klimatike (ngrohje të saj) që kanë ndodhur, si kudo tjetër edhe këtu dhe që reflektohen në këtë mënyrë.

g. *Të tjera*

Këto ishin pak a shumë kulturat kryesore bujqësore që mbillen dhe ia që ia vlen të përmenden në HPUSH. Thjesht për të mos i lënë në harresë, më shumë sesa për sensacion apo për rëndësinë që patën ndonjëherë, duhet thënë se gjatë viteve të sistemit


komunist në këtë zonë u bënë përpjekje për të kultivuar në mënyrë eksperimentale *orizin dhe pambukun*, përpjekje që pak a shumë dështuan sepse as klima, as tradita dhe asgjë tjetër nuk ishte në favor të tyre.

Së fundi përmendim edhe *duhanin*, një kulturë që në një periudhë të caktuar pati marrë një përhapje të konsiderueshme në këtë zonë dhe që më pas u la në harresë. Vitet e fundit ka disa përpjekje edhe për rikultivimin e tij: kështu gjatë v. 2012 në HPUSH kemi 1 ha tokë të mbjellë me duhan, duke dhënë një prodhim prej 1,2 tonësh. Gjithsesi, aktualisht rëndësia e tij mbetet e vogël, megjithëse në të ardhmen mund të investohet më shumë në kultivimin e tij.


IV.2.1.5. Blegtoria - më e pakët, por më cilësore

Blegtoria, dega tjetër përbërëse e ekonomisë bujqësore është gjithashtu e rëndësishme për HPUSH. Pas viteve '90 mund të themi se ka pasur një zhvillim të sektorit blegtoral të zonës. Si bazë për këtë, shërbeu gjëja e gjallë e ish-fermave të dikurshme që mbijetoi nga sistemi i kaluar dhe që iu shpërnda banorëve të zonës. Duhet thënë se tek këta banorë, tradicionalisht fermerë dhe të lidhur ngushtësisht me blegtorinë dhe prodhimet blegtorale, si bazë e jetesës së tyre të përditshme, u ndje shumë - si kudo në Shqipëri, mungesa e këtyre produkteve, sidomos gjatë viteve '80. Prandaj gjëja e parë që bënë fermerët e zonës pas rënies së sistemit komunist, ishte mbarështrimi i gjedhëve, dhenvë, etj. dhe shtimi i tyre.

Mund të thuhet se që atëherë ka pasur një strukturim të ri të blegtorisë në zonën në fjalë. Kështu, disa nga familjet fshatare të zonës e gjetën jetesën e tyre tek mbarështrimi, sidomos i gjedhit dhe dhenvë, duke u specializuar në këtë drejtim. Por, nga ana tjetër, ka mjaft familje të zonës, sidomos në fshatrat Dobraq, Golem, Shtoj i Ri apo Guci e Re, të cilat nuk merren me blegtori, pasi kanë gjetur mënyra të tjera jetese të lidhura me punë në qytet ose jashtë sferës së blegtorisë apo bujqësisë në përgjithësi. Duhet thënë se prodhimet blegtorale të komunës Rrethinat janë një ndër furnizueset kryesore të qytetit të Shkodrës, sidomos me qumësht të freskët. Familjet blegtore e përdorin të gjithë tokën që kanë në dispozicion për këtë qëllim. Edhe kulturat bujqësore që mbillen, janë të destinuara për ushqimin e bagëtive, sidomos si rezervë ushqimore për stinën e dimrit. Ato marrin gjithashtu në përdorim, shpesh herë edhe tokën e familjeve të tjera që nuk e praktikojnë bujqësinë, kundrejt detyrimeve të ndryshme. Është kjo arsyeja, pse një ndër kulturat kryesore bujqësore të HPUSH janë foragjeret dhe veçanërisht jonxha, siç e kemi përmendur më sipër.



Harta 10: Zhvillimi dhe shpërndarja hapësinore e bujqësisë në HPUSH



Graf. 15: Zhvillimi i blegtorisë (numri i krerëve të gjësë së gjallë) në HPUSH

Siç e shohim edhe nga grafiku i mësipërm, *mbarështrimi i gjedhit* përbën drejtimin kryesor të zhvillimit të blegtorisë në HPUSH me gjithsej 2409 krerë, nga të cilat 2000 krerë janë lopë. Dallohen në këtë drejtim sidomos fshatrat Grudë e Re, Dobraq

dhe Shtoj i Vjetër, por gjithsesi kjo gjë vlen thuajse për të gjithë fshatrat e komunës. Një gjë e tillë është e lidhur me prodhimin dhe sigurimin e qumështit dhe mishit jo vetëm për banorët e zonës, por edhe për qytetin e Shkodrës, duke qenë një ndër furnizueset kryesore të tij. Sipas sondazheve të realizuara nga DBUSH¹⁶¹, struktura e gjedhit në familjet që e mbarështrojnë atë në komunë paraqitet e tillë: 75% e familjeve mbajnë 1-2 lopë; 15% e tyre 3 lopë dhe mbi 5 lopë, vetëm 3% e tyre. Fakti që familjet fshatare nuk i kanë zmadhuar tufat e blegtorisë dhe veçanërisht gjedhit, lidhet me sipërfaqen e kufizuar të tokës që ato zotërojnë që luhatet 0.5 - 2.5 ha. Po nga vëzhgimet e programuara në terren nga DBUSH, rezulton se struktura rracore e gjedhit është e tillë: 7% të rracës së pastër laramane të zezë, 34 % e rracës xherse dhe 39 % e përmirësuar.

Ndërkohë, *mbarështrimi i dhenve* në territorin e komunës paraqitet më pak i përhapur, por gjithsesi i rëndësishëm. Gjithsej, kemi 2012 krerë të leshta që rriten në HPUSH, nga të cilat 1620 janë dele, të cilat gjithashtu shërbejnë për furnizimin me mish, qumësht dhe lesh të banorëve të komunës dhe vetë qytetit të Shkodrës. Dallohet këtu sidomos fshati Dobraq. *Të dhirtat* nuk paraqesin ndonjë rol të rëndësishëm, me gjithsej 316 krerë që mbarështrohen në HPUSH. *Rritja e derrit* paraqet një rëndësie për furnizimin me mish të popullsisë në disa prej fshatrave të saj, si psh. në Grudë të Re apo Hot të Ri. Ndërsa *njëthundrakët* me rreth 100 krerë kuaj, gomerë dhe mushka përdoren sidomos për transport të brendshëm mes fshatrave dhe në bujqësi.

Rritja e shpendit ka rolin e vet të rëndësishëm në këtë drejtim, me rreth 102 500 krerë që rriten dhe përdoren për prodhimin e vezëve dhe mishit. Dallohet në këtë drejtim sidomos fshati Dobraq, me rreth 80 000 krerë (ku ndodhet edhe një kompleks modern pularie), ndërsa në fshatrat e tjerë kemi kryesisht rritjen e shpendëve për përdorim shtëpiak.

Së fundi përmendim edhe *zhvillimin e bletarisë* në HPUSH, me rreth 650 koshere bletësh që gjenden në territorin e saj, të cilat prodhojnë 13 kg mjaltë në vit për çdo koshere.

Dallohen këtu veçanërisht fshatrat Grudë e Re, Hot i Ri dhe Dobraq, për numër kosheresh; kurse për cilësi mund të përmendim edhe mjaltin e fshatit Zues, ku bletët kullosin sherebelën në malin e Taraboshit.



Foto nr. 11: *Mbarështrimi i dhenve dhe bletaria në HPUSH (D.Rustja)*

¹⁶¹ Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Shkodër

Ajo që bie në sy në lidhje me zhvillimin e blektorisë në HPUSH, është rënia e numrit të krerëve për të gjitha zërat që përmendëm më sipër, në raport me të dhënat që kemi për v. 2008 (ndërkohë që burimi i të dhënave është i njëjtë). Duke lënë mënjanë saktësinë e të dhënave, ka mundësi që gjatë viteve të fundit, bujqësia në HPUSH të jetë orientuar më shumë drejt frutikulturës dhe vreshtarisë; ndërkohë nuk duhet të harrojmë edhe punësimin e banorëve të HPUSH në sektorët ekonomik jobujqësor, të cilat do i trajtojmë më vonë.

IV.2.1.6. Peshkimi dhe gjuetia

Peshkimi është një tjetër veprimtari ekonomike e rëndësishme për HPUSH. Kjo është e lidhur ngushtë me vetë pozicionin gjeografik mjaft të përshtatshëm që ka ajo, të cilin e kemi theksuar tek hidrografia. Kështu, për këtë aktivitet ekonomik përdoret veçanërisht liqeni i Shkodrës dhe deri diku edhe lumi Buna; ndërsa pak ose aspak lumi Kir. Ka mjaft banorë të komunës, sidomos kryefamiljarë të fshatrave Dobraq, Golem, Shtoj i Vjetër dhe Zues të cilët merren me zënie e peshkut, madje mund të themi që e kanë kthyer atë në profesion, duke siguruar me këtë aktivitet jetesën e familjeve të tyre. Sasia e peshkut që ata zënë shërben për të furnizuar jo vetëm familjet e komunës, por edhe qytetin e Shkodrës. Një pjesë e peshkatarëve të HPUSH e ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë të ligjshme, si pjesë përbërëse e OMP-së¹⁶², e cila është themeluar në v. 2003 dhe e ka qendrën në Shirokë. Në të bëjnë pjesë peshkatarë nga fshatrat Zogaj, Shirokë, Vrakë, Koplik, Stërbeq, Jubicë, Kamicë, Shegan; kurse nga komuna Rrethinat përfshihen peshkatarë të fshatrave Golem, Dobraq, Shtoj i Vjetër dhe Shtoj i Ri (të cilët kufizohen me liqenin e Shkodrës). Kjo organizatë ka aktualisht 400 anëtarë që ushtrojnë veprimtari të ligjshme, por mendohet se edhe 200 të tjerë e ushtrojnë aktivitetin e tyre ilegalisht në liqen. Llojet kryesore të peshqve të destinuar për zënie dhe grumbullim janë krapit (60%), qefulli (10%), kubla (10%) dhe karasi (10%). OMP-ja merret edhe me rritjen e rrasit të peshkut të ri, në mënyrë që peshkimi të realizohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të mos çojë në zhdukjen e biodiversitetit të liqenit të Shkodrës. Megjithatë, peshkimi i paligjshëm dhe me mënyra jo të lejuara (me rrymë elektrike, dinamit, etj), është mjaft shqetësues për këtë liqen, pavarësisht se nuk kanë munguar përpjekjet për ta zvogëluar atë.

Gjuetia përbën një tjetër veprimtari që kryhet në HPUSH, por kryesisht për qëllime argëtimi, më shumë sesa fitimi. Vendi kryesor ku ushtrohet kjo veprimtari nga banorët e komunës, është Pylli i Dobraqit në brigjet e liqenit, dhe më pak në kodrat e Bardhajve apo të Zuesit. Gjithsesi, duke qenë se ushtrimi i gjuetisë në këtë zonë bëhet shpesh herë në mënyrë të paligjshme ose të pakontrolluar, ai padyshim që ka pasur një ndikim negativ në biodiversitetin e zonës, që siç e kemi thënë, nuk paraqitet shumë i larmishëm për shkak të ndikimit dhe ndërhyrjes së hershme të veprimtarisë njerëzore, në modifikimin e tij.

¹⁶² Organizata e Menaxhimit të Peshkimit

V.2.1.7. Pylltaria (livadhet, kullotat) dhe bimët mjekësore

Pavarësisht faktit se është një zonë kryesisht fushore, e gjendur në periferi të qytetit të Shkodrës, territori i HPUSH ka një sipërfaqe jo të vogël të përbërë nga pyjet dhe kullotat. Sipas të dhënave¹⁶³, në këtë hapësirë gjenden rreth 373 ha me pyje dhe 120 ha me livadhe dhe kullota. *Pyjet* gjenden në këto zona kryesore:

- a) Në kodrat e Bardhajve (dhe të Rrencit), pjesë e fshatrave Bardhaj dhe Bleran, gjendet zona pyjore më e rëndësishme e HPUSH. Këtu ushtron veprimtarinë e vet edhe ekonomia pyjore “Pruemos-Sheldi” e cila ka destinacion mbrojtës por edhe prodhues dhe përdoret kryesisht për lëndë drusore. Kjo zonë është pyllëzuar, kryesisht me pishë mesdhetare, gjatë viteve ‘70-‘80. Ka gjithashtu edhe pjesëmarrje të shkurreve, si dëllinjës, shqopës, mares, etj.
- b) Pranë brigjeve të liqenit të Shkodrës, si pjesë e fshatrave Dobraç, Golem dhe Shtoj i Vjetër ku shtrihet një rrip relativisht i gjerë tokë i përbërë sidomos nga pylli i Dobraçit, ku dominon shelgu dhe vidhi. Këtu ekziston ekonomia pyjore “Rosek-Drisht” e cila ka më tepër funksion mbrojtës.
- c) Në shpatin JL të Taraboshit, në fshatin Zues gjendet një hapësirë me sipërfaqe jo të madhe e përbërë nga pyjet e dikurshme me pishë dhe shkurre.

Gjithashtu në zonën e fundit, kemi më tepër shtrirjen e *kullotave*, në zonën e njohur si Ograjat dhe Shullani i Zuesit. Pikërisht këtu, ushtron veprimtarinë e vet edhe ekonomia kullosore “Tarabosh” që përdoret kryesisht si kullotë dimërore për blegtorinë e zonës dhe më gjerë. Po ashtu, një shtrirje të konsiderueshme kanë livadhet edhe në zonën pranë brigjeve të liqenit të Shkodrës, përreth pyllit të Dobraçit, e njohur nga banorët e zonës me emrin “livadet”. Ato janë kryesisht pjesë përbërëse e fshatrave Golem dhe Dobraç dhe shërbejnë akoma si burim ushqimi dhe kullotje për blegtorinë, sidomos gjatë stinës së verës.

Theksojmë faktin se me vendim të Këshillit të Ministrave të v. 2006, sipërfaqja pyjore dhe kullosore e mësipërme, iu kalua nën administrim komunës “Rrethinat”. Ndikimi që ka pasur një gjë e tillë në administrimin e sipërfaqes pyjore dhe kullosore dhe në mjedis mbetet për t’u parë.



Foto nr. 12: *Pyjet dhe kullotat në HPUSH (D.Rustja)*

¹⁶³ Të dhëna të marra nga zyra e tokës dhe sektori urbanistik i komunës Rrethinat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Shkodër

Përsa i takon *bimëve mjekësore*, mund të themi se qoftë shtrirja e tyre, apo edhe roli që luajnë në ekonominë e HPUSH, është e vogël. Mund të dallohen deri diku në këtë drejtim kodrat e Zuesit dhe ato të Bardhajve, ku rritet sherbela, trumza, etj. Siç e thamë, ato nuk përbëjnë një element të rëndësishëm të bujqësisë apo ekonomisë së zonës, por gjithsesi përbëjnë një pasuri që mund të shfrytëzohet më mirë në të ardhmen.

IV.2.1.8. Peisazhi bujqësor (periurban)

Duke pasur parasysh gjithçka thamë më sipër, në HPUSH mund të dallojmë tri zona të zhvillimit të bujqësisë, secila me karakteristikat e saj të veçanta:

- a) *Zona e fushës së Shtojit*; ku për vetë specifikën e saj, llojin e tokës dhe historinë e zhvillimit të bujqësisë, vëmë re se popullsia ruan një traditë të pasur në kultivimin e vreshtarisë dhe drufrutorëve. Në këtë zonë për vite me rradhë, gjatë sistemit të kaluar ishin të mbjellë qindra hektarë me rrush dhe pemë drutore të varieteteve të ndryshme, të cilat ishin pjesë e NB “Perlat Rexhepi”. Fatkeqësisht gjatë periudhës së tranzicionit, ato thuajse u shkatërruan krejtësisht, megjithatë edhe u ruajtën parcela të tyre; sidomos drufrutorë në zonën e Gucisë dhe vreshta në zonën e Shtojit të Ri dhe Grudës së Re. Vitet e fundit vihen re përpjekje për rigjallërimin e vreshtarisë dhe drufrutorëve në këtë zonë dhe mund të thuhet me bindje se zhvillimi perspektiv i bujqësisë në këtë zonë duhet orientuar në këtë drejtim.
- b) *Zona Dobraq-Golem*; tradicionalisht popullsia e kësaj zone në periferinë veriore të qytetit të Shkodrës është marrë me kultivimin e perimeve dhe drithrave (meqë ishte edhe pjesë e IMO-së) si dhe me blegtori, veçanërisht mbarështrimin e gjedhit.
- c) *Zona kodrinore (Bardhaj-Bleran-Zues)*, e njohur sidomos për kultivimin e ullirit dhe më pak të drufrutorëve (fiqve) dhe perimeve. Ndërkohë zona e Zuesit, si pjesë e malit të Taraboshit është e pasur edhe me bimë medicinale.

Ajo ç’ka vlen për t’u përmendur për secilën prej zonave të mësipërme, dhe sidomos për dy zonat e para me karakter edhe fushor, është ndryshimi i rëndësishëm që ka pësuar peisazhi i tyre jo thjesht bujqësor, por edhe human në terësi. Një gjë e tillë ka ndodhur për shkak të ndryshimeve të konsiderueshme që ka pësuar HPUSH gjatë 23 viteve të fundit, si rezultat i prurjeve demografike dhe kthimit të tokës bujqësore në truall ndërtimi. Copëzimi i skajshëm i tokës është pasoja kryesore e tyre; parcelat janë tepër të vogla për të lejuar zhvillimin e një bujqësie që shkon përtej karakterit familjar. Si përfundim themi që *peisazhi bujqësor i kësaj zone, për shkak të të gjitha këtyre ndryshimeve ka marrë tiparet e zhvillimit të një bujqësie të tipit periurban* - karakteristik për hapësirat periferike të qyteteve dhe vendeve në urbanizim të shpejtë dhe kaotik.

Kjo lloj bujqësie zhvillohet në periferi të qyteteve, me të cilët krijon lidhje funksionale dhe shërben për të plotësuar nevojat e tyre. Ajo është kryesisht një bujqësi mbijetese dhe është subjekt i ndryshimeve të shpejta për shkak të rritjes së popullsisë dhe paralelisht me të edhe të çmimit të tokës. Këto ndryshime reflektohen edhe në llojin e bujqësisë që zhvillohet aty, e cila bëhet gjithnjë e më intensive, pasi duhet të plotësojë nevojat e një popullsie në rritje, me një sipërfaqe bujqësore që vjen gjithnjë e në zvogëlim. Pikërisht këto karakteristika i vëmë re edhe për HPUSH, sidomos për zonën Dobraq, Golem, Shtoj i Ri dhe Bleran, të cilat gjenden edhe më pranë qytetit.

IV.2.1.9. Problemet e sotme të ekonomisë bujqësore dhe e ardhmja

Duke parë panoramën e përgjithshme të zhvillimit të bujqësisë në HPUSH të paraqitur më sipër, mund të themi se gjatë 23 viteve të fundit ka pasur ndryshime të rëndësishme strukturore në ekonominë bujqësore të zonës. Kështu, mund të themi që gruri dhe misri kanë humbur rëndësinë e dikurshme, drufrutorët dhe vreshtat vazhdojnë të mbeten të rëndësishme, ndërkohë që ka rritje të sipërfaqes së mbjellë me foragjere dhe perime. Një zhvillim relativ ka pasur edhe sektori blegtoral. Këto ndryshime janë ndikuar nga kërkesat e tregut dhe ndryshimi i sistemeve ekonomiko-politike.

Megjithatë, mund të thuhet me bindje se në këto 23 vite të ekonomisë së tregut, bujqësia në gjithë vendin dhe në komunën Rrethinat gjithashtu, mund të kishte bërë hapa shumë më të rëndësishëm përpara, nëse nuk do të ishte përballur me *disa probleme* të caktuara, të cilët po i paraqesim më poshtë:

- ✓ *ndërrhyrja e munguar e shtetit*, ku duhet ta pranojmë se të gjitha qeveritë post-komuniste e kanë trajtuar sektorin e bujqësisë si një sektor të dorës së dytë, duke mos zbatuar një platformë të qartë kombëtare në këtë drejtim. Gjithashtu ato nuk kanë këshilluar, kredituar apo subvencionuar fermerët siç duhet, duke i lënë ata në mëshirë të fatit.
- ✓ *problemi i pronësisë së tokës*, është një problem që vazhdon të jetë prezent si në të gjithë vendin edhe në HPUSH. Faktikisht ne e kemi trajtuar më sipër këtë çështje dhe kemi përmendur faktin se ka akoma familje të paplotësura me tokë sipas ligjit në komunë, ashtu siç vazhdon të ketë pretendime për rikthimin e tokave pronarëve të dikurshëm.
- ✓ *copëzimi dhe fragmentizimi i madh i tokës bujqësore* është një faktor shumë i rëndësishëm që pengon zhvillimin e bujqësisë në zonën në studim. Parcelat bujqësore janë të copëtuara në pak dynymë, rrallëherë mund të gjesh sipërfaqe toke më të mëdha. Për pasojë është tepër e vështirë që të ketë prodhime në sasi të mëdha, pasi çdo fermer mbjell për vete, atë që atij i duket më e përshtatshme.
- ✓ *degradimi i sistemit kanalizues dhe ujitës* që ndodhi pas viteve '90, ka zvogëluar ndjeshëm mundësinë e kultivimit të bimëve ujëdashëse sidomos në stinën e verës, psh misrit.
- ✓ *përdorimi i pamjaftueshëm i makinerive dhe plehrave kimike* nuk lejon arritjen e prodhimeve dhe rendimenteve më të larta, duke çuar në zhvillimin e një bujqësie të tipit ekstensiv. Këtu ndikon edhe mungesa e këshillimit nga strukturat përkatëse, në mënyrë që fermerët të dinë çfarë është më e përshtatshme për t'u mbjellë nga ana e tyre dhe si mund të rriten rendimentet e produkteve bujqësore.

IV.2.2. Sektori ekonomik dytësor

IV.2.2.1. Objektet dhe veprimtaria industriale

Burimet natyrore të HPUSH, siç e kemi përmendur edhe në kapitullin e parë, nuk janë edhe aq të shumta. Një gjë e tillë lidhet padyshim edhe me sipërfaqen e vogël që ajo përfshin, por edhe me pozicionin gjeografik dhe territorin fushor. Por gjithsesi, bazuar në ato resurse ekzistuese, ofrohet mundësia e zhvillimit sidomos të industrisë agroushqimore. Siç edhe e kemi thënë më sipër, prodhimet bujqësore dhe blegtorale të HPUSH janë të larmishme dhe të konsiderueshme, duke mbuluar jo vetëm nevojat ushqimore të banorëve të zonës, por duke krijuar edhe një tepricë e cila mund të përpunohet industrialisht e të hidhet në treg.

Ndërsa burime të tjera natyrore që mund të lejojnë zhvillimin e industrisë së rëndë si mineralet, siç e kemi thënë janë të pakta në territorin e komunës, por mund të zhvillohet nxjerrja dhe përpunimi i lëndëve inerte dhe materialeve të ndërtimit. Bazuar në këto fakte, mund të themi se *agroindustria* është dega bazë e sektorit dytësor të ekonomisë në HPUSH, megjithëse nuk mungojnë edhe përpjekjet për zhvillimin e degëve të tjera të industrisë së lehtë.

Konkretisht nga të dhënat zyrtare¹⁶⁴ por duke u bazuar edhe në fakte të marra në terren, aktualisht në hapësirën e komunës ka:

- a) kompleks modern pularie për prodhimin e vezëve (objekti më i rëndësishëm industrial që gjendet në territorin e komunës)
- b) furra për prodhimin e bukës
- c) punishte për përpunimin e drurit dhe prodhimin e mobiljeve
- d) punishte për punimin e duraluminit
- e) baxho për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e nënprodukteve të tij
- f) punishte për përpunimin e frutave dhe perimeve
- g) punishte për prodhimin e pijeve alkoolike (raki, verë) dhe kantina të tyre
- h) punishte për përpunimin e vajit të ullirit (Zues)
- i) punishte për prodhimin e tullave, blloqeve, gurëve dekorativ, etj.
- j) impiant për grumbullimin e inerteve (rërë, zhavorr) në lumin Kir, si dhe gurorë për nxjerrjen e materialeve të ndërtimit në Zues.

Pra, nga të dhënat e mësipërme, mund të thuhet se është industria e lehtë dhe ushqimore që mbizotëron në HPUSH. Vihet re se pjesa më e madhe e tyre janë përqendruar në rrugën kombëtare Shkodër - Han i Hotit, ku dallohet veçanërisht fshati Dobraç dhe më pak ai Shtoj i Ri. Ajo që mund të shtohet është fakti se këto njësi prodhuese janë në fazat fillestare të krijimit dhe zhvillimit të tyre dhe gjenden akoma në nivelin e punishteve, megjithëse mundësitë për t'i shndërruar në komplekse të vërteta industriale ekzistojnë dhe për këtë duhet investuar në të ardhmen.

¹⁶⁴ Të dhënat janë marrë në Zyrën e të Ardhurave të komunës Rrethinat, Shkodër - tetor 2013



Foto nr. 13: Punishte (kantinë) për prodhimin e verës në fshatin Shtoj i Ri (D.Rustja)

IV.2.2.2. Sektori i ndërtimit

Ndërtimi është një tjetër veprimtari e rëndësishme ekonomike për zonën në fjalë, gjë që e tregon edhe numri jo i pakët i subjekteve që merren me këtë lloj biznesi në HPUSH, ku vihet re se ka 4 biznese të mëdha që tregtojnë lëndë ndërtimi, dhe 3 biznese të mëdha që janë firma ndërtimi. Kjo lidhet me ndërtimet e shumta të bëra në territorin e saj pas viteve '90, si dhe me faktin se pjesën më të madhe të kursimeve të tyre banorët e zonës e përdorin për ndërtimin e shtëpive të reja, apo për rikonstruksionin e atyre ekzistuese duke i përshtatur me standarte më bashkëkohore.

Ky sektor ekonomik, duhet thënë gjithashtu se punëson edhe një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së HPUSH që nuk është e angazhuar në sektorin bujqësor, edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare në këtë drejtim, ngaqë shumica e tyre punojnë në të zezë. Mund të themi se pas një periudhe lulëzimi të këtij sektori gjatë viteve '90, për shkak të rritjes së numrit të popullsisë dhe nevojës për plotësimin e kërkesës për strehim si për popullsinë e ardhur, ashtu edhe për atë ekzistuese; ndërtimi ka pësuar një lloj rënie gjatë viteve të fundit, qoftë si rrjedhojë e rënies së ritmeve të rritjes demografike, qoftë si rrjedhojë e rënies së të ardhurave që e financuan atë (kryesisht remitancave).

IV.2.3. Shërbimet dhe infrastruktura

IV.2.3.1. Tregtia me shumicë dhe pakicë

Dihet se gjatë 23 viteve të fundit, sektori terciar i ekonomisë - pra ai i shërbimeve, ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm në vendin tonë, duke iu përgjigjur kërkesave të kohës dhe sistemit të ekonomisë së tregut. Kjo lidhet me faktin se ky sektor është i lidhur drejtpërdrejt me plotësimin e nevojave të përditshme të njerëzve dhe është më i prekshëm për ta. Sektori i shërbimeve dhe sidomos tregtia me shumicë dhe pakicë, ka një zhvillim të konsiderueshëm në HPUSH, lidhur kjo edhe me popullsinë e madhe që ka ajo dhe me faktin se sado që qyteti është afër, ai nuk mund të plotësojë të gjitha kërkesat e banorëve të zonës, kurdo që ata kanë nevojë. Prandaj në çdo fshat të komunës ekzistojnë dyqane dhe shërbime të llojeve të ndryshme, të cilët plotësojnë nevojat e

banorëve të zonës, ku mund të përmendim dyqanet ushqimore, bar-bufetë, restorantet, hotelet, fushat sportive, etj.

Duhet thënë se banorët e HPUSH shfrytëzojnë shumë mundësitë që ofron qyteti i Shkodrës në këtë drejtim (tregu i fruta-perimeve të qytetit ndërtuar së fundi gjendet në territorin e komunës), meqenëse një pjesë e mirë e tyre e kanë veprimtarinë e përditshme shumë të lidhur me qytetin. Prandaj mund të themi se në fshatrat e komunës sektori i shërbimeve ekziston aq sa për të plotësuar nevojat imediate të njerëzve, kryesisht të popullsisë më sedentare. Megjithatë zhvillimi i këtij sektori ekonomik në këtë territor është në rritje dhe jo i zakonshëm për një popullsi tipike rurale, gjë që flet edhe njëherë për tiparet periurbane të kësaj zone.

Tabela 11. *Bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në HPUSH*¹⁶⁵


<i>Fshati</i>	<i>Biznes i madh</i>	<i>Biznes i vogël</i>	<i>Të palicensuar</i>	<i>Totali</i>
Dobraç	30	54	40	123
Golem	1	9	12	22
Grudë e Re	1	4	16	21
Guci e Re		2	2	4
Hot i Ri	4	5	5	14
Shtoj i Ri	4	7	15	26
Shtoj i Vjetër	4	2	10	16
Zues	6	6	7	19
Bardhaj		4	2	6
Bleran		4	4	8
Totali	50	97	113	260

Tabela e mësipërme, e paraqitur grafikisht edhe më poshtë, na jep një pamje edhe më konkrete dhe të detajuar të zhvillimit të shërbimeve dhe tregtisë me shumicë dhe pakicë në HPUSH. Së pari nga ajo, arrijmë të kuptojmë lehtësisht se në këtë drejtim mbizotëron fshati Dobraç, në raport me vendbanimet e tjera të HPUSH. Ai i vetëm ka thujse gjysmën e të gjithë llojeve të bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë. Një gjë e tillë është e lidhur me pozitën e tij gjeografike ngjitur me qytetin e Shkodrës si dhe me një lloj tradite në këtë drejtim të trashëguar edhe nga sistemi i kaluar. Përveç se në Dobraç, vihet re se shërbimet dhe bizneset janë të përqendruara edhe në rrugën Shkodër-Han i Hotit, dhe deri diku edhe në fshatin Shtoj i Ri. Për një numër relativisht më të madh të bizneseve të mëdha dallohet edhe fshati Zues (ku janë përqendruar disa bar-restorante të njohura edhe për qytetin e Shkodrës), dhe deri diku edhe fshatrat Shtoj i Ri, Hot i Ri dhe Shtoj i Vjetër. Diçka tjetër që të bie në sy, është numri i konsiderueshëm i bizneseve të palicensuara; të shpërndarë nëpër të gjithë fshatrat e komunës, por sërish mbizotërues në Dobraç.

Janë plot 113 të tillë, dhe nga të dhënat që kemi vihet re se një numër i konsiderueshëm i tyre i paguajnë taksat vendore, edhe pse nuk kanë liçensë zyrtare për të

¹⁶⁵ Të dhënat mbi numrin dhe llojet e bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në HPUSH, janë marrë nga Zyra e të Ardhurave e komunës Rrethinat, tetor 2013.

ushtruar aktivitetin e tyre (?!). Ndërkohë që nuk është i vogël edhe numri i bizneseve të mbyllura, apo i atyre që janë kthyer në biznese të mëdha gjatë periudhës 2008-2013.



Graf. 16: Bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në HPUSH



Foto nr. 14: Biznese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Dobraç dhe përgjatë rrugës nacionale Shkodër-Han i Hotit (D.Rustja)

Nga të dhënat që zotërojmë në lidhje me llojet e bizneseve të mëdha në HPUSH, vëmë re se shpërndarja e tyre është si më poshtë:

Tabela 12: Llojet e bizneseve të mëdha në HPUSH

1.	Farmaci bujqësore	1
2.	Lëndë ndërtimi	4
3.	Bar-Restorant	5
4.	Pika karburanti	7

5.	Prodhim konfeksione	2
6.	Agjensi doganore	3
7.	Firmë ndërtimi	3
8.	Punime druri, duralumini, mermeri	4
9.	Kompleks sportiv	1
10.	Pulari	1
11.	Furrë buke	1
12.	Hidrosanitare	1
13.	Hotel	1
14.	Përpunim qumështi	1
15.	Mobileri	1
16.	Artikuj të ndryshëm (të tjerë)	14

Burimi: Zyra e të Ardhurave, komuna Rrethinat

Ndërsa tek bizneset e vogla shohim se mbizotërojnë këto zëra kryesore: tregti fruta-perimesh, artikuj të ndryshëm, dyqane ushqimore, lëndë ndërtimi, servis makinash, punime druri dhe duralumini, prodhim materiale ndërtimi, profesione të lira, bar-restorante, farmaci, furra buke, fusha minifutbolli dhe firma të liçensuara për transport udhëtarësh. Siç e thamë, nga të dhënat zyrtare por edhe nga vëzhgimet në terren, një pjesë jo e vogël e bizneseve në komunën Rrethinat, janë të paliçensuar.

IV.2.3.2. Turizmi dhe restorantieria

Turizmi është një tjetër degë e rëndësishme ekonomike e sektorit terciar që ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm gjatë 23 viteve të fundit në vendin tonë, dhe në vetë rajonin e Shkodrës, për shkak të pasurive natyrore dhe vlerave kulturore që ai mbart. Ky sektor ka ndikuar gjithashtu ndjeshëm edhe në punësimin e popullsisë dhe në rritjen e të ardhurave të tyre; megjithatë nuk mund të themi se nga këto zhvillime është prekur sa duhet edhe HPUSH.

Vlen për t'u përmendur se në këtë hapësirë ka një zonë turistike më sipërfaqe 3 ha, e cila përfshin fshatin Zues dhe kufizohet:

- Në Veri me liqenin e Shkodrës
- Në Jug me malin e Taraboshit
- Në Lindje nga lumi Buna dhe liqeni
- Në Perëndim po nga bregu i liqenit

Pikërisht këtu, ka ndodhur gjatë këtyre viteve një lloj zhvillimi turistik spontan, kryesisht nëpërmjet shërbimit që ofrojnë disa bare dhe restorante, më tepër për banorët e qytetit të Shkodrës dhe turistët vendas dhe të huaj. Kjo pasi fshati është mjaft piktoresk dhe panoramik, meqë shtrihet në shpatin JL të Taraboshit, të mbuluar me gjelbërim dhe ullishte, dhe për shkak të pozitës gjeografike në rrugën e kalimit që lidh Shqipërinë me Malin e Zi. Vlerat turistike dhe peisazhore këtij fshati ia shton edhe lumi Buna që kalon pranë brigjeve të tij, dhe e gjithë nyja hidrografike liqeni i Shkodrës-lumi Buna-lumi Drin, të cilët bashkohen poshtë kalasë, pranë tij.

Një zonë tjetër më vlera turistike mund të konsiderohet edhe e gjithë pjesa përgjatë brigjeve të liqenit të Shkodrës nga vija e Vrakës në Bishtin e Qindisë, ku gjendet edhe Pylli i Dobraçit, e cila në të kaluarën është përdorur në një farë mënyre për turizëm

lokal nga banorët e zonës. Megjithatë, shihet qartë se zhvillimi i turizmit është sporadik dhe i paorganizuar në këtë zonë dhe në të gjithë HPUSH, megjithëse mundësitë janë më të mëdha.



Foto nr. 15: Pamje nga fshati Zues (D.Rustja)

IV.2.3.3. Transporti dhe telekomunikacioni

a) Transporti


Për vetë pozicionin gjeografik që ka, HPUSH ka avantazhin të përshkohet nga rruga automobilistike kombëtare dhe ndërkombëtare që lidh Tiranën me pikat kufitare të Hanit të Hotit dhe Muriqanit ose Shqipërinë me Malin e Zi. Gjithashtu në të kalon hekurudha e vetme ndërkombëtare e Shqipërisë, që e lidh atë me Malin e Zi dhe rrjetin hekurudhor evropian. Janë këto përparësi që HPUSH i zotëron dhe që në një të ardhme të afërt, lidhur ngushtë me zhvillimin e përgjithshëm rajonal dhe perspektivën e integritimit në BE¹⁶⁶, mund ti krijojnë asaj kushte shumë të përshtatshme komunikimi dhe zhvillimi.

- Transporti automobilistik.

Në terësi, në hapësirën e komunës gjenden 27.7 km rrugë urbane, nga të cilat rreth 18.15 km janë të asfaltuara dhe rreth 9.55 km të pashtruara. Kurse rrugë të brendshme janë gjithsej 35 km, nga të cilat 9 km janë komunale. Gjendja ekzistuese e rrugëve automobilistike lë për të dëshiruar. Mund të thuhet se ka pasur gjithsesi një përmirësim të dukshëm në këtë drejtim, sidomos pas v. 1990; pasi shumica e investimeve të kryera janë realizuar në kuadër të infrastrukturës rrugore. Kështu, sipas të dhënave në dispozicion¹⁶⁷, janë asfaltuar pjesa më e madhe e rrugëve kryesore të fshatrave të komunës, deri tek qendra e tyre, ose tek shkollat. Vlen për t'u përmendur së fundi ndërtimi i rrugës kombëtare Shkodër – Han i Hotit, e cila kalon në një pjesë të konsiderueshme në territorin e HPUSH.

¹⁶⁶ BE – Bashkimi Europian

¹⁶⁷ Zyra e Zhvillimit e Qarkut Shkodër; *Investime në komunën Rrethinat për periudhën 2005-2012*, tetor 2013



Harta 11: Rrjeti kryesor i transportit në HPUSH

Më problematike paraqitet gjendja e rrugëve të brendshme të fshatrave, apo e atyre që i lidhin ata me njëri tjerin. Shumica e tyre janë në gjendje të rëndë dhe kanë nevojë për rikonstruksion ose rregullim tërësor. Përveç pamjaftueshmërisë së rrjetit aktual vihen re edhe mungesa në standarte, si psh: në ndriçim, sinjalistikë, korsi për transport alternativ (biçikleta), trotuare për këmbësorët, si dhe infrastrukturë nëntokësore (elektrike apo hidraulike). Gjithashtu pritet që të kenë një ndikim të rëndësishëm në infrastrukturën dhe rrjetin rrugor të HPUSH edhe ndërtimi i bypassit juglindor të qytetit të Shkodrës si dhe bypassi veriperëndimor i këtij qyteti, që bashkohet pranë fshatit Dobraq me rrugën kombëtare Shkodër-Koplik (nëse do përfundojë).



Foto nr. 16: Rrugë të asfaltuara dhe të paasfaltuara në HPUSH (D.Rustja)

Një vend të veçantë në rrjetin e transportit për HPUSH, për vetë rolin strategjik të tyre zënë edhe urat. Dallojmë në këtë drejtim sidomos dy prej tyre:

- a) *Urën e Bardhajve*, e cila kalon mbi lumin Kir dhe shërben për të lidhur fshatrat Bardhaj dhe Bleran me fshatrat e tjerë të komunës dhe vetë qytetin e Shkodrës. Kjo urë e ndërtuar pas viteve viteve '90, është shumë e rëndësishme për banorët e këtyre fshatrave, megjithatë, edhe pse e ndërtuar relativisht vonë, gjendja e sotme e saj është mjaft e rënduar dhe jashtë kushteve teknike, duke shtruar nevojën për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstrukcion.
- b) *Urën e Vrakës*, e cila ia vlen për t'u përmendur gjithashtu, pasi është pjesë e rrugës nacionale kombëtare Shkodër-Han i Hotit, dhe një pikë e rëndësishme lidhëse e HPUSH me komunën Gruemirë, rrethin e Malësisë së Madhe e më gjerë. E rindërtuar së fundi si pjesë e rrjetit të mësipërm rrugor, gjendja e saj paraqitet mjaft e mirë.

Duke qenë se qyteti i Shkodrës është afër, pjesa më e madhe e banorëve të zonës e kanë zgjidhur në mënyrë vetjake *problemin e lëvizjes dhe të transportit*. Ka mjaft familje të cilat zotërojnë automjete personale ashtu siç është shumë e përhapur edhe lëvizja me biçikleta, karakteristike edhe për qytetin e Shkodrës, sidomos për banorët e fshatrave më afër komunës. Për disa fshatra më të largët të saj si Shtoji i Vjetër, Guçia e Re apo Blerani ekzistojnë dhe linja transporti me furgonë. Në territorin e komunës ushtrojnë veprimtarinë e tyre rreth 25 mjete të licencuara të transportit të mallrave dhe njerëzve. Gjithashtu duhet thënë se stacioni i autobuzëve urban të qytetit gjendet mjaft pranë fshatit Golem. Përfundimisht mund të themi se mundësitë e transportit për banorët e HPUSH janë të favorshme, por edhe mund të përmirësohen.

- Transporti hekurudhor.

Siç e përmendëm, në territorin e HPUSH kalon hekurudha kombëtare dhe ndërkombëtare Tiranë–Han i Hotit, e cila e lidh vendin tonë me Malin e Zi dhe vetë komunën me kryeqytetin. Duhet thënë se gjendja e kësaj hekurudhe paraqitet mjaft e rënduar, për shkak të lënies në harresë dhe mosmirëmbajtjes. Aktualisht ajo përdoret kryesisht për transportin e mallrave me Malin e Zi, por në një të ardhme të afërt mund të përbëjë një vlerë të shtuar shumë të rëndësishme për lidhjet rajonale dhe zhvillimin ekonomik të zonës.

- Transporti ujor

Komuna Rrethinat lidhet me vendet e tjera me transport ujor, nëpërmjet porteve të Shëngjinit (45 km larg) dhe Durrësit (120 km larg).

- Transporti ajror

Së fundi përmendim edhe mundësinë e lidhjes së banorëve të zonës me pjesën tjetër të botës me transport ajror, nëpërmjet aeroportit ndërkombëtar të Rinasit, distanca nga i cili është 80 km, por edhe nëpërmjet aeroportit të Podgoricës. Përmendim këtu edhe

ekzistencën e fushës së aviacionit në territorin e komunës, aktualisht e lënë në harresë dhe pa të ardhme.

b) Telekomunikacioni

Në HPUSH ushtron veprimtarinë e vet një kompani rurale dhe private e *telefonisë fikse*, e cila mbulon me sinjal dhe shërbim të gjithë fshatrat e saj. Aktualisht ajo ka rreth 500 abonentë në po kaq familje. Duhet thënë se me kalimin e kohës numri i abonentëve të kësaj kompanie që arriti mbi 1000 abonentë ka rënë, për shkak të cilësisë së dobët të shërbimit, çmimeve të larta që ofron dhe konkurrencës nga rrjeti i telefonisë së lëvizshme. Ndërsa në fshatin Dobraq vepron edhe dega e Albtelekomit Shkodër, duke ofruar një shërbim edhe më cilësor dhe të garantuar. Gjithashtu, në HPUSH ushtrojnë veprimtarinë e tyre të gjithë operatorët kryesorë të telefonisë celulare që veprojnë në vendin tonë; ata përdoren gjerësisht nga banorët e zonës duke qenë mënyra kryesore e komunikimit telefonik. Kështu, sipas të dhënave të Censurit 2011, 741 familje në HPUSH kanë telefona fiks dhe 4344 të tilla përdorin rrjetin e telefonisë së lëvizshme për komunikim¹⁶⁸.

Kurse *shërbimi postar* sigurohet nëpërmjet degës përkatëse të Postës Shqiptare në fshatin Dobraq, por mund të mbulohet edhe nga degët përkatëse në qytet. Meqë jemi këtu, duhet thënë se në të gjithë territorin e komunës mungon një sistem i saktë, i koordinuar dhe zyrtar i adresave; një problematikë e rëndësishme që shtrohet për zgjidhje në të ardhmen për këtë zonë.

Së fundi, përmendim faktin se prej gati 6 vitesh, në territorin e komunës është hapur edhe një stacion televiziv lokal, valët e të cilit kapen në të gjithë rrethin e Shkodrës, ndërkohë që nuk mungojnë edhe qendrat e internetit, që ua ofrojnë këtë shërbim banorëve që nuk kanë akses në të; megjithëse mjaft prej tyre tashmë kanë filluar ta instalojnë atë në shtëpi. Po sipas të dhënave të Censurit të v. 2011, 573 familje kanë kompjuter dhe 428 prej tyre lidhje interneti.

IV.2.3.4. Furnizimi me ujë dhe energji elektrike

a) Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë ka përbërë gjatë këtyre 23 viteve, problemin më të rëndësishëm dhe akoma të pazgjidhur për banorët e HPUSH. Ky problem që faktikisht ka qenë evident në këtë hapësirë pothuajse gjithmonë, si kudo në fushën e Mbishkodrës, gjeti një farë zgjidhjeje gjatë sistemit të kaluar dhe ishte një ndër investimet më të rëndësishme të tij për të. Mirëpo pas viteve '90, me ardhjet e reja të popullsisë nga zonat malore dhe vendosjen e tyre përgjatë tubacioneve të ujësjellësit, problemi u riaktivizua sërish dhe fuqishëm.

Aktualisht, vetëm fshati Dobraq dhe pjesërisht fshati Golem, furnizohen me ujë nëpërmjet ujësjellësit të qytetit të Shkodrës. Po ashtu edhe një pjesë e Hotit të Ri (popullsia poshtë rrugës nacionale Shkodër-Mes), furnizohet me ujë nëpërmjet një investimi të kryer në v. 2001, me kullë ajrore. Një investim i rëndësishëm në këtë drejtim është bërë edhe për fshatin Zues, megjithëse vetëm një pjesë e banorëve marrin ujë nga

¹⁶⁸ INSTAT; *Censuri i popullsisë dhe banesave 2011 – Qarku Shkodër*, Tiranë 2012

ujësjellësi i ndërtuar. Ndërsa fshatrat e tjerë janë pothuajse pa ujë. Furnizimi i tyre me këtë element jetik duhet të kryhet nga ujësjellësi i Mbishkodrës, i ndërtuar në vitet 1976-1979; mirëpo me ndarjen administrative të Koplikut nga qyteti i Shkodrës, ai pothuajse doli jashtë funksionit. Banorët e tyre merrnin ujin që tepronte nga fshatrat e Gruemirës, që sot janë pjesë e rrethit të Malësisë së Madhe dhe ku kalon linja kryesore. Pjesa e ujësjellësit që furnizonte fshatrat e qytetit të Shkodrës mbeti pa administrim. Duke i shtuar kësaj, edhe ndërhyrjet e pakontrolluara në tubacionet kryesore pas v. 1990, si dhe rritjen e kërkesës për ujë për shkak të rritjes demografike të popullsisë, situata degradoi aty ku është sot: ku mbi 70 % e banorëve të zonës nuk i sigurohet nga strukturat shtetërore, një nevojë bazike dhe e drejtë njerëzore si uji.

Në fakt, zgjidhja e vetme aktuale e mundshme për këta banorë është hapja e puseve artificiale dhe individuale (familjare) me ngritje mekanike. Kjo është në thelb edhe mënyra kryesore e furnizimit me ujë për HPUSH. Kështu, sipas të dhënave të Censurit 2011, nga 4821 banesa të HPUSH, 1420 kanë rrjet ujësjellësi brenda banesës, 143 jashtë banesës por në ndërtesë, 298 jashtë ndërtesës, 2708 sistem të furnizimit me ujë të llojit tjetër (puse) dhe 257 familje nuk kanë asnjë lloj sistemi të furnizimit me ujë.

Një situatë e tillë paraqitet mjaft paradoksale, po të kemi parasysh faktin se në territorin e HPUSH, gjenden pusët arteziane të Dobraçit, nga më të pasurit dhe të rëndësishmit për vendin tonë, të cilët furnizojnë me ujë qytetin e Shkodrës dhe siç e thamë një pjesë të vogël të popullsisë së komunës. Pavarësisht se ekzistojnë disa projekte¹⁶⁹ në lidhje me furnizimin me ujë të popullsisë së kësaj zone, deri më sot asgjë konkrete nuk ka në këtë drejtim. Ndërtimi i një ujësjellësi të ri, i cili të mundësojë furnizimin normal të banorëve të zonës me ujë të pijshëm, mbetet një ndër prioritetet kryesore që duhet të zgjidhet; kjo pasi investimet e realizuara deri më tani në këtë drejtim janë të pamjaftueshme dhe sporadike, duke mos prekur thelbin e problemit.

b) Furnizimi me energji elektrike

Bashkë me furnizimin me ujë, furnizimi i popullsisë së HPUSH me energji elektrike, mund të thuhet me bindje se kanë përbërë dhe përbëjnë dy nga problemet kryesore me të cilat janë përballur dhe përballen banorët e zonës në jetën e tyre të përditshme. Në ditët tona, furnizimi me energji i HPUSH realizohet kryesisht nga nënstacioni Shkodra 1 dhe nga 3 fidra të ndryshëm me kapacitet 6-kilovatësh të tij; ku burimi parësor i energjisë është HC i Vaut të Dejes¹⁷⁰.

Më konkretisht, fidri nr. 4 furnizon me energji elektrike fshatrat Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër dhe një pjesë të fshatit Dobraç; fidri nr. 5 - fshatrat Golem, Hot i Ri, Grudë e Re dhe Guci e Re; kurse fidri nr. 15 fshatrat Bardhaj dhe Bleran. Ndërkohë, duhet thënë se një pjesë e fshatit Dobraç, furnizohet me energji nga fidri nr. 16 me kapacitet 20 kilovatë, i cili njëkohësisht furnizon edhe një pjesë të qytetit të Shkodrës. Përsa i takon fshatit Zues, ai furnizohet me energji nga një nënstacion më vete dhe nga fidri nr. 1 me kapacitet 6 kilovat. Në të gjithë fshatrat janë rreth 30 kabina elektrike shtetërore, ku në secilën prej tyre është vendosur një transformator; por paralelisht me këtë në çdo fshat ka

¹⁶⁹ Bazuar në informacionet dhe të dhënat e marra nga Ndërmarrja e Ujësjetillësit Fshat – Shkodër (NUFSH)

¹⁷⁰ Të dhënat mbi furnizimin me energji elektrike në HPUSH janë marrë nga dega Shkodër e CEZ Shpërndarje dhe KESH (Korporata Energjitike Shqiptare), si dhe nga burime në terren.

kabina (transformatorë) privat të cilat janë vendosur në mënyrë joformale nga vetë banorët; ato gjenden kryesisht në zonat informale të ndërtuara dhe banuara pas v. 1990.

Në terësi në të gjithë komunën ka rreth 5000 abonentë (familjarë dhe biznese), dhe niveli i pagesës së energjisë së konsumuar është rreth 42%. Siç e shohim, kjo vlerë është mjaft e vogël, ndër më të ulëtat në rrethin e Shkodrës dhe është e lidhur me një sërë faktorësh. Mund të përmendim këtu varfërinë dhe nivelin relativisht të ulët ekonomik të popullsisë së zonës; ku një pjesë e mirë e abonentëve që nuk paguajnë janë banorë të ardhur pas v. 1990; por edhe mungesën e ndërgjegjësimit të popullsisë në përgjithësi në këtë drejtim. Si rezultat, nuk kanë munguar edhe ndërprerjet e energjisë elektrike në këtë zonë nga strukturat përkatëse, si një masë ndëshkimore, nganjëherë edhe në mënyrë kolektive. Një rast i tillë në nëntorin e v. 2012 solli deri acarimin e popullsisë lokale dhe përplasjen fizike me strukturat e CEZ-it Shkodër.

Po ashtu, vlen për t'u theksuar fakti se gjendja e rrjetit elektrik në HPUSH paraqitet mjaft e amortizuar për shkak të mungesës së investimeve në këtë drejtim; kabinat elektrike dhe i gjithë rrjeti në terësi, nuk mirëmbahet. Si rezultat, defektet janë të shpeshta dhe të vazhdueshme dhe janë kthyer në një makth të vërtetë për popullsinë e zonës, sidomos në stinën e dimrit. Një gjë e tillë lidhet me faktin se, ndërkohë që numri i popullsisë në HPUSH është dyfishuar gjatë 20 viteve të fundit, rrjeti dhe kapaciteti mbajtës i tij ka mbetur thuajse i njëjti si më përpara. Në rrethana të tilla dhe në mungesë të ndërhyrjeve të nevojshme nga strukturat shtetërore, kuptohet që furnizimi me energji elektrike do mbetet problematik për banorët e zonës edhe në të ardhmen e afërt.

IV.2.3.5. Menaxhimi i ujrave të përdorura dhe trajtimi i mbeturinave urbane

Menaxhimi i mbetjeve të *ujrave të zeza* është një element i infrastrukturës që akoma nuk ka filluar të vlerësohet në HPUSH. Kanalizimet e tyre mungojnë në të gjithë fshatrat, dukë bërë që mënyra e vetme për sistemimin e ujrave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin dhe duke rrezikuar përhapjen e sëmundjeve infektive.

Përqëndrimi gjithnjë e më i madh i popullsisë në HPUSH, me fshatra që i kalojnë 5000 banorë, ka bërë që kjo zonë të ndotet shumë nga *mbetjet urbane*, prej hedhjes së pakontrolluar të tyre. Këto mbetje, por sidomos edhe mbetjet e ngurta urbane përbëjnë një shqetësim për komunën Rrethinat. Nuk ekziston një vend depozitimi, grumbullimi, përpunimi apo shërbim me rrjet kazanesh për hedhjen e mbeturinave. Kjo zonë ka probleme të konsiderueshme edhe me shërbimin e mbledhjes dhe të trajtimit të tyre. Fluksi aktual i mbetjeve urbane llogaritet në 5 tonë/ditë, kurse sasia vjetore e tyre në këtë komunë llogaritet në 2000 m³/vit. Thuajse kudo, anës rrugëve, në kanalet kulluese dhe vaditës, gjenden grumbuj mbeturinash, që hidhen kryesisht nga familjarët dhe bizneset private, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në HPUSH. Kjo situatë është më alarmante përgjatë lumit Kir, veçanërisht në zonën Bardhaj-Bleran; por edhe në fushën e aviacionit, që gjendet mes fshatrave Grudë e Re dhe Hot i Ri. Këtu hidhen jo vetëm mbetjet e kësaj komune por edhe ato të zonave fqinje, në shumë raste. Nganjëherë, këto mbetje edhe ndizen, duke përkeqësuar edhe më shumë nivelin e ndotjes së ajrit në HPUSH, sidomos në fshatrat më pranë tyre. Kurse mbetjet industriale nuk janë të shumta.

Kuptohet qartë se një ndër prioritetet kryesore të HPUSH në të ardhmen është marrja e masave për menaxhimin dhe trajtimin e këtyre mbetjeve.



Foto nr.17: *Mbetjet e ngurta dhe urbane në zonën Bardhaj-Bleran, pranë lumit Kir (D.Rustja)*


IV.3. Veçoritë dhe treguesit e zhvillimit social-ekonomik

IV.3.1. Banesat dhe gjendja e strehimit

Ndërtimet e bëra në fshatrat e HPUSH, janë në përgjithësi ndërtime të thjeshta, pa ndonjë tipar, traditë apo specifikë dalluese. Një gjë e tillë është e lidhur edhe me faktin se në përgjithësi zona është e re, dhe siç e kemi theksuar nuk është se mbart ndonjë traditë të pasur historike, që mund të reflektohej në strukturën e banesave dhe arkitekturë.

Një burim i vlefshëm për të njohur dhe kuptuar më mirë gjendjen e strehimit dhe banesat në HPUSH, është censusi i v. 2011¹⁷¹. Sipas të dhënave të tij, në këtë hapësirë gjenden gjithsej 5537 banesa (dhe 4812 ndërtesa): nga këto 4793 janë banesa të zakonshme të banuara, 716 banesa të zakonshme jo të banuara dhe 28 banesa jo të zakonshme. Më konkretisht këto të dhëna po i paraqesim në grafikun e mëposhtëm:

¹⁷¹ INSTAT; *Censusi i popullsisë dhe banesave 2011 – Qarku Shkodër*, Tiranë 2012




Graf. 17: Banesat dhe llojet e tyre në HPUSH

Duke e parë këtë grafik të bie në sy numri i konsiderueshëm i banesave, jo i zakonshëm për hapësirat rurale në vendin tonë; si dhe numri jo i vogël i banesave të zakonshme jo të banuara, të cilat në përgjithësi u përkasin familjeve që janë në emigracion. Jo pa interes paraqitet edhe numri i banesave jo të zakonshme, ku marrim parasysh strehimin në kushte të papërshtatshme (kasolle, baraka, etj)¹⁷², i cili në total është i vogël për HPUSH në ditët e sotme; gjë që flet për përmirësimin e gjendjes së strehimit në këtë zonë pas viteve ‘90.

Përsa i takon pronësisë së banesës, vëmë re 4582 zotërues të tyre (kryefamiljarë) deklarojnë se janë pronarë ose janë duke u bërë pronarë; 57 prej tyre deklarojnë se janë qiramarrës, kurse 262 banues të tyre deklarojnë se nuk jetojnë në shtëpitë e tyre, por nuk paguajnë qira (jetojnë falas). Pra vëmë re se shumica e banorëve që jetojnë në banesat e zakonshme janë edhe pronarë të tyre.

Një element tjetër i vlefshëm për t’u studiuar, po nga të dhënat e censusit është edhe lloji i ndërtesës, që po e paraqesim sërish në grafikun e mëposhtëm:



Graf. 18: Ndërtesat për qëllime banimi sipas llojit të tyre

¹⁷² Në periudhën e parë të pas viteve ‘90, popullsia e ardhur në territorin e komunës, u vendos fillimisht në banesa të tilla provizore, të cilat më pas u kthyen në shtëpi banimi me kushte optimale

Shohim qartë se shtëpitë individuale përbëjnë edhe llojin kryesor të ndërtesës në HPUSH me 4264 të tilla nga 4812 ndërtesa gjithsej; shtëpitë pjesërisht të veçuara kanë rolin e tyre të rëndësishëm me 391 të tilla; ndërkohë që bie në sy edhe një numër relativisht i vogël i pallateve, të cilët duhet thënë se janë ndërtuar kryesisht para vitit 1990 dhe gjenden më tepër në fshatin Dobraq, Shtoj i Ri, Grudë e Re dhe Bleran.

Nga totali i ndërtesave, 4555 prej tyre janë me një kat, 221 me dy kate, 30 kanë 3-5 kate dhe vetëm 6 ndërtesa kanë më shumë se 6 kate.

Pra duke bërë një përmbledhje të të dhënave të mësipërme në lidhje me gjendjen e banesave dhe strehimit në HPUSH, vëmë re se mbizotërojnë banesat me një ndërtesë (4291 të tilla), ku zakonisht jeton edhe një familje e vetme. Një gjë e tillë është e lidhur kryesisht me ndryshimet e ndodhura pas viteve '90, ku si rezultat i ndryshimeve social-ekonomike dhe politike dhe pronësisë së tokës, kemi copëtimin e familjes së madhe në familje individuale, të cilat gradualisht ndërtuan shtëpitë e tyre të reja në tokat që morën nga reforma agrare. Kjo vlen edhe për familjet e ardhura pas viteve '90, të cilat përgjithësisht ndërtuan shtëpi të reja individuale.


Megjithatë, jo të pakta janë edhe ndërtesat me dy banesa, konkretisht 413 të tilla, që tregojnë për shtëpi të ndërtuara me dy kate, ose dy hyrje, ku jetojnë nga 2 familje, zakonisht me lidhje farefisnore apo gjaku mes tyre. Ndërsa numri i ndërtesave që kanë më shumë se dy banesa është i pakët, gjithsej 108 të tilla, ku përgjithësisht bëjnë pjesë pallatet.

Një element i veçantë që ia vlen për t'u studiuar, në lidhje me gjendjen e strehimit dhe banesave në HPUSH, është edhe *periudha e ndërtimit* të tyre. Të dhënat në lidhje me këtë po i paraqesim në tabelën dhe grafikun e mësipërm dhe po i analizojmë më pas:

Tabela 13: *Ndërtesa për qëllime banimi sipas periudhës së ndërtimit në HPUSH*

<i>Gjithsej</i>	<i>Deri më 1960</i>	<i>1961-1980</i>	<i>1981-1990</i>	<i>1991-2000</i>	<i>2001-2005</i>	<i>2006-2011</i>	<i>Nuk dihet</i>
4812	146	390	379	1280	873	696	1048

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave 2011, Qarku Shkodër



Graf. 19.

Të dhënat e paraqitura më sipër na e bëjnë të qartë se pjesa më e madhe e ndërtesave dhe banesave në HPUSH janë ndërtuar pas viteve '90. Edhe nëse nuk marrim

paraysh numrin e lartë të ndërtesave ku banuesit e tyre nuk e dinë (ose nuk kanë dashur të përgjigjen) kohën e ndërtimit, prapë se prapë janë 2849 banesa zyrtarisht të ndërtuara në këtë periudhë, pra më shumë se gjysma e tyre. Megjithatë, ka mundësi që edhe një pjesë e mirë e ndërtesave të kategorisë “nuk e di”, të jenë ndërtuar pas vitit 1990, kryesisht nga popullsia e ardhur në HPUSH pas këtij viti, të cilët nga frika për shkak të mungesës së dokumentacioneve dhe mosdeklarimit për legalizim, janë përgjigjur në këtë mënyrë.

Vihet re se një numër i vogël i ndërtesave janë ndërtuar para v.1960, ndërkohë që ka një rritje të numrit të tyre në periudhën 1961-1990. Një gjë e tillë lidhet drejtpërdrejt me rritjen e numrit të popullsisë dhe numrin e familjeve; megjithatë mund të thuhet se numri i banesave të reja të ndërtuara në këtë periudhë, mund të kish qenë më i madh nëse do ekzistonin mundësitë ekonomike për ta bërë një gjë të tillë.

Ndërsa, rritja e jashtëzakonshme e numrit të ndërtesave të ndërtuara pas v.1990, lidhet pikërisht me rritjen e numrit të popullsisë në HPUSH, copëtimin e familjes së madhe dhe ndryshimin e strukturës së pronësisë së tokës gjatë kësaj periudhe.



Foto nr. 18: Pallatet e vjetra (Dobraç) dhe pallatet e reja që po ndërtohen në HPUSH, ngjitur me bashkinë (D.Rustja)

IV.3.2. Mënyra dhe niveli i jetesës¹⁷³

Mënyra dhe niveli i jetesës së banorëve të HPUSH, është shumë i lidhur me tiparet e zhvillimit të këtyre treguesve në shkallë rajonale dhe kombëtare. Kjo pasi vetë niveli i jetesës dhe mundësitë ekonomike të këtyre banorëve, varen shumë nga gjendja e përgjithshme social-ekonomike e vendit, si dhe nga konteksti lokal i rajonit të Shkodrës.


Një burim i rëndësishëm i të dhënave në këtë drejtim, janë treguesit e marrë nga dy rregjistrimet e përgjithshme të popullsisë dhe banesave, të vitit 2001 dhe 2011.

Kështu, nga të dhënat e Censurit 2011, në HPUSH ka gjithsej 4901 njësi ekonomike familjare, nga të cilat 371 NJEF pa bërthamë familjare, 3897 NJEF me një bërthamë familjare, 553 NJEF me dy bërthama familjare dhe 80 NJEF me bërthamë jo të vlefshme¹⁷⁴. Pra vihet re qartë se mbizotërojnë njësitë ekonomike me një bërthamë familjare.

¹⁷³ Të dhënat mbi treguesit social-ekonomik që trajtohen në këtë pjesë janë marrë nga burime zyrtare, kur ka qenë e mundur dhe nga kontakti i drejtpërdrejtë me banorët; megjithatë duhet theksuar se ato janë të mangëta dhe të pamjaftueshme për të bërë një trajtim plotësisht të saktë në këtë drejtim.

¹⁷⁴ INSTAT; *Censuri i popullsisë dhe banesave 2011 – Qarku Shkodër*, Tiranë 2012

Po ashtu, burimet e këtij censusi japin të dhëna të rëndësishme edhe mbi pajisjet elektro-shtëpiake që përdoren nga familjet e HPUSH, të cilat po i marrim në shqyrtim, në mungesë të të dhënave të tjera dhe po i paraqesim më poshtë:



Graf. 20: Gjendja e pajisjeve elektroshtëpiake të përdorura në HPUSH

Siç e shohim nga grafiku i mësipërm, televizori është pajisja elektroshtëpiake më e zakonshme që zotërojnë banorët në HPUSH, ku nga 4901 NJEF¹⁷⁵, 4567 familje janë të pajisura me TV; më pas vijnë frigoriferët (4424) dhe lavatriçet (3637). Pra vihet re se shumica e familjeve të HPUSH kanë pajisjet bazë elektroshtëpiake (TV dhe frigoriferë), por jo të gjitha prej tyre; lavatriçet nuk gjenden në gati 25% të NJEF të HPUSH, ndërkohë që më shumë se gjysma e tyre nuk kanë mundësinë për ta ngrohur ujin me boiler elektrik. Aksesit ndaj këtyre pajisjeve bazike mund të konsiderohet i domosdoshëm për zhvillimin normal të jetesës së një familjeje, dhe fakti që as gjysma e tyre nuk i kanë të gjitha, tregon se gjendja dhe niveli i jetesës së banorëve të HPUSH, nuk është i kënaqshëm. Nga ana tjetër, vetëm 929 familje të HPUSH janë të pajisura me automjet privat, kështu që këtë mjet mjaft të nevojshëm për jetën e sotme bashkëkohore, mund ta konsiderojmë si një luks që shumica e familjeve të kësaj zone nuk e kanë.

Një tregues interesant është edhe ai që tregon mënyrën e ngrohjes së ambienteve shtëpiake nga familjet e HPUSH: kështu nga të dhënat e censurit 2011, vihet re se 4643 familje ngrohen me dru, 34 me energji elektrike, 158 me gaz dhe 57 nuk kanë asnjë lloj ngrohjeje; ndërkohë vetëm 125 familje kanë kondicionerë në shtëpitë e tyre.

Sado që mund të ketë vend për pasaktësi të dhënash apo edhe ndryshim të tyre gjatë 3 viteve të fundit, të dhënat dhe treguesit e lartpërmendur japin një pamje deri diku realiste të mënyrës dhe nivelit të jetesës së banorëve të HPUSH, e cila, edhe nga diskutimet dhe intervistat e realizuara me ta, vihet re që nuk plotëson nevojat dhe kërkesat e tyre, pra lë për të dëshiruar¹⁷⁶.

¹⁷⁵ Njësi Ekonomike Familjare


¹⁷⁶ Dritan Rustja; *Intervista me personat kyç për çdo fshat*; shtator - nëntor 2013

IV.3.3. Punësimi (dhe papunësia)

Një tregues i rëndësishëm i gjendjes social-ekonomike të banorëve të HPUSH dhe mënyrës së tyre të jetesës është edhe ai i punësimit (dhe papunësisë). Duhet thënë që në fillim se edhe në lidhje me këtë tregues, të dhënat janë të mangëta, nga burime të ndryshme dhe nganjëherë edhe kontradiktore.

Sipas të dhënave të komunës¹⁷⁷, numri i përgjithshëm i të punësuarve shkon në 4787 persona, por kjo shifër është e ulët në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë. Shumica e tyre – 4613 persona, janë të punësuar në sektorin privat; kryesisht ky numër përbëhet nga të vetëpunësuarit në bujqësi¹⁷⁸, e megjithatë nuk është fort i besueshëm. Ndërsa sektori publik punëson shumë më pak persona sesa nevojat, 174 të tillë. Ka mangësi personeli në arsim, shëndetësi, shërbime komunale, etj. Duhet thënë se edhe në komunat fqinje që janë më të vogla sesa HPUSH, numri i të punësuarve në këtë sektor është thuajse i njëjtë, duke krijuar një raport jo të drejtë në këtë drejtim.

Sipas të dhënave të Censurit 2001^{179, 180} statusi i banorëve të HPUSH në lidhje me punësimin paraqitet i tillë: 4541 persona të punësuar, 1432 të papunë dhe 4430 joekonomikisht aktivë (nga gjithsej 15300 banorë). Sipas gjinisë kemi: 3203 të punësuar meshkuj dhe 1338 femra; 830 të papunë meshkuj dhe 602 femra; 1106 persona joekonomikisht aktivë meshkuj dhe 3324 të tillë femra. Më konkretisht këto të dhëna po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:



Graf. 21: Struktura e punësimit në HPUSH në v. 2001

Grafiku i mësipërm tregon sesi në sektorin e punësimit mbizotëron popullsia e gjinisë mashkullore, ndërkohë që të papunët ndahen gati në mënyrë të barabartë; gjithsesi edhe këtu mbizotëron popullsia mashkull. Fakti që edhe numri i të punësuarve të gjinisë femërore, edhe ai i të papunëve të kësaj gjinie nuk është shumë i lartë, të bën të besosh se shumica e popullsisë së aftë për punë të kësaj gjinie, gjendet në kategorinë “joekonomikisht aktive”, ku futen më tepër shtëpiaket, studentët, pensionistët në moshën e punës, të papunët që nuk kërkojnë punë dhe personat me aftësi të kufizuar.

¹⁷⁷ Të dhëna të marra nga zyrat e ndryshme të komunës “Rrethinat”, Shkodër – tetor 2013

¹⁷⁸ Studime të ndryshme, si dhe të dhënat nga terreni, tregojnë se jo të gjithë personat e konsideruar si të vetëpunësuar në sektorin bujqësor, janë realisht të angazhuar në këtë sektor

¹⁷⁹ Instat, *Popullsia e Shqipërisë*, Qarku Shkodër, Tiranë 2001

¹⁸⁰ Të dhënat mbi punësimin nga census i v. 2011 për këtë zonë, nuk disponohen

Tabela 14: *Struktura e punësimit sipas grupmoshave në HPUSH në v. 2001*

<i>Grupmosha</i>	<i>Të punësuar (Meshkuj)</i>	<i>Të papunë</i>
15-19	694 (419)	194
20-29	606 (402)	831
30-44	1643 (1423)	344
45-54	1243 (689)	58
55-64	329 (251)	5
>65	26 (19)	-

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave, 2001

Tabela e mësipërme na bën të kuptojmë sesi grupmosha 30-54 vjeç dhe veçanërisht ajo e gjinisë mashkull mbizotëron në zërin e të punësuarve në HPUSH.

Duhet thënë se këto të dhëna zyrtare janë të para 13 viteve dhe patjetër që nuk reflektojnë në mënyrë krejtësisht të saktë gjendjen e tregut të punës dhe strukturën e punësimit dhe papunësisë në HPUSH. Edhe pse nuk disponojmë të dhëna zyrtare më të vonshme, nga vëzhgimet e bëra në terren dhe intervistat e realizuara me personat kyç në komunë dhe për çdo fshat, vihet re se degët kryesore ekonomike ku janë të punësuar banorët e komunës Rrethinat janë:

- ✓ Të vetëpunësuarit në bujqësi që përfshijnë kryesisht moshat e mesme dhe të mëdha, mbi 4000 të tillë
- ✓ Të punësuarit në sektorin publik (arsim, shëndetësi, pushtet lokal, etj), që afërsisht llogaritet të jenë 175
- ✓ Të punësuarit në sektorin privat, sidomos në industrinë e fasonëve kryesisht vajza dhe gra të angazhuara me punë në fabrikat e këpucëve apo të rrobaqepësisë në qytetin e Shkodrës apo në aktivitete të tjera.
- ✓ Të punësuarit privat në sektorin terciar ku mund të përfshijmë kryesisht sektorin e ndërtimit dhe tregtisë
- ✓ Së fundi theksojmë faktin se një burim i rëndësishëm i punësimit dhe të ardhurave për banorët e HPUSH mbetet emigracioni, edhe pse siç e kemi theksuar, numri i tyre nuk dihet saktësisht.

IV.3.4. Shtresëzimi social dhe varfëria

Studimet e bëra në lidhje me varfërinë, tregojnë qartë sesi tiparet e saj kanë një shpërndarje hapsinore të caktuar, në shkallë kombëtare dhe rajonale. Siç dihet, Shqipëria është një ndër vendet më të varfra të Europës. Kjo varfëri, ndihmuar nga zhvillimi i pakontrolluar gjatë periudhës së tranzicionit, si dhe nga destabiliteti i përgjithshëm social-ekonomik dhe politik, kanë krijuar kushtet për rritjen e shpejtë të varfërisë në zonat periurbane¹⁸¹. Një gjë e tillë vihet re edhe në HPUSH.

Duhet thënë gjithashtu se kriteret që merren për matjen e varfërisë janë të ndryshme dhe për pasojë japin rezultate të ndryshme. Përmendim këtu dy llojet kryesore të varfërisë, atë absolute dhe relative. Kështu, varfëria absolute, ka të bëjë me “mungesën e kushteve bazë të jetesës, si ushqimit, ujit të pijshëm, strehimit, shërbimit shëndetsor dhe

¹⁸¹ Deda, L; Tsenkova, S; *Poverty and inequality in Greater Tirana: the reality of peri-urban areas*, Physica – Verlag, 2006, fq 151-173

arsimor, etj”. Kurse varfëria relative, ka të bëjë me “urinë, keqshqyerjen, aksesin e kufizuar në shërbimet bazike, strehimin e papërshtatshëm, mungesën e sigurisë, diskriminimin social dhe përjashtimin nga vendimarrja dhe jeta civile...”¹⁸².

Studimet e bëra në Shqipëri mbi varfërinë, sidomos në zonat periurbane, nuk janë të shumta, dhe janë realizuar në përgjithësi për hapësirën periurbane të Tiranës, kryesisht nga OJQ-të¹⁸³. Në këto studime, vihet re sesi zonat periurbane dhe kryesisht informale të Tiranës si Bathorja, të krijuara pas vitit 1990, kanë shenja të qarta të shprehjes së varfërisë ekstreme dhe mungesa të shumta infstrukturore (në arsim, shëndetësi, ujë të pijshëm, etj.). Ato tregojnë gjithashtu, sesi në hapësirat periurbane, njerëzit ndihen të braktisur nga shteti dhe të injoruar nga shoqëria, duke pasur pak shpresë për një jetë më të mirë¹⁸⁴.

Tiparet e lartpërmendura të varfërisë, absolute dhe relative, vihen re edhe në HPUSH. Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare në lidhje me varfërinë absolute të shprehura në terma financiar për këtë zonë (si psh. të ardhurat mesatare vjetore apo mujore për person), të dhënat e marra nga terreni¹⁸⁵ tregojnë qartë se jetesa është e vështirë për pjesën më të madhe të banorëve të zonës, dhe me shumë mundësi afër ose nën nivelin mesatar në shkallë rajonale dhe kombëtare. Burimet kryesore të të ardhurave për këta banorë janë bujqësia dhe blegtoaria, tregtia, ndërtimi dhe emigracioni. Ato gjithsesi janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat, nganjëherë edhe bazike, të popullsisë. Një gjë e tillë tregohet qartë edhe nga shifrat e larta të papunësisë, të paraqitura më sipër, apo edhe nga numri i konsiderueshëm i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike (rreth 23% e tyre).

Mund të thuhet se deri diku më e mirë paraqitet situata në lidhje me strehimin, ku shumica e shtëpive, siç e theksuam më sipër, janë ndërtuar apo riparuar pas v. 1990¹⁸⁶ dhe janë të një cilësie relativisht të mirë.

Ndërkohë, siç e kemi theksuar, mjaft problematike paraqitet gjendja në lidhje me furnizimin e popullsisë së HPUSH me ujë, ku gati 70% e banorëve nuk furnizohet në mënyrë të rregullt me të, nga strukturat shtetërore, duke u detyruar të gjejë zgjidhje alternative dhe personale.

Ndërkohë, aksesin në shërbimin shëndetsor dhe arsimor për pjesën më të madhe të banorëve të HPUSH është i pranueshëm, edhe pse jo i kënaqshëm.

Theksojmë faktin se nëse marrim parasysh kriteret që përkufizojnë varfërinë relative, të cilat i kemi përmendur më sipër, mund të themi se shumica dërrmuese e banorëve të zonës do e gjenin veten në njërën prej tyre; sidomos ndjesia e përjashtimit nga organet vendimarrëse dhe e braktisjes nga strukturat shtetërore, është dukshëm prezente dhe e vënë re thujse në të gjitha intervistat dhe bashkëbisedimet e realizuara ma banorët e HPUSH.

Shkaqet e varfërisë në këtë zonë janë të ndryshme, dhe shkojnë nga pozicioni gjeografik rajonal¹⁸⁷, tek papunësia, burimet e kufizuara të fitimit nga bujqësia dhe

¹⁸² Social Summit; World Conference for Social Development, Copenhagen 1995

¹⁸³ Dallohet këtu veçanërisht Co-PLAN ose Instituti për Zhvillimin e Habitatit

¹⁸⁴ PADCO; *Strategic plan for Greater Tirana –vol.I*; Urban Land Management Project, Washington 2002

¹⁸⁵ Dritan Rustja; *Intervista me personat kyç për çdo fshat*; shtator - nëntor 2013


¹⁸⁶ Ato janë ndërtuar kryesisht me kontributin e emigracionit, sidomos për popullsinë e ardhur në HPUSH pas v. 1990, dhe nëpërmjet kontributit financiar të përftuar sidomos nga shitja e tokës së marrë nga ligji 7501, për familjet më të hershme të zonës.

¹⁸⁷ Dihet se rajoni i Shkodrës dhe në vetvete zonat rurale të tij, janë ndër më të varftrat në Shqipëri

blegtoaria, copëzimi i tokës bujqësore dhe shkalla e ulët e mekanizimit të saj¹⁸⁸, mungesa e vëmendjes së strukturave shtetërore ndaj zonave periferike dhe periurbane, etj.

IV.3.5. Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike

Një ndër treguesit më të vlefshëm për matjen e nivelit të jetesës dhe varfërisë në Shqipëri dhe vetë HPUSH, është edhe numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike. Në muajin qershor 2013, ishin 1400 të tilla, nga një total prej 6044 familjesh që ka komuna¹⁸⁹. Pra, rreth 23% e familjeve të komunës mbështetet tek asistencën sociale për të mbijetuar. Më konkretisht, shpërndarjen e ndihmës ekonomike në HPUSH, po e paraqesim më poshtë:



Graf. 22: Shpërndarja e ndihmës ekonomike sipas fshatrave në HPUSH (v. 2013)

Duke parë edhe grafikun e mësipërm, vihet re se numri më i madh i familjeve përfituese gjendet në fshatrat Grudë e Re, Bleran, Dobraç, Golem dhe Hot i Ri; një gjë e tillë është e lidhur edhe me numrin e familjeve, dhe duke bërë një lidhje mes tyre mund të dallojmë Bleranin, Shtojin e Vjetër dhe Grudën e Re, si fshatrat me përqendrimin më të madh të përfituesve të ndihmës ekonomike në HPUSH. Një gjë e tillë mund të jetë një tregues që flet edhe për përqendrimin e varfërisë në HPUSH, megjithëse duhet të jemi të ndërgjegjshëm se këtu ndërhyjnë edhe faktorë të tjerë subjektiv. Në raport me vitin 2008, vëmë re se ka një rritje prej gati 500 familjesh përfituese për të gjithë komunën, një rritje e konsiderueshme kjo, e cila mund të flasë deri diku edhe për mosndryshimin apo përqendrimin e gjendjes ekonomike në HPUSH. Duhet thënë se të gjitha familjet trajtohen me ndihmë ekonomike të pjesshme, vlera e së cilës është rreth 3000 lekë.

¹⁸⁸ Selman Sheme, Sabri Laçi; Seminari ndërkombëtar “Shkodra në shekuj, 2002, fq. 225-239

¹⁸⁹ Të dhënat janë marrë në Zyrën e Ndihmës Ekonomike të komunës Rrethinat, shtator 2013

Masën kryesore të familjeve që e përfitojnë këtë ndihmë e përbëjnë familjet me të ardhura të pakta, të cilat nuk kanë burime të tjera të ardhurash apo persona formalisht të punësuar në sektorin publik apo privat. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre familjeve vijnë nga popullsia e ardhur në territorin e komunës pas viteve '90. Gjithashtu, ekziston edhe një kategori tjetër përfituesish që janë personat me aftësi të kufizuar (invalidë, të verbër, etj); të cilët në terësi për të gjithë komunën mund të jenë rreth 130. Rreth 100 familje përfituese janë nga ato që kanë kryefamiljare gra; dhe rreth 25 janë familje që kanë në përbërje të tyre jetim. Gjithsesi duhet të jemi të ndërgjegjshëm se me atë vlerë monetare që merret, mbijetesa do të ishte thuajse e pamundur; një gjë e tillë të bën të besosh se numri i familjeve që vërtet kanë nevojë për këtë mbështetje financiare duhet të jetë më i vogël. Nga të dhënat e marra në terren si dhe nga intervistat e kryera me personat kyç dhe banorët e zonës, kuptohet qartë se me shpërndarjen e ndihmës ekonomike në HPUSH është abuzuar gjatë gjithë këtyre viteve dhe vazhdon të abuzohet, duke bërë që përfitues të saj të jenë familje që nuk kanë nevojë, madje në disa raste edhe familje me të ardhura të larta. Një gjë e tillë bëhet kryesisht për qëllime përfitimi ekonomik apo edhe politik (elektoral), ose thjesht nga mungesa e kontrollit dhe zbatimit të ligjit.

IV.3.6. Personat me aftësi të kufizuar


Siç e përmendëm edhe më sipër, ndër familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike, janë edhe ato që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuar. Sipas të dhënave që zotërojmë, gjendja dhe gjinia e personave me aftësi të kufizuar në HPUSH, paraqitet si më poshtë:

Tabela 15: *Gjendja dhe gjinia e personave me aftësi të kufizuar në HPUSH:*

<i>Persona me aftësi të kufizuar</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
1258	572	686

Burimi: Censusi i popullsisë dhe banesave 2011, Qarku Shkodër

Siç e shohim, numri i personave me aftësi të kufizuar në HPUSH paraqitet i konsiderueshëm, ndërsa lloji i aftësisë së kufizuar, paraqitet në grafikun e mëposhtëm, ku shohim se janë 433 persona që kanë kufizim në dëgjim, 306 në dëgjim, 786 në ecje, 336 në kujtesë, 385 në kujdesin ndaj vetes dhe 271 në komunikim. Ky numër në fakt, nuk përputhet me numrin e personave me aftësi të kufizuar që marrin ndihmë ekonomike në HPUSH (rreth 130), gjë e cila lë vend për diskutime në lidhje me faktin se sa i vërtetë është ai, ose nëse ata ndihmohen në masën e duhur.



Graf. 23: Lloji i aftësisë së kufizuar në HPUSH

IV.3.7. Pensionistët

Numri i personave që përfitojnë pension në HPUSH është mbi 5000¹⁹⁰. Edhe pse shumica e tyre merr pensionin minimal, duhet thënë se ai gjithsesi përbën një burim të rëndësishëm të ardhurash për një pjesë të konsiderueshme të familjeve dhe banorëve të zonës. Kjo edhe për shkak të varfërisë që e karakterizon atë. Kështu, nga vëzhgimet e kryera në terren në fshatin Golem, vihet re se për rreth 30% të familjeve, burimi kryesor zyrtar i të ardhurave, janë pensionet.

Nga intervistat e kryera me personat kyç dhe banorët e zonës - pensionistë, vihet re qartë pakënaqësia e tyre në lidhje me shpërblimin e mundit dhe djersës shumëvjeçare të tyre dhe pamundësia e përballimit të një jetese normale me pensionin që përfitojnë. Shumica e tyre shprehen, se nëse nuk do të kishin mbështetje të tjera financiare (kryesisht remitanat nga fëmijët në emigrim), kostoja e jetesës për ta do të ishte thuajse e pamundur¹⁹¹.

¹⁹⁰ Të dhëna të marra nga specialisti – shpërndarës i pensioneve në HPUSH, dega Dobraq - Shkodër

¹⁹¹ Dritan Rustja; *Intervista me personat kyç dhe banorët e HPUSH*, tetor 2013

IV.3.8. Qeverisja vendore

Një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punëve në një njësi të caktuar administrative, ka edhe qeverisja e saj. Përsa i takon *pushtetit lokal në* komunën Rrethinat, ai ushtrohet nëpërmjet strukturave përkatëse qeverisëse, ku përmendim së pari kryetarin e komunës dhe këshillin e komunës, të cilët zgjidhen nga banorët, nëpërmjet zgjedhjeve vendore.

Në këtë drejtim, mund të themi se dy partitë kryesore politike në vend, e kanë zëvendësuar njëra - tjetrën në drejtimin e komunës gjatë këtyre 23 viteve; duke shprehur në një farë mënyre edhe ndarjen pak a shumë të barabartë të elektoratit përsa i takon orientimit dhe përkrahjes politike, megjithëse duhet thënë se në dy zgjedhjet e fundit vendore, drejtimi i komunës është fituar nga të majtët.

Tabela 16: *Struktura organizative e komunës Rrethinat*




Tabela e mësipërme na ndihmon për të kuptuar më mirë, *strukturën organizative të qeverisjes së HPUSH*¹⁹². Më konkretisht, ajo përbëhet nga këta sektorë:

- a) Staf i politik dhe ekzekutiv, i përbërë nga: kryetari, nënkryetari dhe sekretari i këshillit të komunës, si dhe nga kabineti i kryetarit (sekretari, juristi dhe zëdhënësi i tij)
- b) Drejtoria ekonomike, që përbëhet nga sektori i financës dhe të ardhurave, ka si qëllim menaxhimin dhe administrimin e të ardhurave të komunës; ndërsa sektori i ndihmës ekonomike dhe sociale, merret me përcaktimin dhe shpërndarjen e ndihmës ekonomike për familjet e varfra dhe personat në nevojë.
- c) Sektori i urbanistikës, luan një rol të rëndësishëm në strukturën qeverisëse të komunës Rrethinat. Përbëhet nga përgjegjësi i zyrës së urbanistikës, inspektoriati ndërtimor dhe ai kadastral.

¹⁹² Të dhënat janë marrë nga vetë komuna Rrethinat, tetor 2013

- d) Drejtoria e shërbimeve dhe infrastrukturës merret me administrimin e shërbimeve publike dhe administrative për komunën. Ajo ka në përbërje të saj punonjës që merren edhe me menaxhimin e mbetjeve urbane si dhe me mirëmbajtjen e varrezave dhe rrugëve.
- e) Sektori i policisë së komunës, është një tjetër element përbërës i strukturës organizative të saj, me 5 punonjës.
- f) Së fundi përmendim faktin se komuna ka në përbërje të saj edhe punonjës me kontratë, për shërbime të ndryshme të përkohshme.

Në tërësi, janë 52 punonjës me kohë të plotë, që janë pjesë e strukturës organizative dhe qeverisëse të komunës Rrethinat, dhe që paguhen sipas nivelit përkatës të punës dhe pagës. Ndërkohë janë edhe rreth 30 punonjës me kontratë, që marrin pagesë të pjeshme (roje shkolle, sanitare, etj), si dhe 25 këshilltarë dhe 10 kryepleq.

Edhe pse në pamje të parë kjo strukturë organizative edhe qeverisëse e komunës duket e plotë, me një numër të konsiderueshëm punonjësish duke mbuluar gjithë sektorët kryesorë; duhet thënë se efikasiteti i saj dhe impakti i tyre në komunitet duhet të jetë më cilësor.



Foto nr. 19: Ndërtesa administrative e komunës Rrethinat (D.Rustja)

b) Përsa i takon *buxhetit*, vihet re se pjesa më e madhe e të ardhurave vjetore të komunës Rrethinat vjen nga granti i buxhetit të shtetit, nga fondet e kushtëzuara të ministrive, por edhe nga vetë të ardhurat që përfiton komuna nga taksat dhe tatimet e ndryshme të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e saj, të cilat siç e kemi thënë janë të konsiderueshme. Vlen për tu theksuar se zëri “investime të huaja” është thujse zero, gjë që flet për nivelin e ulët të veprimit të OJF¹⁹³-ve dhe bashkëpunimit të tyre me strukturat drejtuese të komunës dhe komunitetin.

¹⁹³ Organizatë Jo-Fitimprurëse

Pjesa më e madhe e shpërndarjes së të ardhurave janë shpenzime për administratën e konsiderueshme që ka komuna (që i përmendëm më sipër), e më pas vijnë shpenzimet për shërbimet publike, arsimin, shëndetësinë, gjendjen civile, ndihmën sociale, etj. Për pasojë, vetëm një pjesë relativisht e vogël mbetet për investimet e nevojshme dhe të shumta që ka nevojë HPUSH me një popullsi të madhe dhe problematika të larmishme.

Pavarësisht se nuk kanë munguar investimet gjatë këtyre 23 viteve, të cilat ne i kemi përmendur më lart, vihet re qartë se roli dhe ndikimi i *qeverisjes vendore në komunitet, si dhe marrëdhëniet mes komunitetit dhe qeverisjes lokale*, kanë nevojë për t'u përmirësuar dukshëm. Nga ana e komunës dhe strukturave qeverisëse të saj, nevojitet një transparencë më e madhe me publikun mbi përfitimin e të ardhurave dhe sidomos mbi mënyrën e shpenzimit të tyre; ndërkohë që edhe vetë komuniteti duhet të jetë më i përgjegjshëm për rolin që ka dhe që duhet të luajë në mirëqeverisjen e komunës.

Kapitulli i pestë

PËRDORIMI I HAPËSIRËS, RREGULLIMI I TERRITORIT DHE PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

V.1. Përdorimi i hapësirës në HPUSH

Përdorimi i hapësirës, është një koncept shumë i gjerë, që gjithsesi në thelb ka të bëjë me mënyrat kryesore sesi përdoret hapësira (toka) në një vend të caktuar¹⁹⁴. Ai ndikohet nga një sërë faktorësh, ku rolin kryesor e luan veprimtaria njerëzore, e cila në përgjithësi e modifikon dhe ndryshon atë duke ia përshtatur kërkesave dhe nevojave të veta.

Edhe në HPUSH, përdorimi i territorit ka evoluar në kohë, në varësi të historisë së popullimit të saj, rritjes demografike dhe zgjerimit të vendbanimeve, si dhe ndikimit të faktorëve të tjerë social-ekonomik dhe politik.

Në studimin e përdorimit të territorit në HPUSH, ne kemi marrë në konsideratë dy periudha kohore të ndryshme: v.1985 dhe v.2013, duke evidentuar mënyrën e përdorimit të tokës në secilën prej tyre, por paralelisht duke bërë edhe një krahasim të transformimeve të ndodhura në këtë drejtim, gjatë 28 viteve që i ndajnë. Duhet thënë se kjo është edhe periudha e ndryshimeve më të mëdha social-ekonomike dhe demografike për këtë hapësirë dhe vendin tonë, gjë që padyshim është reflektuar edhe në përdorimin e territorit.

Për të realizuar një gjë të tillë:

a) është përdorur harta topografike e v. 1985 për të njohur dhe realizuar përdorimin e territorit në këtë vit

b) është përdorur harta ortofoto e v. 2006 dhe imazhet satelitore te sotme (nga Google Maps), si dhe të dhëna të marra nga terreni, për të njohur dhe realizuar përdorimin e tokës së HPUSH në v. 2013

Bazuar në të dhënat e mësipërme janë ndërtuar hartat e përdorimit të tokës për v. 1985 dhe 2013 duke përdorur SIG-un (Sistemin e Informacionit Gjeografik); si dhe harta e krahasimit mes tyre, për të evidentuar dallimet kryesore në përdorimin e tokës në këtë zonë mes viteve 1985 dhe 2013.

V.1.1.Transformimet hapsinore të HPUSH

V.1.1.1 Përdorimi i territorit në HPUSH në v.1985.

Në v.1985, kjo zonë kishte rreth 10 000 banorë¹⁹⁵. Fshatrat që e përbëjnë atë sot gjendeshin në njësi të ndryshme të organizimit administrativ të asaj periudhe, më konkretisht:

a) Blerani, Gruda e Re, Gucia e Re, Hoti i Ri dhe Shtoji i Ri, ishin pjesë e NB “Perlat Rexhepi”,

b) Dobraqi dhe Golemi ishin pjesë e NB Dobraq (Instituti i Misrit dhe Orizit)


¹⁹⁴ Philip R. Berke et al. “*Urban Land Use Planning, 5th edition*”, University of Illinois Press Urbana and Chicago, 2006

¹⁹⁵ Zyra e Statistikave të INSTAT, Shkodër – tetor 2013

- c) Shtoji i Vjetër ishte pjesë e NB Grilë - Malësi e Madhe
- d) Bardhajt - pjesë e NB Mes (Postribë)
- e) Zuesi, pjesë e NB Oblikë

Vihet re se në v. 1985 vendbanimet dhe ndërtesat ishin të përqendruara, duke lënë mjaft hapësirë për shfrytëzimin e tokës në mënyra të tjera ku dallojmë:


- a) *tokën arë*, në pjesën më të madhe të fushës së Dobraçit dhe deri diku asaj të Shtoit (e kultivuar veçanërisht me drithra – grurë dhe misër, por dhe oriz);
- b) *vreshtarinë dhe frutikulturën*, ku përmendet NB P. Rexhepi e cila u specializua në këtë drejtim, kryesisht në fushën e e Shtoit;
- c) *ullishtet*, për kultivimin e të cilave dalloheshin veçanërisht fshatrat Bardhaj dhe Zues;
- d) *zona pyjore dhe kënetore* pranë liqenit të Shkodrës;
- e) *pyjet e pishës*, karakteristikë për zonën kodrinore të Bleranit e më pak në Zues;
- f) *zona zallishtore dhe shkurrore* përgjatë luginës së Kirit;
- g) *stacioni i pompave* të Dobraçit dhe ish - *fusha e aviacionit*, mes fshatrave Hot i Ri dhe Grudë e Re.



Harta 12: Përdorimi i territorit në HPUSH në v. 1985

V.1.1.2. Përdorimi i territorit në HPUSH në v. 2013

Në v. 1990, në prag të ndryshimeve të mëdha politike dhe social-ekonomike në shkallë vendi, gjendja e përdorimit të tokës në HPUSH, ishte pak a shumë si ajo më sipër. Mirëpo, gjatë 23 viteve në vazhdim, në këtë njësi administrative që u krijua në v. 1992, situata ndryshoi në mënyrë rrënjësore. Shkaqet kryesore qenë: prurjet e mëdha demografike (ardhja e popullsisë nga zonat malore dhe rurale), ndryshimi i pronësisë së tokës¹⁹⁶, liria e rifituar dhe apatia e shtetit, etj. Si rezultat zona u përfshi nga një urbanizim i shpejtë dhe kaotik.



Harta 13: Përdorimi i territorit në HPUSH në v. 2013

¹⁹⁶ Bazuar në ligjin 7501, toka iu dha në përdorim punëtorëve të ish-fermave bujqësore; mirëpo ata e shpërdoruan këtë të drejtë duke ndërtuar shtëpitë e tyre të reja në këto toka, si dhe duke ua shitur atë banorëve të ardhur

Nga harta e mësipërme kuptojmë zgjerimin e konsiderueshëm që ka pësuar sipërfaqja e banuar në HPUSH në raport me v. 1985, duke përbërë një ndër format kryesore të përdorimit të tokës sot. Toka arë e mbetur në dispozicion është shumë e copëzuar dhe ka ndryshuar deri diku strukturën e saj të përdorimit (ka rritje të sipërfaqes së mbjellë me foragjere, perime dhe zarzavate, patate, etj).

Sipërfaqja e dikurshme e mbjellë me vreshta dhe drufrutorë, gjithashtu është prekur nga urbanizimi dhe copëzimi. Zona pyjore dhe kënetore pranë liqenit mund të thuhet se ka pësuar një zgjerim të saj, në dëm të tokës së dikurshme bujqësore, për shkak të moskujdesit dhe lënies djerrë të kësaj të fundit. Ullishtet e dikurshme të Zuesit dhe Bardhajve, ruhen deri diku, por nuk mirëmbahen më. Pyjet me pishë në kodrat e Bleranit dhe Zuesit, janë zvogëluar në sipërfaqe dhe dëmtuar; kurse përgjatë luginës së Kirit, mbizotëron zona zallishtore e dikurshme, që gradualisht po kthehet edhe në një vendgrumbullim jo të ligjshëm mbeturinash për HPUSH dhe qytetin e Shkodrës.

Vëmë re se zërin kryesor vazhdon ta përbëjë toka bujqësore, si dhe rolin e rëndësishëm që luan toka urbane dhe sipërfaqja e zënë me vendbanime informale të krijuara pas v.1990. Në shumicën e rasteve, këto vendbanime informale janë krijuar në territorin e ish-NB, që gjendeshin në afërsi të qyteteve kryesore të Shqipërisë¹⁹⁷; ose duke blerë tokë bujqësore për ndërtim nga pronarët që e morën atë sipas ligjit, ose duke zaptuar tokë bujqësore dhe jobujqësore. Një gjë e tillë është karakteristike edhe për HPUSH.


V.1.1.3. Ndryshimi i përdorimit të territorit në HPUSH për periudhën 1985-2013

Harta e mëposhtme na jep një pamje të përgjithshme dhe më konkrete të ndryshimeve të ndodhura në përdorimin e tokës në HPUSH gjatë periudhës 1985-2013. Vihet re qartë zgjerimi i konsiderueshëm i vendbanimeve ekzistuese dhe krijimi i vendbanimeve të reja, zgjerim i cili është bërë në mënyre kaotike dhe pa një plan rregullues, si rezultat i urbanizimit spontan; ku rezultojnë gjithsej 2397 ndërtesa të vetëdeklaruar për legalizim të ndërtuara në 9 zona informale me një sip. 700 ha¹⁹⁸. Një zgjerim i tillë ka ndodhur sidomos në dëm të tokës së dikurshme bujqësore që ishte pjesë e N.B Dobraç dhe Perlat Rexhepi.

Fshatrat që kanë pësuar ndryshimet më të mëdha janë Dobraçi, Golemi, Gruda e Re, Shtoji i Ri. Zonat kryesore të prekura nga ndryshimet janë fusha e Shtoit, Dobraçit dhe Bardhajve, ku toka bujqësore në një masë të madhe është kthyer në troje ndërtimi për vendbanimet informale.

¹⁹⁷ Haxhi Aliko dhe Romeo Sherko: *Rregullimi ligjor i vendbanimeve joformale në Shqipëri në Urbanistika në ekonominë e tregut*, ed. Kenneth K.Baar dhe Dorina Pojani, Dita 2000, Tiranë 2004, fq 407-421

¹⁹⁸ Të dhënat janë marrë në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, dega Shkodër – tetor 2013



Harta 14: Ndryshimet kryesore në përdorimin e territorit në HPUSH, në v.1985-2013

V.2. Rregullimi i territorit në HPUSH

V.2.1. Nevoja për rregullimin e territorit në HPUSH

Nga gjithçka trajtuam më sipër, kuptohet se zhvillimi informal dhe kaotik urban është një ndër sfidat kryesore me të cilat përballet zhvillimi i territorit në HPUSH sot. Prandaj rregullimi i territorit, përmirësimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i problemeve mjedisore, mbeten nevojat kryesore aktuale për të. Duket qartë që kjo zonë ka nevojë për hartimin dhe implementimin e një plani rregullues (ose të përgjithshëm vendor) për të orientuar politikatat e zhvillimit territorial në të ardhmen, i cili aktualisht mungon¹⁹⁹.

Në kuadër të Planit të Përgjithshëm Rregullues do të gjenin zgjidhje këto probleme themelore të hapësirës periurbane të Shkodrës, sot:

1. *Përcaktimi i identitetit: rurale, urbane, periurbane?!* Transformimet e gjithanshme hapsinore gjatë dy dekadave të fundit, kanë sjellë ndryshime drastike në përdorimin e territorit. Një zonë relativisht e gjerë afër vijës së verdhë të qytetit, vuan mungesën e identitetit, pasi paraqet dendësi të lartë banimi, sipërfaqe të pakët bujqësore dhe fragmentizim të saj, zhvillim të vrullshëm të sferës së shërbimeve dhe veprimtarive ekonomike jobujqësore, domethënë më shumë karakteristika të hapësirës urbane sesa asaj

¹⁹⁹ Të paktën deri në kohën e realizimit të këtij studimi

rurale. Nga ana tjetër, këto tipare nuk janë aq të zhvilluara sa për ta njësuar me hapësirën urbane.

Madje, për sa kohë toka do të klasifikohet si *bujqësore*, do jetë shumë e vështirë të menaxhohet në mënyrë efikase nga pushteti vendor dhe komuniteti. Pra, del i nevojshëm *rivlerësimi administrativ* i territorit dhe përcaktimi i identitetit.

2. *Formalizimi i zhvillimit informal*. Numri i kërkesave të paraqitura pranë strukturave përkatëse për legalizimin e *banesave* nga banorët e komunës Rrethinat është 2397, duke e renditur atë të dytën në rang qarku, pas bashkisë Shkodër. Ndërtimet informale pas vitit 1990 kanë krijuar konflikte të shumta sociale dhe ligjore, sidomos në lidhje me pronësinë e tokës. Informaliteti shfaqet edhe në aspektin *demografik*, pasi ka mospërputhje të të dhënave në këtë drejtim, duke mos pasur një shifër të saktë mbi numrin real të popullsisë në komunë. Po ashtu, shqetësues paraqitet ai edhe në *ekonomi*, sidomos në sektorin e shërbimeve, ku shumë biznese dhe punonjës janë të pargjistruar dhe veprojnë jashtë sektorit formal. Sfida e legalizimit të banesave, popullsisë, shërbimeve dhe veprimtarive ekonomike mbetet parësore.

3. *Kompletimi dhe modernizimi i infrastrukturës*. Zhvillimeve të vrullshme hapësinore nuk u janë përgjigjur me të njëjtën dinamikë investimet në infrastrukturë, që janë përqendruar kryesisht në përmirësimin e sistemit rrugor dhe deri diku infrastrukturës arsimore dhe shëndetsore, duke lënë jashtë vëmendjes kanalizimet e ujërave të bardha e të zeza, menaxhimin e mbetjeve urbane dhe komunale, furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike.

Një vend të rëndësishëm në këtë drejtim zë edhe domosdoshmëria e rigjallërimit të jetës social-kulturore të banorëve të HPUSH, e cila aktualisht është shumë e zbehtë për shkak të mungesës së objekteve dhe investimeve në këtë drejtim.

4. *Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe kullotave*, si rezultat i ndryshimeve dhe zhvillimeve të lartpërmendura, është një çështje shumë e rëndësishme për HPUSH në ditët e sotme. Gjatë 20 viteve të fundit ka pasur shumë ndërhyrje negative në këtë drejtim, duke sjellë si rezultat copëzimin dhe degradimin e tokës bujqësore, shtimin e erozionit dhe deri shenja të dezertifikimit të saj. Po ashtu, është rishfaqur kërcënimi nga rrisqet natyrore, sidomos përmbytjet për shkak të urbanizimit por edhe shpyllëzimit.

V.2.2. Kuadri ligjor i rregullimit të territorit në vendin tonë dhe për rastin e HPUSH

Duke qenë se planifikimi si proces është shumëdimensional dhe ndërdisiplinor dhe zhvillimi i territorit ndërthur interesa ekonomike, me aspekte sociale dhe mjedisore, terësia e legjislacionit në lidhje me rregullimin e territorit në vendin tonë, është e gjerë. Ne po shqyrtojmë më poshtë ata më të rëndësishmit, që vlejné edhe për rastin e HPUSH.

I. Aktualisht, ligji bazë që orienton dhe rregullon planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Shqipëri, është ligji nr. 10119, datë 23.04.2009, "*Për planifikimin e territorit*", i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi me efekt të plotë më 30 Shtator 2011, bashkë me aktet nënligjore të tij²⁰⁰. Ky ligj përpiqet të reflektojë ndryshimet e thella social-ekonomike të Shqipërisë gjatë 20 viteve të fundit²⁰¹.

²⁰⁰ Të paktën deri në kohën e realizimit të këtij studimi

²⁰¹ AKPT (Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit): "*Manual teknik i planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Shqipëri*", Tiranë 2011

Sipas këtij ligji, hartimi dhe miratimi i PPV-ve²⁰², është detyrim ligjor për çdo njësi vendore. Instrumentat e planifikimit në nivel vendor janë:

- Politika e Përgjithshme për Zhvillimin e Territorit të Njësisë Vendore (PZhTNjV)
- Plani i Përgjithshëm Vendor
- Rregullorja e planifikimit për PPV

Për të hartuar një PPV, duhet miratuar së pari PZhTNjV-ja për territorin përkatës. Nisma për hartimin e PPV-së merret nga kryetari i njësisë vendore dhe miratohet nga këshilli i saj. Ai hartohet nga Autoriteti Vendor i Planifikimit të Territorit, ose nga subjekte të tjera të kontraktuara për këtë qëllim, kalon në dëgjim publik dhe miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

• *Përmbajtja e PPV-së*

Në vija të përgjithshme, PPV-ja përmban të dhëna të ndryshme mbi njësinë vendore përkatëse (duke bërë fillimisht një mbledhje të informacionit dhe analizë të gjendjes ekzistuese të saj), si:

- a) Madhësinë e territorit dhe të popullsisë së saj
- b) Veçoritë fizike, natyrore dhe gjeografike të territorit
- c) Nivelin, llojin dhe sasinë e aktiviteteve ekonomike
- d) Tiparet e zhvillimit të territorit të saj
- e) Nivelin, llojin dhe cilësinë e infrastrukturës ekzistuese
- f) Informacione të tjera të disponueshme dhe të vlefshme për hartimin e PPV-së

1. Për hartimin e çdo Plani të Përgjithshëm Vendor, është e nevojshme që fillimisht të përcaktohen *zonat e rëndësisë kombëtare* (zona të mbrojtura të trashëgimisë natyrore apo kulturore, hidrocentrale, miniera, porte, aeroporte, etj), të cilat nuk janë subjekt planifikimi.

2. Analiza e *problematikës së pronësisë mbi tokën*, është një tjetër çështje me karakter themelor në hartimin e PPV-së. Duhet të ekzistojë një hartë e pronave për njësinë vendore²⁰³, e cila duhet të ketë të dhëna mbi sipërfaqet e çdo prone (parcelë apo ndërtesë), pronarët e tyre, ndarjen pronë publike dhe private, konfliktet e mundshme të pronësisë, etj.

3. Duhet përcaktuar zonat që kanë nevojë për *riparim, rigjenerim, rihvillim apo edhe konservim*, brenda njësisë vendore. Përcaktimi i këtyre zonave bazohet në analiza të problemeve të degradimit social-ekonomik dhe mjedisor, ku përfshihen edhe zonat urbane periferike dhe jo të integruara.

4. Njohja e *tipologjisë hapsinore* së zonës ku do realizohet planifikimi, përbën një moment tjetër kyç; ku dallojmë llojin e përdorimit të hapësirës, ndërtesave, sistemit rrugor dhe hapësirave publike, intensitetit të ndërtimit dhe densitetit.

5. *Analiza e elementëve të fortë territoriale*: si psh, një përrua apo lumë që e ndan dhe kufizon zonën së cilës do i hartohet PPV-ja, me zonat e tjera, një kodër apo një mal,

²⁰² PPV - Plani i Përgjithshëm Vendor

²⁰³ Hartë kadastrale nga ZRPP – Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

një aks rrugor i rëndësishëm, etj. Arsyet pse identifikohen këta elementë, është sepse ata përbëjnë pika të forta mbështetëse për planifikimin e zhvillimit të zonës.

6. Territori administrativ që i nënshtrohet PPV-së, rekomandohet të ndahet në *njësi strukturore* (zona më të vogla) bazuar në kritere të caktuara, dhe nëse është e nevojshme edhe në nënjësi strukturore. Pastaj përcaktohet se cila prej tyre do i nënshtrohet PDV-ve (Planeve të Detajuara Vendore), që zakonisht janë zona me prioritet zhvillimi.

7. Pjesë integrale e PPV-së janë edhe TDZH – *Transferimi i të Drejtës së Zhvillimit*, programe zhvillimi që mund të aplikohen psh. në zonat urbane ku ka presion zhvillimi, por ku densiteti i zhvillimit nuk është shumë i lartë, pra ka ende hapësirë për zhvillim. Në këtë zona mund të transferohet psh. intensitet banimi (sipërfaqe e ndërtuar) vetëm për qëllime banimi – nga zona të tjera ku presioni i zhvillimit është më i vogël. Nëse vendoset që të realizohet një TDZH, duhen përcaktuar zonat dhënëse (ato që duhen ruajtur) dhe marrëse (ato nënjësi strukturore apo zona me prioritet zhvillimi).

8. *Zonimi i territorit*. Kur hartohet një PPV dhe rregullorja përkatëse e tij, duhet bërë zonimi i territorit, sipas kategorive bazë të përdorimit të tokës. Zonimi i territorit ka si qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, përmes garantimit të mjedisit të pastër, shëndetit publik, sigurisë dhe mundësive të zhvillimit social-ekonomik.

Sipas ligjit të planifikimit të territorit, kemi përdorime të lejuara, të kushtëzuara dhe të ndaluara të tokës dhe 4 sisteme territoriale bazë: urban, natyror, bujqësor dhe të urbanizueshëm (territore që pritet të urbanizohen në 10 vitet e ardhshme). Këto sisteme përbëhen nga 8 kategori bazë të përdorimit të tokës, që janë:

- a) *Banim* – përfshin të gjithë ato zhvillime të lejuara që bëhen për qëllime banimi
- b) *Industri* – përfshin përdorimin e tokës për parqe industriale, fabrika, zona për nxjerrje dhe përpunim materialesh ndërtimi, etj.
- c) *Bujqësi* – përfshin zonat bujqësore të kultivuara ose jo të kultivuara, infrastrukturën e kullimit dhe vaditjes së tokës, etj.
- d) *Shërbime* – përfshin strukturat dhe rrjetet e sistemit të transportit rrugor, hekurudhor, ujit të pijshëm, ujërave të zeza, menaxhimit të mbetjeve urbane, furnizimit me energji; strukturat dhe territoret e përshtatura për arsimin dhe shëndetësinë, institucionet publike, shërbimet tregtare, hapësirat publike (parqe, lulishte, fusha sportive), si dhe zona hoteliere dhe pushimi.
- e) *Përdorime të veçanta* – përfshin përdorimin e tokës për struktura publike si hidrocentrale, nënstacione elektrike, ujësjellës, landfille, varreza, etj.
- f) *Natyrore* – përfshin zonat natyrore si lumenjtë, pyjet, kullotat dhe livadhet, zonat natyrore të mbrojtura, tokat e pafrytshme.
- g) *Monumente kulturore dhe historike* – përfshin zonat arkeologjike, zonat muze, monumentet e kulturës, etj.
- h) *Zona ushtarake* – përfshin përdorimin e tokës për qëllime dhe struktura ushtarake.

II. Një tjetër ligj i rëndësishëm që ia vlen për t'u përmendur në rastin tonë, është ligji nr. 9482, datë 3.04.2006 “*Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje*”. Ky ligj u miratua me qëllim legalizimin e vendbanimeve informale që u krijuan në Shqipëri pas vitit 1990 dhe futjen e tyre në rrjellat e ligjshmërisë dhe zhvillimit; gjë që vlen edhe për HPUSH, e cila siç e kemi përmendur disa herë më lart, është prekur shumë nga urbanizimi dhe informaliteti pas vitit 1990. Proçedurat kryesore të procesit të legalizimit, sipas këtij ligji janë²⁰⁴:

- a) *Legalizimi* – dhënia e titujve të pronësisë për tokën dhe ndërtesat; banorët do duhet të paguajnë një pagesë fikse për tokën që kanë zënë
- b) *Kompensimi* – shuma financiare e grumbulluar do mblihet nga agjensia e legalizimeve – ALUIZNI, dhe do përdoret për kompensimin e ish-pronarëve (tokat e të cilëve janë zënë nga ndërtesat informale); një pjesë e tyre do shkojë edhe për urbanizimin e zonave informale
- c) *Urbanizimi* – ka të bëjë me sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe rregullimin e territorit të vendbanimeve informale; dhe do ndodhë pas përfundimit të procesit të legalizimeve.

V.2.3. Rregullimi i territorit të HPUSH në kontekstin rajonal

HPUSH, të cilën ne e kemi njësuar si emërtim me njësinë administrative të komunës “Rrethinat”, nuk mund të zhvillohet e shkëputur dhe në mënyrë të pavarur nga konteksti dhe hapësira më e gjerë që e rrethon. Edhe në aspektin e rregullimit të territorit, ajo duhet parë e lidhur ngushtë me planifikimin në shkallë kombëtare dhe rajonale. Në mungesë të një Plani të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit²⁰⁵, i cili do ishte i rëndësishëm për të kuptuar pozicionin e zonës që kemi marrë në studim në të, në këtë pjesë po trajtojmë disa plane dhe projekte ekzistuese të zhvillimit dhe rregullimit të territorit në nivel rajonal dhe lokal, të cilën kanë të bëjnë edhe me HPUSH, dhe që mund të ndihmojnë për të kuptuar vendin që zë ajo në ta, mënyrën si është trajtuar dhe rolin që mund të luajë kjo zonë në kontekstin e një zhvillimi më të gjerë. Le t'i shohim me rradhë disa prej tyre, që paraqiten edhe më të rëndësishëm për zonën tonë:

1. *Plani Rajonal Shkodër-Lezhë 2005-2020*²⁰⁶. Nga kërkimet e realizuara për hartimin e kësaj teme disertacioni dhe studimin e HPUSH, mund të themi se ky plan, është ndoshta më i ploti i realizuar për rajonin e Shkodrës, që jep rekomandime konkrete për zhvillimin e tij dhe të HPUSH.

Ky plan synon zhvillimin e një rajoni urban të integruar dhe të shërbejë si udhërrëfyes për planet në nivel lokal. Ai rekomandon krijimin e një rajoni urban policentrik ndërkufitar që lidh ekonomitë urbane të Shkodrës, Lezhës, Podgoricës, Tivarit dhe Ulqinit (*Pod-Shkod*), dhe hapësirën përreth tyre në mënyrë organike.

- Në plan theksohet se është ndërtuar informalisht një korridor nënurban zgjerimi 15 km i gjatë, në rrugën Shkodër-Koplik (një pjesë e mirë e të cilit

²⁰⁴ UN-HABITAT; Technical Chamber of Greece 2010, fq. 37

²⁰⁵ AKPT (Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit): “*Manual teknik i planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Shqipëri*”, Tiranë 2011, fq. 29

²⁰⁶ FSHZH - Fondi Shqiptar i Zhvillimit, *Plani Rajonal Shkodër-Lezhë (2005-2020)*, Eptisa, prill 2006

gjendet në HPUSH). Ky proces urbanizimi paraqet ndryshimin kryesor dinamik në rajon dhe favorizon një zhvillim të fuqishëm social-ekonomik. Dendësia e këtij korridori është shumë e vogël për të mundësuar krijimin e një infrastrukture të përshtatshme; por as shtëpitë nuk mund të shemben. *Përqasja më e mirë do ishte rritja e dendësisë, legalizimi i zhvillimit dhe financimi i rrugëve dhe infrastrukturës.* Ky plan koncepton 4 lloje kryesore fshatrash: a) nyje ekonomike rurale (për fshatrat afër me qendrat urbane dhe rrugët kryesore), b) fshatra kryesorë shërbimesh, c) fshatra mbështetës dhe d) fshatra në rënie. Plani parashikon gjithashtu krijimin e dy qyteteve të mëdha, Shkodrës dhe Lezhës, që rriten nëpërmjet densifikimit dhe shtrirjes në periferi. Shkodra do zgjerohet përgjatë korridorit nënurban Shkodër-Koplik, por në mënyrë të planifikuar (që i takon pikërisht në HPUSH). Pjesa më e madhe e kërkesës për tokë në të ardhmen, mund të plotësohet duke mbushur dhe densifikuar zonat urbane ekzistuese. Plani sugjeron përcaktimin e “zonave të zhvillimit të sugjeruar” dhe përgatitjen e planeve për këto zona.

- Sipas këtij plani, *zona në Veri të qytetit të Shkodrës* (mes qytetit të Shkodrës dhe Koplikut) është zhvilluar me dendësi të vogël shtëpish në formën e vilave, me një zhvillim informal në infrastrukturë dhe shtrirje; por është tërheqëse dhe e ndërtuar mirë. Toka është me vlera të mëdha bujqësore dhe sistemi i kanaleve ujitëse eksizton në pjesën më të madhe. Rekomandohet që në të ardhmen të rritet densiteti i banimit në këtë zonë, në mënyrë që të sigurohet edhe intensiteti i nevojshëm i ndërtimit, që i bën efikase ndërhyrjet në infrastrukturë. Zonat e lira duhet të rezervohen për ferma të vogla ose kopshte tregu, ndërkohë që plani lokal duhet të përcaktojë një kufi të urbanizimit, përtej të cilit nuk duhet lejuar asnjë ndërtesë e re. Një ndër zonat ku mund të përqendrohet rritja urbane është Shtoji. Gjithashtu duhet të përcaktohen vendet për infrastrukturën arsimore dhe shëndetsore, përdorime publike dhe tregtare.

- Rrugët anësore duhet të përmbajnë kanalizime ujërash, me një kolektor të vendosur paralel me bregun e liqenit. Në distancë prej disa kilometrash, duhet të ndërtohen zona të lagështa artificiale (4-5 ha), si laguna të shkarkimit të ujërave të zeza në drejtim të liqenit.

- Hekurudha nga Lezha në Podgoricë duhet të vihet në funksionim me stacione të reja (me parking makinash), në interval prej 2 km.

- Në aspektin ekonomik, plani parashikon bujqësinë, si lokomotivën e mundshme për ripërtëritjen ekonomike të rajonit (përfshirë këtu dhe agrobiznesin). Një rol të rëndësishëm mendohet se do luajnë edhe pylltaria dhe industria e përpunimit të drurit, peshkimi, turizmi, industria e lehtë dhe shërbimet. Rekomandohet bashkimi i tokave të fermerëve në ferma 10-50 ha, krijimi i kompanive private të shërbimit bujqësor si dhe të një banke për zhvillimin e sektorit parësor; kësaj i shtohet edhe propozimi për ngritjen e një agjencie marketingu për prodhimet bujqësore. Po ashtu, propozohet edhe krijimi i një agjencie për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë V.

- Në korridorin Shkodër – Koplik, mund të ndërtohet një rrip panoramik toke pa ndërtesa, përgjatë bregut të liqenit. Plani propozon gjithashtu edhe krijimin

edhe pjesa më e urbanizuar e tij. Megjithatë edhe këtu aksesit direkt në liqen është i vështirë. Edhe pse turizmi nuk konsiderohet prioritet për këtë zonë, sugjerohet që të bëhen përpjekje për mbrojtjen e mjedisit dhe brigjeve lindore të tij; ku përfshihen trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbetjeve urbane, reduktimi i ndotjes së ajrit, etj. Pjesa e HPUSH që përfshihet në zonën lindore, shihet si një burim i rëndësishëm i furnizimit më produkte bujqësore dhe shërbime, në kuadër të zhvillimit perspektiv të turizmit në liqenin e Shkodrës.

- Ndërkohë në këtë zonë paraqiten mjaft të rëndësishme edhe aktivitetet ekonomike joturistike dhe meqënëse liqeni i Shkodrës klasifikohet si “Rezervat Natyror i Menaxhuar”²⁰⁸, dhe në të aplikohet shkalla e 3-të e mbrojtjes, sugjerohet që nga ana hapsinore duhet mbajtur një distancë e përshtatshme nga bregu dhe zonat ekologjikisht sensitive. Sipërmarrësit do jenë përgjegjës për të përdorur teknologji moderne për të shmangur ndotjen për shkak të funksionimit të tyre. Në bujqësi mund të lejohet kultivimi për konsum vetjak, sidomos i drufrutorëve dhe perimeve, por përdorimi i plehrave dhe pesticideve duhet të rregullohet sipas standarteve të bujqësisë bio dhe duhet të kontrollohet.

3. *Plani i rregullimit të territorit – bashkia Shkodër.* Në kuadrin e zhvillimit dhe rregullimit perspektiv të territorit të HPUSH, ia vlen të shihen marrëdhëniet e saj në këtë drejtim, sidomos me qytetin e Shkodrës. Kjo për vetë faktin, se siç e kemi thënë, komuna Rrethinat e rrethon thuajse nga të gjitha anët bashkinë e Shkodrës, duke bërë që ne ta njësonim atë me HPU të saj. Për këtë arsye, është e nevojshme të shihet se çfarë parashikon PPV i qytetit të Shkodër²⁰⁹, në lidhje me hapësirën periferike të tij.

- Ky plan vëren së pari, se ndarja administrative e pushtetit lokal në Shqipëri, është përcaktuar në bazë të ligjit nr. 8653, të v. 2000 “Mbi ndarjen administrative”, i ndryshuar; por ai nuk ka harta zyrtare të bashkëngjitura, që të përcaktojnë qartë edhe kufinj të administrativ mes njësisive vendore të afërta. Gjithashtu, ky plan vendor kufizohet brenda kufinjve administrativ (vijës së verdhë të dikurshme) të qytetit, duke mos marrë parasysh ndryshimet e ndodhura gjatë këtyre 23 viteve si dhe ndërlidhjet dhe bashkëveprimin që ai natyrshëm ka në aspektin natyror dhe zhvillimor, me njësitë e tjera administrative që e rrethojnë, e veçanërisht me HPUSH²¹⁰. Megjithatë, ai thekson se, sipas Planit të Përgjithshëm Rregullues të Shkodrës - v.1984, sugjerohet se në perspektivën afatgjatë, qyteti i Shkodrës mund të zgjerohet në pjesën veriore të tij, duke përfshirë Dobraçin e deri në afërsi të fshatit Golem.

²⁰⁸ Vendim mbi shpalljen e pjesës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat Natyror i Menaxhuar” nNr. 684, 2.11.2005), Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave.

²⁰⁹ HYDEA, “Politika e zhvillimit të territorit – bashkia Shkodër”, Gusht 2010

²¹⁰ Krejt ndryshe shihet kjo gjë në Planin Rregullues të Tiranës, të hartuar në Shtator 2012, ku zhvillimi i ardhshëm i kryeqytetit është parë në lidhje të ngushtë dhe harmoni me territorin e komunave periferike që e rrethojnë, për shkak se edhe tendenca e shtrirjes së kryeqytetit është drejt tyre. Përveç se si tokë urbane, territori i komunave rrethuese të Tiranës, do shërbejë edhe për krijimin e parqeve natyrore dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në kryeqytet

V.2.4. Një model i rregullimit të territorit për HPUSH

Në këtë çështje bëhet një përpjekje për të ndërtuar një model të thjeshtë të rregullimit të territorit në HPUSH, bazuar në transformimet hapsinore që ka pësuar përdorimi i tokës në këtë zonë në kohë, nevojën e qartë për rregullim dhe planifikim që paraqet ai, kuadrin ligjor në fuqi dhe planet hapsinore rajonale ekzistuese.


V.2.4.1. Vështrim i detajuar mbi përdorimin e territorit në HPUSH në ditët e sotme

Karakteristika kryesore e përdorimit të territorit të HPUSH sot, është larmia e tij, pavarësisht sipërfaqes relativisht të vogël që ka kjo njësi administrative. Si rezultat i ndryshimeve të ndodhura pas vitit 1990, prurjeve demografike dhe urbanizimit, përveç se i larmishëm, territori i sotëm i HPUSH dhe mënyra e përdorimit të tij, paraqitet gjithashtu edhe mjaft e copëzuar. Një gjë të tillë na e tregon edhe harta e mëposhtme satelitore e kësaj zone, e cila është ndërtuar duke bërë një gërshëtim të hartës ortofoto të ALUIZNIT, të marrë në v. 2006 me pamjet e marra nga Google Earth:




Harta 16: Pamje satelitore e HPUSH

Një pamje edhe më të qartë të përdorimit të territorit në HPUSH, na e jep harta e mëposhtme e realizuar nëpërmjet SIG-ut (Sistemit të Informacionit Gjeografik), duke shfrytëzuar pak a shumë të njëjtat burime si dhe të dhënat në terren.



Harta 17: Përdorimi i territorit në komunën Rrethinat në v. 2013



Graf. 24: Përdorimi i tokës në HPUSH²¹¹ sipas zërave kryesor

²¹¹ Të dhënat janë marrë në Zyrën e Urbanistikës së komunës Rrethinat– tetor 2013

Duke u bazuar tek harta dhe tek grafiku i mësipërm, le të shohim më konkretisht cilat janë format kryesore të përdorimit të tokës në HPUSH në ditët e sotme (v. 2013), të renditura sipas zërave kryesor dhe të konkretizuara me shifra dhe foto:

1. *Toka arë*, përbën formën kryesore të përdorimit të tokës në HPUSH, edhe në ditët e sotme. Këtu përfshihet toka e kultivuar me bimë arash si drithrat, foragjerët, perimet, etj; por edhe toka arë e lënë djerr. Sipërfaqja që zë ajo është rreth 1547 ha, dhe fshatrat kryesorë ku gjendet ajo janë: Shtoji i Vjetër, Dobraçi, Golemi, Gruda e Re, etj. Duhet thënë se gjatë 23 viteve të fundit toka arë dhe ajo bujqësore në terësi ka ardhur duke u zvogëluar në sipërfaqe, duke u copëzuar dhe duke degraduar, si pasojë e urbanizimit.



Foto nr.20: Tokë arë në HPUSH (D.Rustja)

2. *Toka urbane*, përbën një formë tjetër shumë të rëndësishme të përdorimit të tokës në HPUSH, duke zënë rreth 570 ha. Këtu përfshihen vendbanimet e fshatrave të komunës, që janë ndërtuar brenda vijës së verdhë dhe rregullave urbanistike (kryesisht ato të ndërtuara para v.1990). Pjesën më të madhe të sipërfaqes së tokës urbane, gjendet në fshatrat më të mëdhenj të HPUSH si: Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Golem, etj.
3. Sipërfaqja e zënë nga *vendbanimet informale*, zë rreth 700 ha, dhe përbën në fakt, formën e dytë më të rëndësishme të përdorimit të tokës në HPUSH, pavarësisht faktit se ne e kemi vendosur atë pas tokës urbane (formale). Këtu bën pjesë pikërisht hapësira e zënë me vendbanime joformale, të ndërtuara kryesisht pas vitit 1990, jashtë kufinjve urban dhe vijave të verdha të miratuara të fshatrave. Numërohen gjithsej rreth 2397 ndërtesa të tilla, të vetëdeklaruar për legalizim; megjithatë shifrat e vërteta mund të jenë edhe më të larta.

Sipas akteve ligjore nga ALUIZNI dhe KRRTRSH²¹² është miratuar vija kufizuese e zonave informale për fshatrat e Komunës Rrethinat, si më poshtë²¹³:

1. Fshati Shtoj i Vjetër :

- Sipërfaqe e zonës informale: 55.02 ha
- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 90

2. Fshati Shtoj i Ri:

- Sipërfaqe e zonës informale: 105.72 ha
- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 241

3. Fshati Guci e Re:

- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 33
- Sipas informacioneve është miratuar kufiri i zonës informale, por nuk është dërguar akoma dokumentacioni pranë komunës nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

4. Fshati Grudë e Re:

- Sipërfaqe e zonës informale: 141.7 ha
- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 344

5. Fshati Hot i Ri:

- Sipërfaqe e zonës informale: 98.19 ha
- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 197

6. Fshati Golem:

- Sipërfaqe e zonës informale: 195.65 ha
- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 321

7. Fshati Dobraç:

- Sipërfaqe e zonës informale: 125.06 ha
- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 714

- Fshati Dobraç është i ndarë në 2 zona informale (Dobraç-1 dhe Dobraç-2). Zona Dobraç-2 nuk është miratuar akoma për arsye se është zonë e mbrojtur e puseve të ujësllësit të qytetit Shkodër dhe e liqenit të Shkodrës.

8. Fshati Bardhaj-Bleran:

- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 415
- Sipas informacioneve është miratuar kufiri i zonës informale, por nuk është dërguar akoma dokumentacioni pranë komunës

9. Fshati Zues:

- Numri total i ndërtimeve të vetëdeklaruar: 41

²¹² Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë

²¹³ Të dhënat janë marrë në Zyrën e Urbanistikës së komunës Rrethinat– tetor 2013

- Zona informale Zues nuk është miratuar akoma, për arsye se është zonë e mbrojtur turistike
- Në terësi janë 2396 ndërtime të vetëdeklaruar, nga të cilat 2263 janë objekte banimi dhe 133 objekte social – ekonomike.
- Vihet re se edhe në HPUSH, ecuria e procesit të legalizimeve ka qenë mjaft e ngadaltë dhe deri në v. 2013 ka vetëm 35 dosje vetëdeklarimesh të dorëzuara, që janë pajisur me leje legalizimi.



Foto nr.21: Sipërfaqe e ndërtuar informale (pas v. 1990) në HPUSH (D. Rustja)


4. *Sipërfaqja e zënë me vreshtat, drufrutorë dhe ullishte* ka një rol të rëndësishëm në përdorimin e tokës së HPUSH. Së bashku ato zënë mbi 900 ha, sipas të dhënave të komunës. Siç e kemi thënë, vreshtat gjenden kryesisht në fushën e Shtoit, së bashku me drufrutorët; kurse ullishtet në Zues dhe Bardhaj. Edhe ato janë prekur nga dëmtimi dhe shkatërrimi, si rezultat i urbanizimit të pas viteve '90; veçanërisht vlen kjo për sipërfaqen e mbjellë me vreshta dhe drufrutorë, në fushën e Shtoit.
5. *Pyjet dhe kullotat*, përbëjnë një tjetër formë të rëndësishme të përdorimit të tokës në HPUSH, me rreth 490 ha. Ato gjenden kryesisht në kodrat e Zuesit, Bardhajve dhe pranë brigjeve të liqenit të Shkodrës, dhe janë prekur gjithashtu nga dëmtimi dhe urbanizimi.

6. Rreth 165 ha tokë në HPUSH, zihen nga sipërfaqja që zënë *rrugët, kanalizimet dhe hekurudha*. Dallojmë këtu veçanërisht rrugën kombëtare Shkodër – Han i Hotit dhe hekurudhën ndërkombëtare Tiranë – Han i Hotit, të cilat kalojnë në HPUSH, dhe që do përbëjnë në të ardhmen arterie të rëndësishme komunikimi dhe zhvillimi.
7. Rreth 140 ha tokë të HPUSH, zihen nga shtretërit e lumenjve dhe kënetat. Përmendim këtu kryesisht zallishtoren e lumit Kir dhe zonën kënetore në brigjet e liqenit. Sipërfaqe këto, që mund të konsiderohen si natyrore dhe duhen mbrojtur në perspektivën e planifikimit të territorit të HPUSH.
8. Së fundi, duhet të përmendim edhe sipërfaqen e zënë nga varrezat e qytetit të Shkodrës, rreth 17 ha aktualisht, që gjenden në territorin e HPUSH. I veçojmë ato, jo aq nga hapësira që zënë, por nga rëndësia; pasi përbëjnë zonën kryesore të rrethit të Shkodrës në këtë drejtim dhe duket qartë që do kenë nevojë për zgjerim në të ardhmen dhe prandaj duhen pasur parasysh në kuadër të planifikimit perspektiv.

V.2.4.2. Parashtrimi i një linje veprimi për planifikimin dhe rregullimin e territorit në HPUSH


Bazuar në atë që thamë më sipër, po japim më poshtë *një linjë pune* që mund të ndiqet për hartimin e një plani rregullues për HPUSH:

- I. *Përcaktimi i zonave të rëndësisë kombëtare, rajonale dhe me status të veçantë, të cilat duhen mbrojtur nga zhvillimi dhe që në përgjithësi nuk janë subjekt i planifikimit. Si zona të tilla në HPUSH, mund të përmendim:*
 - a) Vendburimin e ujit të pijshëm dhe stacionin e pompave të Dobraçit
 - b) Zonën turistike të mbrojtur të Zuesit (me sipërfaqe 3 ha)
 - c) Rezervatin natyror të menaxhuar përgjatë brigjeve të liqenit të Shkodrës (kryesisht pyllin e Dobraçit)
 - d) Zonën e varrezave të qytetit të Shkodrës
 - e) Luginën e lumit Kir (zonë e kërcënuar nga përmytjet)




Harta 18: Zonat e rëndësishme të veçantë në HPUSH


II. *Analizë e problemeve të pronësisë.* Njohja e karakteristikave të pronësisë, është një element i domosdoshëm paraprak, për realizimin e çdo plani rregullues. Ne e kemi trajtuar këtë problem në kapitujt e mësipërme, si psh. tek bujqësia, dhe kemi theksuar faktin se toka bujqësore në HPUSH është shpërndarë në bazë të ligjit 7501, megjithëse problemet dhe konfliktet në këtë drejtim, nuk mungojnë. Ato janë shtuar edhe për shkak të zhvillimit informal urban të zonës, pas v. 1990. Psh në fshatin Zues, banorët e zonës i administrojnë tokat që kanë në zotërim, edhe pse nuk zotërojnë tapi. Përveç se mes privatëve, ka konflikte pronësie të tokës edhe me njësitë administrative fqinje, si me komunën e Gruemirës, por edhe me bashkinë e Shkodrës. Të gjitha këto detaje e vështirësojnë rregullimin, planifikimin dhe zonimin e territorit në HPUSH, duke qenë një element thelbësor paraprak që duhet zgjidhur në këtë drejtim.




Harta 22: Gjendja e pronësisë në fshatin Golem




Harta 23: Gjendja e pronësisë në fshatin Grudë e Re




Harta 24: Gjendja e pronësisë në fshatin Guci e Re




Harta 25: Gjendja e pronësisë në fshatin Hot i Ri



Harta 26: Gjendja e pronësisë në fshatin Shtoj i Ri



Harta 27: Gjendja e pronësisë në fshatin Shtoj i Vjetër, ngjitur me komunën Gruemirë



Harta 28: Gjendja e pronësisë në fshatin Zues

- III. *Përcaktimi i zonave që kanë nevojë për riparim, rigjenerim apo rihvillim urban*, ku përfshihen zona të caktuara të njësisë administrative, me problematika të theksuara social-ekonomike dhe mjedisore, që janë në degradim dhe kanë nevojë për një trajtim të veçantë. Në HPUSH, si të tilla mund të përmendim veçanërisht zonat informale, të cilat siç e thamë më sipër janë 9 të tilla, nga një thuajse për çdo fshat, por duke qenë më karakteristike për zonën Dobraq 1 dhe 2, që janë edhe më të mëdhatë. Gjithsesi, duke qenë një zonë periferike urbane me zhvillim kryesisht joformal, thuajse e gjithë HPUSH mund të konsiderohet si e tillë.
- IV. *Njohja e tipologjisë hapsinore së zonës ku do realizohet planifikimi*, përbën një tjetër element kyç; ku dallojmë llojin e përdorimit të hapësirës, ndërtesave, sistemit rrugor dhe hapësirave publike, intensitetit të ndërtimit dhe densitetit.
- Në trajtimin e përdorimit aktual të tokës në HPUSH më sipër, u evidentuan llojet dhe format kryesore të përdorimit të tokës në të. Aty vihet re qartë një larmi e tyre, ku gjithsesi mbizotëron toka bujqësore e gërshetuar ngushtësisht me tokën urbane dhe informale (vendbanimet), duke sjellë një copëzim mjaft të madh të përdorimit të territorit, gjë që gjithashtu e vështirëson çdo përpjekje për rregullim dhe planifikim në të ardhmen.
 - Përsa i takon vendbanimeve, vihet re se ata janë të përqendruar kryesisht në zonën fushore, si në fushën e Dobraqit, Shtoit dhe Bardhajve; si dhe përgjatë arterieve kryesore të komunikimit, veçanërisht përgjatë rrugës automobilistike kombëtare Shkodër – Han i Hotit (ose siç e quajtmë ndryshe më sipër korridorit nënurban Shkodër – Koplik).
- V. *Dendësia e popullsisë dhe banesave*

Llogaritja e dendësisë së popullsisë, përbën një element shumë të rëndësishëm për të kuptuar dhe drejtuar rregullimin dhe planifikimin e territorit në një zonë të caktuar. Siç e kemi thënë në HPUSH, dendësia mesatare e popullsisë është 534 b/km², me një dendësi më të lartë në vendbanimet ngjitur me qytetin, sidomos në fshatin Dobraq, ku

shkon në mbi 800 b/km². Gjithsesi, në lidhje me planifikimin e territorit, praktikat ndërkombëtare veçojnë 3 kategori²¹⁴:

- a) Zonat me dendësi më të ulët se 100 banorë/ha (hektar), ku përfshihen kryesisht zonat periferike të qyteteve; këtu përfshihet në fakt shumica e territorit dhe vendbanimeve të HPUSH
- b) Zonat me densitet të mesëm 100-400 banorë/ha, përbën një standart të pranueshëm për zonat e banuara në qytet; në rastin e HPUSH mund të themi se vetëm fshati Dobraq ka një dendësi të tillë në zonën më të banuar të tij, duke pasur pozicionin dhe karakteristikat e përshtashme për tu integruar me qytetin në planin afatmesëm ose afatshkurtër
- c) Zonat me dendësi 400-600 banorë/ha, ku bëjnë pjesë zakonisht qëndrat e qyteteve të mëdha, që nuk kanë të bëjnë me rastin e HPUSH.

Në lidhje me planifikimin dhe rregullimin e territorit në një zonë të caktuar, rëndësi ka edhe njohja dhe *parashikimi i situatës demografike*. Nga ajo që kemi përmendur në kapitullin përkatës, vihet re se numri i popullsisë në HPUSH sot, zyrtarisht është rreth 26 000 banorë dhe ka tendencë rritjeje, e cila pas v. 1990 rezulton me mesatarisht 1000 banorë të shtuar për çdo vit. Duhet thënë se këtu më shumë sesa shtimi natyror i popullsisë ka ndikuar vlera pozitive e migrimit të brendshëm të popullsisë në këtë zonë, dmth prurjet demografike. Duke qëndruar në këto vlera, mund të parashikohet se në 10 vitet e ardhshme popullsia e HPUSH do të rritet me rreth 10000 banorë; megjithatë ky është skenari më optimist. Kjo për faktin se në vazhdimësi si shtimi natyror, ashtu edhe ardhjet e popullsisë në këtë zonë kanë ardhur në rënie, edhe pse mbeten pozitive.

Duke pasur parasysh një skenar më realist dhe të moderuar, mund të parashikohet se në 10 vitet e ardhshme, popullsia e kësaj zone të rritet me 5000-6000 banorë; nga ana tjetër nuk duhet të harrojmë se numri real i popullsisë në këtë zonë është mbi 30 000 banorë, pasi këtu jeton edhe një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së komunave malore të qarkut të Shkodrës. Si përmbledhje, mund të themi se në 10 vitet e ardhshme, pritet që në HPUSH të jetojnë 35000 – 40000 banorë, duke bërë të domosdoshme planifikimin e vendosjes së kësaj popullsie në territorin e HPUSH.

VI. Analiza e elementëve të fortë territorial, shërben për të identifikuar ata elementë natyror apo infrastrukturor që përbëjnë pika të forta mbështetëse për planifikimin e zhvillimit të zonës. Në HPUSH janë disa të tillë, të cilët ne po i analizojmë me rradhë:

- a) Në *aspektin natyror* (fiziko-gjeografik), janë disa elementë të tillë të rëndësishëm që duhen marrë në konsideratë. Së pari, *relievi* i zonës bën të mendosh që drejtimi i zhvillimit do jetë pak a shumë i orientuar ashtu siç është sot; dmth është e pritshme që popullsia dhe vendbanimet të vazhdojnë të përqendrohen në zonën fushore, konkretisht në fushën e Shtoit, Dobraqit dhe Bardhajve. Kjo edhe për shkak të përbërjes hidrogjeologjike të tokës,

²¹⁴ AKPT (Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit): “Manual teknik i planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Shqipëri”, Tiranë 2011

pasi aty është e përqendruar edhe toka bujqësore dhe burimet ujore nëntokësore, që shfrytëzohen nga banorët e zonës për sigurimin e ujit të pijshëm nëpërmjet puseve.

- Ndërkohë, zona kodrinore ka mundësi të jetë më pak e preferuar për banim, ashtu siç është edhe sot. Kjo vlen në fakt më shumë për kodrat e Bardhajve, pasi kodra e Zuesit ose më saktë shpati JL i Taraboshit siç e kemi quajtur, që ka orientim nga lumi Buna dhe kalaja e qyteti i Shkodrës, përbën një zonë mjaft tërheqëse për banesa, veçanërisht të tipit elitare. Këtu vihen re edhe shenjat e para të suburbanizimit në HPUSH, dhe ka mundësi që edhe në ardhmen kjo zonë të mbetet e preferuar për të ndërtuar shtëpi tip vile nga shtresat me të ardhura më të larta të HPUSH dhe qytetit të Shkodrës.

- Një element të fortë territorial natyror për HPUSH përbën edhe *rrjeti hidrografik* i saj. Përmendim këtu veçanërisht lumin Kir dhe shtratin e gjerë zallishtor të tij, që përbën arterien kryesore hidrografike të zonës. Përveç se kërcënon me përmytje, lumi Kir përbën edhe furnizuesin kryesor të ujërave nëntokësore në fushën e Shtoit të krijuar prej tij. Ndërkohë, përroi i Vrakës ka rëndësinë e tij në këtë drejtim, pasi shërben edhe si kufi ndarës me njësitë administrative në veri të HPUSH; kurse lumi Buna ia vlen të përmendet më shumë si një atraksion turistik dhe vlerë e shtuar e biodiversitetit për këtë zonë.

- b) *Në aspektin infrastrukturor*, HPUSH ka disa elementë të fortë territorial shumë të rëndësishëm për zhvillimin dhe planifikimin perspektiv të saj. Dallojmë këtu veçanërisht *rrugën nacionale Shkodër – Han i Hotit*, që siç e kemi thënë përbën artieren kryesore të komunikimit dhe zhvillimit për HPUSH. Pikërisht përgjatë saj ka ndodhur zhvillimi më i madh demografik dhe ekonomik për këtë zonë, dhe jo vetëm. Aty janë përqendruar shumë nga ndërtesat e reja, të cilët paraqiten gjithashtu edhe ndër më cilësoret në gjithë komunën dhe rajonin e Shkodrës. Po ashtu, përgjatë kësaj rruge është përqendruar edhe numri më i madh i bizneseve të kësaj zone dhe tendenca mbetet e tillë edhe për të ardhmen, aq më shumë tani që ajo është zgjeruar dhe rikonstruktuar.

- Ndërkohë, edhe përgjatë rrugëve *Shkodër – Muriqan* dhe *Shkodër – Mes* vihet re një zhvillim i tillë, gjë që të bën të besosh se të gjitha këto rrugë të rëndësishme komunikimi do përbëjnë shtyllat e orientimit të zhvillimit të HPUSH edhe në të ardhmen.

- Së fundi, përmendim këtu edhe *hekurudhën Tiranë – Han i Hotit*, një pjesë e rëndësishme e së cilës kalon në territorin e HPUSH, e cila duhet thënë se nuk ka më rëndësinë e dikurshme, madje ka degraduar ndjeshëm. Gjithsesi në kuadër të zhvillimit perspektiv të zonës, rivitalizimi i kësaj hekurudhe dhe mundësive që ofron ajo, paraqitet mjaft i rëndësishëm.


V.2.4.3. Rekomandime mbi planifikimin, rregullimin dhe zonimin e territorit në HPUSH

Nga gjithçka thamë mësipër, kuptohet që urbanizimi do vazhdojë të jetë një faktor kyç në dinamikën e zhvillimit të HPUSH edhe në të ardhmen. Ritmet e rritjes së popullsisë pritet të vazhdojnë, por do të vijnë drejt stabilizimit. Prandaj zhvillimi i ardhshëm urban duhet orientuar drejt zonave më të përshtatshme, me qëllim edhe mbrojtjen e mjedisit natyror dhe tokës bujqësore. Po ashtu, mund të thuhet me bindje se zhvillimi i ardhshëm i HPUSH, nuk mund të shihet ndryshe veçse në lidhje të ngushtë funksionale me qytetin e Shkodrës, nga i cili merr edhe jep kapital fizik e human, si dhe shërbime. Në këtë kuadër duhet parë edhe zhvillimi perspektiv i territorit të HPUSH, në funksion të një hapësire më të gjerë sesa vetë ajo. Për këto arsye, rekomandohet që:

- Pjesa më e madhe e kërkesës për tokë në të ardhmen mund të plotësohet duke densifikuar zonat urbane ekzistuese brenda fshatrave; një perspektivë të tillë ka veçanërisht korridori nënurban Shkodër – Koplik, përgjatë rrugës kombëtare dhe zona periferike veriore e qytetit pranë fshatrave Dobraq dhe Golem. Një gjë e tillë do bënte të mundur rritjen e intensitetit të ndërtimit, duke i bërë më efikase ndërhyrjet në infrastrukturë. Më pas duhen përcaktuar kufinj të zhvillimit urban, përtej të cilave nuk duhet lejuar asnjë ndërtesë e re.
- Kjo mund të konsiderohet si *zona e zhvillimit të ardhshëm urban* për HPUSH; nëse është e nevojshme ajo mund të shërbejë edhe për plotësimin e nevojave për troje ndërtimi dhe banesa, si rezultat i zgjerimit dhe shtrirjes së mëtejshme të qytetit të Shkodrës, që aktualisht po ndodh drejt veriut dhe rrethinave të tij.
 - a) Mbrojtja e tokës bujqësore eksituese, pyjeve dhe kullotave paraqitet si domosdoshmëri: është mirë që ato të vendosen në një status të privilegjuar, pasi kjo zonë nuk mund t’ia lejojë më vetes luksin e dëmtimit të mëtejshëm të mjedisit dhe humbjes së tokës bujqësore. Kjo edhe për faktin se bujqësia është dhe pritet të jetë edhe në të ardhmen e afërt, aktiviteti kryesor ekonomik dhe burimi më i rëndësishëm i të ardhurave, për banorët e zonës. Toka arë, vreshtat, drufrutorët dhe ullishtet e HPUSH, mund të konsiderohen si *zona të zhvillimit të aktivitetit ekonomik primar*, dhe duhen parë me përparësi.
 - Ky rregull mund të gjejë përjashtim vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me vepra të forta publike, sidomos kur ato kanë rëndësi rajonale dhe kombëtare
- b) *Hapësirat periferike natyrore* të qytetit, që janë pjesë e HPUSH, si psh. zona përreth brigjeve të lumenjve Kir dhe Bunë, bashkë me Zuesin dhe kodrat e Bardhajve mund të shihen me syrin e zonave të ardhshme të parqeve periferike çlodhëse dhe turistike, në funksion jo vetëm të banorëve të zonës periurbane, por edhe qytetit të Shkodrës. Aty mund të krijohen parqe, lulishte, kënde lojrash, fusha të vogla sportive, etj.
- Ndërkohë, në pjesën lindore të liqenit, përgjatë korridorit Shkodër – Koplik, mund të krijohet një rrip panoramik toke, i cili mund të shërbejë si një itinerar dhe korridor turistik, që mund të përdoret për shëtitje, ecje, çiklizëm, etj.

- c) Zona ngjitur me pjesën veriore të qytetit të Shkodrës, që bën pjesë në territorin e HPUSH (Dobraç) propozohet të përdoret si “*park biznesi*”, duke përfshirë magazina të shitjes me shumicë e pakicë, ekspozita, supermarkete, ndërtesa të Universitetit, etj. Kurse përgjatë korridorit suburban KopShkod (Shkodër-Koplik), mund të ndërtohen punishte të vogla, magazina, pika shitjeje shumice, etj; tendenca të cilat tashmë janë në zhvillim e sipër.

Së fundi, theksojmë faktin se çdo planifikim dhe rregullim i territorit në këtë zonë dhe në zonat e tjera periurbane me tipare informale në të ardhmen, që të jetë funksional do kërkojë si domosdoshmëri përfundimin e procesit të legalizimeve që është në vazhdim dhe zgjidhjen e problemeve të pronësisë.



Harta 29: Rregullimi dhe zonimi perspektiv i territorit në HPUSH

V.3. Planifikimi i zhvillimit të qëndrueshëm në HPUSH

Zhvillimi i qëndrueshëm është një koncept relativisht i gjerë, që sipas përkufizimit kryesor përcaktohet si: “*zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes, pa cënuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre*”²¹⁵. Ai synon integrimin dhe harmonizimin e zhvillimit ekonomik me barazinë sociale dhe cilësinë e mjedisit.

Në këtë këndvështrim do e shohim edhe planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm në HPUSH. Nga gjithçka thamë më sipër, shihet qartë që kjo zonë ka nevojë për hartimin e një platforme të tillë zhvillimi, bazuar së pari në resurset natyrore dhe njerëzore që ajo ofron dhe në bashkëpunimin e pushtetit qendror me pushtetin lokal dhe komunitetin.

V.3.1. Resurset natyrore dhe njerëzore, bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të HPUSH

- Ndër *resurset natyrore* që HPUSH ofron, përmendim:
 - Pozicionin gjeografik pranë qytetit më të madh verior – Shkodrës dhe liqenit me të njëjtin emër, si dhe pranë rrugëve të rëndësishme të transportit dhe komunikimit
 - Relievin kryesisht fushor, të përshtatshëm për zhvillimin e jetesës, por të gërshetuar edhe me kodra, duke ia shtuar atij larminë
 - Toka të përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, si vreshtarisë, pemëtarisë, drithrave, etj.
 - Klimë mjaft të favorshme me dimër të butë dhe reshje të bollshme dhe pasuri hidrografike, si liqeni i Shkodrës, lumi Buna, lumi Kir, ujëra nëntokësor
 - Pasuri minerale si lëndëve inerte (zhavorre, rëra) etj. në luginën e lumit Kir, argjilave në bregun e liqenit, etj.
 - Pasuri të konsiderueshme me pyje dhe kullota, në raport me sipërfaqen e vogël dhe pozicionin gjeografik periurban
- Ndër *burimet njerëzore*, që përbëjnë një premisë për zhvillim në HPUSH, mund të evidentojmë:
 - Një popullsi të konsiderueshme (mbi 25 000 banorë), duke përbërë në këtë aspekt një ndër komunat më të mëdha në vend²¹⁶. E gjithë kjo popullsi përbën një burim të rëndësishëm human për tregun e punës, duke siguruar kapitalin fizik dhe mendor të nevojshëm për zhvillimin perspektiv të saj.
 - Mosha mesatare e popullsisë në këtë zonë është në mesataren e vendit, rreth 35 vjeç, duke garantuar një popullsi aktive dhe të aftë për të përballur sfidat e së ardhmes.

²¹⁵ WCED; *Our common Future*, Oxford University Press, Oxford 1987

²¹⁶ Sipas të dhënave të Censurit 2011, komuna Rrethinat është komuna e 4-rt me e madhe në vend, dhe si njësi administrative, e 15-ta (duke përfshirë bashkitë dhe komunat).

- Rreth 64% e popullsisë i përket grupmoshës së punës (15-60 vjeç) që do të thotë se mbi 16000 banorë të saj mund të përfshihen në aktivitete ekonomike që gjenerojnë të ardhura.
- Struktura gjinore deri diku e balancuar e popullsisë dhe ekzistenca e mundësive të arsimit dhe kualifikimit, bëjnë të mundur që gratë dhe vajzat të kenë mundësi të shprehin potencialin e tyre në zhvillimit e komunitetit.
- Të dhënat aktuale demografike dhe tendenca e tyre tregojnë se të paktën edhe përsa i takon së ardhmes së afërt, numri i popullsisë do vazhdojë të rritet dhe paralelisht me të edhe grupmosha e popullsisë së aftë për punë.
- Marrëdhëniet mes pjestarëve të komunitetit janë në përgjithësi të mira dhe tolerante, duke lejuar bashkëpunimin dhe duke krijuar një klimë pozitive pune dhe jetese.
- Popullsia e kësaj zone është përgjithësisht e mirëarsimuar, bashkëpunuese, ambicioze, që njih vlerat qytetare dhe kërkon të renë, etj.
- Të qenit në periferi të qytetit të Shkodrës ka ndikuar në krijimin e tipareve kulturore deri diku urbane për banorët e zonës dhe gjithashtu u ka dhënë mundësinë atyre për tu arsimuar dhe edukuar në mënyrë cilësore.

- Duke analizuar këto resurse, karakteristikat aktuale të zhvillimit të HPUSH dhe prirjet e tij në të ardhmen, si dhe duke e parë këtë në këndvështrimin e zhvillimit rajonal, jemi munduar të përcaktojmë disa drejtime kryesore mbi të cilët mund të bazohet zhvillimi i qëndrueshëm i kësaj hapësire, të cilat më gjerësisht po i trajtojmë më poshtë:

I. Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik

II. Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit

III. Zhvillimi social dhe mirëqeverisja

V.3.2. Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik

Zhvillimi ekonomik i HPUSH në të ardhmen duhet të përqendrohet në këto drejtime kryesore:

1. Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë dhe sektorit primar në terësi:

Me shumë mundësi, bujqësia do vazhdojë të jetë aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik dhe burimi kryesor i të ardhurave, për pjesën më të madhe të banorëve të HPUSH, edhe në të ardhmen e afërt. Objektivat kryesore në bujqësi do të synojnë në rritjen e prodhimeve bujqësore nëpërmjet rritjes së prodhimit të perimeve, zhvillimit të mëtejshëm të frutikulturës dhe vreshtarisë, si dhe përmirësimin sasior dhe cilësor të produkteve blegtorale. Siç e kemi thënë HPUSH ka shumë potenciale dhe traditë për zhvillimin e bujqësisë. E gjithë kjo do të arrihet duke zgjidhur problemet e pronësisë mbi tokën, krijimin e fermave të mëdha, dhënien e mendimit teknik dhe të mbështetjes financiare dhe të prodhimit të produkteve të orientuara nga tregu.

Më konkretisht, rekomandohet:

- a) Shtimi i sipërfaqes së mbjellë me drufrutorë sidomos në Guci të Re, Hot të Ri, Bardhaj e Bleran; dhe me vreshta në Shtoj të Ri, Shtoj të Vjetër, Grudë të Re, etj
- b) Rritja e sipërfaqes dhe numrit të serrave, sidomos në fshatrat Golem dhe Dobraç, ku toka është më e përshtashme, duke shfrytëzuar edhe pozicionin gjeografik pranë qytetit të Shkodrës
- c) Shtimi i sipërfaqes së mbjellë me ullinj, sidomos në fshatrat Zues dhe Bardhaj që edhe kanë traditë në këtë drejtim
- d) Blegtoria përbën një tjetër potencial të rëndësishëm zhvillimi thuajse për të gjithë fshatrat e HPUSH; në këtë drejtim është e rëndësishme të realizohet përmirësimi racor dhe shtimi i numrit të krerëve të gjësë së gjallë, veçanërisht gjedhit; ekziston mundësia dhe ka shembuj në komunë për krijimin e komplekseve blegtorale bashkëkohore
- e) Rehabilitimi i sistemit ujitës dhe kanalizues dhe rritja e sipërfaqes nën ujë
- f) Mbështetja e fermerëve me mekanikën e avancuar bujqësore
- g) Zgjerimi i madhësisë së fermave dhe bashkimi i parcelave të tokës, kuptohet në mënyrë vullnetare nga fermerët, me qëllim përfitimin e përbashkët; për këtë duhen gjetur mekanizmat dhe instrumentat nxitëse edhe nga ana e strukturave shtetërore
- h) Nxitja e zhvillimit të peshkimit si një aktivitet i rëndësishëm ekonomik dhe burim të ardhurash për banorët e HPUSH; por brenda kuadrit ligjor dhe në kuadrin e OMP. Vaskat e dikurshme të rritjes së peshkut që kanë ekzistuar në Shtoj të Vjetër, mund të rivihen në funksionim; gjithashtu mund të ngrihet edhe një qëndër e mbledhjes dhe përpunimit të tij
- i) Zhvillimi i mëtejshëm i bletarisë; veçanërisht në zonat kodrinore të Bardhajve dhe Zuesit që ofrojnë një perspektivë të mirë në këtë drejtim, me qëllim shtimin e numrit të koshereve dhe cilësisë së mjaltit që prodhohet
- j) Hartimi i politikave për dhënie kredie lehtësuese për fermerët dhe blegtorët

2. Zhvillimi i agrobiznesit dhe agroindustrisë:

Larmia dhe sasia e produkteve aktuale bujqësore dhe blegtorale të HPUSH, krijon mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të agroindustrisë. Konkretisht mund të investohet në:

- a) Ngritjen e punishteve të reja të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si psh. qumështit dhe nënprodukteve të tij; modernizimin e mëtejshëm të atyre ekzistuese
- b) Shtimin e punishteve dhe fabrikave të përpunimit të rushit, drufrutorëve dhe ullinjve, me qëllim prodhimin e verës, vajit të ullirit, etj.
- c) Ngritja e një pike për riparimin dhe tregtimin e pajisjeve mekanike të bujqësisë

3. Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të shërbimeve:

Shërbimet dhe tregtia kanë marrë një zhvillim të konsiderueshëm në HPUSH gjatë 24 viteve të fundit dhe duket që ky sektor ka potencialin e një zhvillimi edhe më të madh. Në këtë drejtim, rekomandohet që:

- a) Të evidentohen, rregjistrohen dhe formalizohen të gjitha subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në HPUSH, në mënyrë që t'i krijohet hapësira e nevojshme konkurrencës së lirë dhe të ndershme
- b) Pas formalizimit, të krijohen lehtësitë e nevojshme finaciare dhe ligjore për nxitjen e këtij sektori, nëpërmjet paketave fiskale dhe taksave konkurruese
- c) Taksat duhen mbledhur rregullisht dhe sipas rregullave në fuqi, dhe një pjesë e tyre duhet të përdoren për investime lokale

4. Zhvillimi i turizmit

Turizmi përbën një tjetër mundësi të rëndësishme zhvillimi për HPUSH, që akoma nuk është shfrytëzuar siç duhet. Duke pasur parasysh pozitën gjeografike, kushtet natyrore dhe karakteristikat aktuale të tregut turistik në Shqipëri dhe rajonin e Shkodrës; disa nga *tipet e turizmit* që mund të zhvillohen në këtë zonë janë:

- a) Turizmi rural dhe agroturizmi; përbën një potencial të veçantë pozitiv për zhvillimin ekonomik lokal në HPUSH. Fermat dhe objektet e tjera me karakter rural dhe bujqësor të zonës, japin mundësinë që turistët të shijojnë peisazhin bujqësor të saj; ata gjithashtu mund të njihen nga afër me jetën e fshatit, të marrin pjesë në veprimtaritë rurale, etj
 - b) Turizmi i gastronomisë, lidhur me prodhimet bujqësore dhe blegtorale të zonës, sidomos vreshtave (në fushën e Shtoit), ullishteve (Zues) dhe produkteve blegtorale; ndihmuar edhe nga ekzistenca e restoranteve të shumta në territorin e saj, sidomos në brigjet e Bunës pranë fshatit Zues, por edhe në zona të tjera
 - c) Turizmi lumor dhe liqenor ka mundësi zhvillimi gjithashtu përgjatë lumenjve Kir dhe Bunë dhe padyshim edhe në brigjet e liqenit të Shkodrës
 - d) Turizmi i kampingjeve dhe ai natyralistik, sidomos në zonat më të mbrojtura natyrore të HPUSH, si pylli i Dobraqit, kuptohet gjithmonë duke qenë miqësor me natyrën.
- Disa nga *destinacionet më tërheqëse* për zhvillimin e turizmit në HPUSH, mund të jenë:
- Zona e fshatit Zues, parë sidomos nga kodrat e tij, që është në fakt një zonë e mbrojtur turistike
 - Brigjet e liqenit të Shkodrës; mbi 5 km brigje të liqenit që prekin territorin e komunës nga vija e Vrakës, deri në Bisht të Qindisë
 - Kodrat e Bardhajve dhe rezervuari i Bleranit
 - Biodiversiteti i zonës dhe lugina e lumit Kir

V.3.3. Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit

Për shkak të ndryshimeve që ka pësuar HPUSH gjatë 23 viteve të fundit, përmirësimi i infrastrukturës dhe integrimi i saj me zonat administrative fqinje, përbën një ndër drejtimet kryesore ku duhen përqendruar investimet dhe politikat zhvilluese të saj. Më poshtë po japim disa rekomandime konkrete për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës në HPUSH, sipas drejtimeve kryesore.

1. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit

Megjithëse, siç kemi thënë në këtë drejtim ka pasur mjaft investime, shumë mbetet akoma për tu bërë, në mënyrë që banorëve të HPUSH t'u sigurohet një rrjet transporti efikas dhe cilësor, kusht i domosdoshëm për çdo zhvillim të mëtejshëm. Një gjë e tillë vihet re edhe në tiparet aktuale të zhvillimit të kësaj zone, ku shihet qartë tendenca e zhvillimit përgjatë rrugëve kryesore të transportit dhe komunikimit, sidomos në rrugën nacionale Shkodër – Han i Hotit, e cila ka përfunduar së ndërtuari së fundi. Për ta përmirësuar gjendjen aktuale, jepen këto rekomandime konkrete:

- a. Rrjeti rrugor i komunës duhet të integrohet me strukturën rrugore të qytetit të Shkodrës dhe komunave fqinje. Në këtë drejtim paraqitet e nevojshme lidhja e vendbanimeve të saj me arteriet kryesore të transportit, si me rrugën nacionale të lartpërmendur, rrugën Shkodër – Mes dhe Shkodër – Muriqan, si dhe me unazën perëndimore tashmë të përfunduar të qytetit, dhe me unazën lindore në ndërtim e sipër
- b. Rregullimin dhe sistemimin e rrugëve kryesore që lidhin fshatrat me njëri-tjetrin; një pjesë e të cilëve është e paasfaltuar
- c. Përmirësimin dhe asfaltimin e sistemit rrugor të brendshëm të fshatrave, që është në gjendje të mjerueshme; rikonstruksionin e Urës së Bardhajve
- d. Zgjerimin, riparimin dhe sistemimin e rrugëve ekzistuese kryesore; në përgjithësi ato nuk janë ndërtuar sipas standarteve bashkëkohore pasi vihet re mungesa e trotuareve, ndriçimit dhe kanalizimit të ujërave të bardha.
- e. Mund të shihet mundësia e një linje të re urbane, për të bërë të mundur lidhjen midis fshatrave, e cila aktualisht mungon; si dhe lidhjen më të shpejtë dhe efikase me qytetin e Shkodrës
- f. E rëndësishme është edhe vendosja e një sistemi zyrtar të adresave dhe emërtimi të rrugëve në vendbanimet e HPUSH, i cili gjithashtu mungon
- g. Një element të veçantë në këtë drejtim përbën edhe hekurudha kombëtare dhe ndërkombëtare Tiranë - Shkodër - Han i Hotit, që në një pjesë të konsiderueshme kalon në HPUSH. Rivitalizimi i kësaj hekurudhe mund të përbëjë një incentiv të rëndësishëm në zhvillimin e zonës në perspektivë. Kuptohet që për ta realizuar një gjë të tillë, duhet ndërhyrje nga strukturat përkatëse në nivel qendror, e më pas koordinim me ato në nivel lokal.

2. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm

Siç e kemi thënë, furnizimi me ujë përbën ndoshta problemin më madhor për banorët e HPUSH. Shumica e tyre e sigurojnë vetë ujin e pijshëm, kryesisht nëpërmjet puseve individuale. Vetëm fshati Dobraq dhe një pjesë e fshatit Golem, janë të lidhur me sitemin e ujësjellësit të qytetit të Shkodrës. Një pjesë e fshatit Hot i Ri dhe Zues, kanë në përdorim ujësjellës lokal me kullë ajrore; por ata nuk shërbejnë për të gjithë banorët, ndërkohë që edhe sasia e ujit është e pamjaftueshme. Ndërsa, përpjekjet e bëra deri më tani për ndërtimin e ujësjellësve lokal për fshatra apo lagje të caktuara, me shpime masive; nuk kanë rezultuar të sukseshme. Ata ose kanë degraduar, ose janë përdorur apo keqpërdorur për qëllime të tjera. Gjendja në këtë drejtim paraqitet mjaft e rënduar dhe perspektiva jo fort e qartë, gjë që duket e vështirë për t'u besuar, kur dihet se kjo zonë ka resurse të konsiderueshme ujore. Kështu, në territorin e saj gjenden 11 pusët arteziane të Dobraqit, me largësi 500-900 m nga brigjet e liqenit dhe me thellësi 40-60 m, të cilët furnizojnë qytetin e Shkodrës, dhe siç e thamë një pjesë të HPUSH.

Zgjidhja e problemit të furnizimit me ujë për banorët e kësaj zone, paraqitet e vështirë dhe komplekse, dhe kërkon investime serioze nga shteti dhe strukturat në nivel lokal. Gjithsesi, për përmirësimin e gjendjes në këtë drejtim të paktën në këndvështrimin afatshkurtër, do rekomandonim që:

- a) Fshati Dobraq dhe Golem të lidhen plotësisht me rrjetin e ujësjellësit të qytetit të Shkodrës, bashkë me zonat informale të tyre. Kjo gjë normalisht do rrisë presionin mbi këtë ujësjellës, pasi shton një numër jo të vogël popullsie, prandaj duhen realizuar investime që të bëjnë të mundur lidhjen dhe furnizimin efikas të kësaj popullsie me ujë dhe shtimin e kapacitetit të vetë ujësjellësit.
- b) Të investohet më tej në përmirësimin e ujësjellëve lokal që ekzistojnë në fshatin Zues dhe Hot i Ri, duke furnizuar të gjithë popullsinë me ujë të bollshëm dhe të vazhdueshëm
- c) Fshatrat e tjerë të komunës ka mundësi që të lidhen me rrjetin e ujësjellësit të Malësisë së Madhe; gjithashtu ekziston edhe një projekt për furnizimin e tyre me ujë nga burimet e Rrjollit; gjithsesi për këtë duhen investime dhe angazhim serioz i strukturave përkatëse, në nivele të ndryshme
- d) Mund të bëhen studime të tjera hidrogjeologjike, për të gjetur dhe shfrytëzuar burime të reja të ujit të pijshëm në territorin e HPUSH, sidomos në zonën pranë brigjeve të liqenit dhe në zhavorret aluvionale të fushës së Dobraqit dhe Golemit
- e) Vetë banorët e zonës, duhet të ndërgjegjësohen më shumë në lidhje me këtë problem jetik, ta ngrenë zërin aty ku duhet dhe njëkohësisht të kuptojnë se uji është një resurs bazë, të cilin për ta siguruar duhet shpenzuar; dhe kur sigurohet duhet paguar.

3. Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike

Mosfurnizimi i rregullt dhe cilësor me energji elektrike përbën një tjetër problem të rëndësishëm për banorët e HPUSH, gjatë këtyre 23 viteve të fundit. Një gjë e tillë ka ardhur si rezultat i ndryshimeve të ndodhura, rritjes së numrit të popullsisë, ndërhyrjes së paligjshme në rrjet, mungesës së investimeve nga strukturat përkatëse dhe mospagesës së energjisë së konsumuar nga vetë banorët e zonës. Për përmirësimin e gjendjes në këtë drejtim, rekomandohet:

- a) Shtimi i kabinave të reja elektrike dhe transformatorëve në çdo fshat, sipas nevojave përkatëse (gjendjes ekzistuese, numrit të popullsisë), gjë që është veçanërisht e nevojshme për zonat informale; si dhe kompletimi dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese
- b) Formalizimi i kabinave dhe transformatorëve privat, që janë ndërtuar në mënyrë joligjore dhe shkapëputja e ndërhyrjeve të paligjshme në rrjet
- c) Përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në HPUSH (zëvendësimi i shtyllave të dëmtuara dhe linjave elektrike ajrore, shtrirja e një rrjeti elektrik të plotë dhe me kablllo cilësore)
- d) Vendosja e matësve elektrik në të gjithë banesat familjare dhe subjektet private të HPUSH
- e) Pagimi i energjisë: banorët e zonës duhet të ndërgjegjësohen në këtë drejtim dhe të kuptojnë se energjia elektrike sa është një element i dosmosdoshëm dhe jetik për një jetesë normale, aq edhe është e kushtueshme dhe duhet paguar
- f) Lidhja dhe integrimi më i mirë i rrjetit elektrik të HPUSH me atë të qytetit të Shkodrës: edhe pse janë kaq pranë, investimet dhe cilësia e ofruar e këtij shërbimi mes tyre ndryshon rrënjësisht, duke bërë që banorët e zonës periurbane të ndihen të pakonsideruar nga strukturat shtetërore dhe të diskriminuar
- g) Ngritja e një nënstacioni të veçantë elektrik për HPUSH, ose dhe zonave të afërta me të, duke pasur parasysh popullsisë e konsiderueshme dhe mbingarkesën e rrjetit, mund të shihet si një opsion apo mundësi investimi në planin afatmesëm
- h) Futja në përdorim e formave alternative të energjisë; rekomandohet që të paktën uji i ngrohtë të sigurohet nga energjia diellore nëpërmjet paneleve, por për këtë duhet ndjekur një strategji afatgjatë

4. Rregullimi dhe përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza.

Edhe sistemi i kanalizimeve të ujrave të bardha ka degraduar rëndë gjatë 23 viteve të fundit në HPUSH, qoftë për shkak të ndryshimeve të gjithanshme të ndodhura, qoftë edhe si rezultat i mungesës së investimeve në këtë drejtim. Prandaj, rekomandohet:

- a) Realizimi i investimeve nga strukturat përkatëse qendrore në bashkëpunim me pushtetin lokal, për rikthimin e kapacitetit të

- dikurshëm ujitës nëpërmjet ujëmbajtësit të Shtodrit dhe hidrovorit pranë liqenit, në Dobraç
- b) Megjithë dëmtimin e konsiderueshëm të këtij rrjeti, duhet thënë që linjat kryesore të tij nuk janë prekur, dhe rrjeti i dikurshëm ekziston, por nuk është mirëmbajtur. Prandaj është e nevojshme që të realizohen investime për thellimin, zgjerimin dhe pastrimin e tyre, si dhe riveshja e tyre me pllaka betoni
 - c) Mirëmbajtja e rrjetit kullues dhe vaditës të rehabilituar duke përfshirë edhe fermerët, të cilët drejtpërdrejt janë të interesuar në këtë drejtim, për rritjen e prodhimeve të tyre bujqësore

Ndërkohë, në lidhje me *sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza*, duhet thënë se nuk ekziston një i tillë në HPUSH. E vetmja mënyrë që përdoret në këtë drejtim aktualisht, janë gropat septike individuale dhe familjare, të cilat shpesh herë gjenden edhe mjaft pranë puseve të ujit të pijshëm, duke kërcënuar ndotjen e tyre. Prandaj, në këtë drejtim mund të merren disa masa për përmirësimin e gjendjes, si më poshtë:

- a) Fshati i Dobraçit dhe mundësisht edhe ai i Golemit duhet të integrohen me sistemin publik të KUZ²¹⁷ Shkodër; kjo pasi këta fshatra kanë edhe popullsi dhe dendësi më të madhe dhe ndodhen afër qytetit
- b) Pas Dobraçit dhe Golemit, prioritet duhet të kenë fshatrat e tjerë të mëdhenj të komunës si Gruda e Re, Hoti i Ri dhe Shtoji i Ri: për ta dhe për fshatrat e tjerë të komunës rekomandohet ndërtimi i një sistemi bashkëkohor të gropave septike dhe përmirësimi i gjendjes së atyre ekzistuese
- c) Në të ardhmen mund të shihet edhe mundësia e krijimit të një apo disa lagunave natyrore të trajtimit të ujërave të ndotura në zona larg vendbanimeve dhe ku toka bujqësore ka cilësi të dobët (psh në perëndim të rrugës Shkodër – Han i Hotit, por jo shumë pranë brigjeve të liqenit); siç rekomandohet në planin rajonal Shkodër - Lezhë

5. Menaxhimi i mbetjeve urbane:

Siç e kemi thënë, si shumëkund tjetër në Shqipëri, edhe për HPUSH depozitimi vend e pa vend i mbetjeve urbane, mungesa e pastërtisë dhe menaxhimit të tyre, përbën një problem shumë serioz. Zonat më problematike gjenden përgjatë kanaleve të ujërave kulluese, në ish-fushën e aviacionit dhe sidomos pranë Urës së Bardhajve, mbi lumin Kir. Përmirësimi i gjendjes në këtë drejtim, kërkon marrjen e disa masave, ku do të rekomandonim:

- a) Organizimin e një aksioni nga strukturat lokale të qeverisjes, në bashkëpunim me strukturat qendrore dhe komunitetin, për pastrimin paraprak të territorit të zonës periurbane nga mbetjet e hedhura në “*hot spotet*” e mësipërme

²¹⁷ Kanalizimet e Ujërave të Zeza

- b) Hartimin e një plani të grumbullimit të mbetjeve për komunën në terësi dhe për çdo fshat në veçanti; sistemi i tanishëm është elementar dhe jo i plotë
- c) Trajtimin e mbetjeve urbane në mënyrë të integruar, duke bërë ndarjen e tyre në vend depozitime familjare, vendosjen e koshave dhe kazanëve për mbledhjen e tyre dhe përcaktimin e një vend depozitimi provizor të tyre
- d) Bashkëpunim me strukturat qendrore për depozitimin e mbetjeve në landfillin e Bushatit që është përcaktuar si vend depozitimi përfundimtar për zonën e Shkodrës, status që realisht dhe për fat të keq e ka zona pranë Urës së Bardhajve dhe pikat e tjera të HPUSH; duke e kthyer atë në “koshin e plehrave” të qytetit dhe zonave të tjera të përafërta

V.3.4. Zhvillimi social dhe mirëqeverisja

Zhvillimi social dhe mirëqeverisja përbëjnë një tjetër drejtim të rëndësishëm ku duhet përqendruar zhvillimi i qëndrueshëm i HPUSH në të ardhmen. Në këtë drejtim do të rekomandonim:

1. Përmirësimin e cilësisë së arsimit

Pavarësisht investimeve të kryera në këtë drejtim, ka akoma shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të arsimit në HPUSH. Në këtë drejtim do të rekomandonim:

- a) Ndërtimin e një shkolle të mesme për banorët e komunës, e cila siç e kemi theksuar mungon në këtë zonë me popullsi të konsiderueshme. Mund të shihet mundësia që ajo të këtë profil bujqësor pasi shkolla mekanike-bujqësore e dikurshme e qytetit të Shkodrës nuk është më funksionale dhe të rinjtë po e humbasin krejtësisht kontaktin me bujqësinë
- b) Zgjerimi i klasave dhe ambjenteve në shkollat që e kanë të nevojshme një gjë të tillë, si Dobraç dhe Golem, në mënyrë që mësimi të zhvillohet me një turn dhe në kushte normale; kjo duke pasur parasysh edhe shtimin e popullsisë në të ardhmen
- c) Ngritja e laboratorëve mësimorë për lëndët bazë si dhe lidhja me internet, tashmë që laboratorët e kompjuterave janë ngritur në shumicën e shkollave
- d) Krijimi i ambjenteve moderne sportive në të gjitha shkollat
- e) Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe theksimi i karakterit praktik të saj

2. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit shëndetsor

Prioritet i shërbimit shëndetsor në HPUSH duhet të jetë mirëfunksionimi i qëndrave shëndetësore të saponduarta në të gjithë fshatrat e komunës. Gjithashtu, për një rritje cilësore të tij, do rekomandonim:

- a) Përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së shërbimit
- b) Zgjerimin e stafit me personel të kualifikuar për të arritur standartet e duhura

3. Përmirësimi i jetës social- kulturore dhe sportive

Përmirësimi i sistemit arsimor dhe shëndetësor është i lidhur ngushtë me zhvillimin e jetës sociale, kulturore dhe sportive. Për këtë është e nevojshme ndërtimi i ambienteve kulturore, i qëndrave sportive, i ambienteve çlodhëse dhe parqeve, i këndeve të lojrave për fëmijë, ngritja e grupeve artistike si dhe organizimi i aktiviteteve sportive, kulturore dhe sociale në rang komune dhe më gjerë, një traditë që dikur ka ekzistuar. Kjo do ndihmonte edhe në shtimin e kontakteve sociale dhe forcimin e lidhjeve të zbehura vitet e fundit mes anëtarëve të komunitetit. Një gjë e tillë mund të realizohet edhe duke bashkëpunuar me OJF të profilizuara në këtë drejtim. Për më shumë në këtë drejtim, rekomandohet:

- a) Ndërtimi i një biblioteke në fshatin Dobraq, si fshati më i madh dhe më i urbanizuar i komunës
- b) Ngritja e një qendre kulturore dhe një grupi artistik për HPUSH
- c) Ndërtim qendrash sportive për të rinjtë me fondet e komunës në hapësirat publike në dispozicion
- d) Ndërtimi i këndeve të lojrave për fëmijë dhe ambienteve çlodhëse për pleqtë dhe banorët në përgjithësi

4. Mirëqeverisja

Qeverisja e mirë përbën një domosdoshmëri për realizimin e rekomandimeve të mësipërme dhe zhvillimin e qëndrueshëm të HPUSH. Në këtë drejtim ka shumë për të bërë, në mënyrë që impakti i qeverisjes lokale në komunitetin periurban të jetë pozitiv dhe cilësor. Prandaj, administrata dhe Këshilli i komunës “ Rrethinat” duhet të drejtohet nga principi i hapjes maksimale ndaj publikut. Administrata duhet të synojë që të inkurajojë pjesmarrjen e banorëve, grupeve të interesuara apo dhe të shoqatave në procesin e vendimmarrjes. Prioritet nuk duhet të jetë vetëm dhënia e informacionit të duhur komunitetit por edhe marrja e informacionit nga komuniteti në mënyrë që ta kthejë këtë informacion në faktor për një qeverisje të mirë. Rritja e transparencës, rritja e aftësive profesionale të administratës vendore, krijimi i kushteve optimale për punë, rritja e nivelit përfaqësues të të zgjedhurve lokal, forcimi i komunikimit mes pushtetit vendor dhe komunitetit, si dhe marrja e mendimit kritik të komunitetit për punën e komunës, janë të tjera synime për arritjen e qeverisjes së mirë.

Për më shumë në këtë drejtim do rekomandonim:

- a) Qeverisjen në mënyrë transparente dhe rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në të, gjë që mund të realizohet nëpërmjet publikimit të vendimeve të këshillit të komunës dhe administratës së saj, ngritjes së standave për informim, takimeve të shpeshta me banorët për të evidentuar dhe zgjidhur problemet që ata i shqetësojnë, hapjes së mbledhjeve të këshillit komunal dhe nxitjes së komunitetit, target grupeve dhe shoqatave për të marrë pjesë në vendimmarrje
- b) Zgjedhjen e një stafi të kualifikuar të administratës por edhe trajnimin dhe kualifikimin e atij ekzistues; duhet thënë se në këtë drejtim shumë e rëndësishme është mosndërhyrja e politikës dhe interesave klienteliste të saj
- c) Mirëmenaxhimin e buxhetit në dispozicion të HPUSH dhe taksave të mbledhura prej njësive tregtare dhe bizneseve të saj dhe shfrytëzimin më efikas të tyre, duke i orientuar shpenzimet dhe investimet në zërat dhe drejtimet më të nevojshme; shfrytëzimin e mundësive për investime edhe nga OJF-të, të cilat aktualisht mungojnë
- d) Binjakëzimin me komunat vendase dhe me komunat e huaja me tipare zhvillimi të ngjashme, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencave dhe përvojave në fushën e financës, shërbimeve publike, etj;
- e) *Rishikimin e ndarjes administrativo-territoriale*, duke pasur parasysh ndryshimet e ndodhura gjatë 24 viteve të fundit. Shihet qartë që fshati Zues nuk ka as lidhje organike, as territoriale, as funksionale dhe as kulturore me komunën Rrethinat; ndërkohë që edhe fshati Dobraq, sidomos në pjesën më të urbanizuar të tij, paraqet më shumë ngjashmëri me qytetin; ne mendojmë se të dy këta vendbanime duhet t'i bashkohen administrativisht bashkisë së Shkodrës. Madje në kuadrin e zonave funksionale, një gjë e tillë do ishte e përshtatshme dhe e rekomandueshme thuajse për të gjithë HPUSH, pasi nga gjithçka thamë më sipër, vihet re qartë lidhja e ngushtë dhe shumëdimensionale e saj me këtë bashki.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Bazuar në pyetjet kërkimore të hedhura në fillim të kësaj teme disertacioni dhe në rezultatet dhe gjetjet e saj pas trajtimit të çështjeve përkatëse, *nxivren këto përfundime dhe jepen këto sugjerime përmbyllëse:*

a) *Përfundime*

- HPUSH, të cilën ne e njësuaam që në fillim me komunën Rrethinat, paraqet mjaft karakteristika të një zone me tipare periurbane, dhe është formuar si e tillë pas vitit 1990, si rezultat i ndryshimeve social-ekonomike dhe politike që përfshinë vendin tonë, rajonin e Shkodrës dhe zonën në fjalë, gjatë kësaj periudhe.
- *Tiparet periurbane të saj vihen re në këto drejtime kryesore:*
 - a) *në aspektin demografik*, ku dallojmë: rritjen e numrit dhe dendësisë së popullsisë së saj (më shumë se dyfishim të tyre), rënien e ritmeve të shtimit natyror, ndryshimin e strukturës moshore dhe gjinore të popullsisë dhe mbizotërimin e prurjeve demografike në migrimin e brendshëm
 - b) *në aspektin e përdorimit të territorit*, ku përmendim: zgjerimin e konsiderueshëm të vendbanimeve, sidomos atyre informale; humbjen dhe copëzimin e tokës bujqësore dhe shtimin e larmisë së formave të përdorimit të tokës
 - c) *në aspektin mjedisor*; ku veçojmë: përdorimin e resurseve natyrore në mënyrë të paqëndrueshme dhe shtimin e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe problemeve mjedisore në terësi, rritjen e shkallës së erozionit dhe rikthimin e kërcënimit nga përmytjet, shpyllëzimin dhe shenja të shkretizimit të tokës bujqësore
 - d) *në aspektin ekonomik*, ku përmendim: zvogëlimin e rolit dhe rëndësisë së bujqësisë dhe ndryshimin strukturor të saj, zhvillimin e një bujqësie të tipit periurban, zhvillimin e industrisë së lehtë dhe asaj agrorshqimore; rritjen e konsiderueshme të sektorit të shërbimeve dhe rolin e rëndësishëm që luan sektori informal;
 - e) *në aspektin social*, ku vëmë re: copëtimin e familjes së madhe, zbehjen e marrëdhënieve sociale dhe lidhjeve fafëfisnore të dikurshme, përzierjen e popullsisë si rezultat i migrimit dhe krijimin e një lloji heterogjiniteti social, probleme me integrimin e popullsisë së ardhur dhe shtimin e tensioneve sociale dhe ndjesisë së përjashtimit, krijimin e tipareve kulturore të përziera ruralo-urbane dhe nevojën për identitet
 - f) *në aspektin social-ekonomik*, mund të përmendim; ndryshimin e strukturës së punësimit dhe nivel të lartë papunësie; vlera më të larta të varfërisë në raport me zonën urbane dhe numër të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike; diversifikimin e burimit të të ardhurave

- g) *në aspektin infrastrukturor*, ku dallojmë: probleme të konsiderueshme në furnizimin me ujë dhe energji elektrike, mangësi në infrastrukturën rrugore, arsimore dhe shëndetsore; mungesën e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe ujrave të zeza; mungesën e infrastrukturës sociale
- h) *në shkallën e lartë të dinamizmit* që e karakterizon zonën dhe në mungesën e vëmendjes ndaj saj nga stukturat politike dhe qeverisë; ku ajo nuk ka arritur ta përdorë dhe imponojë siç duhet rolin dhe potencialin e saj
- Në thelb të tipareve të mësipërme të zhvillimit dhe ndryshimit të HPUSH, qëndrojnë migrimi i brendshëm dhe rritja e popullsisë, ndryshimi i strukturës së pronësisë së tokës dhe urbanizimi; të cilat edhe këtu ndodhën relativisht shpejt dhe në mënyrë kaotike, duke i dhënë mundësi zhvillimit të informalitetit urban, ekonomik dhe demografik
 - Duke bërë një krahasim mes tipareve të zhvillimit të HPUSH me ato të HPU të Tiranës (të cilën e kemi trajtuar në kapitullin e parë), vëmë re ato paraqesin mjaft ngjashmëri në shumicën e karakteristikave të lartpërmendura; por dallojnë në faktin se intensiteti i shprehjes dhe dinamika e zhvillimit të tyre është e ndryshme, duke qenë më të theksuara në hapësirën periferike të kryeqytetit
 - Duke bërë një krahasim me HPU në botë, mund të themi se HPUSH, por edhe ajo e Tiranës, paraqesin tipare origjinale dhe një *lloj zhvillimi periurban hibrid*, duke zotëruar gjithsesi më shumë veçori të vendeve në zhvillim (informalitet, mungesë vëmendjeje, probleme infrastukture, marginalizim social, mungesë rregullimi); kjo sidomos në lidhje me atë që është në dorë të strukturave qeverisëse
 - Koncepti i suburbanizimit përëndimor nuk vlen shumë për rastin e tyre, megjithëse mund të themi se ka disa shenja fillestare të tij, kryesisht në pjesën juglindore të kryeqytetit; dhe më pak edhe në pjesën jugore të HPUSH, konkretisht në fshatin Zues
 - Si konkluzion përmbyllës mund të themi se HPUSH dhe në përgjithësi hapësirat periurbane në Shqipëri, janë zhvilluar kryesisht pas vitit 1990; ato në përgjithësi janë joformale dhe pa identitet të qartë administrativ dhe një ndër arsyt kryesore që pengon qeverisjen e mirë të tyre është pronësia e diskutueshme e tokës.

b) Sugjerime:

- Për zgjidhjen e problematikave të lartpërmendura të HPUSH dhe hapësirave periurbane të vendit tonë në tërësi, paraqitet si domosdoshmëri kryerja e procesit të legalizimit, zgjidhja e problemeve të pronësisë, riorganizimi administrativ i territorit, hartimi i planeve rregulluese dhe urbanizimi i zonave informale
- Këto hapësira mbeten pjesë organike e qyteteve përreth të cilëve gjenden dhe, në aspektin e planifikimit perspektiv, duhen parë si pjesë integrale e tyre dhe funksionale e tyre
- Hapësirat peri-urbane në Shqipëri mbeten pak të njohura, prandaj kontributi i gjeografëve në studimin e problemeve social-ekonomike, territoriale dhe mjedisore të tyre është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin dhe urbanizimin e qëndrueshëm të tyre në të ardhmen;
- Në këtë drejtim, shpresojmë që ky studim të shërbejë si një hap i parë dhe i hedhur mirë, që shtron rrugën për studime të tjera, pse jo më të thelluara dhe të plota, në lidhje me këto hapësira të reja dhe të veçanta gjeografike në vendin tonë, që meritojnë më shumë vëmendje nga studiuesit dhe strukturat vendimarrëse.

Burimet e shfrytëzuara

1. Adriana Allen; *Environmental planning and management of the peri-urban interface: perspectives on an emerging field*, Environment&Urbanization Vol 15, No 1, April 2003
2. Akademia e Shkencave - Instituti Hidrometeorologjik, *Klima e Shqipërisë*, Botimet Hidmet, Tiranë 1975
3. Akademia e Shkencave e RPSSH; *Fjalori enciklopedik* nr. 3, Tiranë 1985
4. AKPT (Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit): “*Manual teknik i planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Shqipëri*”, Tiranë 2011
5. Annette Piore et al; *Peri-urbanization in Europe: toward European policies to sustain urban-rural futures, a Synthesis Report*, University of Copenhagen 2011
6. Albert Sidney Hornby; *Oxford Dictionary for Advanced Learners*; Oxford University Press; 4th edition, May 1989
7. Artan Fuga, Zyhdi Dervishi; *Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global, trajtesë sociologjike*, Botimet Dudaj, Tiranë 2010
8. Banka Botërore; *Vlerësim i sektorit urban në Shqipëri*, World Bank Office, Tiranë 2007.
9. Banka Botërore; *Qeverisja në mbrojtjen e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në Shqipëri: sfidë e vazhdueshme*, botim II, Tiranë, prill 2012
10. Banka Botërore; *Shqipëria: zhvillimi urban, migrimi dhe ulja e varfërisë, një vlerësim mbi varfërinë*, Tiranë, qershor 2007
11. Banka Botërore; *Statusi i reformës së tokës dhe i tregut të pronave të paluajtshme në Shqipëri*; Tiranë 2006
12. Bashkia Tiranë; *Vlerësim strategjik dhe mjedisor i planit rregullues të Tiranës*, Tiranë 2012
13. Besnik Aliaj, et al: Tirana: *The Challenge of Urban Development*, CETIS, Tirana 2003
14. Cecilia Tacoli; *Rural-urban interactions: a guide to the literature*, Environment and Urbanization, Vol.10, nr. 1, April 1998
15. David L. Iaquina dhe Axel W. Drescher; *Defining the peri-urban: rural-urban linkages and institutional connections*; Land Reform 2000/2, FAO
16. Dorina Pojani; *From Squatter Settlement to Suburb: The Transformation of Bathore, Albania*; Housing Studies, Volume 28, Issue 6, 2013
17. Dorina Pojani; *Urbanization of post-communist Albania: economic, social and environmental challenges*; Debatte, vol. 17, nr. 1, April 2009
18. Dritan Rustja; *Intervista me personat kyç për çdo fshat*; shtator - nëntor 2013
19. Dritan Rustja; *Studimi i hapësirave periurbane – risi në kërkimet gjeografike shqiptare*; Studime Albanologjike nr.4, Tiranë 2012
20. Dritan Rustja; *Roli i gjeografisë në menaxhimin e transformimeve hapsinore-rasti i hapësirës periurbane të Shkodrës*, Buletini Gjeografik Kroat 73 (2), Zagreb 2011
21. Dritan Rustja; *Transformimi i hapësirës periurbane të Shkodrës pas v. 1990 – sfidat drejt zhvillimit*; Studime Albanologjike nr. 4, Tiranë 2009
22. Dritan Rustja; *Intervista të thelluara me popullsinë e ardhur në HPUSH pas vitit 1990*; Shkodër, nëntor 2013

23. DRASH; Të dhëna të marra në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, dega Shkodër – tetor 2013
24. DRBUSH; Të dhëna të marra në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit, Shkodër; gusht 2013
25. DRSHSHP; Të dhëna të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Shëndetsor Parësor – Shkodër, tetor 2013
26. DSHPSH; Të dhëna të marra nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor – Shkodër, shtator 2013
27. Douglas Webster; Larissa Muller; *Peri-urbanization: zones of rural urban transition*, Human settlement development -Vol.1, Encyclopedia of Life Support Systems 2002
28. EMA-PLAN; *Habitatet, flora dhe fauna e zonës së liqenit të Shkodrës*, Tiranë, dhjetor 2013
29. EMA-PLAN; *Studim social-ekonomik i zonës rreth liqenit të Shkodrës*; Tiranë, dhjetor 2013
30. Erka Çaro; *From the village to the city: Adjustment Process of Internal Migrants in Albania*, Dizertacion, Rijkuniversiteit, Groningen 2011
31. Edward A. Keller, Robert H. Blodgett; *Natural hazards: Earths's processes as hazards, disasters and catastrophes, 2nd edition*; Pearson Prentice Hall, NJ –USA, 2008
32. Eljaz Kraja; *Mësues në fshat në vitet '60 - kujtime dhe refleksione*, Rozafa 1, Shkodër 2005
33. Ermao Armao; *Vende, kisha, lumenj, male dhe toponime të ndryshme të një harte të lashtë të Shqipërisë Veriore*, Botimet Korbi, Tiranë 2006
34. Fiona Marshall, et al; *On the edge of Sustainability: Perspectives on Peri-urban Dynamics*, STEPS Working Paper 35, Brighton - STEPS Centre 2009
35. Frederick R. Stanier dhe Kent Bulter; *Standartet e projektimit urban dhe planifikimit*; Ufo Univesity Press, Tiranë, qershor 2010
36. FSHZH - Fondi Shqiptar i Zhvillimit, *Plani Rajonal Shkodër-Lezhë (2005-2020)*, Eptisa, Shkodër 2006
37. Fondacioni KEA; *Historia e bujqësisë dhe agroindustrializimit shqiptarë*; Tiranë 2003
38. German Adell; *Literature review: Theories and models of the peri-urban interface-a changing conceptual landscape*, DPU – University College London, UK
39. Gordon Clark; *Land-use conflict at the urban fringe*, në *Applied Geography; Principles and Practice* (ed. Pacione, M.), Routledge, London 1999
40. Gjovalin Gruda, *Ultësira e Shkodrës*, në *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, ASHRSH, Tiranë 1991
41. GTZ, “*Liqeni i Shkodrës - Koncept mbi zhvillimin ndërkufitar: një këndvështrim hapsinor*”, Podgoricë/Shkodër, Mars 2007
42. H. Felstehausen; *Urban growth and land use changes in Tirana: with cases describing land claims*”, Working Paper nr. 31 - Albanian Series, Land tenure Center, University of Wisconsin Madison, USA, 1999
43. HYDEA, “*Politika e zhvillimit të territorit – bashkia Shkodër*”, gusht 2010

44. Joe Ravetz, et al; *The dynamics of peri-urbanization*, në “*Peri-urban futures: scenarios and models for land use change in Europe*”, Springer-Verlag, Berlin Heidelberg 2013
45. Jorida Cila; *Making a Livelihood : a study of rural migrants in Bathore - Tirana*, Erasmus University, MSc Thesys, Rotterdam 2006
46. Haxhi Aliko dhe Romeo Sherko: *Rregullimi ligjor i vendbanimeve joformale në Shqipëri në Urbanistika në ekonominë e tregut*, ed. Kenneth K.Baar dhe Dorina Pojani, Dita 2000, Tiranë 2004
47. Ilir Gedeshi, Elira jorgoni; *Social Impact of Emmigration and Rural - Urban Migration in Central and Eastern Europe*, Final Country Report, Albania, European Commission April 2012
48. Ilir Nase, Mehmet Ocakci; *Urban Pattern Dichotomy in Tirana: Socio-spatial impact of liberalism*; European Planning Studies, 18:11
49. INSTAT; *Të dhënat paraprake të Censurit 2011*, Tiranë 2012
50. Injac Zamputi; *Rregjistri i kadastrës dhe konçesioneve për rrethin e Shkodrës*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Historisë, Tiranë 1977
51. Këshilli i Qarkut Shkodër; *Studimi i tregut të punës - Qarku Shkodër*, Shkodër 2013
52. Luan Deda; Sasha Tsenkova; *Poverty and inequality in Greater Tirana: the reality of peri-urban areas*, në “*The urban mosaic of post-socialist Europe: space, institutions and policy*” (ed. Tsenkova, S), Physica -Verlag, 2006
53. Marcela Mele; *Transition Stories: Politics of Urban Living Space in Tirana city Region-Albania*, Dizertacion, University of Hull 2010
54. Martin Schuler et al; *Typology of communes and definitions of agglomerations in Albania, në Socio-demographic statistics in Albania: selected topics and future developments*, INSTAT, Tiranë 2010
55. Mahir Hoti; *Veçoritë fiziko-gjeografike të fushës së Mbishkodrës*, Studime gjeografike nr. 4, Tiranë 1990
56. McGregor, D., Simon D. & Thompson D.; *The peri-urban interface: approaches to sustainable natural and human resource use*, London, Sterling V.A: Earthscan 2006
57. Mehdi Kroni; *Vështirësi dhe sfida të integritit të banorëve të ardhur pas vitit 1990 në qytetin e Shkodrës*; Lente sociologjike, Vëllimi I, nr. 1 – 2011
58. METE; *Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal;Draft Final*; Shtator 2007
59. Michael Buxton et al; *Change and continuity in peri-urban Australia: state of the peri-urban regions: a review of the literature*; RMIT University, Melbourne 2006
60. Michael Q. Patton; *Qualitative Research and Evaluation Methods, 3rd edition*, London - Sage Publications
61. Nicolas Clifford, et al; *Key Methods in Geography, 2nd edition*, SAGE 2010
62. NGJSH; *Të dhëna të marra nga Ndërrmarrja Gjeologjike Shkodër*: gusht 2011
63. NUFSSH; *Të dhëna të marra nga Ndërrmarrja e Ujësjellësit Fshat – Shkodër*: tetor 2013
64. Orjan Sjoberg; *Underurbanisation and the zero growth hypothesis: diverted migration in Albania*; Geografiska Annaler, Series B, Human Geography, Vol. 74, No. 1 (1992)

65. PADCO; *Strategic plan for Greater Tirana –vol.I*; Urban Land Management Project, Washington 2002
66. Perikli Qiriaz; *Gjeografia fizike e Shqipërisë*, Tiranë 2001
67. Përparime Huta; *Fshati në sanxhakun e Shkodrës në shekujt XV-XVI*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 1990
68. Philip R. Berke et al.; *“Urban Land Use Planning, 5th edition”*, University of Illinois Press Urbana and Chicago, 2006
69. Raport i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave; Shkodër më 21.01.2010
70. Riley Smith; *Peri-urbanization: what is it and why is it happening*, aksesuar në faqen: <http://www.celsias.co.nz/article/peri-urbanization:what-is-it-and-why-it-happening>, më 04.11.2012
71. Robert K. Yin; *Case Study Research: Design and Methods 3rd Edition*; SAGE, CA 2002
72. *Rregjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i v. 1945* (Lokaliteti i Qendrës); Të dhëna të marra në Arkivën Shkodër, tetor 2012
73. *Rregjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i v. 1989*; INSTAT Shkodër, tetor 2013
74. RPSSH - Komiteti Ekzekutiv i rrethit Shkodër; *Vjetari Statistikor i v. 1986*, Shkodër 1986
75. Sabri Laçi, Selman Sheme; *Shkaqet dhe pasojat e lëvizjes hapsinore të popullsisë në rrethet Shkodër dhe Malësi e Madhe gjatë periudhës 1990-1995*; Seminari ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër 1995
76. Sabri Laçi; *Gjeografia Rurale*, PROGRES, Tiranë 2005
77. Sabri Laçi, Dritan Rustja, Esmeralda Laçi; *Diversified economic activities – the basis for sustainable development of rural settlements in Shkodra lakeshore (case study – Zogaj village)*; Liqeni i Shkodrës – gjendja dhe perspektivat II, 2011
78. Sabri Laçi; *Përdorimi i hapësirës dhe rregullimi i territorit në rrethin e Kurbinit 1945-2009*; Studime Albanologjike 4, 2009/4
79. Selami Pulaha; *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e RP. të Shqipërisë, Tiranë 1974
80. Sasha Tsenkova; *Urban Planning and Informal Cities in South-East Europe*, Journal of Architectural and Planning Research, 29:4, 2012
81. Selman Sheme, Sabri Laçi; *Konsiderata për dilemën e zhvillimit të qëndrueshëm në rajonin e Shkodrës*; Seminari ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, 2002
82. Social Summit; Report of the World Summit for Social Development – World Conference for Social Development, Copenhagen 1995
83. Sonia Hirt; *Suburbanizing Sofia, characteristics of post-socialist peri-urban change*, Urban Geography 2007, 28, 8
84. Shqyqyri Aliaj, etj.; *Sizmiteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri*, ASHSH, Tiranë 2010
85. Teki Selenica; *Shqipëria në v. 1927*, Tiranë 1928
86. World Commission on Environment and Development, *Our common Future*, Oxford University Press, Oxford 1987
87. United Nations Population Fund; *State of the world population report: unleashing the potential of urban growth*, New York 2007

88. University of Nottingham & University of Liverpool ; *Literature review on Peri-urban Natural Resource Conceptualization and Management Approaches*, Final Technical Report, Natural Resource Systems Programme, 1999
89. UNDP; *Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri*, Raport përmbledhës, Tiranë 2003
90. UNDP; *Local vulnerability and capacity assessment in Albania*, Study Report, Tiranë 2004
91. UN-HABITAT; *Informal Urban Development in Europe – Experiences from Albania and Greece*; Technical Chamber of Greece 2010
92. Zyhdi Dervishi; *Urbanizimi i jetës së popullsisë fshatare apo ruralizim i qyteteve? Rasti i Tiranës*, Politika dhe shoqëria 2001, 1 (8)
93. ZAKRR; Të dhëna të marra në Zyrën e të Ardhurave të komunës Rrethinat, Shkodër - tetor 2013
94. ZGJCKRR; Të dhëna të marra nga Zyra e Gjendjes Civile e komunës Rrethinat, Shkodër - shtator 2013
95. ZNEKRR; Të dhëna të marra në Zyrën e Ndhmës Ekonomike të komunës Rrethinat, shtator 2013
96. ZSSH; Të dhëna të marra në Zyrën e Statistikave të INSTAT, Shkodër, korrik 2013
97. ZSDRASH; Të dhëna të marra nga Zyra e Statistikave të Drejtorisë Rajonale Arsimore - Shkodër; tetor 2013
98. ZUKRR; Të dhëna të marra në Zyrën e Urbanistikës të komunës Rrethinat, qershor 2013
99. ZZHQSH; Të dhëna të marra në Zyrën e Zhvillimit të qarkut Shkodër, shtator 2013

SHTOJCA

Shtojca 1. Intervista me personat kyç për çdo fshat

Kjo intervistë realizohet për qëllime studimore, në kuadër të doktoraturës “Hapësira periurbane e Shkodrës: përdorimi i territorit dhe veçoritë e zhvillimit social-ekonomik”, të autorit Dritan Rustja, pedagog i Departamentit të Gjeografisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Përgjigjet e saj do përdoren vetëm për realizimin e synimeve të kësaj teze doktrature, dhe përgjigjet apo edhe personat e intervistuar (nëse kërkohet), do jenë konfidenciale duke mos cënuar privacinë tuaj.

Ju faleminderit parapraakisht

Fshati:

Emri Mbiemri:

Data:

1. Cila është origjina e banorëve të këtij fshati? Kur është krijuar ai si vendbanim?
2. A ka ndonjë moment të veçantë në historinë e këtij vendbanimi apo ndonjë personalitet të shquar që ia vlen të përmendet?
3. Cilat janë disa nga karakteristikat kryesore të vendbanimit tuaj sot (popullsia, sipërfaqja, zhvillimi ekonomik, etj)?
4. Sa ka ndryshuar ky vendbanim gjatë 20 viteve të fundit, me aq sa ju jeni në dijeni, dhe në ç’drejtime kryesore ka ndryshuar?
5. Cilët janë disa nga problemet kryesore me të cilat përballet vendbanimi juaj në ditët tona?
6. Si paraqiten marrëdhëniet në komunitet, pra ato mes banorëve? Nëse ka probleme apo ndonje lloj konflikti social, cilat janë arsyet sipas mendimit tuaj?
7. Si paraqitet gjendja ekonomike e zonës, cilët janë burimet kryesore të të ardhurave për banorët e këtij fshati?
8. Cilat janë nevojat kryesore që ka ai sot (prioritetet) që duhen zgjidhur?
9. Çfarë investimesh kryesore janë realizuar për të përmirësuar gjendjen ekistuese të vendbanimit dhe për t’i zgjidhur këto probleme? Cili është kontributi i qeverisjes lokale në këtë drejtim?
10. Sipas mendimit tuaj, në ç’drejtime kryesore duhet përqendruar zhvillimi perspektiv i vendbanimit tuaj, bazuar tek resurset që ai ka?
11. Ka diçka tjetër që dëshironi të shtoni, ju lutem?

Shtojca 2. Intervista me personat kyç të pushtetit lokal

Kjo intervistë realizohet për qëllime studimore, në kuadër të doktoraturës “Hapësira periurbane e Shkodrës: përdorimi i territorit dhe veçoritë e zhvillimit social-ekonomik”, të autorit Dritan Rustja, pedagog i Departamentit të Gjeografisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Përgjigjet e saj do përdoren vetëm për realizimin e synimeve të kësaj teze doktrature, dhe përgjigjet apo edhe personat e intervistuar (nëse kërkohet), do jenë konfidenciale duke mos cënuar privacinë tuaj.

Ju faleminderit parapraakisht

2.1. Intervista me kryetarin aktual të komunës:

1. Cilat janë disa nga karakteristikat kryesore të komunës “Rrethinat” (sipërfaqja, numri i popullsisë, tiparet e zhvillimit, etj), në këndvështrimin tuaj?
2. Sa ka ndryshuar kjo komunë gjatë 20 viteve të fundit, me aq sa ju jeni në dijeni, dhe në ç’drejtime kryesore ka ndryshuar?
3. Cilët janë disa nga problemet kryesore me të cilat përballet komuna, në ditët tona?
4. Si paraqitet gjendja e mjedisit, ç’farë problemesh kryesore mund të evidentoni në këtë drejtim?
5. Si paraqiten marrëdhëniet në komunitet (brenda të njëjtit vendbanim, mes vendbanimeve të ndryshme, mes popullsisë më të hershme dhe asaj të ardhur)? Nëse ka probleme apo ndonje lloj konflikti social, cilat janë arsyet sipas mendimit tuaj?
6. Si paraqitet gjendja ekonomike e zonës, cilët janë burimet kryesore të të ardhurave për banorët e komunës?
7. Cilat janë nevojat kryesore që ka komuna sot (prioritetet) që duhen zgjidhur?
8. Çfarë investimesh kryesore janë realizuar për të përmirësuar gjendjen ekistuese të komunës, dhe për t’i zgjidhur këto probleme?
9. Si paraqitet marrëdhëniet mes qeverisjes lokale të komunës dhe qeverisjes qendrore? A mendoni se kjo zonë ka marrë vëmendjen e duhur nga institucionet përkatëse? Nëse jo, pse?
10. Sipas mendimit tuaj, në ç’drejtime kryesore duhet përqendruar zhvillimi perspektiv i komunës, bazuar tek resurset që ajo ka?
11. Ka diçka tjetër që dëshironi të shtoni, ju lutem?

2.2. Intervista me specialistin e zyrës së kadastrës

1. Sa është sipërfaqja e komunës dhe cilët janë kufinj të saktë të saj? Po sipërfaqja dhe kufinj sipas fshatrave?
2. A ka probleme (apo mbivendosje) të kufinjve të komunës me njësitë vendore fqinje; a janë të përcaktuar saktë ata?
3. A ka harta përkatëse në lidhje me këtë?
4. Si ka ecur procesi i shpërndarjes së tokës në fshatrat e komunës? A ka pasur probleme në këtë drejtim? Mbi ç’bazë ligjore është kryer ai?
5. Si paraqitet cilësia e tokës në komunë sipas fshatrave, dhe sa është ajo e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë?
6. A dëshironi të shtoni diçka tjetër, ju lutem?

2.3. Intervistë me urbanistin e komunës

1. Si paraqitet gjendja aktuale e zhvillimit urban në komunë (informaliteti, ndërtime, etj)? Sa ka ndryshuar ajo gjatë këtyre viteve dhe pse?
2. Si ka ecur procesi i legalizimit të vendbanimeve informale në komunë? Çfarë bashkëpunimi ka me ALUIZNIN?
3. Cilët janë problemet kryesore urbane të zonës, si përdoret territori dhe cila është tendenca e zhvillimit në këtë drejtim?

4. Cilat janë nevojat kryesore urbane të zonës, ç'po bëhet në lidhje me përdorimin e territorit dhe rregullimin e tij?
5. A dëshironi të shtoni diçka tjetër, ju lutem?

2.4. Intervistë me specialistin e Zyrës së Gjendjes Civile

1. Si ka evoluar numri i popullsisë në komunë gjatë 20 viteve të fundit, cilat janë zhvillimet kryesore në këtë drejtim?
2. Sa është numri zyrtar i popullsisë në komunë? Si mund të shpjegohen mospërputhjet mes të dhënave të ZGJC të komunës me të dhënat e Censurit 2011 dhe realitetin?
3. A janë ndjekur rregullisht procedurat e regjistrimit të popullsisë sipas kriterëve përkatëse?
4. A mund të ketë banorë të parregjistruar në komunë? Nëse po, pse?
5. Si paraqitet tendenca e zhvillimit të popullsisë në këtë komunë sipas jush në të ardhmen (rritje, ulje, etj)?
6. A dëshironi të shtoni diçka tjetër, ju lutem?

Shtojca 3. Intervistat e thelluara me popullsinë e ardhur pas vitit 1990 në komunë

Kjo intervistë realizohet për qëllime studimore, në kuadër të doktoraturës “Hapësira periurbane e Shkodrës: përdorimi i territorit dhe veçoritë e zhvillimit social-ekonomik”, të autorit Dritan Rustja, pedagog i Departamentit të Gjeografisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Përgjigjet e saj do përdoren vetëm për realizimin e synimeve të kësaj teze doktrature, dhe përgjigjet apo edhe personat e intervistuar (nëse kërkohet), do jenë konfidenciale duke mos cënuar privacinë tuaj.

Ju faleminderit paraprakisht

Të dhënat bazë të personit të intervistuar:

Mosha: _____
Gjendja civile: _____
Punësimi: _____
Arsimimi: _____
Vendbanimi aktual: _____
Vendbanimi më i hershëm: _____

Pyetjet:

1. Cila ishte gjendja social-ekonomike e familjes suaj para se të vendosnit për të emigruar?
2. Cilat ishin shkaqet që ju çuan në vendimin për të emigruar bashkë me familjen tuaj?
3. Pse zgjodhët vendbanimin tuaj aktual dhe komunën Rrethinat për t'u vendosur dhe jetuar aty?
4. Si e keni gjetur truallin (tokën) ku keni ndërtuar shtëpinë tuaj?
5. A ka banorë të tjerë nga zona ku banonit më përpara që jetojnë tashmë pranë jush ose në territorin e komunës Rrethinat?

6. Si paraqitet niveli i jetesës së familjes suaj aktualisht: a jeni të kënaqur për vendimin që morët për të ardhur këtu?
7. Cilat janë burimet kryesore të të ardhurave të familjes suaj (me se e nxirrni jetesën)?
8. Cilat janë marrëdhëniet që keni me fqinjët (banorët më të hershëm por edhe ata që kanë ardhur pas viteve '90)?
9. A keni gjetur ndonjë lloj mbështetje (ekonomike apo morale) nga ana e strukturave të organeve qeverisëse gjatë këtyre viteve?
10. Sa e ndjeni ju veten pjesëtar të komunës Rrethinat dhe si e shihni të ardhmen tuaj si banorë të saj?

Përmbledhje

Kjo temë disertacioni ka marrë në shqyrtim hapësirën periurbane të Shkodrës dhe përbën studimin e parë në lidhje me të dhe vetë hapësirat periurbane të vendit tonë, në këndvështrimin geografik. Hapësirat periurbane konsiderohen si zona kalimtare ndërmjet hapësirave urbane dhe atyre rurale, duke zotëruar për pasojë tipare të të dyjave, por duke pasur njëkohësisht edhe karakteristikat e tyre origjinale.

Në këtë studim, hapësirën periurbane të Shkodrës e kemi njësuar me komunën “Rrethinat”, duke marrë parasysh afërsinë e saj me qytetin e Shkodrës, përcaktimin zyrtar të saj si njësi administrative rurale dhe shkallën e lartë të ndryshimeve të përjetura nga ajo gjatë 23 viteve të fundit.

Nga analizimi i të dhënave sipas tematikave përkatëse, rezulton se HPUSH është formuar pas vitit 1990 dhe paraqet mjaft karakteristika të zhvillimit të zonave periurbane, si: rritje të konsiderueshme të numrit dhe dendësisë së popullsisë; zgjerim të vendbanimeve, sidomos atyre informale dhe copëzim të tokës bujqësore, theksim të problemeve mjedisore dhe përdorim të paqëndrueshëm të resurseve; diversifikim të veprimtarive ekonomike; heterogjinitet social; vlera të larta të papunësisë dhe varfërisë, probleme të ndryshme infrastrukturore dhe një shkallë të lartë dinamizmi.

Në fund të kësaj teme disertacioni arrihet në përfundimin se HPUSH dhe hapësirat periurbane të vendit tonë në përgjithësi, paraqesin tipare origjinale zhvillimi, duke zotëruar gjithsesi më shumë karakteristika të vendeve në zhvillim. Ndërsa koncepti i suburbanizimit perëndimor nuk vlen shumë për to, ose mund të thuhet se ka vetëm disa shenja të vonshme dhe fillestare të krijimit të tyre.

Këto hapësira mbeten pak të njohura dhe të studiara, dhe në këtë drejtim geografët patjetër që mund të kontribuojnë më shumë, për të analizuar dhe kuptuar larminë e problemeve të tyre mjedisore dhe social-ekonomike, dhe për të dhënë alternativa dhe rekomandime konkrete mbi zhvillimin perspektiv të tyre.

Fjalët kyçe: hapësira periurbane e Shkodrës, periurbanizim, migrim i brendshëm, zhvillim informal, rregullim territori

Summary

This dissertation has taken into consideration the peri-urban area of Shkodra city and constitutes the first study about this area and the peri-urban areas in our country in general, from a geographical point of view. Peri-urban areas are considered as transitional zones between urban and rural areas, possessing as a result features of both of them, while still holding their own originality.

In this study, the peri-urban area of Shkodra city has been identified with “Rrethinat” commune, based on its proximity to the city of Shkodra, its official definition as a rural administrative unit and due to the high rate of change it has experienced during the last 23 years.

By analyzing the data in disposition, it results that the peri-urban area of Shkodra city has been created mainly after 1990 and presents many development patterns of a peri-urban area, such as: the significant increase in the number and density of population; the expansion of settlements, especially informal ones and the fragmentation of agricultural land; highlighted environmental problems and unsustainable use of resources; diversification of economic activities; social heterogeneity; high rate of unemployment and poverty, various infrastructural problems and a high degree of dynamism.

At the end of this dissertation it can be said that the periurban area of Shkodra city and the peri-urban areas of our country in general, represent original patterns of development, possessing however more characteristics from the developing countries. Meanwhile, the concept of western suburbanisation does not apply to their case, or it can be said that there are only some initial and recent signs of their creation and development.

These areas remain little known and studied, and in this regard the geographers for sure can contribute much more in analyzing and understanding their environmental problems and socio-economic conditions, and in giving concrete alternatives and recommendations for their future development.

Keywords: peri-urban area of Shkodra city, peri-urbanization, internal migration, informal development, land use planning